


BIBLIOTEKA

034-31

285

Preç Zogaj
PA HISTORI

ROMAN



28

84431

285

PREÇ ZOGAJ

PA HISTORI

- Roman -



SHTËPIA BOTUESE «FAN NOLI»

Tiranë, 1993

tuar femrat nga pika të fshehta, nuk kishte parë gjë, ose kishte parë dhe nuk i bënte zemra të tregonte. Por kjo nuk e kishte penguar Adrianin t'i ndiqte me sytë e mendjes dy napoletanët, që në fakt ishin fitologë, duke i shkuar kësisoj gjer në fund asaj që mbase nuk kishte ndodhur, me siguri nuk kishte ndodhur, por që mund të ndodhte dhe, tekembramja duhej të ndodhte, s'ishte ndonjë çudi që të ndodhte. Kështu ishte ai. Fantazia i merrte hov sidomos në pikën, sipas tij të devijuar të ngjarjeve dhe prej aty u ndërtonte atyre një vazhdim tjetër, vazhdimin e natyrshëm dhe finalen e vërtetë, atë që josh, atë që ka shije, por që tremb, sepse nuk u përket individëve, por duhet t'u përkasë të gjithëve dhe brenda këtij morali lartësohet muri që ndërpret vijën e ndodhive.

Adriani largoi çarçafin me këmbë, drita i vrau sytë. Instinktivisht çoi dorën t'i fërkonte. Në mollëzat e gishtave ndieu lagështinë e djersës. Ai i vështroi me çudi sikur shihte gjak. Bënte vapë në dhomë dhe, për më tej, drita e shumtë që hynte nga dritaret, i kallëzonte një për një të gjitha njollat e vrimat në murë. Ai u kthye përmbys, dhe përsëri iu përhi Liljana, lakuriq, duke dalë nga uji, duke ikur me vrap midis kallamishtes... Atëhere kishte qenë muaji gusht. Nuk donte të mendonte për këtë! Veçanërisht për këtë nuk donte të mendonte, më saktë të fantazonte, sepse Liljana s'kishte bërë gjë me napoletanin, por kishin ardhur kohë të çuditshme edhe në Barbullajë, kur shumë gjëra bëjnë jetë të dyfishtë: një reale të ndrydhur dhe një tjetër imagjinare, të shpenguar. Këto dy jetë brenda një jete, ëmbëlsojnë dhe hidhërojnë njëra-tjetrën, largohen dhe tërhiqen, dhe rezultatja e këtij bashkëveprimi rëndom është një gjendje gati pezullore, të cilën e përforcon edhe moti i pandërrueshëm i tetorit që hyri dhe po del pa një rigë shi, pa një fill erë.

Gjethet në pemë, palosur njëra mbi tjetrën si luspa, rreziten të përgjumura nën diellin e qartë të jugut.

Ngjyra e tyre ndryshon ngadalë për kah e verdha apo e kuqja e fortë. Po të mos jetë ky ndryshim i ngjyrës që kapet me sy, fare mirë mund të mendohet se në tokën e Barbullajës mbillen pemë butaforike.

Prej disa ditësh sipas kalendarit meteorologjik duhej të kishte shpërthyer era. Por duket se Eoli i tërbuar i Grykës në veriperëndim ka vdekur. Veçanërisht pasditet nderen në një limonti ndjellakeqe. Pleqtë e pastër me gjyslykë miopësh të kapur pas kokës me spango, llastikë, fitila e lloj-lloj lidhësesh dalin në pragjet e shtëpive dhe shkëmbejnë më të rrallë ndonjë fjalë pa e kthyer kokën nga njëri-tjetri. Mësuesi i historisë, Dodë Balsha, i vetëquajtur pinjoll i Balshajve të lavdishëm të Arbërisë së vjetër, një tip që ka se çfarë të thotë për të gjitha temat, shkon e vjen i shqetësuar andej-këndej duke porositur fshatarët të forcojnë tjegullat e çative. rezet e dritareve dhe kashtën e kasolleve sepse, sipas tij, vjeshta e tretë do të çelet me një uragan të paparë. Doda ka veshur para gjithë të tjerëve pardesynë e gjatë ngjyrë blu. Teksa dredhon nëpër rrugicat e panumërta të fshatit, gjithë i alarmuar si një profet mes të paditurve, kindat e pardesysë i përplasen furishëm pas këmbëve. Të duket se era i është fshehur diku nën rroba dhe do të shpërthejë nga çasti në çast.

Njerëzit shkrihen së qeshuri e gjethet e hurmave vazhdojnë të skuqen si prushi, gjethet e plepave zverdhen si flaka e drurit të pishës, bari ende i blertë tkurret, shkurtohet. Duket se çdo gjë në natyrë ndodh jashtë kohës, por vendësit e dinë: bukuria e rrallë e pemëve do të kalojë bashkë me vjeshtën, se çdo gjë që lind do të vdesë, çdo gjë që fillon do të mbarojë, se i përjetshëm është këmbimi i stinëve, i gjetheve, por jo stinët dhe gjethet.

Atëhere ishte gusht... Ato ditë Liljana kishte pasur një periudhë të vrullshme mësimi të italishtes, por ai s'kishte dashur ta pyeste dhe në fakt nuk e kishte

pyetur përse po mësonte italisht, gjersa një mbrëmje ajo i tregoi vetë diçka për napoletanët e sjellshëm, njëri prej të cilëve i kishte premtuar një metodë për mësimin e gjuhës. Ashtu? Po Desaretit çfarë i premtoi? Ai që penduar menjëherë për këtë pyetje, dhe kishte pritur me qetësi qortimet e saj, por çuditërisht në sytë e Liljanës kishte filluar të ndizej një dritë e rrezikshme përkëdhelëse, joshëse, ftuese, më në fund klithëse që forcohej njëkohshëm me ngritjen e gjoksit. Përse s'më puth kurrë? — kishte thënë ajo me një fije zë dhe fytyra i qe prishur sikur do të qante. Përse s'më puth kurrë? — kishte përsëritur pastaj me zë më të fortë, teksa përdridhte midis gishtave një fije bari, duke vështruar me habi grumbullin e kodrinave sipër fshatit që thithinin si sfungjer ngjyrën e muzgut. A nuk mundësh, a? Ku é di ti se nuk mundem? Oh, sa seriozisht i merr gjërat, ia pat kthyer ajo si me të qeshur dhe fjalët i patën dalë prej shpirtit dhe ai, i tronditur ngaqë Liljana kishte goditur në shenjë, e kishte ndier me të gjitha shqisat se vërejtja e saj nuk kishte lidhje me atë mbrëmje dhe as me hijen e napoletanit, por me krejt qëndrimin e tij ndaj dashurisë e ndaj saj, sikur nuk dinte ku ta çonte, sikur nuk dinte ç'të bënte me të, sikur nuk shihte diçka tjetër përtej puthjeve dhe prandaj ngurronte t'i jepte dhe t'i kërkonte ato, sepse në kokë i rrihte si çekan pyetja: E pastaj? E pastaj? E pastaj?

«Kur erdhën ata, ne ishim veshur, pra, nuk ishim ashtu siç ta ka përshkruar ai agjenti yt», pat vazhduar ajo duke bërë një grimasë tallëse sikur thoshte «ne ishim shëmtuar atë çast».

«Unë nuk kam agjent. Desareti e tha për të më defryer», ai ishte përpjekur të nënqeshte, por fytyra e prishur e kishte tradhtuar dhe ajo sakaq ia kishte plasur vajit. Kishte qenë e qetë, e qetë fare deri në çastin e pakapshëm kur e ndryshuan të qarat; më e qetë se cipa e ujërave të liqenit në një mëngjes vere, kur ja, papritur e pakujtuar, cipa prej qelqi kishte krisur dhe

nëpër të çarat e plasaritjet kishin buisur çurga e fluska lotësh. Adrianit i qe mekur fryma nga habia dhe dëshpërimi; kurrë nuk e kishte parë Liljanën duke qarë me dënasa dhe atëherë i kishte hedhur njëren dorë në qafë, duke ia shpleksur fije-fije flokët e dendur me dorën tjetër. E kishte afruar nga vetja, ia kishte zbuluar fytyrën e përlotur dhe i kishte thënë «më shiko». Ajo kishte ngritur vetëm një çast qepallat me qerpikët e lagur, sa për të kallëzuar vezullimin refuzues të syve dhe kur ai kishte filluar t'i puthte flokët, duke i rrëshqitur buzët ngadalë drejt fytyrës së vajzës, ajo qe shkëputur nga krahët e tij, qe ulur mbi një gur të rënë nga muri rrethues i varrezave dhe pat qarë përsëri. Ai e pat pritur në këmbë gjersa qe errur krejt. Liljana kishte pushuar së qari dhe Adrianit i kishte mbetur në mendje trupi i saj i kruspullosur nën dengun e flokëve. Dukej sikur flinte.

«Ngrehu të ikim», i tha. «Të ikim! Ku?» pyeti ajo. «Në shtëpi, ku tjetër», ia ktheu ai, ndërsa përtueshëm, si për inerci të një zakoni pat përshpëritur pa zë: Te njëri-tjetri! Gjithmonë te njëri-tjetri. Këto fjalë të menduara kalimthi, bashkë me muzgun dhe heshtjen pa fund të fushave, shtëpive, varrezave dhe plepave, sikur e kishin kapur në grackë. Te njëri-tjetri! Gjithmonë te njëri-tjetri! Ç'do të thotë kjo? O zot, sa të vetmuar që jemi! Dhe rishtas i ishte dukur mëkat e puthura pa vazhdim dhe i kishte ardhur turp që kishte dashur ta puthte atë pak më parë... Po përse nuk desh i ajo? Ajo që disa herë ka dashur, madje më ka qortuar mua...? Përshtypja se Liljana kishte bërë diçka me atë napoletanin e sjellshëm, se në mos kishte bërë, kishte pësuar diçka prej tij, i pat rekëtitirë përbrenda si një fluturzë, e mbështjellë me membrana që kërkon të ngjallet. Në hutim e sipër, për të mos thënë në dashje e sipër — jo, jo në dashje e sipër, kurrën e kurrës në dashje e sipër, —, në hutim e sipër pra, ajo e kishte pranuar pësimin dhe pastaj më vonë, kur

gjithçka kishte marrë fund, ajo ishte kthjelluar për atë që kishte ndodhur dhe nuk ishte më e qetë. Se ishte e pamundur që ai, si çdo burrë tjetër, megjithë mirësjelljen e tmerrshme, të mos e kishte ëndërruar Liljanën, çka më tepër kur e kishte parë të zhveshur, Evë të përkryer, pa rrobat e rëndomta që ia pakësonin bukurinë.

Dikë, nga muri i varrezave që rrokullisur një gur. Këshedi qysh kur prët të rrokulliset, pat menduar ai, e këshedi sa do të presë për t'u rrokullisur prapë se është në mur i gjori. Ndërkohë Liljana që ngritur në këmbë dhe e priste të niseshin.

— Unë dua të të tregoj, — i pat thënë ajo gjatë rrugës, — por s'di përse nganjëherë ndiej një pengim. Dhe pengesa je ti, Adri. Më duket sikur nuk më dëgjon, sikur nuk të pëlqen të dish gjë për mua... dhe... kupton?

— Oh! Ke gjë për të thënë ti?

— Si nuk kam! Si kujton se nuk kam gjë për të thënë?

— Ëndrra me sy hapur e me sy mbyllur shohim plot në Barbullojë.

— Ti i pari.

— Unë jam 26 vjeç tani. Nuk më pëlqen t'i them ëndrrat.

— Sa serioz je!

— Ma ke thënë një herë.

— Serioz dhe i zymtë.

— Dhe i pasjellshëm!

— I pasjellshëm! Nuk më dukesh i pasjellshëm!

— Mirësjellja s'ka fund... Apo jo?

— Ç'do të thuash më këtë?

Duke ndier ndërkaq përgjalljen e asaj fluturzës së dyshimit, ai e kishte pyetur pa e kthyer kokën:

— Përse qave qeparë? Përse s'më le të të puth? Përse qave? Trego, folë, kallëzo! Ti ke gjëra për të thënë. Vetë the se ke gjëra për të thënë. Ja, unë jam gati të të dëgjoj, kam qejf të të dëgjoj, kam shumë dëshirë të di... dëmtë të çfarë të bëri ai... Aldoja?

Mezi e pat shqiptuar këtë emër, si ta kishte bërë petë në darën e dhëmbëve dhe pastaj pat shpejtuar hapat dhe ajo gjithashtu pat shpejtuar hapat dhe patën ecur ashtu me nxitim, pa folur, duke përplasur pa kujdes këpucët në pluhurin e rrugës.

— Hë, pra, përgjigju!

— Ndalo pak! S'kam si flas!

— Dëgjoj unë...

— Ai s'më bëri asgjë. Asgjë s'më bëri!

— Ah, si flet! Të erdhi keq.

Ajo e pat zënë përkrahu, i qe varur në sup dhe i pat folur në vesh:

— Po, Adi. Të them të vërtetën, kisha dëshirë të më përkëdhelte njëherë!

Ai qe sprapsur me habi, ndërsa ajo kishte mbetur disa sekonda në majë të këmbë, me krahët e hapur pafajësisht sikur do të fluturonte.

— A t'i pa sytë? — e pat pyetur ai me inat.

— Po, m'i pa.

— Përse nuk të përkëdheli, pra?

— Ku di unë. Ndofta nuk donte të më përkëdhelte.

— Si nuk paska dashur? — pat bërëtitur ai. — Dhe pastaj: — Ishte Donika aty, prandaj nuk të përkëdheli.

— Nuk besoj se e la për këtë. Donika ishte larg. Po shtrydhte bluzën në kallamishte.

— Atëherë i ka ardhur zor prej shokut të vet...

— Nuk besoj! Shoku i tij nuk erdhi te gjoli.

Adriani qe hutuar shumë nga kjo përgjigje. Nuk mbante mend çfarë ishte thënë më tej. Në mbrëmje dhe ditë të tjera më vonë kishte menduar se mos Liljana po i punonte ndonjë lojë me qëllim që ta detyronte të fejojeshin. Mirëpo s'gjente fakte për ta bazuar këtë hamendje. Liljana, sikurse ai, nuk kishte shfaqur ndonjëherë pakënaqësi apo padurim për kohën që kalonte. Ajo ishte pajtuar me gjendjen pezull të dashurisë, nuk

ngutej t'ua bënte të njohur të tjerëve lidhjen me Adrianin, madje sikur kishte qejf ta shtynte dita me ditë këtë sekret, aq sa Adriani nganjëherë kishte përshtypjen se ajo, krejt natyrshëm, mund t'i thoshte një mbrëmje: A nuk e lëmë fare?

Shtatori kaloi në paqe, po kështu edhe gjysma e parë e tetonit. Ato shiheshin shpesh mbrëmjeve prapa murit të varrezave të vjetra në fushë ku rrallë shkelte këmbë njeriu. Liljana vinte drejt e nga puna në orizore, mundohej të dukej e çlodhur, e freskët, por shenjat e lodhjes dhe mundimit i dalloheshin qartë. Ulej përdhe, mbështeste kurrizin pas murit rrethues të varrezave, fuste duart në gjinj ose i lëshonte në prehër si të mos ishin të sajat. Pastaj vështronte herë Adrianin, herë horizontin që nxihet dalëngadalë. Ajo kishte një fytyrë të mbushur që dukej e vogël në krahasim me shtatin e bëshëm dhe gjoksin e madh prej fshatareje. Por ndofta fytyra i dukej e vogël edhe për shkak të flokëve të dendur dhe syve shumë të mëdhenj që, kur të shikonin papritur, të krijonin përshtypjen se pas pak, diku aty rrotull ose larg në horizont, do të ndodhte diçka e çuditshme.

Adriani do ta kishte quajtur ogurbardhë paqen që përshkonte ato mbrëmje. ato takime gati-gati të heshtura, sikur të mos i rrinin në mendje dy gjëra: ikja përkohësisht e napoletanit në atdheun e vet dhe refuzimi i Liljanës për t'u puthur, kur ai e dëshironte më të rrallë këtë gjë.

Ajo kishte një mënyrë të veçantë për të prapsur e fashitur dëshirat e tij. Nuk thoshte jo, nuk mbrohëj me duar. Fytyra i merrte shprehjen e një mundimi të vështirë, sikur dashuria ishte diçka e ulët, e huaj. Atëherë atij i therte në shpirt ajo dëshira e saj momentale e paqortueshme për t'u përkëdhelur prej napoletanit dhe binte në mërzi.

*
*
*

Adriani i rikujtoi të gjitha këto teksta këqyrte vjesh-tën nga dritarja. Nuk donte, por ishte e pamundur të mos dyshonte se mosdalja e Liljanës në kala lidhej një-farësoj me napoletanin që ishte kthyer ato ditë nga Italia. Ndofta Aldoja do të merrte pjesë në festë dhe Liljana ishte vënë në dijeni përmes Desaret Lecit. Prandaj kishte vendosur të mungonte dhe kjo ishte një nga ato tërheqjet e bukura të mallit. Rikthimi i Aldos e ka tronditur shpirtin e saj, mendoi Adriani dhe ajo ndo-dhet prapë mes dy zjarresh.

Të nesërmen u ngjit qysh në mëngjes në kala dhe kur nuk e pa kërkund napoletanin e sjellshëm, u kthye mbrapsht dhe me zemër të thyer u nis mespërmes fushave drejt rezervatit të gjuetisë. Ktheu!, — i tho-shte në zë. Më mirë të mos shohësh gjë! E çfarë do të shoh?, — përgjigjej vetë. Në mendjen e tij hepohej; e përmbysesj e ngrihej prapë e hepohej prapë, pambari-misht, mu si rrezimi i përsëritur i një peme në ekran, një skenë e mynxyrshme sikur Liljana po puthej me Aldon dhe ai ia zbrëthente kopsat e trikos, pastaj edhe ato të bluzës, pastaj fustani i saj mblidhej lart dalë-ngadalë si perde, por kurrë deri në fund, sepse sapo duart e tij bëheshin gati për veprim tjetër, skena ndër-pritej e kthehej sa çel e mbyll sytë në pikën e nisjes për të rifilluar nishtas. Kthehu! Më mirë të mos sho-hësh gjë! Por këmbët e çonin përpara, madje me ngut, si të mos ishin të tijat.

Ai u ngjit në tarracën e hidrovorit. Era e lehtë i le-dhatoi fytyrën e skuqur. Shteti sytë rrethoqark nëpër parcelat dhe kallamishtet e rezervatit deri larg në fshatin Stom nga e djathta, që në zhargonin e të rinj-ve të Barbullojës quhej «Shteti tjetër». Mbretëronte kudo një heshtje varri. S'levizte asgjë, s'pipëtinte asgjë. Lart në kala ngjyrat e rrobave të pjesëmarrësve ishin salduar si njolla në bedenat e hirtë. Dukej sikur festa kishte

dhënë shpirt atje. Ai ndjeu një therje në shpirt dhe e kaploi hutimi teksa përfytyroi sikur poshtë ujërave dhe tokës ishte ndryrë një shungullimë dhe natyra kishte rënë në letargji pikërisht për të mos e zgjuar atë shungëllimë. Ai zbriti ngadalë shkallët në formë spiraleje, pastaj, sa deshi të shkelte tokën, u ndal gjithë frikë. Po ashtu, me frikë në zemër, e uli këmbën me kujdes të madh sikur do të shkelte mbi mina.

Në atë minutë Liljana gjithashtu po zbriste në majë të gishtërinjve shkallët e brendshme të shtëpisë. E bënte vazhdimisht atë gjë, krejt kot, si e si që të realizonte një zbritje fare të shurdhër. Por ishte e pamundur. Shkallët ishin të vjetra dhe rënktonin.

KAPITULLI I DYTË

Në njërën nga mbasditet e tetorit në tokën e Barbullojës hyri karvani i të rinjve të «Shtetit fqinj», që bënin ciklokrosin tradicional të vjeshtës. Vargu i biçikletave rrëshqiti si një kordele laramane në rrugën e asfaltuar midis hurmave, bëri një rrotullim të plotë në oborrin e shkollës dhe, i shoqëruar nga britmat entuziaste të kalamajve, mori përsëri rrugën e kthimit. Dhjetëra sy, fshehur në kopshtije apo prapa dritareve, ndoqën deri larg trupat e përkulur të çiklistëve me ato kapelet prej llastiku të ngjeshura në kokë, me bluzat jakëgjera dhe me tërë ato xhinglamingla në biçikleta që tundeshin hijshëm. Zhurma e rrotave, rënkimi i pedaleve dhe frymëmarrjet e shpeshta të çiklistëve sikur mbetën pezull në ajër edhe pasi stomionët qenë larguar.

Shfaqja dhe largimi i tyre i menjëhershëm la prapa një si mpirje të përgjithshme. Shumë nga djemtë e rinj dolën nga kopshtijet dhe u mblodhën në oborrin e shkollës.

Dikush-dikush shfaqti zili për stomianët, të cilët i quajti «të huaj», një tjetër mallkoi: «prapa diellit të venë», një i tretë u betua se do t'u punonte qindin po u panë më në Barbullojë të kapërdisur mbi biçikleta, një i katërt, në të kundërt, propozoi t'i prisnin me lule e duartrokitje...

Nga ana tjetër, nuk ishin të paktë pala e krenarëve.

Këtyre as që u hynte në sy çiklokrosi i stomianëve. Krenarët mendonin se lavdia e Barbullojës, rivale e kahershme e Stomit, nuk ishte thjesht përkujtim i kohës së shkuar, siç ishte shprehur me shumë guxim njëra nga gazetatat e Tiranës. Vërtetë vitet e fundit jeta ishte bërë akoma më e vështirë, por kjo nuk ishte arsye e mjaftueshme për ta ulur kokën! Barbulloja e tyre kishte hotelklubin «Ngjala» ku vinin njerëz nga të katër anët. Hotelklubi «Ngjala» ishte një dritare e madhe dhe këtë e kishte vërtetuar koha. Njerëzit e Barbullojës dukeshin më të dalë se ata të Stomit. Ndërkaq rrënjët e Barbullojës shtriheshin thellë në kohërat e lashta! Lexoni, lexoni historikun e Dodë Balshës, lexoni shkrimet e profesorëve të dëgjuar në librat e arkeologjisë, shkoni more qafira në muzeun historik të shihni me sy stolitë e grave të gjendura në varrezat tumulare të këtushme, terrakotat, amforat, sëpatat dhe enët e ndryshme që datojnë qytetërim të pashkëputur! Më tej: hidhini një sy këndit të prehistorisë ku janë rreshtuar veglat prej stralli dhe prej kockash të fosilizuara, të cilat kanë vulën e paleolitit të mesëm. Ku u gjenden këto relikte? Në shpellën e Kajanit mbi Barbullojë, ku tjetër? Kurse Stomi! o perëndi. Kënetë ka qenë mot pas moti!

Duke i parë gjërat tej prizmit të ngushtë të një dekade, krenarëve u dukej qesharak çiklokrosi i stomianëve, ajo sfidë e momentit që tretej si pikë uji në hambarin e madh të kohës.

Megjithatë, e ashtuquajtura sfidë e «të huajve» nuk u hodh prapa krahëve fët-fët me katër llafe. Për t'iu përgjigjur në mungesë stomianëve, në oborrin e shkollës filluan menjëherë garat e akrobacisë. Barbulloja gjallonte nga akrobatët. Rrallë gjeje një djalë që s'dinte të bënte urën apo të rrinte në sparkatë. Në ditë festash rrugët mbusheshin me djem që ecnin me duar, duke i mbajtur këmbët e përthyerat lart. Kështu pra, nja pesëmbëdhjetë veta u vunë në garë kush shkon më larg, duke ecur me duar. Një pjesë tjetër mateshin kush qëndron më gjatë në vertikale, duke mbështetur kokën

ose duart në tokë. Këta ishin stoikët, kryeneçët, që kishin ndjenjën e fortë të fshatit dhe e përbuznin zilinë. Jetmir Cubi, një djalë rreth të njëzetave, që bezdisej tepër nga pantallonat dhe për këtë arsye pjesën më të madhe të kohës e kalonte në të mbathura, i habiti të gjithë kur mundi t'i binte tre herë rreth e qark oborrit të shkollës pa bërë asnjë pushim, duke vendosur kështu një rekord. Kur mbaroi garën, ata që i kishin shkuar nga pas me brohorima, vunë re se pëllëmbët e tij ishin gjakosur në katër-pesë vende nga guriçkat. Shoku i tij i ngushtë, Festim Ndoja, qëndroi plot njëzet minuta me vertikale. Edhe Festimi korri duartrokite të stuhishme. Pas kësaj, që të dy, të lodhur dhe të dehur nga suksesi u shtrinë në kurriz duke vështruar qiellin e mbrëmjes.

Në këtë kohë Adriani dhe Liljana ishin takuar si zakonisht prapa varrezave të vjetra që nuk përdorehin më. Duart lidhur në gjoks dhe me një qesëndi trishuese në fytyrë, Adriani kundronte prej së largu akrobacinë masive të bashkëfshatarëve. Kurse Liljana kishte hapur fundin si parashutë dhe rrinte shesh mbi një si jastëk gjethemullagash, duke vërtitur një fije bari sa të njëri cep i gojës te tjetri.

— Po erret, — tha nëpër dhëmbë Adriani. Liljana e vështrroi nga poshtë sikur pyeste: «e çfarë?».

— Kjo do të thotë se duhet të ndahemi, — tha ai, duke perifrashuar shprehjen e saj të zakonshme kur i zinte muzgu bashkë.

— Ashtu? — Liljana mbuloi fytyrën me flokë. Përtej fijeve të hallakatura shndritën sytë e saj të mëdhenj, ku ndizej papushim drita e një dëshire ngacmuese.

Më tej ajo zbuloi fytyrën dhe vuri një gisht në anën e djathtë të mjekrës sikur kërkonte arsye në fjalët e paarsyeshme të Adrianit. Ajo priste, ajo donte, ajo nuk kishte frikë nga asgjë!

Adrianit se si i erdhi. Një copë herë mbeti duke vështruar hapësirat e heshtura për qark me trungjet e

nxirë të hurmave, me arat e korrura përtej dhe me rreshtin e përgjumur të plepave ndanë rrugës.

«Sonte paska dëshirë të puthet»; — tha me vete, ndërsa i zgjati të dyja duart vajzës dhe e ndihmoi të ngrihej. Po pse sonte, pse pikërisht sonte? Pa ia lëshuar duart e afroi nga vetja aq sa majat e gjinjve të saj nën bluzën e hollë prej kambriku i prekën kraharorin. Liljana psherëtiu lehtë, por nuk lëvizi. Adriani ndjeu regëtimin e gjakut në damarë. E mbajti vajzën një copë herë të mbështetur pas vetes mandej e largoi pak, i hodhi duart në bel dhe duke e kqyrur drejt, e pyeti me djallëzi:

— I pe ciklistët?

— I pashë, — tha Liljana e vrenjtur. Adriani nxorri frymën sikur thoshte: «ç'të bësh» dhe qeshi. Ajo ia largoi duart nga beli.

— Janë të ligj, — tha Adriani.

— Cilët?

— Stomianët. Kastile vijnë këndeje me biçikleta. Për të na plasur zemrën.

— Sa budalla qenke!

— Hiç s'jam budalla.

— Si të shkon ndër mend se ata vijnë për të na plasur zemrën? Ata argëtohen për qejfin e tyre!

— Ke të drejtë, — mërmëriti ai pas një pauze. Ata argëtohen për qejfin e tyre.

Përsëri ra heshtje dhe larg përtej kopshtijeve, dritat e zbehta të shtëpive përcillnin qëndresën e vështirë të jetës. Liljana ishte vonuar. Ai e vështroi me bisht të syrit. Shih! ia bëri me vete i habitur. Aq i bën që është errur! Një mall i madh iu përzi papritur në kraharor, zgjati prap dorën dhe e mbështolli Liljanën për mesi. Gati ashpërsisht e tërhoqi nga vetja dhe sakaq pati përshtypjen se diçka po shkrinte në duart e tij. Me një ndjenjë alarmi kërkoi si i verbër buzët e saj të rreshkura nga dielli.

— Sa budalla që je, — tha ajo me zë të mekur.

— Jam, — pëshpëriti ai duke e puthur.

Ajo që po bënte iu duk e cekët, madje e rëndomtë. Ai u ndie fajtor që nuk mundi ta mbushte çastin e shumëpritur të puthjes me zjarrin e ëndërruar sa e sa herë. U përpoq rishtas, por duart e saj e larguan.

Ajo u tërhoq dy tre hapa. Rregulloi fundin që i kishte shkuar anash, pa ia hequr sytë djaloshit që rrinte si vuf para saj. Ajo ishte shumë e bukur, sharmi i diellit të Jugut i pluskonte si prush nën lëkurë. Dhe Adriani përsëri u ndie fajtor. Papandehur e pllakosi një ndjesi dështimi dhe humbjeje. Liljana tëhujësohej me shpejtësi dhe ai nuk ishte i zoti të bënte asgjë. Kishte vetëm një shpresë. Ndoshta ajo do t'ia mbathte me vrap, duke dënesur siç bëjnë shumica e vajzave kur puthen për herë të parë. Por Liljana s'kishte sypërçapje të ikte.

Sytë e saj të mëdhenj nxinin si hone plot enigma. Për një çast atij iu bë sikur ajo e përbuzte. E përbuzte që ai ishte lëshuar me etje dhe tërbim mbi të, sikur gjatë gjithë jetës s'kishte bërë gjë tjetër veç e kishte ëndërruar gjer në skutat më të fshehta të femrës: e përbuzte për puthjen e varfër pa ngrohtësi dhe trallisje. Dy vetë që dashurohen duhet të puthen që të kuptojnë më mirë se ç'janë për njëri-tjetrin. Nganjëherë puthja vulgare i shkatërron të gjitha: shikimet, fjalët, ëndrrat, dhuratat, shëtitjet, prekjet, padurimin e ndarjeve. Do syri, po shqisa materiale nuk përgjigjet dhe mosdashja e shqisës materiale nuk mund të mos përfillet. Kur kishte ëndërruar të puthej me Liljanën. Adriani kishte parashikuar një mrekulli më të madhe të aktit, një elektrizim të trupave, një harrim, një ikje nga sendet rreth e përçark, një kalim lumturor në sfera më të larta, më të kulluara. kur etja e dashurisë nuk shuhet kurrë, kur gjithçka që jepet merret dhe magjia e puthjes nuk priset asnjë çast. Kurse tani ishte i zhgënjyer. Mes tij, ëndrrës së tij dhe Liljanës vërtitej diçka e pamërtueshme, diçka e keqe që herë i nxiste furishëm drejt njëri tjetrit për të bërë një provë tjetër, herë i mbante të mbrëthyer në një pendim të përziëshëm. Dhe Liljana, për dreq, ngjante shumë më e bukur me atë pendim të përzishëm në fytyrë.

Ajo i bëri shenjë të afrohej. Adriani u bind.

— Si është puna? — tha ajo.

Kjo nuk është në vete, mendoi Adriani, dhe u tkurr sikur priste një shpullë. Në të vërtetë pëllëmba e saj bëri një hark në ajër dhe pushoi në faqet e tij. Ajo pas-taj ia mori dorën, ia kaloi prapa shpinës së vet, dhe e tërhoqi drejt rrugës.

— A shkojmë në klub, — tha me nxitim Adriani. Ishte një propozim kot. Liljana sigurisht nuk do të shkonte me të, madje tepër ishte vonuar. Mirëpo në kundërshtim me hamendjen e tij, ajo tha «mirë» dhe Adrianit iu mblodh një lëmsh në grykë.

— Shiko se nuk je në rregull, — tha.

— Pse nuk qenkam në rregull?

— Unë të dua!

— Shumë faleminderit!

— Po ti, a më don?

— Posi.

— Prapë?

— Prapë.

— A më ke dashur gjithmonë?

— Nuk e di...

Përtej një plepishteje përballë ndriçonin dritaret e hotel-klubit.

Adriani e zuri vajzën nga parakrahu dhe e ktheu nga vetja.

— Nuk do të shkojmë në hotelklub, — tha nëpër dhëmbë. Pa pritur reagimin e saj, e puthi në faqe. Liljana u gëlltit dhe vështroi disa sekonda në tokë.

— Në çiklokrosin e Stomit kishte edhe vajza, — tha papritur dhe filloi t'i hidhte hapat më me ngut.

— Po, kishte edhe vajza.

— Ato dukeshin shumë të bukura mbi biçikleta.

Adriani nuk foli. Dritat e hotelklubit afroheshin vazhdimisht dhe Liljana dukej e vendosur të shkonte atje.

«Ajo kërkon të shpallet puçja e buzëve në terr», mendoi Adriani. «Ajo po fyen besnikërinë time!»

— Liljana, ktheu! — i thirri.
Ajo u ndal dhe, duke u kthyer përgjysëm, pyeti gati me përcmim.

— Ke frikë?

— Po ti nuk ke frikë?

— Jo, nuk kam frikë.

— Mblidh mendjen, — tha Adriani me zë të butë.
— Të shkojmë në hotelklub tani është aventurë.

— S'ke turp! — errësira sikur kërci nga toni i saj i thatë.

— Liljana, të lutem! Do të bëhesh nusja ime dhe...

— S'dua të bëhem nusja jote! — tha ajo dhe krisi e iku me vrap mespërmes plepshites. Adriani e arriti me një frymë dhe zuri t'i fliste me një mallëngjim të pazakonshëm «Liljana, Liljana» si ta kishte shpëtuar atë dhe veten nga një rrezik i madh. Ajo e vështroi një grimë herë si e pataksur pastaj mori kokën në duar dhe dënesi.

Mandej ajo pushoi së dënesuri, u mbajt me duar pas trupit të djalit dhe ktheu fytyrën kundruall qiellit.

I shpallur zot i plotfuqishëm nga heshtja dhe nënshtrimi, nga tulatja dhe përulja e vajzës, ai e kundronte atë nga sipër siç shikojmë fytyrën tonë në ujin e thellë të një pusi. E kundronte shkarazi, pandërprerje sikur kishte frikë mos do të lajthiste nga mendja duke mbajtur në duar një vetëtimë. Më në fund u përkul mbi të symbyllur, e puthi me zjarr në buzë, në faqe, në gushë. Lëkura e vajzës digjej si në ethe. «Ç'po bëj kështu, ç'po bëj kështu», u ankua zëmbytur gjersa kurri i saj preku barin.

Disa çaste ai ndenji sipër saj krejt i hutuar, sikur nuk dinte ç'të bënte e nga t'ja fillonte. Pastaj ngrohtësia e trupit të vajzës tok me drithërimat dhe impulset e panumërta të kyçeve e damarëve, e përfshiu edhe atë. Gjithçka u krye shpejt, dhe po aq shpejt, në misterin e rëndomtë të atij akti, u varros gjithë ai vlim gjaku

dhe endjeje. Liljana e harroi atë, zgjati kokën midis shalëve dhe pyeti me habi:

— A e sheh gjakun?

Adriani u ul në gjunjë pranë saj, por nuk deshi të dinte për asgjë.

— A e sheh gjakun? — përsëriti ajo, kësaj here e alarmuar. Pa prituri përgjigje, e tërhoqi atë sipër vetes, iu ngjesh pas gjoksit e pas këmbëve sikur do t'i hynte në trup, dhe sakaq, ndërsa tkurrej me mundim nën të, e mori vaji.

Të qarat sikur e sollën përsëri në vend trupin e saj. Por ata ndenjën edhe më tej sipër njëri-tjetrit si dy kufoma. Adriani vështronte dritaret e shtëpisë sipër rrugës. Përtej xhamave lëviznin silueta njerzish. Pamja e tyre përfntonte një botë hijesh, ose negativin e botës reale të ngjyrave dhe zërave. Atij i ra ndërmend diçka e çuditshme: në fshat nuk lihte asnjë qen. Çudi si nuk e kishte vënë re më parë. Ai deshi t'ia thoshte Liljanës këtë, por i erdhi turp. Sakaq heshtjen e natës e thyen të folurat me zë të lartë në shtëpinë e Lazër Bocit. Lazri sëç thoshte me atë zërin e tij të trashë dhe të ngjirur, e shoqja ia kthente gjithë me një vikamë të mprehtë që të shponte veshët, pastaj ndërhynte djali i tyre i madh, Lini me një zë të mbytur koke sikur fliste në qyp.

Përmbi të folurën e tyre si në mulli u ngritën tingujt e një borije melodike, pastaj u dëgjua kërcitja e fre-nave të një makine që ndaloi në sheshin para zyrave të kryesisë. Një heshtje e thellë kureshtare. Pastaj katër përplasje dyersh metalike. Nata sikur u lëkund. Lazër Boci bubulloi përsëri. Kësaj radhe Adriani e mori vesh. Ai kërkone një gotë ujë.

KAPITULLI I TRETË

Adriani u nda nga Liljana, por nuk i shkohej në shtëpi. Kujtimi i asaj që ishte kryer përgjysëm pak më parë mes dashjes dhe mosdashjes, përqafimeve dhe refuzimit të Liljanës, i sillej në kokë si mjegull. Një dhimbje e përcaktuar i rëndonte në kraharor. Një mendje i thoshte se Liljana ishte dorëzuar nga dëshpërimi. Indiferenca e napoletanit, dyshimet e pashprehura dhe gërryese të Adrianit, ciklokrosi i stomianëve, vajzat mbi biçikleta, fytyrat e tyre të skuqura, mëngoret dhe manshetat e gjëra që u valëviteshin nga pas, të gjitha këto s'mund të mos e helmonin shpirtin e Liljanës, duke i kujtuar ndërkaq se ç'jetë monotone bënte. Prandaj, për të thyer monotoninë, për të mbushur një boshllëk të thelluar befas, për të përkëdhelur dëshpërimin a dreqi e di për çfarë tjetër, ajo nuk e kishte quajtur më të shenjtë e të paprekshëm trupin e vet. Shkurt fjala: Dashuria e saj ishte një lloj sfide ndaj rrugës së shkurtër dhe të pandryshuar ku zinin fill dhe soseshin ditët e saj, ndaj mungesave dhe ndaj shtypjes që ushtronte mbi të fisi i zyrtë i Simonajve me atë mpleksje kurorash nën një çati dhe me atë tërheqje të frikshme nga koha. Nëse është kështu, mendoi Adriani, atëhere dashuria e saj e pakmëparshme nuk mund të quhet sfidë, por shkrehje, nënshtrim.

Ai ra në mërzë dhe se si i erdhi për Liljanën. Ideja se edhe më tej ajo mund të luftonte ashtu kundër mo-

notonisë e turbulloi akoma më keq. U ndie i përjashtuar nga jeta e saj. Në mos i përjashtuar, i pranishëm vetëm si shërbenjës, ose si padron, por jo si partner. Kjo ishte e rëndë dhe në kundërshtim me natyrën e tyre si çift. Asnjë mashkulli nuk i pëlqen që vajza t'i jepet për hir të një ndjenje apo qëllimi që s'ka lidhje me vetë mashkullin. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për femrën. Dashuria nuk është kurrë tradhëti. Aty ku është tradhëtia, aty ku s'ka më marrëdhënie të dyanshme fillon prostitucioni. Adrianit i tingëlloi e kobshme kjo fjalë, të cilën e shqiptoi copa-copa sikur thyente një rrigë qelqi. Si për t'i shpëtuar ngjasjes së arsyetimeve negative ai çoi nëbër mend njohjen me Liljanën, mirëkuptimin e heshtur dhe të menjëhershëm me të, sikur duheshin prej kohësh dhe sikur e dinin këtë. Dashuria e tyre që në fillim pra kishte pasur një moshë dhe sipas Adrianit, kjo shpjegonte mungesën e vrulleve dashurore dhe epsheve të ndërsjella. Megjithëse dukeshin shumë, asnjëherë nuk e kishin mendjen plotësisht të njëri tjetri, prania e një gjëje të pacilësueshme u rrinte në mes, ata e ndjenin dhe mund t'i gjenin një emër po të vrisnin mendjen, por nuk donin ta emërtonin atë gjë që i linte në një të tashme të palëvizshme, duke përjashtuar nga jeta e tyre planet e një ardhmërie tjetër.

Edhe pas asaj që ndodhi në plepishte, Adriani e ndiente se nuk ishte plotësisht zot i saj, se, ajo nuk ishte plotësisht e tij dhe nuk mund t'i drejtohej me fjalën e bukur imzot. Një forcë harbute, më e madhe se forca e dashurisë, ushtronte diktatin e vet mbi ndjenjat e tyre. E keqja është se unë nuk di ç'të bëj me të, përsëriti me vete Adriani. Të fejohe mi? Të martohemi? Një fjalë goje! Për dreq unë jam 26 vjeç dhe ajo është 24 vjeç, pra nuk jemi më fare të rinj dhe dimë më shumë se sa kemi.

Ideja e martesës me Liljanën sikur hapte papritur para tij një hon, buzë të cilit ishte afruar symbyllur. E dinte se prindërit e Liljanës do t'i kërkonin para për pajë. Por edhe sikur të mos i kërkonin gjë a

merrej nusja me një fill tesha? Kishin ndodhur martesë me rrëmbim, madje këto lloj martesash ishin përhapur shumë kohët e fundit sa nga varfëria aq edhe nga mospajtimi i të rinjve me prindërit.

Sa herë dëgjonte për to Adriani trishtëhej. Se si i vinte për ato djem dhe vajza që ktheheshin drejt e nga fusha dhe përuoronin shtratin bashkëshortor mes endjeve dhe trishtimeve romantike të natës së parë. Çapkënë dhe kokëkrisur në fillim, madje dhe krenarë, këta bashkëshortë zbulonin pastaj me mall dhe me pendim vlerën e akteve të njëpasnjëshme nëpër të cilët realizohet një martesë. Në biografinë e daskurisë së tyre mungonte luksi i ndritshëm i ceremonialit të dasmës, mungonte pjalmi qiellor i të qenit dhëndërr dhe nuse... Gjithçka ishte thjeshtuar dhe kjo, sipas Adrianit përbënte një dhunim të dhimbshëm të zakonave shekullore.

Po edhe të merrje nuse me pajë e me dasëm nuk ishte lehtë. Adriani paguhej si topograf me ditë pune. Dyzet ditë pune shumëzuar për gjashtë lekë, se aq kushtonte një ditë pune, bëheshin dyqind e dyzet lekë në muaj.

Me to mbante veten dhe nënën, një grua shtëpiake pothuajse plakë që kishte mbetur e ve që prej njëzet vjetësh dhe që deri vonë ishte marrë me një tufë delesh duke siguruar jetesën me fitimet që nxirrte nga shitja e leshit dhe bylmetit. Tani që delet i kishte marrë kooperativa, shumicën e kohës rrëmonte në kopësht, por ende nuk ia thoshte si kopshtare. Pra nga ana e nënës Adriani nuk shpresonte gjë. Për ndihmë tjetër nga të afërm e kushërinj s'bëhej fjalë. Prandaj martesë, ashtu siç e mendonte, i dukej shumë e largët. Por ajo që e friksonte më shumë ishte perspektiva e martesës. Ai mund t'i merrte hua gjëkund për paratë e pajës dhe dasmës, ose mbyllte njeriu sy dhe martohej ashtu, me rrëmbim. Mënjëherë pastaj mendjen e tij e pushtonte një pyetje e thjeshtë: çfarë do të ndërtonte

me atë martesë? Përgjigja gjithashtu vinte thjesht:
Asgjë!

Pakuptuar, këmbët e shpunë në vendin ku disa minuta më parë kishte bërë dashuri me Liljanën. Sa u çudit kur vuri re se dritaret e hotelklubit ishin aq afër, madje po të vije veshin mund të dëgjoje zhurmërimat e bisedave atje! Ai uli kokën dhe mendoi se në çastin kur i mundi dëshira ose ideja e sfidës edhe ai, edhe Liljana qenë çliruar nga çdo lloj frike. Dhe kjo sipas tij nuk ishte një gjë e mirë.

Një rreze drite i binte mbi fytyrë. Ai vend zuri t'i dukej tepër banal. Ai vend që ishte një ironi e ëndërritjeve të tij të larta për shtratin bashkëshortor. Ai uli kokën dhe u përpoq të dallonte barin e shtruar për tokë. Asnjë gjurmë, asnjë dëshmi. Për një çast ai pati përshtypjen se nuk kishte ndodhur asgjë dhe kjo e qetësoi.

KAPITULLI I KATËRT

Hotelklubi «Ngjala», ishte ngritur mbi ujrat e kthjellta të prroit që zbriste nga malet. Arkitekti dhe ndërtuesit kishin arritur ta zbusnin hovin e ujrave duke hapur gjithandej në oborr kanale të vegjël, zbukuruar me gurë të rrumbullakët me ngjyra. Vendi për rreth ishte zbukuruar me lehe lulësh, palma, salkamë dhe tre kaktusë të mëdhenj. Por brenda ishte diçka krejt tjetër. Në paretet e mureve veshur me dru të lëmuar pishe qenë mbërthyer fenerë të madhësive e formave të ndryshme, punuar me fletë llamarine të zezë. Aty këtu shikoje shpendë të ballcamosur të faunës së zonës, pelikanë, pulëbardha, rosa të egra, qafka. Ndërthyer në një cilindër duralurini fare pranë tryezës kryesore në qoshkun e majtë.

Salla e ngrënies kishte nja njëzet tryeza. Ndriçimi ishte i dobët, por gjithsesi intim, me përjashtim të banakut në krye ku rrezellinte një neon nja një metër i gjatë. Nën dritën e tij të fortë shkëlqente pudra, kremi dhe rimeli i përdorur pa kursim nga Tereza, baha-kierja trashaluqe që shërbente prej dy dekadash në atë vend. Emri i saj ishte bërë sinonimi i «Ngjalës» për të gjithë ata që kishin njohuri të hollësishme për giden turistike të vendit.

Dikur Tereza kishte qenë një femër elegante dhe

mjaft e përzemërt. E hollë dhe e zhdërvjellët si një ngjalë, ajo kishte mbajtur në kurriz për shumë kohë detyrën e dyfishtë të kamarieres dhe banakieres. Me kalimin e viteve trupi i saj i hajthshëm që mbushur e shëndosur tepër, nuk e kishte më shkathtësinë e dikurshme, prandaj kishte vendosur të mbante vetëm banakun dhe kujdesin mbi dhomat e gjumit.

Diku aty rrotull vërtitej si hije i shoqi, Ibër Rama, një burrë dorëcung, plak të thuash, mjaft i përfolur në fshat, me të cilin banakierja nuk kishte lindur fëmijë. Ibëri ishte pesëmbëdhjetë vjet më i madh se Tereza. Qysh në fillim martesë e tyre pat ngjallur diskutime dhe dyshime të njerëzisë së Barbullojës, të cilëve u që dukur e papërfytyrueshme që ai burrë i dobët tërë nyje e deje si një hardhi, të mund të zaptonte një pelë xanaxare si Tereza. Disa patën shfaqur mendimin se Tereza zgjodhi pikërisht atë martesë për të lëshuar perden mbi dashuricat e njëpasnjëshme në kthinat e hotelklubit. Asaj i duhej një burrë, makar edhe eunuk, mjaft që në regjistrin e gjendjes civile të figuronte si mashkull. Në të vërtetë askush nuk kishte mundur të nxirrte në dritë ndonjë fakt të qartë që të vërtetonte shturjen e Terezës.

Qysh se pat vënë kurorën e martesës, Ibëri futi një krëhër në xhepin e përparmë të xhaketës, zuri të mbahet me të madh dhe të sillej me fodullëk me të gjithë ata që i dilnin përpara, natyrisht kur nuk ishin të deleguar nga Tirana. Pikërisht kapardisja e tij komike provokoi shpikjen e një tregimi të gjatë me titull «Fluturimet e jashtëzakonshme dhe shumë të andrallshme të Ibërit të shkretë», i cili zgjatet dimër për dimër në Barbullojë si një nga argëtimet më të pëlqyera. Nuk dihen me saktësi autorët e këtij tregimi, njëherë e një kohë autorësia i pat mbetur Gjergj Sherrit, një mesoburrë i heshtur dhe i tretur si cingël që i ka lexuar nga katër a pesë herë gjithë librat e bibliotekës së fshatit. Mirëpo Gjergji, sado që ka pjesën e vet në

«Fluturimet» asnjëherë nuk pati paturpësinë t'i dilte për zot atij krijimi kolektiv. Vërtetë: Kushdo që lexon një libër ku flitet, fjala vjen, për beduinët e Afrikës, menjëherë kujtohet ta shpjerë Ibërin në shkretëtirat e atjeshme, duke shtruar kësisoj një kapitull të ri në udhëtimet e tij imagjinare.

Adriani hyri në hotelklub dhe për pak u përplas turi për turi me shefin e llogarisë, Nevruz Begollin, i cili po rrinte në pozicion gatitu prapa derës. Novruzi i hodhi një shikim prej tuafi të porsaardhurit, pastaj u kthye papandehur dhe nxitoi drejt banakut. Tereza po ndërronte me ngut lidhësen e bardhë të flokëve. Ata seç çuçuritën vesh më vesh, Tereza u fut në aneks që nga u kthye pas pak e qeshur dhe shend e verë me një vazo lulesh. Novruzi ia rrëmbeu nga dora dhe nxitoi ta vendoste në tryezën kryesore.

«Pritje, mendoj Adriani. Barbulloja këmbëngui me fanatizëm të krijojë përshtypje të mirë, vetëm përshtypje të mirë te miqtë».

Ai hodhi sytë në sallë dhe pa Skënder Abdylin, babanë e pesë vajzave, një shulak që të fuste frikën, por timid në fytyrë. Ishte ulur në një tryezë afër banakut. Pinte duhan në heshtje, me një ndenjje të lexueshme respekti për të pranishmit. Më tej Ibër Rama kishte lidhur pecetën e bardhë në qafë dhe hante darkën ngadalë, duke zgjatur dorën e shëndoshë drejt pjatave të vendosura më larg se sa mbahen zakonisht. Një çift nga kryeqyteti që kalonte muajin e mjaltit në Barbullojë, gjithashtu po hanin darkë. Memeci Hysen, klienti i përhershëm i hotelklubit, po dremiste. Prenga i gjatë, i cili para një muaji ishte caktuar kamarier, rrinte mendjetretur te sporteli i kuzhinës... Ja dhe dy bashkëmoshatarët e Adrianit, Ludoviku dhe Ferdinandi. Adriani përsëndeti me kokë çiftin nga kryeqyteti dhe u ul përballë Ludovikut. Prania e tij në klub përbëntë një surprizë. Zakonisht, sa thyhej pasditja, i hipte urbanit dhe shkonte në qytet. Këshedi ç'po ujdís andej,

mendoi Adriani, dhe sytë i shkuan te flokët e tjetrit të qethur shkurt deri afër veshëve sipas një mode të përhapur kohët e fundit. Ludoviku mori një cigare nga paketa mbi tryezë dhe e ndezi. Nën dritën e flakës së çakmakut Adriani mundi të dallonte në të dhjetën e sekondës sytë e tij të turbullt që nuk të shikonin kurrë drejt. Me siguri ujdís diçka, diçka që nuk ia thotë kërkujt, mendoi rishtas Adriani. Në mendjen e tij rrëshqiti figura e urtë e Donika. Shqutit. Një mbrëmje vere, duke kaluar nga kavaletat e bykut, ai kishte dëgjuar fare pranë një rënkim të mbytur vajze. Instinktivisht kishte kthyer kokën majtas dhe kishte njohur Ludovikun. Në kashën e verdhë të bykut, përtej supeve të tij, nxinin një tufë flokësh të hallakatur. Adriani kishte vazhduar rrugën dhe s'kishte dashur të dinte cila ishte vajza e fshehur pas trupit të madh të Ludovikut. Por të nesërmen ky i zuri pritë në rrugë dhe iu lut të heshte për sa kishte parë natën e kaluar. Donika po çmendet nga në qafë, unë e tërhoqa me forcë drejt kavaletave të bykut... Rri i qetë, ia kishte kthyer Adriani dhe s'kishte dashur të dëgjonte më tej.

I pa edhe tre katër herë të tjera bashkë duke u fjalosur me gishtë si shurdhmemecët. Pastaj nga fytyra gjithnjë e më e zbehtë e Donikës, nga ecja e saj e pames tyre ishte braktisur e mohuar pa dëshminë e tjetërkujt.

Dera e lokalit u hap, Novruz Begolli që kishte zënë pritë atje u zbyth me shpejtësi katër posë hapa. Kryetari i kooperativës, Gaspër Matrizi bëri këmbë i pari. Pas tij hyri një plak i shkurtër me borsalinë dhe ngjitur me të një djalë i ri shtathedhur, vetë shur si burrë i madh me kostum të zi, me këmishë të bardhë dhe gravatë. Të gjithë me radhë shtrënguan duart me Novruz Begollin. i çili i ftoi të uletshin në tryezën e gjatë të qoshkut, stolisur tashmë me pije, meze dhe lule. Plaku hoqi borsalinën dhe

përshëndeti me kokë në një drejtim të papërcaktuar. Ibëri e njohu. Ishte shoku Mitro, kryetari i parë i Komitetit në atë krahinë. Megjithatë nuk u tund nga vendi. Rradha e tij vinte gjithmonë pak më vonë.

Pasoi një shamatë e vogël se cili nga të porsaardhurit të zinte kreun e tryezës. Gaspri jo vetëm nuk pranoi të dilte para plakut, por bëri ca gjeste e grimasa prej të fyeri dhe të poshtëruari ngaqë dikujt i shkonte ndërmend se ai mund të zinte në atë shoqëri karrigen e kreut.

Ludovikut iu dha për të qeshur, pastaj ia shkrepri gazit edhe Ferdinandi. Gaspri u hodhi një vështrim të rreptë. E ndërsyer nga vështrimi i kryetarit, Tereza ia mbërriti sa çel e mbyll sytë pranë tryezës së djemve.

— Ju çuna do merrni gjë? — i pyeti me qortim sikur thoshte: «Po s'deshët gjë, qërohuni!».

— E pse jo? Po të na qerasë xha Ibëri gati jemi, — tha Ludoviku dhe i shkeli syrin Adrianit.

— Naaaa, hundëkrut! — ia bëri Tereza nën zë duke i rënë bërrylit me pëllëmbë, pa i hequr sytë nga tryeza e gjatë ku Novruz Begolli po çokiste me radhë gotat e secilit.

Ibëri ndërkohë kishte mbaruar së ngrëni dhe po pastronte dhëmbët me kruarse. E shpërfilli shamatën e të shoqes me çunakët xhepzbrazur që ngrohnin karriget e hotelklubit mbrëmjeve. Më tej fshiu buzët me pectetë, kroi veshët, nxorri krëhërin nga xhepi i përparmë i xhakëtës dhe u kreh. Pasi u vetëshërbye kështu, me një përkuqdesje të thellë, nxorri nga xhepi i brendshëm portofolin me zinxhir. E hapi dhe, duke u mblacitur, shfletoi me gishta një tufë kartmonedhash. Memeci Hysen, që gjithë kohën kishte dremitur, u përmend si ta kishte shpuar njeri me gjilpërë në prapanicë. Nga flokët e tij të ngatërruar u shkund dhe ra në dysheme një gjethe e tharë rrushë.

— Aiiuuuu, — bulëroi duke vështruar i tromaksur portofolin e Ibërit.

U ngrit nga karrikja dhe, duke u hedhur mbi një-rën këmbë ngaqë tjetra i qe mpirë gjatë kohës që kishte dremitur, u afrua pranë djemve. Sytë i vizllonin nga lak-mia, përplaste buzët me mundim duke treguar me gisht Ibërin, pastaj hapte dhe mbyllte krahët hareshëm sikur i binte fizarmonikës.

— Ai, Ibëri, lekë shumë, — i tha Ludoviku! Memeci Hysen vuri buzën në gaz dhe tundi kokën si-kur thoshte «ohu sa ka ai». Ibëri nuk e prishi te-rezinë, madje vëmendja e djemve dhe e memecit si-kur e argëtonte. Me lëvizje të matura tërhoqi nga portofoli një kartëmonedhë dyqind e pesëdhjetëshe dhe e vuri mbi mbulesën e tryezës. «Pëf» ia bëri duke shtrembëruar turinj të sikur përbuste shkallëzimin e parasë deri te dyqind e pesëdhjeta.

Ferdinandi tha një fjalë të rëndë për kuletën e Ibërit. Nusja që kalonte muajin e mjaltit në Barbullojë lëshoi lugën mbi pjatë dhe u vërejti. «Qetësohuni!» i tha i shoqi frengjisht me zë të ulët.

— Pa mbushni një herë kuletën tuaj me asi sendi se kushedi, prapanica ua shton në vlerë! — ia plasi Ibëri.

— Ik! Ik, or ti! Na u hiq qafe se nuk të shohim dot!
— tha me bezdi Ferdinandi.

— E, e! Ndaj po iki se nuk më shihni dot, — i tha Ibëri dhe u nis rëndë-rëndë drejt tryezës kryesore. Atje iu var në qafë Mitros së shkretë, e mbuloi me të puthura.

— Oh sa na bëhet qejfi që të shohim përsëri mes nesh, — tha duke tundur krahun cung. Fytyra e Terezës u zgjat mbi supin e të shoqit si një zogëz e lumtur.

— Ja, dal ndonjëherë, më merr malli, — tha Mitroja — Malli i plakut qenka i çuditshëm!

— Oh, ju jeni akoma i freskët, — u hodhën me një gojë Ibëri, Tereza dhe Novruz Begolli. Ky i fundit çoi gotën e verës në lartësinë e syrit dhe ngriti me solemnitet një shëndet për jetëgjatësinë e shokut Mitro.

— Do ta pi me fund për ju, shoku Mitro. Kur ju kemi mes nesh na dukeni të zakonshëm, por kur mendojmë se si e mbollët këtë pemë të bukur dhe të vështirë, që quhet kooperativë, si e bëtë të hedhë rrënjë e të lulëzojë, na bëheni heronj. Hajt gëzuar! — tha Novruzi i kënaqur me ligjëratën e vet dhe shkulloi gotën me dy të hequra.

— Sa ju doli pensioni, shoku Mitro? — pyeti Gaspri, duke u mbllaçitur.

— Doli ca, — u përgjigj Mitroja duke qeshur.

— Domosdo, goxha kuadër, — shtoi po me të qeshur Gaspri.

— Po si erdhët kështu pa pritur, shoku Mitro, pa lajmëruar! — u hodh Tereza. Së paku të ngrohni dhomat! Se të themi të drejtën këto dhomat e hotelit tonë janë ca të ftohta! Ja, ja, filluam ne me ankesa! — në fytyrën e gruas u përhap një buzëqeshje e gjerë.

— Moj, pritet miku me këmbët e para? — ndërhyri Ibëri duke lazdruar sytë si zog. Çunaku i veshur si burrë me gravatën e lidhur fort në fytyrë, gjë që nxirrte më mirë në pah gushën e tij të parakohshme, reagoi menjëherë pas njoftimit të Terezës për dhomat. Ishte nipi i Mitros. Më vonë u muar vesh se ai i qepej nga pas gjyshit këmba-këmbës kudo ku shkonte. Nipi nuk lejonte që plaku të bënte më shumë se 80-90 kilometra rrugë gjatë një dite dhe as të flinte në dhoma teke.

Ndërkohë në tryezë u ndez biseda për traditat e Barbullojës. Mitroja erdhi në qejf.

— Që në fillim e kuptova se njerëzit këtu ishin me humor, — tha. — Dhe kjo cilësi i ndihmonte për të përqaftuar shpejt të renë. Ju e dini se fshatarët e Barbullojës u futën qind për qind në kooperativë pa asnjë mëdyshje. Por edhe tabutë bënin punën e tyre. Ja, për shembull, lagunat këndeje ishin të pasura me pulzë. Fshatarët nuk e gjuanin pulzën. Pulza është

një shpend që nuk bie nën nivelin e rosës, po të dish ta gatuash. Unë i hëngra i pari pulzat këtu. Dikujt-dikujt i vinte ndot. Po pse të vjen ndot, o derëzi? Dynja-ja hanë bretkosa, kërminj! Nuk e di, e hanë tani pulzën në Barbullojë, apo jo? — pyeti Mitroja duke u kthyer nga kryetari.

— E hanë, — u përgjigj Ibëri në vend të kryetarit.
— Madje disa të rinj kanë zënë të hanë edhe mishin e bretkosës.

— Ashtu, më rrofsh, — u gëzua Mitroja.

Ndërsa në tryezë vazhdonte biseda, nipi tërhoqi mënjane Terezën dhe i pëshpëriti në vesh se dëshëronte t'u hidhte një sy dhomave të fjetjes.

— Po ç'është nevojë? — kundërshtoi gruaja me një bujari të shpallur në fytyrë. — Ejani sonte nga ne!

— Shkojmë! — tha nipi i vendosur.

— Oh, unë qyqja që nuk e dija qysh më parë! Të kisha vënë reflektorët! — mermëriste nëpër dhembë Tereza teksa printe drejt dhomave. Ata kaluan mespërmes sallës dhe u zhdukën prapa një dëre në krahun e majtë të banakut.

Ferdinandi shpoi me bërryl Adrianin dhe duke qeshur nën zë, tha:

— Nuk i përlau dot Ibëri.

Ludoviku mblodhi shuk paketën e cigareve dhe e hodhi mbi taketuke. Çifti që kalonte muajin e mjaltit hanin në heshtje.

— Nusja është e bukur, — tha Ferdinandi.

— Ata sytë si të gjinkallës e prishin ca, — tha Ludoviku.

— Kurse dhëndërrin se si më ngjan, si mallotë!

— Nuk e marr vesh, si nuk mërzhiten gjithë ditën bashkë! — vërejti Ludoviku.

Adriani trazoi me një fije të djegur shkrapseje hirin e cigareve në tavëll.

— As ke për ta marrë vesh, — tha me zë të shuar dhe menjëherë u tendos duke parandjerë reagimin e ashpër të Ludovikut.

— Pse, ti më demek e merr vesh?

— Po, e marr vesh.

— Pa hë, na e thuaj edhe ne, injorantëve!

— Ata duhen. Kam lexuar se të të plotësojë një vajzë do të thotë emancipim.

— Leri librat! — tha Ludoviku. — Këtu jemi rritur të gjithë, pranë «Ngjalës». Kemi parë e jemi njohur me lloj-lloj njerëzish!

— Ti nuk dëshëron të më kuptosh, — tha Adriani i ngrysur. — Ti kujton se emancipim do të thotë të hidhesh lule më lule!

Ludoviku u skuq. Për herë të parë ngriti sytë e turbullt dhe e vështroi tjetrin drejt.

— Sa është ora? — pyeti Skënder Abdyli. Adriani ktheu kokën dhe i erdhi çudi që ai goxha burrë ndodhëj akoma në lokal. «Edhe Skënderit i është mërçitur familja», mendoi me trishtim.

— Sa dje në këtë vakt, — u përgjegj Ferdinandi.

— E gëzofsh, — tha Skënderi.

Dhëndri që kalonte muajin e mjaltit në Barbullojë u përgjigj «tetë e njëzet» duke falenderuar para-prakisht. Memeci Hysen u përpush në karrigë dhe hapi sytë i trembur.

— Hihih! — u zgërdhi si të kishte parë një ëndër gazmore. Pas tij ia plasën gazit edhe të tjerët me përjashtim të nuses, e cila rrotulloi sytë në të gjitha anët, pastaj i nguli në fytyrën e bashkëshortit, gjest ky i njëvlershëm me urdhërin «dalim!»

Ndërkohë nipi i Mitros dhe Tereza u rikthyen në lokal. Nipi ishte në mëdyshje. Dhomat në fakt s'kishin të sharë: me ujë, me ndriçim, me shtretër të rregullt, me çarçafë të pastër. Veçse, ashtu siç kishte paralajmëruar Tereza, ishin ca të ftohta. Por mund të gjendej një zgjidhje: t'u merrej reflektori çiftit që kalonin muajin e mjaltit në Barbullojë dhe të vendosej në dhomën ku do të flinte Mitroja me nipin. Tereza, me gjithë respektin e thellë për ish kryetarin dhe nipin e tij simpatik, nuk e merrte përsipër transferimin e reflektorit. I mbetej nipit ta hidhte këtë hap. Por Mitroja e ndaloj të hynte në biseda të tilla me çiftin.

— Nipçe mos më duaj kaq shumë! — tha i zemëruar.

Kryetarit të kooperativës i pëlqeu fort ky qëndrim i plakut dhe trokiti gotën e verës me të tijën.

— Epo s'keni nga t'ia mbani, ratë në grackën e Ibërit, — tha duke i shkelur syrin në fshehtësi Terezës.

Atmosfera në tryezë u bë përsëri e gëzuar. Novruz Begolli, që për shumë minuta kishte ndenjtur si i ngrirë me duart e fshehura nën tryezë, i hapi krahët më në fund, siç hap pula fletët para se të fluturojë, e tha:

— Ç'është kështu me juve, shoku Mitro! S'po pini fare!

— Ku të le ky! — ia bëri Mitroja duke përkëdhelur me shpoti kokën e nipit që tani, nervoz dhe i prekur për pengesën që i vuri gjyshi inisiativës së tij, dukej akoma më kalama. Mitroja e piu gotën me fund.

— Gjak e dhjamë, — tha Ibëri Rama dhe bëri fësht pas dere që të bënte gati shtëpinë.

Gaspri ngriti shishen të mbushte përsëri gotën e zbrazur të Mitros, por nipi ia mbajti dorën.

— Dale, ta marr vesh! Kush është i parë këtu? — thirri çakërçejf Gaspri.

Vërejtja e tij gazmore mbeti pezull. Mitroja ishte bërë dyll. Dejtë e qafës i dridheshin, ndërsa nuk i hiqte sytë nga tryeza e djelmoshave.

Atje, Ludoviku që gjatë gjithë kohës kishte ndjekur me sy lëvizjet e Ibërit dhe të personave të tjerë në tryezën kryesore, sapo kishte thyer një gotë në pëllëmbët e mbledhura si kupë dhe tani po hiqte copat e qelqit nga mishi.

Memeci Hysen klithi i tmerruar kur pa gjakun të pikonte në dysheme. Qafëmbledhur u sul për të ikur, por në vend që të gjente derën u përplas pas murit anash, u shemb në dysheme, u ngrit përsëri dhe duke zgjatur kokën si të breshkës, çau si plumb pushke përjashta.

Adriani ishte zverdhur, kurse Ferdinandi kishte rudhur buzët dhe tundte kokën në shenjë mospajtimi.

Ludoviku vazhdonte të hiqte qetësisht thërmijat e qelqit nga mishi i pëllëmbës. Skënder Abdyli prishi me shpejtësi tre katër cigare dhe ia vuri mbi plagë. Mitroja ndërkohë ishte ngritur nga karrikja në mënyrë protestuese. Me krahët ngjeshur pas të qepurës së pantallonave, duke i hedhur hapat ngadalë por vendosmërisht, ai dukej se po shkonte drejt një gjëme.

— Përse more djalë, përse,? — pyeti duke iu marrë fryma.

Ludoviku liroi nofullat e kyçura dhe foli buzagaz:

— Desha të paguaj diçka, xhaxha!

— Të paguaje për një gjellë, jo për gotën! — thirri Gaspri kërcënueshëm. Ra heshtja. Ludoviku vështron-te me qesëndi pëllëmbën e mbuluar me duhan që ngjante me një rrasë të veshur me lëmashk. Mitroja

u mat të thoshte diçka, por në çastin e fundit u pendua. Buza e poshtme i dridhej. Nipi e kuptoi mënjëherë se kjo skenë ishte e dëmshme për emocionet e plakut, i futi krahun dhe e tërhoqi nga vetja. Mitroja iu bind pa fjalë. Gaspri tundi gishtin kërcënueshëm sikur thoshte «do ta shohim, do ta shohim» dhe vrapoi të arrinte Mitron.

Tereza, që mezi kishte pritur sa të dilnin shokët kryesorë, klithi në kulmin e nervave:

— Përjashta! Përjashta se do ta mbyll! S'u vjen turp. Vagabondë! Skënder! Marsh te gruaja! Te kalamanjtë! Pesë ke apo gjashtë? Vetë i ke bërë, s'i bëra unë, pse më shikon me inat! S'u ka faj njeri që bëni nga një krye vitit e pastaj s'u dalin lekët për fërnët! Ehi, iu duket fushë me lule puna në shtrat, po pas nëntë muajsh si ju duket? Hajde çuna, në shtëpi! Ikni shihni televizor! Tfy, u shpëlaftë i paudhi. Na e nxitë faqen para miqve! Rraca e keqe! Përjashta! Përjashta! More, ku vajti kamarieri? Prengë! Prengë! Më la vetëm! Për zotin më la vetëm! Hajde, zhdukuni tani se do ta mbyll!

Furia e Terezës ndeshi me indiferencën e rrezikshme të djemve që nuk tundeshin nga karriget.

— Moj, ç'të pjell mendja? — u hodh Skënder Abdyl; — Në po të duam hedhim valle këtu dhe s'na ndalon as ti, as Ibëri yt! Është lokali ynë ky!

— Ha, ha, ha! Qenka lokali juaj! — u zgërdhi Tereza — Të ishte për ju i kishte mbirë ferra në derë! Ky është lokali i atyre që dinë të bëjnë qejf! E more vesh tani? Hajde, natën e mirë!

Skënderi drejtoi trupin e madh. Dy xhunga zemërimi i rrëzinin sipër vetullave. U duk se në ato çaste kishte aq fuqi sa ta shkulte me themele hotelklubin.

Terezës i hyri frika kur e pa ashtu të madh, të zemëruar, të gatshëm për sherr. Skënderit mund t'i shkrepj të përmbyste tryezat dhe ajo s'mund t'i bënte ballë.

— Marshalla! Marshalla! — ia bëri me një zë lajktar. — Ishalla bën një djalë, o Skënder! E ke punuar tokën sivjet, e ke bërë qilizëm apo jo? Hi, hi, hi, hi! — kukurisi ndërta u nis drejt banakut duke përdredhur vithet groteske.

Adrian Miraj ndjeu neveri. Sakaq dyshemeja u trondit. Skënder Abdyli i kishte rënë fort me thembër! Ai goditi edhe dy tre herë të tjera pa i hequr sytë e mjegulluar nga Tereza dhe qetë-qetë u nis drejt daljes.

KAPITULLI I PESTË

Jashtë ishte natë e freskët e tetorit me kupolën e lartë plot yje të bardhë. Çifti që kalonte muajin e mjaltit në Barbullajë shëtisnin në rrugën para hotel-klubit, duke folur frengjisht. Skënder Abdyli u tha natën e mirë dhe, pavetdijshëm, ndërsa pati dëshirë të dëgjonte kuvendimin në gjuhë të huaj të çiftit, nxi-toi hapat, lidhi duart prapa dhe zuri të fishkëllente melodinë e një kënge të vjetër nizamësh.

Fërshtëllente kot, pa ndërë këngën, ndërsa diku, në një kënd të përfytyrimit të tij, skuqte pëllëmba e për-gjakur e Ludovik Margjonit dhe lëviznin vështtrimet pothuajse pa shprehje të djemve të tjerë, sikur e di-nin me kohë se Ludoviku do ta thyente gotën. Skën-si i vinte për ata djem të rinj që nuk e ndjenin më jetën, që çonin netët kot duke iu kallzuar njëri-tjet-rit sa për të thënë se jemi, që flisnin kaq rrallë madje me një përbuzje të brendshme për fjalët e gjuhës shqir-pe, që kishin frikë të martoheshin... Kur kishte qenë i ri, optimizmi ishte në modë, gjithkund flitej e shkruhej për një ardhmëri të shkëlqyer dhe prandaj ai, sikurse moshatarët e brezit, nuk kishte pasur dilema për t'u martuar, për të bërë fëmijë. Gjithsesi, ky mashtrim i ëmbël, i verifikuar më vonë, i kishte dhënë jetë rinisë së tij, ndërsa brezi i tanishëm, pavarësisht se propoganda

e ftonte në eopera të reja, nuk përgjigjej, nuk besonte, por edhe nuk shpresonte. Një ditë ata do t'ja fillojnë shkatërrimeve, tha me vete Skënder Abdyli. Ai u çudit se si i lindi në kokë ky mendim. Përfytyrimi i asaj që do të ndodhte sikur u shkep dhe u dynd nga magma e errësirës pa fund dhe ai ngriu në vend. Pastaj shtatë-tetë sekonda më vonë, ndërsa imagjinimi i pakmëparshëm i kaloi dhe nata e kredhur në paqe u kallzua përsëri ashtu siç ishte, e gjeti veten duke rrahur tokën me këmbë. Një ndjesi lashtësie, e paprovuar më parë, tepër e qartë dhe tepër konkrete, e lidhi si me zinxhirë me një të kahershme prej nga e dinte se kishte ardhur, por që nuk e kishte prekur kurrë. Dhe kështu iu fanitën të parët që kërcenin vallen e moçme të rrahjes së tokës me këmbë. Ndofta kjo është vallja e mallkimit për tokën që jep kaq pak për ne, tha me vete.

Atë ditë kishte marrë rrogën e pesëmbëdhjetëditëshit. Gjithsejt njëqind e pesëdhjetë lekë. Paratë e mbledhura shuk i kishte rrasur në xhep dhe as kishte qejf t'i prekte. Kishte punuar sa për dy, njëzet e katër norma për trembëdhjetë ditë pune, pak kush i fitonte. Mirëpo sa para bënte. Në mbrëmje kishte shkuar në hotelklub, gati kot, i bindur se nuk do të mernte gjë, sa për të vënë në provë durimin. Çka! Rrihej edhe pa marrë gjë. Po të bëheshe burrë, rrije edhe pa marrë gjë. Mirëpo s'të linte rehat Tereza, ajo shtërpane llafazane! Si kishte thënë ajo, si? Vetë e keni fajin që bëni një vathë kalamaj? Eh, unë si Skënder jam kampion në këtë pikë. Tridhjetë e pesë vjeçar me pesë kalamaj! I gjashti po përgatitet! Bukur, për zotin! Ah, sa budalla që jam! Në vend që të bëj dy fëmijë, bëj gjashtë! Edhe në Stom janë tepër, pale në Barbullojë! Lexoj parullat unë! Besoj rrenacakët e Tiranës! Mirë të më bëhet!

Me këto mendime në kokë hyri në oborrin e shtëpisë së vet njëkatëshe, u afrua me hapa të lehtë të dritaret dhe vuri sytë në xham. Adilja, e shoqja, kishte vënë një pulë në mes të këmbëve dhe po e operonte në gushë. Gratë e Burbullojës ia kishin marrë dorën

pastrimit të shpendëve që helmoheshin me kokrra gruri të dezinfektuar.

Pulën nuk e mbanin këmbët. Qëndronte mbi bisht, por te sytë i vizëllonte shpresa e jetës. Skënderi hyri brenda dhe uroi gruan për operacionin. Pastaj u përkul mbi pulën dhe i uroi edhe asaj shërim të shpejtë. Pastaj largoi një perde bojëqielli që zinte hyrjen për në dhomën tjetër. Vajzat atje po flinin. Fytyrat e tyre të kthyer në pozicione të ndryshme ndriçonin në gjysm-errësirë. Skënderi ndjeu t'i rëndonte diçka mbi buzën e poshtme. Në çast pañdehu se po i dilnin mustaqe dhe instinktivisht preku me gishta mishin e ashpër mbi buzë. Aty dridhej pa ndërprerje një nerv. Ai e lëshoi perden me një gjest të prerë, u ul në karrige, ndezi një cigare dhe tha:

— Nuk prisha asnjë lekë!

Adilja i mëshoi më fort letrës xumpara mbi fundin e nxirë të një tenxhereje. U përhap një zhurmë lënduese. Skënderi u ngrit nga karriga dhe e pushtoi në bel me kujdes.

— Po ti pse më le të iki nga shtëpia? — thirri ai. Gruaja fërgëlloi e alërmuar dhe ai mbylli sytë, e ktheu atë nga vetja, mbështeti kokën në krahërorin e saj dhe dëgjoi aq qartë goditjen e aortës dhe një mori rrahjesh të tjera sikur krahërori i gruas të ishte prej letre. I merreshin mendtë.

— Ti je e re, je shumë e re, Adile, — mërmëriti me një zë të plagosur.

— Ne u martuam shpejt, — tha ajo, por duket se Skënderi nuk e dëgjoi.

— Unë jam kafshë! — briti dhe kafshoi buzën e poshtme.

Pasoi një heshtje e rëndë, ai ngriti kokën i trembur. Në cepat e syve të tij të skuqur zvarrisej një ulërimë.

— Mos kështu, mos se është gjynah, — tha Adilja duke i ledhatuar faqet.

— Nxirre këtë fëmijë, Adile! Nxirre sa s'është vo-

në. Ik diku dhe nxirre... Mjaft... i kemi pesë vajza. Mjaft i kemi dhe... të më falësh, pash zotin! Ë? — ai u gëlltit si i kapur në faj dhe instinktivisht ngriti dorën për të prekur gjuhën.

— Jo, mos e nxirr! — tha pastaj. Është gjynah, është shumë gjynah ta nxjerrësh.

Adilja i përkëdheli faqet rishtaz dhe shkoi të lidhte pulën e operuar pas karrigës.

— Erdhi prapë mësuesi për unazën, — po thoshte ndërkohë. — E ngriti edhe pesëqindë lekë pazarin. Kam frikë se do t'ia shes...

Ishte fjala për një unazë me gjashtë gurë smeraldi, të cilën Adilja e kishte kujtim nga e ëma. Mësuesi i matematikës një riosh kaçurrel, ia kishte vënë syrin dhe javë për javë e torturonte Adilen duke e rritur çmimin.

Hija e madhe e Skënderit lëkundej në mur. Diçka fërfërinte lehtë në oborr. Ai u afrua te dritarja dhe vështroi jashtë. Nga tenda e rrushit këputeshin pa pushim gjethet e zverdhura. Tenda ishte në terr, përmbi ndriçimin e dobët të oborrit dhe gjethet e heshtura që binin ëndërrisht si mbi një terren hënor, dukeshin sikur ishin nisur prej larg, prej shumë larg për t'u prehur më në fund në tokë. «Kështu po zbresin në gjithë katundin», mendoi.

Ai shkoi të flinte, u xhvësh në terr me ngut, sikur koha për t'u kredhur në harrimin e mirë të gjumit po mbaronte, dhe më tej s'u ndie, më gjersa kënga e gjelave erdhi drejt e në dhomën e tij bashkë me dritën miturake të mëngjesit. Ai shtriu dorën të prekte trupin e Adiles, por vendi, ku kishte fjetur ajo ishte bosh. Hapi sytë. Errësira rrëshqiste ngadalë nga faqet e mureve dhe ngjeshej në qoshet e dhomës, prapa raftit të rrobave, anash kornizave të varura në mur. Atij i mbetën sytë te fotografia e madhe e martesës. Në fakt nuk kishin dalë ditën e dasmës, por nja dhjetë ditë prapa. Në letër ishte fiksuar e qeshura e lirshme e

Adiles, që sikur u frynte me buzë mbeturinave të fundit të mugut sipër korrnizës.

Në kuzhinë u dëgjua kërcitja e kripës në vajin e djegur. Ai e mori me mend se Adilja po fërgonte rrishtat e bukës të ngjyera me vezë për vajzat. Ndërkaq në rrugë, nja njëzet metra përtej dritares, një njeri kalonte duke kënduar këngën «Shkova në prru me la qemerin».

Kjo këngë ishte në modë kohët e fundit. Këndohesh gjithandej, qëkur zbardhte deri sa ngrysej. Djemtë e Barbullojes e kishin zakon të jetonin disa javë e muaj me zbulime të reja, me një këngë, me një batutë, me një anekdotë, madje nganjëherë edhe me një fjalë pikante që shkëputej nga konteksti i një historie dhe tingëlonte pastaj pa kuptim. Skënderi mbante mend: kur kishte qenë çunak, në fshat që përhapur si epidemi fjala «rring», të cilën dikush e solli peshqesh nga qytati. Prapa pjergullave të rrushit në kopshtije, te berberi, në oborrin e shkollës, në mëngjes dhe në mbrëmje dëgjoje gjithandej fjalën e pakuptueshme «rring». Dukëj sikur në Barbullojë binte vazhdimisht një zile shëtitëse. Një mbrëmje, duke ardhur rrotull nëpër shtëpi. Skënderi ia kishte bërë papritur «rring». Nëna dhe motra e tij ishin shikuar sy ndër sy sikur pyesnin «çfarë thotë ky kështu?» dhe Skënderi ishte skuqur nga turpi. Pas asaj mbrëmjeje nuk kishte thënë më «rring» gjersa ajo fjalë u harrua si të mos kishte qenë kurrë. Por vite më vonë, gjatë shërbimit ushtarak, duke kaluar një natë me togën ndanë një fshati të Gjirokastrës, në errësi kishte dëgjuar dikë t'ia bënte «rring». Ai kishte kthyer kokën me vrull, gjithë mall, andej nga kishte ardhur zëri. Nuk kishte parë gjë. Dhe kishte dashur të thërriste me zë të lartë «rring» si për t'i kthyer parrullën e njohjes njeriut në errësi.

Në Barbullojë dilnin fjalë, këngë, shprehje të reja që përdroreshin e flakeshin si lodrat e kalamajve. Ca hidheshin shpejt, ca të tjera mbaheshin më gjatë, si përshembull shprehja «s'kalon pasha», e shkëputur nga teksti i një kënge popullore. Skënderi e shikonte qarkullimin

e shprehjeve tamam si një lojë, si një lojë njerëzish që nuk janë më kalamaj por që kanë nevojë, kërkojnë dhe gjejnë lodrën e tyre. Përveç kësaj loja e shprehjeve ishte edhe shenjë njohjeje, anëtarësie e barazie në kolektivitetin e njerëzve që bënin të njëjtën jetë nën çati të ndryshme.

Skënderi e dinte se pas pak ditësh nga trupi i gjatë i këngës «shkova në prru me la qemerin» do të veçohej një gjymtyrë, ndofta fillimi i vargut të parë «Shkova në prru», ndofta fillimi i vargut të katërt «Lumja ti», varet se kush do ta kishte tingëllimin më të fortë. Por ai nuk do të shqiptonte asnjërën, as tjetrën gjymtyrë të këngës. Ishte shumë i rritur tani.

U ngrit nga shtrati, u vesh shpejt e shpejt dhe zgjati kokën në derë t'i thoshte diçka Adiles. Ajo po ushqente në oborr pulën e sëmurë duke trembur me thupër pulat e tjera që sulëshin si të babëzitura t'i rrëmbenin ushqimin.

Ai u la te lavamani në aneksin e kuzhinës dhe ndër-
sa kthehej në dhomë, thirri me zë të lartë:

— Adile, eja pak kur të mbarosh!

Susta e shtratit të vajzave kërciti. Skënderi mbylli derën pa bërë zhurmë. Nxorri nga xhepi i pantallonave disa kartmonedha dhe i palosi mbi komo. Pastaj rrëmoi në xhepat e tjerë dhe nxorri ca lekë të vogla që bëheshin gjithsej një grusht. I la edhe ato mbi komo. «Çohuni vajza, Alma ikëm ne», thirri Adilja nga kuzhina dhe, ai u tendos sikur po bënte një faj.

— Mirëmëngjes — tha Skënderi, kur ajo, gjithë duke u ngutur, u fut në dhomën e gjumit.

Skënderi u përpoq të dukej sa më i qetë, edhe pse në shpirt i trazohej diçka, as vetë s'e dinte çfarë. «Ç'ke, fol!» ia bëri Adilja me duar. Ai tregoi me gisht kartmonedhat e vëna njëra mbi tjetrën dhe përgun e vogël të dhjetëshve e tridhjetëshve mënjanë.

— Këto po i mbaj unë për cigare, — tha duke i mbledhur në grusht paratë e vogla. — Këto të tjerat mbaji ti. Dakort? Tash e tutje do t'i mbash ti lekët.

Adilja e kundroi tufën e parave me një habi primitive në sy sikur s'kishte parë kurrë gjëra të tilla.

— Për këtë më thirrre? Nuk i mbaj, — tha ajo dhe u nis të dilte. Skënderi i vuri kurrizin derës.

— Mbaji paratë, mos e zgjat më!

— Nuk i mbaj pra! Kemi biseduar njëherë kush duhet t'i mbajë paratë.

— Ke për detyrë të më lajmërosh dy ditë para se të mbarohen...

— Kam për detyrë të fitoj aq sa mundem dhe të shoh punët e tjera të shtëpisë.

— Merri tani! — tha Skënderi gjoja i lehtësuar nga një barrë e pakëndshme dhe përplasi shuplakat sikur thoshte «uf, shpëtova». Shkoi te pasqyra të krihej, u vonua kot duke lidhur këpucët.

— Kështu t'ia kishim bërë me kohë, — thoshte me kokën e përkulur midis këmbëve. — Ti i di shumë më mirë se unë skutat dhe vrimat e ekonomisë. Ç'dua unë me paratë? Apo që të më gënjejë mendja dhe t'u fus një sharrë te Tereza. Grave nikoqire u lihen lekët, moj. E di apo nuk e di? — shtoi me një ton akoma më mik-lues.

Adilja s'pipëtinte. Ai ngriti kokën dhe me bisht të syrit pa duart e saj të mbledhura në prehër dhe tufën e kartmonedhave të paprekura.

— Më shëndet, pra, me faqe të bardhë, — tha duke qeshur dhe u nis të dilte.

— Shko, unë nuk i prek! — tha Adilja.

Ai i vuri përsëri kurrizin derës, kësaj radhe nervoz, por edhe i hutuar.

— Pse nuk i mban? Nuk janë helm!

— Nuk i mbaj pra! Hape derën se dua të shkoj në punë!

— Do t'i mbash se s'bën! Ndryshe i bëj copë-copë! — e ngriti zërin Skënderi.

— Pse t'i bësh copë-copë? Mbaji në xhep! Ti je burrë këtu, të ka hije t'i mbash! — në zërin e Adiles ndjehej një ironi fare e lehtë.

Skënderi u platit pas dere si i goditur keq, pa të drejtë. Hiqej i vrarë, megjithëse mendja i thoshte se mund ta bindte Adilen kur t'i donte qejfi. Bam-bam-bam, kërciti dera prapa kurrizit të tij. «Babi, hape derën!» thirri vajza e vogël. Brenda krahërorit të tij hovi përpjetë diçka. Pa fuqi, pa shpirt, si një automat, i tha Adiles se në këtë mes, pra në kundërshtimin e saj të prerë për të mbajtur paratë, ishte një hile. «Babi, babi, hape derën!»

— Nuk ka asnjë hile! — tha Adilja.

— Babi, o babiiii, — zëri i vajzës së vogël u zgjat vajtueshëm. Ai hapi derën me vrull. Vajza vështroi një çast e trembur, pastaj mori zemër nga buzëqeshja e tij, iu hodh në krahë dhe iu ngjesh pas krahërorit krejt e mekur. Atij iu bë se dikush ia mblodhi zemrën me dorë, pastaj ajo dorë e padukshme sikur u çel dhe në tërë kurmin ndjeu t'i përhapej diçka e ngrohtë, ngacmuese, e dhemshur. Zuri ta puthte vajzën në flokë, në qafë, në duar, kudo ku i zinin buzët, ndërsa ajo i përdridhej gjithë qejf sa në një krah në tjetrin. «Përbesë e ka hāk një dru të mirë ajo shterpania e «Ngjales»,» mermëriti Skënderi. Adilja nuk mori vesh gjë.

* * *

Barbulloja ishte zgjuar nga gjumi dhe ishte e lodhur. Vajzat dhe nuset e reja me drapërinjtë nën sqetull tërhiqnin çizmet e mëdha drejt orizoreve dhe arave me misër. Në katër pesë vende këndohej kënga «Shkova në prru me la qemerin» Melodia e saj e shtruar sikur mbante pezull korreset e orizit, gjethet e tulatura të pemëve, gratë që çonin fëmijët në çerdhe, plakat që bënin muhabet para dyqanit të qumështit, rrokullimën e memecit Hysen drejt hotelklubit, zënkën komike faqe të gjithëve të flakëthinjurit Ndue Margjoni me brigadier Palushin që ishte një mesoburrë hijerëndë, me

një fytyrë si të djegur plot preнка dhe me kapele doku të rrasur në kokë si paruke, të cilën e hiqte vetëm kur flinte.

— Me ç'mendje hidhni grurë të helmatisur rrotull shtëpive pa lajmëruar! — bërtiste Ndue Margjoni. — U mblodhtë ju, tre katër veta që i keni shtëpitë në kodër! Të hedhim helm anës rrugës, thatë. Të cofin pulat! Punë e madhe! Sa qejf keni t'ia fusni fshatarit mor, aman! Grurë do të merrni nga këto baçe të vogla si përparëse? Arat e grurit janë në fushë, jo këtu, por juve ju kanë plasur sytë. Për një plesht digjni jor-ganin! Po sikur të hajë kokrra gruri një fëmijë i paditur? Po sikur të mbush një kupë me kokrra të helmatisura unë dhe t'i hedh në magjen e furrës? Gjithçka bën vaki gjersa helmi është sheshit!

Ndoi shkumëzonte, duke kruar kokën para dhe prapa kurse brigadieri e vështronte me qesëndi sikur thoshte: «Të ngordhën pulat? Me shëndet!»

Adrian Miraj ishte ndaluar te pasarela poshtë hotel-klubit. Liljana po vinte prapa shoqeve duke i hedhur hapat panatyrshëm, sikur kërcente mbi një litar të padukshëm që dikush ia hidhte vazhdimisht tek këmbët. Dhe litari i padukshëm, mendoi ai me një lloj ankthi dhe frike se mos Liljana më në fund do platosej përdhe ose do të ngrihej fare në ajër, pra litari i padukshëm nuk ishte gjë tjetër pas atij vargut përqeshës «lumja ti» që dikush e këndonte me një ngarkesë të pamasakruar provokimi pikërisht për Liljanën. Dikush na ka parë mbrëmë, mendoi Adriani. Pavetëdijshtëm bëri me dorë një gjest nervoz sikur i thoshte mjaft asaj kënge idjote. Si një ëndërrim brutal i pakthyeshtëm në mendjen e tij u përhi një skenë filmi me kuaj që suleshin si të tërbuar në një fushë të hapur deri në kufijtë e mjegullës dhe atje rrëzoheshin mbi njëri tjetrin krejt papritur. Ai ndjeu një dridhje elektrike diku në një kënd të trupit. Ç'dreqin kam kështu? tha dhe ngriti sytë e lodhur nga rruga me parandjenjën se atje tashmë batërdia ishte

bërë. Por jo. Liljana i kishte kapërcyer të gjithë litarët, u kishte rezistuar çapojve të këngës që kishin dashur t'a rrëmbenin në hapësirë dhe ja tek po vinte duke u hedhur mbi hapat e lehtë. Pse nuk i ka faqet e purpuruara? tha Adriani me vete. Pse është kaq e zbehtë? Kushedi ç'heq atje, në atë gërmadhën e Simonajve që ditën nxjerr tym nga të katër anët sikur e ka marrë flaka nga brënda.

Natën e kaluar, ndërsa nuk e zinte gjumi, kishte thurur një plan rrëmbimi të Liljanës. Me kuaj, me kanxha, me litarë. Por kjo përpjekje mendore e kishte përplasur pa fund me shtëpinë e çuditshme të Simonajve, ku secila nga shtatë kurorat që banonin në të, kishte shtuar krejt pa plan dhoma të vogla ngjitur me të parat. Ditën ajo banesë shëmbëllente me një hieroglif. Pranë gurit skuqte tulla, zardhte betoni, nxinte katramaja, eterniti. Ndërsa natën, kur qëllonte të ndizeshin të gjitha dritat, përngjiste në një vapor të ankornuar në mes të errësirës.

— Mirëmëngjez! — tha Liljana.

— Mirëmëngjez.

Liljana ishte kërehur bukur, kishte veshur një pulovër të re bojë qielli që i shkonte shumë. Nga fytyra dhe rrobat e saj shpërndahej një aromë e mirë sapuni dhe mollësh. Adrianit se si i erdhi që natën e kaluar ajo kishte ëndërruar dhe ishte përpjekur si e si të hijeshohej për sytë e tij, kurse ai, në të kundërtën i kishte qarë hallin dhe kishte kryer në imagjinatë rrëmbimin. Ishte ngjitur me litar në dhomën e saj e kishte zgjuar nga gjumi dhe i kishte mërmëritur: Eja Liljana, këtu të zihet fryma, ajri është plot me lagështirë dhe llagëmet, desha të them koridoret janë shumë të ngushtë dhe ti rron këtu netëve si në çeli, nën shtypjen e tavanëve të ulët, nën kërcënimin e zjarreve, pra ti rron në këtë ferr, ti që je aq e bukur dhe zemërmadhe, ndërsa unë bredh i lirë netëve me të drejtën time prej mashkulli. zgjas krahun në errësirë krejt kot sepse e di që nuk je aty dhe dora më mbetet pezull dhe më vjen

t'i sulem me bomba dore kësaj gërmadhe, pastaj më vjen të thërras në kupë të qiellit «Liljanaaaa», por para se të thërras unë, errësira dridhet si krahët e një shpendi të plagosur dhe dëgjohet rënkimi i Lazër Bocit. Atë e kanë mbërthyer dhimbjet e stomakut. Kjo do të thotë se moti i mirë i ka ditët e numëruara, se pas pak do të fillojnë shirat, nga gryka në veriperëndim do të lëshohen erërat tona të vrullshme. Dridhem në terr, më bien ndërmend orizoret që drëmisin dhe shkërmoqen në diell ditë ditës. Kundër vullnetit, i tmerruar, i përfytyroi duke rënë nën kamzhikun e stuhisë, duke e ngjeshur në baltë nga shiu i ngrirë...

— Ç'ke kështu? Je zverdhur? — ia bëri Liljana. Zëri i saj i kthjelltë sikur e sollti në një botë tjetër, të pastër, të brishtë, fluide.

— Edhe ti dukesh e zbehtë, — tha. — Pse je e zbehtë ti?

— Unë kështu kam qenë gjithmonë. Kështu e kam ngjyrën e lëkurës.

Adriani heshti një hóp, «mos më thuaj mua, ajo gërmadha i ka fajet», pastaj përplasi qepallat dhe tha:

— Kam për të të vjedhur një ditë, do të të nxjerr prej andej. — dhe bëri me dorë nga shtëpia e hallakatur. Mua më pëlqejnë ceremonitë. Do të kisha qejf të të merrja nëse me krushq, me bori, me pëllumba. Por kushedi sa hënë ndërrojnë deri atëherë. Ti s'do durosh dot gjatë në atë shtëpi. Ndaj do të të vjedh...

Liljana e pa me habi dhe tallje. Ajo dukej shumë e bukur me atë shprehje mes habisë dhe talljes.

— I marrë, po kur? — tha me të qeshur. Ndërkaq vuri re se vajzat e tjera kishin kaluar shumë përpara, përshëndeti dhe u nis me nxitim t'i arrinte.

— Eja në mbrëmje! — Adriani tregoi me dorë varrezat e vjetra. «Jo», ia bëri ajo me gisht gjithë duke ikur. «Po», thirri Adriani dhe u kthye prapa sepse nuk deshiti ta shihte atë duke refuzuar me gisht.

KAPITULLI I GJASHTË

Një veturë «Aro» u fut me shpejtësi në sheshin para zyrave të kryesisë dhe kur u duk se po përplasej me shkallaret e jashtme, frenoi në vend, duke ngritur pluhur, gjethe e copa letrash nga toka. Ibër Rama që ia kishte këshilluar në vesh shoferit këtë aventurë të vockël qeshi me djallëzi, teksa pa shokun Mitro që po çante fytyrëprishur përmes pluhurit e letrave fluturake. Ky i fundit pra nuk nguroi ta pësonte të keqën për të marrë zemër kundër saj. Me këtë rast shprazte edhe një pjesë të rezervës së vërejtjeve që veteranët e karrierës së lartë politike e bartnin kudo ku shkonin.

— Ah! — ia bëri duke pasur ndërmend natën e paqme dhe mëngjesin e bukur në shtëpinë e Ibërit. — E keqja nuk mungon t'i zërë pritë humorit tonë!

Me atë të ecurën karakteristike, mu sikur e priste ujët e hollë, përparoi drejt kryetarit të kooperativës, të cilit iu drejtua kështu:

— Ç'janë gjithë këto papastërti në shesh, shoku Gaspër?

Gaspër Matrizi, një krijesë pak a shumë brënda llojit të kryetarëve që e kujtonin veten të sakrifikuar në fshat dhe prandaj nuk mbanin kurrfarë diete, me këmbë të trasha e të shkurtëra, me krahët gjithashtu të trashë që i qëndronin gjithmonë gjysëm të ngritur, sikur kishte gurë nën sqetulla, pra ky njeri që të krijonte përshtypjen e një shpendi grabitqar të lodhur që nuk

largohet më nga preja e dorëzuar, miratoi me kokë vërejtjen e shokut Mitro dhe aty për aty u dha urdhër punonjësve të administratës të pastronin vendin.

— Nuk jeni ju të vetmit që e lini pas dore higjenën e mjediseve. — tha Mitroja, tashmë me një ton më të zbutur. — Gjë e vogël, thoni, e parëndësishme. Por... alfabeti fillon me gërmën «A»!

— Ashtu është, shoku Mitro, ashtu është! — tha Gaspri, pak i çuditur që në rrugën para zyrave, njerëzit venin e vinin si në një spital të marrësh. Ata shkollin deri te ura e vjetër në drejtimin jugor ose deri te shkolla tetëvjeçare në drejtimin verior dhe pastaj ktheheshin mbrapsht, të njëjtët njerëz, ose njerëz të tjerë, kush e merrte vesh. Ndofta edhe në ditët e mëparshme kishte ndodhur ai parakalim i çuditshëm dhe i frikshëm, po, po, edhe i frikshëm, por Gaspri nuk e kishte vënë re dhe, në të vërtetë nuk është ndonjë gjë për t'u vënë re, tha me vete. Të parët njerëz që do të jepnin kushtimin ishin i plotfuqishmi i zonës, komandanti i batalionit rezervist, brigadier Palushi e dhjetra përgjues të tjerë vullnetarë, të cilët çonin ditët kot pasi përgjimi i dëndur e kishte tharë prej kohësh jetën.

Gaspri vështroi orën. Pastaj i hodhi një vështrim të ftohtë Ibër trutharit. Ky kurdoherë e kishte pasur të shkruar në ballë rolin e kamarierit që di të thotë vetëm «ç'dëshironi të merrni», por tani kishte rënë në të thella dhe s'po bënte asnjë përcapje t'u printe nga hotelklubi.

Punonjësit e administratës i mblodhën letrat e gjetet në kosha dhe i dërguan diku prapa zyrave për t'i djegur. Aksionit të tyre i qe bashkuar vetë Novruz Begolli, i cili, pasi pat spërkatur sheshin me ujë, përplasi pëllëmbët me njëra-tjetrën dhe u avit drejt grupit të burrave me pamjen e kënaqur të njeriut që është gati të rraportojë. Por askush nuk e kishte mendjen. Sytë e tyre lëviznin gjithë hutim në përpjekjen për të shmangur shikimin nga rruga, ku njerëzia tani shkëmbeheshin gjithnjë e më dëndur, duke i kumtuar njëri-tjetrit mesazhe

të pakuptueshme me gjuhën e veçantë të fërshëllimave e gishtave që përdorej vetëm në Barbullajë. Kishe përshlytjen se po qante një bletë.

Mitroja nxorri shaminë dhe teri ca bulëza djerse në ballë. Nipi i tij u përkul dhe i pëshpëriti diçka te veshi, ndofta i tha ikim tani.

— Dëshironi të merrni ndonjë gjë te «Ngjala»? — tha më në fund Ibër Rama.

«Nxirre të shkretën se na lujte tepelekun!» u duk sikur tha Gaspër Matrizi tek përplasi qepallat në mënyrë festive. Ata nxituan njëri pas tjetrit të zinin vend në makinë. «O perëndi!» Kanë shkalluar të gjithë», mërmëriti i lehtësuar kryetari.

Pasditë, megjithë kundërshtimet energjike të nipit, i shoqëruar nga Gasprri, Mitroja zbriti në këmbë fushave për t'u çmallur. Njerëzit e shpërndarë andej këndej nëpër ara e lanë punën dhe u mblodhën te kapat e misrit për të nderuar atë plak që kishte marrë mundimin t'i begeniste.

Ibër Rama, që se ku kishte gjetur një drapër dhe e kishte rrasur nën sqetull, bashkë me Lena Përgjokën, shtylla e disa reportazheve që ishin shkruar nëpër gazetë për Barbullojën, kishin dalë disa metra para të tjerëve. Mitroja u afrua. Duart e Ibërit lanë drapërin në tokë dhe u zgjatën me një mall patetik. Sa çel e mbyll sytë koka e thinjur e Mitros u troshit në supin e tij. Në cepat e buzëve të Gasprit ishin sajuar dy vija të holla nënqeshjeje. Edhe në sy i lodronte një ngarkesë e lehtë ironie përzier me keqardhje. «Nuk është nevoja, nuk është nevoja. Mitroja s'është asgjë, or budallenj», dukej sikur thoshte mimika e tij. Lena Përgjoka gjithashtu i hodhi dorën në sup të porsaardhurit si të ishte biri i saj i kthyer nga ushtria.

Ludvik Margjoni ia shkrepë gazit i pari, pastaj edhe tre katër djem të tjerë që ishin mbështetur në kapat e misrit dhe bënin sehir skenën. Mitroja i vuri re. Në shpirt iu përshkua vala e një pikëllimi të beftë. Me kujdes e hoqi nga supi dorën e Lena Përgjokës dhe

i hodhi hapat para atyre që kishte në krah sikur kërkonte shpëtim të grumbulli i njerëzve përballë që ndërkohë kishin zënë të duartrokisnin. Nuk i hiqej nga mendja gazi i djelmoshave. Ai gaz i kujtonte se aty, pak më parë, diçka kishte ndodhur dhe se episodi komik kishte pasur spektatorë.

Ai kaloi edhe një herë shikimin nëpër ato dhjetra fytyra grash, burrash, vajzash, djemsh... Fytyra të qeshura, serjoze, indiferente, të fjetura, festive, inerte; ankuese trumbullake, të mprehta, të lëmuara, me rru-dha... Mbi to përgjonin ca sy kureshtarë që atij sepse iu dukën pothuajse njëlloj. Ah, ja tek ishte pikë e zezë në dërrasë të bardhë, fytyra sarkastike e një burri brun që mbante triko leshi nën këmishën kafe. Ishte Skënder Abdyl. Mitroja u kujtua se e kishte parë atë njeri mbrëmjen e kaluar në hotelklubin «Ngjala».

I përhumbur siç ishte, dëgjoi të shqiptohet me zë të lartë emri dhe mbiemri i tij, pastaj ca duartrokitje të përmbajtura dhe përskaj tyre duartrokitjet e veçanta të Ibër Ramës. Për një çast i shkoi nëpër mend se mos ky Ibër ishte një djall e gjysëm që donte ta kthente në parodi takimin e tij me popullin. Kërkoi edhe një herë fytyrën e lodhur të Skënderit. E gjeti. Ajo tashmë ishte pa shprehje, e ngrirë.

«Ç'të bëj?» tha me vete pasi u bëri njerëzve pyetjet e zakonshme të mirësjelljes. Ai kujtoi se do t'i fyente po të mos u mbante një fjalim.

E zuri shtruar, duke numëruar qysh në krye, sipas një skeme të njohur, të zezat që kishte hequr populli i atyre anëve në histori. Dhe e mbylli paragrafin kështu:

— Kur i numëronim njëherë me një plak të zezat që ka hequr Barbulloja, ja ashtu siç i numërova unë pak më sipër, ai më tha: Kaq keni vuajtur sa tani më vjen gjynah kur ha bukë sa të dua dhe gjellë. Kështu më tha, për besë, dhe unë e besova atë plak dhe i ngula në mendje fjalët e tij.

Dikush i përgatiti një si jastëk me kashtë orizi dhe

e ftoi të ulej. Mitroja falenderoi me dorë në zemër, domethënë sa mirë e vutë re se po më dridheshin gjunjët.

Gaspri ishte mbushur deri në grykë me mërzi. Ai kishte përshtypjen se njerëzia po tregoheshin tepër të përzemërt me Mitron me qëllim që ta lëndonin në sedër kryetarin e tyre!

— A do të flasë njeri? — pyeti kur ra heshtja. Adrian Mirajt i shkuan sytë te profili i Liljanës. Në faqen e saj të majtë zbardhte një gërvishtje kashte. Vetvetiu iu kujtua korriku, kur ajo merrte një fije kashte dhe llogariste normën në lëkurën e nxirë nga dielli.

U ngrit Lena Përgjoka. Në të folurën e saj të përgjëruar sikur krijoheshin e pëlçisnin aty për aty ca si bombola të vogla ajri. E vështronte Mitron ngul-tas, diku poshtë mollzave dhe hepohej përpara pa kuptuar, madje hidhte edhe ndonjë gjysmë hapi me një mëdyshje të frikshme për t'u turrur dhe për të kapur diçka te njeriu përballë. Të dukej se askush në lëmshin tokësor nuk kishte hequr mundime si të asaj dhe nuk kishte provuar gëzime si të asaj.

Kujt i duhet ky argëtim barbar? desh thirri Adrian Miraj i neveritur nga gjestet, toni dhe fjalët e asaj gruaje shtëpiake. Sytë e tij të ndezur sikur e flakën këtë pyetje mbi fytyrën kuqalashë me një ndriçim festiv të Gasprit.

Mandej me një vrull sa të egër aq edhe solemn, sikur u kishte shpëtuar nga duart ca njerëzve që s'donin ta linin të fliste, u ngrit Ibër Rama. Në stilin e vet, por duke u mëshuar fjalëve, kushedi pse, ai përsëriti pak a shumë ato që kishte thënë Mitroja. Sytë e këtij, të mbushur me një bezdi të largët, sikur i iknin papushim vështrimit prej makuti të Ibërit.

Adriani nënqeshi hidhur. Iu bë se dikush po e vështronte. Ktheu kokën majtas... Një grua e përgjurmur, dy kunatat e Liljanës me fytyrat si të derdhura në gips që i përfytyruan trishtueshëm banesën e

tyre groteske dhe pak më tej Liljana me të gërvi-shturën. në faqe që atij sepse i shëmbëlleu me një plagë. Nuk po e shikonte njeri. Fytyrat e ngrira të kunatave të Liljanës iu dukën të tmerrshme. Ai mbylli sytë me vull.

Kur i çeli pas pak, dhjetra koka qenë kthyer prapa. Ishte ngritur Skënder Abdyli. Me diellin mbi shpinë, fytyra e tij solide dhe e nxirë ku ishte shtruar si ton i lehtë diçka miturake, dukej pa relief. Hija e trupit të tij të madh lartohej në një kapë misri përpara. Ngaqë Skënderi mbante xhakëtë dhe pantallona të zeza, Adriani që e shihte nga prapa pati përshtypjen se në këmbë ishin ngritur dy njerëz.

Skënderi po vonohej të fliste. Elipset e dritës vërtiteshin si në një lojë marramendase mbi kokat e njerëzve, iknin tutje në hapësirën e shkretëtë sikur kërkonin një mejdan tjetër për t'u ndeshur e për t'u shbërë dhe ja ku ktheheshin ose riformoheshin prapë për të nisur gjithçka nga e para. E gjithë kjo e bënte heshtjen edhe më të thellë dhe pritjen e shtrirë të orizoreve të padurueshme.

— Nuk kisha ndërmend të flisja, ne se si u mblodhëm këtu, — ia nisi Skënderi, — por Lena dhe Ibëri e bënë mbledhje. I dëgjova! Desha të shtoj se Stomi matanë bërtet: Ç'bëni ju Barbulloja?

Shtatë-tetë veta kthyen kokat prapa sikur nga Stomi të kishin thirrur vërtetë.

— Në vend që të nxjerrim mësimë nga Stomi, disa prej nesh që u bie luga në mjaltë, vazhdojnë të mburren e të çirren nga kënaqësia sikur i ka vënë njeri të shkruajnë hartime shkolle. Ku të lë Stomi të mburren? Dalëngadalë Stomi po hedh turpin mbi fytyrën tonë. Jemi kthyer prapa, vlera e ditës së punës ka rënë. Në derë të dyqanit falemi për të gjitha, kjo dihet. Shikoni ç'ndodh! Ulen parat, shtohen hyrjet në dyqan. Ç'po bëhet? pyesim njëri-tjetrin. Ç'ka bërë vaki? Dhe vërtetë, meqenëse na u dha rasti të kemi shokun Gas-për këtu, po e pyes: Ç'po ndodh me Barbullojen?

Pyetja e Skënderit mbeti pezull në ajër si një shpend i ngrirë. Gaspri e ndjeu ngarkesën ironike të frazës «meqënëse na u dha rasti...». U përpush përsëri dhe mërmëriti nëpër dhëmbë duke nënqeshur me zor:

— E dija unë!

— Ç'farë dije? — e pyeti Mitroja me zë të ulët.

— Ja, presionin e tij. Don të shkojë në punë në ndërmarrje shtetërore... Do t'ia pres fjalën!

— Në asnjë mënyrë!

Gaspri e vështroi tjetrin pjerrtas. Vetëm thinjat e plakut e penguan të mos ia plaste aty për aty. «Leri more këto demokratizmat tuaja!

Ibër Rama, pasi kishte studiuar fytyrën e pakënaqur të kryetarit, u ngrit fiu në këmbë dhe pa i kthyer sytë nga Skënderi, tha:

— Hallet tuaja, djalë i mbarë, mos i shkarko mbi Barbullojën. Sukseset e saj s'ka bir burri t'i errësojë! Kush dëshiron të punojë...

— Ty kush të ka vënë avokat të Barbullojës? — e ndërpreu Ludovik Margjoni me përbuzje. — Barbulloja nuk është hotelklubi «Ngjala».

Katër-pesë djelmosha u qeshën nën zë, Ludoviku u hodhi një vështrim të rreptë dhe plot mosdashje për të bërë humor.

Fashoja me të cilën kishte lidhur pëllëmbën i qe bërë pis. Sytë e tij mbetën një copë herë atje, sikur lexonte një tekst të cilin kishte detyrë ta thoshte përmendësh. Vështrimi i shuar i një burri faqedjegur me kasketë që thirrej nga të gjithë me emrin brigadier Palushi u zvarrit deri te këmbët e Ludovikut dhe sapo ky tha se babagjyshat tanë të vuajtur kanë vdekur. Vështrimi i brigadierit u hodh përpjetë si gjarpër.

— Ulu ti... rrugaç! — tha dhe papritur u trishtua.

— Mbaj gojën! — ia ktheu Ludoviku. — Mbaj gojën se po e hapa unë thesin tim nuk dihet kush del rrugaç e maskara.

Brigadier Palushi nuk mori mundimin t'i përgjigjej, sa kohë që tubimi nuk i jepte mundësi të bënte atë që duhej të bënte e që do ta bënte pastaj...

— Ky është një takim i gëzuar, — tha një punonjëse e administratës, duke mbajtur kotnasikoti një kalem përpara buzëve të lyera tepër.

Nga grumbulli i njerëzve u ngrit një mërmërimë kundërshtuese. Gaspri e pa të arsyëshme të ndërhynte:

— Ore, ju sikur qenkeni djegur për mbledhje, — tha si me shaka ndërsa ngrihej. Sa mori drejtqëndrim. fytyra e tij u bë serioze, — Ç'po ndodh me Barbullojnë? — përsëriti duke hedhur vështrimin larg. — Një pyetje pak provokuese. pak e ekzagjeruar, po ne jse. Meqenëse e bën një punëtor i thjeshtë i kooperativës, po e marrim në konsideratë. Ja, të të pyes unë ty, Skënder, si anëtar i kooperativës që je aq i interesuar për mbarëvajtjen e saj. Cili është mendimi yt?

Skënderi u tkurr si i kapur në befasi.

— Mendim? Unë?

— Po, po, — ia nguli sytë kryetari. I kënaqur nga hutimi i tjetrit, vazhdoi, pa pritur përgjigje: — Nuk është hera e parë, shokë, që ndeshemi me një koncept pesimist për kooperativën. Nuk është hera e parë që na bëhen presione, kështu anash e anash, me qëllim përfitimi ose për të shkaktuar dallavere. Nuk është hera e parë që njeri apo tjetri niset nga vetja dhe bën përgjithësime për tërë grupin. Por ne nuk kemi pyetur, as do të pyesim! Pesimistëve dhe dallaverexhinjve u bëjmë thirrje të mbledhin mendjen, t'i shtrohen punës. Ndryshe do ta gjejnë vendin e tyre. Ne nuk e lëshojmë kooperativën! — thirri Gaspri dhe mishi i faqeve iu drodh. U mbush me frymë, nxorri shaminë nga xhepi dhe pështyu. Skënderit iu qesh.

— Më parë se ti, jam unë Barbulloja, o Gaspër, — tha më në ton mes dhimbjes dhe pikëllimit. — Kam lindur, jam rritur, jam ushqyer e veshur këtu. Këtu kam varret e prindërve, kam gruan dhe vajzat. Kurse

ti, ehoo, ti shkon e vjen, Rrogën merr këtu, pazarin dhe gjumin i bën në qytet.

— Bukur, shumë bukur! — e zbuti tonin kryetari. — Ti je Barbulloja! Dakort, ore, shumë dakort, s'e luan topi! Ju e ndritni, ju e nxini kooperativën, — sytë e tij xixëlluan, — pesë përqind është roli im. Tani unë pyes: përse nuk i kërkonit llogari vetes suaj? Pse i bëni bisht përgjegjesisë? Pse lejoni që njëri të punojë, tjetri të dredhë zinxhirin? Pse lejoni hatëre nëpër brigada? A jeni ju kooperativa? Hë, pra, mbrojeni?

Përsëri ra heshtja. Gaspri kërriti zërin dhe vazhdoj me një ton të shtruar prej fitimtari:

— E keqja është se disa këtu, jo të gjithë sepse kemi bujq të mbrekullueshëm, të mrekullueshëm që t'u heqësh kapelen t'u heqësh, pra e keqja është se disa kokrra këtu e mbivlerësojnë rolin e individit. Kryetari na shpëton, kryetari na mbyl! Pse, Zeusi është kryetari? Kryetari nuk është perëndia, mos u bëni fetarë! Ky koncept shokë, është jashtëzakonisht i dëmshëm se kultivon indiferentizëm, papërgjegjësi individuale dhe kolektive. Dhe janë pikërisht këto kokrra që në raste të veçanta na dalin si kritizerë e shkuar kritizerëve. Jo, ore jo! Po ua përsëris: kryetari as të shpëton, as të mbyl! Kjo të kuptohet nga të gjithë! Hiqeni kryetarin, vini një tjetër! Sa para bën në qoftë se nuk ndjehet secili kryetar në punën e vet?

Ai kotrolloi një çast efektin e ligjëratës, nxorri shaminë dhe pështyu prapë.

— Unë do të thosha, — vijoj me ton edhe më të shtruar, — se Barbulloja aktualisht përballon ca probleme të paparashikuara. Ka vendnumëro, ka edhe zigzake. Jetë i thonë kësaj. Mos u bëni si ato vajzat, na muzqare që sa u mungon një byzylyk varin kokën dhe rënkojnë «uf, moj nënë, pse na linde?».

— Uu, pika! — foli nga vendi Lena Përgjoka. Në sytë e saj të brengosur lodronte një dëshirë e etshme për ta sqaruar shokun e deleguar se në asnjë rast nuk

do të bëheshin si ato vajzat pipiruve, se Barbulloja ha mishin e vet, por kurrë, sa të jetë jeta....

— Shoku i deleguar, shoku i deleguar!

Nuk e dëgjoi njeri pos një vajze e re në krah, e cila kukurisi dhe tha gjithë me zë të ulur:

— Nuk është i deleguar, moj Lenë!

Gaspri mbërtheu kopsën e xhakëtës dhe u ul. Ishte i bindur se më në fund i kishte vënë pikat mbi i.

— Dokrra, — tha Skënder Abdyli flakë i kuq në fytyrë. — Në qoftë se ju jeni kaq i parëndësishëm këtu, atëhere pse paguheni më shumë se ne, të rëndësishmit?

Fjalët e tij u pritën me gaz. I pandikuar nga të qeshurat, Skënderi vazhdoi:

— Sa për atë që në Barbullojën tonë ca tërheqin majtas, ca djathtas, këtë e sheh edhe bufi. Ku e ka shkakun kjo rrëmuje? Këtë më sqaro mua ti. Për teori jam plot, gjer në grykë.

Gaspri u step sikur dëgjonte një hata. «E teprove, e teprove shumë», thoshin sytë e tij të skuqur.

— Meqë ra fjala, pse nuk organizohen të gjitha brigadat për korrjen e orizit? Çfarë pritet? Orizi po firon dita ditës, — tha Skënderi.

— Ehu, paska nge ky! — mermëriti, Ibër Rama, të cilin i pihej një kafe. Me siguri edhe shokëve në atë farë presidiumi u pihej një kafe.

— Përgjigju! — i tha Mitroja Gasprit.

«Po ky ç'pati? Rolin e masovikut po na luan këtu?» mendoi Gaspri dhe me bisht të syrit i hodhi një vështrim të ngadalshëm. Fytyra e ngjeshur e Mitros, me atë hundën e kthyer paksa që sepse iu duk më e madhe, i kujtoi skulpturën e një shpendi të zhdukur që ai e kishte parë një herë diku në një atllas zoologjie.

— Këto ditë do të vinë atuokombajnat, — tha me përtesë:

— Ja, zuri një shi, ç'na duhen pastaj autokombajnat?
— u hodh Ferdinandi.

— Nuk priten shira, — tha ftohtë Gaspri dhe gjezdisi me sy lart e poshtë si për të thënë «ta mbyllim tani, kokëtulët dhe dembelët muhabet duan».


«Kryetari nuk e ka dëgjuar rënkimin e Lazër Bocit». mendoj Adrian Miraj dhe instinktivisht ktheu kokën nga orizoret e kredhura në një heshtje varri. Larg, në fundin e parcelave fluturonin ulët një tufë zogjsh.

— Nuk ka shi. mos u mërzitni! — përsëriti Novruz Begolli.

— Është marrë vesh me Shënkollin sipër, — tha duke bërë kryqin Ndue Margjoni.

Shpërtheu një gaz i përgjithshëm dhe një mori kumtimesh me gishta e me fërshëllima. Mjaft! E mbyllim tani! Ç'të llapim kot! Asgjë nuk ndryshon! Kush i ka fajet, Gaspri? I ziu Gaspër! Gjynah! Qaj hallin e Gasprit ti!

Banorët e Barbullojës e kishin gjetur bukur: Sa herë u mërzitëshin mbledhjet fillonin të qeshnin e të flisnin me gjuhën e tyre të fërshëllimave e gjesteve. Me qenë se zakonisht u mërzitej çdo mbledhje kishte ndodhur që të gjitha mbledhjet të mbylleshin me gaz e fërshëllima.



Me t'u larguar shoku Mitro, krejt i pakënaqur ç'është e drejta, madje i vuajtur, pavarësisht nga fundi i lumtur i takimit, brigadier Palushi u përkul një copë herë mbi orën e dorës sikur po e kurdiste dhe si e vendosi atë që kishte ndërmend, e urdhëroi Vlash Keqin, njërin prej dy zëvendësve kryesorë, që Ludovik Margjoni të dërgohej pas një ore në zyrën e brigadës. Në sytë e fshehur të brigadierit u përpëliti para kohe një gëzim i veçantë, të cilin Vlashi e kuptoi shumë mirë. Bri-

gadieri kishte vendosur të merrte hak dhe më tej akoma, të aplikonte një kanosje me qëllim që, t'u shtinte frikën të tjerëve. Atë nuk e zinte gjumi poqese nuk i vinte në vend, para se t'i drejtohej shtratit, të gjitha gjërat që cënonin personin e tij.

Vlasi fiksoi në mend pozicionin e akrepave në çastin kur mori urdhërin dhe, me t'u mbushur ora, e zbatoi faqe të gjithëve. Vajzat u prenë në fytyrë, disa nga djemtë i thanë Ludovikut «mos shko» me fishkëllima, Vlash Keqi ngulmoi në atë që urdhërat duhen zbatuar e jo të ecet me paragjykime, ca më tepër kur dihet se në zyrën e brigadës njerëzit thirreshin për të punuar me ta kokë më kokë.

Si për të hedhur poshtë rrenën e shëmtuar të Vlashit, Ludoviku hodhi drapërin në sup dhe u nis me turr, pa e përfillur trishtimin e vajzave.

Në zyrën e brigadës, në atë kotec pa tavan e pa suva, me tre rreshta stolash përballë tryezës në krye dhe me një mori parrullash e fotografish të varura në katër faqet e murit më thupra, po prishte brigadier Palushi, komandanti i batalionit rezervist të fshatit, — një shulak mendjemadh që tre katër darka në javë i kalonte nëpër shtëpitë e rezervistëve të preferuar. — dhe zëvendësi tjetër i Palushit, Lekë Kunora. Komandanti kishte hequr kapelën dhe shfletonte vetullngrysur një fletore të trashë. Midis ballit i qe formuar një e çarë e thellë dhe po të mos ishin kohë paqësore dhe po të mos ndodhej përkrah Palushit në atë farë kasollejë plot me objekte zyre, fare mirë mund të mendoje se po mendonte planin luftarak të daljes nga rrethimi. Po gjithsesi portreti i tij prej ushtaraku të kalitur në beteja nuk mund dhe nuk meritonte të parodizohet. Sepse ishte bërë normë që gjithçkaje, qoftë edhe një mjekre të parruar t'i kushtohej maksimumi i rëndësisë dhe përkushtimit, meqenëse ajo mjekërr, fjala vjen, e ushqente kripin në konceptet e gabuara për jetën dhe moralin. Llogjika e lidhjes së menjëhershme të një fakti të rëndomtë me një pastulat të karakterit

teorik i shërbente komandantit për t'u mbrojtur nga akuzat dhe për të qetësuar ndërgegjejen e vet profesionale kur i ndihmonte Palushit apo kur dublonte policin e zonës. Vërtetë, në pamje të parë nuk i takonte të fuste hundët në punët e djelmohave të fshatit, por përveçse ushtarak ishte edhe kuadër dhe komunist, kështu që kishte të drejtë që çka me të.

Palushi ndihej më tepër se kurrë i fuqishëm kur gjendej përkrah komandantit të batalionit apo policit të zonës. E bukur ishte se ai dinte ta administronte mirë këtë fuqi duke e shpërndarë në mënyrë përpjesëtimore gjatë gjithë ditës. Vlerësimet e tij kishin ndikuar që në radhët e adoleshentëve, por edhe në radhët e më të rriturve të përhapëj legjenda sipas së cilës goftë komandanti i batalionit, goftë polici i zonës të zbulonin çfarë kishe në kokë thjeshtë duke të parë. Prandaj ishte e kotë t'u bëje dredha kur ato të pyesnin për ndonjë gjë.

Tre burrat po rrinin kokulur dhe të heshtur. Shtëllungat e tymit të duhanit u endeshin mbi kokë, kur dera kërciti vajtueshëm. Hyri Ludoviku.

— Eja, — tha brigadier Palushi teksa fikte bishtin e cigares në tavëll.

Komandanti i batalionit fiku gjithashtu cigaren e vet, hodhi këmbën mbi këmbë dhe u rrotullua me gjithë karrige nja tridhjetë gradë nga e djathta. Në profil ai dukej më hijerëndë dhe më i pakomunikueshëm. Ai luante ashtu rolin e skalionit të dytë, i gatshëm për të ndërhyrë sapo brigadier Palushi të ngecte.

Ludoviku mbeti vetëm përballë tre burrave të ser-të. Një copë herë nuk u dëgjua asgjë pos frymëmarrjes së tre burrave që vinte duke u rritur vazhdimisht, vazhdimisht si zhurma e ekspresit të kafesë. Ludoviku pati përshtypjen se nga muri i thurur me thupra do të fillonte të dilte avull.

Heshtja brenda po zgjaste pambarim. Ishin çastet kur fajtori çarmatosëj, si të thuash, pa filluar akoma.

Dhe vërtetë: kishte patur raste kur brigadier Palushi s'kishte patur nevojë ta hapte gojën pasi fajtori, me t'u gjendur në rrethimin e ftohtë dhe kërcënues të heshtjes, kishte filluar të qante e t'i binte kokës me grushta. Edhe po që se heshtja nuk bënte kaq shumë punë, gjithsesi ajo e frikësonte fajtorin, pra si hap i parë, ishte më se e leverdisshme.

Dikush brenda u kollit, pastaj vijuan të kollitura të shpeshta dhe ja ku më në fund brigadier Palushi e ngriti zërin në qiell:

— Kulaku i Dyvelit kruan kokën! Thyen ti një gotë, fap kruan kokën! Pret ti me shatë bimën e shëndoshë, fap e kruan prapë. Ngrihesh në mbledhje dhe hedh helm!

Nga mënyra se si fliste brigadieri, merrej vesh se Ludoviku s'kishte pyetur as për heshtjen, as për të kolliturat dhe as për profilin e ngrirë të komandantit të batalionit. Shkëmbimi i replikave vazhdoi dy tre minuta me radhë, rishtas zyra shungulloi nga një mori të kolliturash, kërcaskash e zhurmash të tjera të frikshme që s'kishte njeri t'i identifikonte. Përmbi këtë zallamahi djallëzishte buçiti plot seriozitet zëri i komandantit të batalionit.

— Të hedh heukrat në vend, edepsëz!

Ai pò i tundte grushtin në turi Ludovikut, duke tundur me dorën tjetër çantën me zinxhir ku trokëllinte vërtet diçka metalike. Por as ky kërcënim i radhës së fundit nuk e tronditi Ludovikun në atë masë sa t'i dridhej qerpiku. Atëherë komandanti dhe brigadieri kapën njëhershëm telefonin me dorezë dhe u hoqën sikur po lidheshin me degën e punëve të brendshme.

Pikërisht në çastin kur dega me demek doli dhe ata kthyen sytë e skuqur për të fundit herë nga Ludoviku, duke u gëzuar kësisoj për forcën e tyre, Lekë Kunora bërtiti «faleni» dhe i këputi djaloshit një shpu llë bujare, domethënë më mirë një goditje këtu se sa një dajak në polici.

Ludoviku u tërhoq në thellësi të zyrës për të

shmangur goditjen e dytë. Sytë i nxirrnin flakë, tre burrat kujtuan se do t'ju vërtitej me stol dhe atëhere kur s'e prisnin, Ludoviku u ul i dërmuar mbi një thes me patate, mori kokën me duar dhe s'bëzajti më.

— Qërohu! — urdhëroi brigadier Palushi që s'mund të pajtohej me një mbyllje të tillë sentimentale. Dhe për të përligjur goditjen e Lekë Kurorës: — Atje, në degë e ke vendin! Ti Lekë mos m'u përziej më se për ideal i prishim punët bashkë!

Sa doli Ludoviku që të tre u vështruan miqësisht, si njerëzit që sapo kanë kryer një punë të vlefshme. Asnjërit s'i bëri zemra të ngrihej sikur kishin frikë mos u binte rrugës gëzimi delikat dhe madhështia e triumfit. Qëndruan në zyrë derisa perëndoi dielli.

KAPITULLI I SHTATË

Adriani ecte me nxitim mbi bankinë e kanalit vaditës sikur shpejtonte të dilte nga kllapa e horizontit që po mbyllej diku para tij. Akoma i jehonin në veshë kollitjet, zhurmat, britmat e çjerrjet në zyrën e brigadës. Ludoviku kushedi pse pat thënë «shpëtova prap» kur pat dalë prej andej dhe Adrianit se si i kishte ardhur.

Prapa dëgjoi zhurmë hapash, ktheu kokën dhe në muzgun ngjyrë vjollcë të fushës pa çiftin që kalonte muajia e mjaltit në Barbullojë. Ata ecnin të përçafuar mbi një si taracë të gjatë betoni në anën tjetër të kanalit. Herëpashere vajza vinte kokën në supin e djalit sikur flinte, duke e bërë shumë më reale heshtjen e fushave dhe të shtëpive karshi.

Adriani kishte pirë kafe me ta një mbrëmje në hotelklub. Dhëndrri quhej Hektor, kurse vajza Eda. Atë mbrëmje Hektori kishte thënë se «Ngjala» e ka emancipuar mjaft Barbullojën. Vinë, shkojnë njerëz të profesioneve të ndryshme, kishte vijuar mendimin e vet Hektori. Gjithë ky qarkullim njerëzish nga anë të ndryshme, të profesioneve, rangjeve dhe natyrave të ndryshme...

Atëhere Adriani ishte bindur se tjetri e kishte seriozisht.

Brezi i lëmashkut në paretet e kanalit vaditës bëhej kaf me shpejtësi. Po errej. Adriani ngadalësoi hapat.

Te pasarela në krye të kanalit i qëlloi të shkëmbehej me çiftin.

— Mirëmbërëma! — ia bëri Hektori, ndërsa Eda përshëndeti lehtë me kokë.

— Mirëmbërëma! Ku paskeni qenë kështu?

— Te Drandja e Madhe, — u përgjegj Hektori me mburrje.

Drandja e madhe ishte një plakë si nja shtatëdhjetë vjeçe që jetonte fillikat në një shtëpi të vjetër në skajin jugor të Barbullojës. Ajo kishte qenë gjithë jetën bareshë dhe këngëtare e ciklit të kreshnikëve. Rasti i saj i tregohej si «antikë» cilitdo mysafiri në Barbullojë.

— A, dëgjuat këngë nga eposi? — pyeti Adriani.

— Jo, e lamë për një ditë tjetër. Drandja e Madhe po kalonte një rrufë. Përveç kësaj, — shtoi Hektori, — asaj i kishin «hypur dreqnit».

— Ashtu? — tha Adriani. Fytyra e tij u bë serioze.

— Ç'do të thotë «më kanë hypur dreqnit?» — pyeti Eda.

— Nuk e di, — u përgjegj nën zë Adriani. — Do të pyes Dranden dhe do t'u them. Ndofta vij me ju radhën tjetër.

— Shumë bukur! — thanë ata me një gojë dhe kaluan duke uruar natën e mirë. Nga rrobat e nuses shpërndahej një aromë e mirë deodoranti. Adrianit iu qesh ndërsa solli ndërmend qarkullimin e njerëzve të ndryshëm... Dhe aromave të ndryshme, shtoi me vete.

U shmang djathtas, hyri nën plepishte poshtë hotelklubit, u mbështet pas një trungu dhe priti. Liljana erdhi kur kishte rënë ora kritike e mbrëmjes dhe ai kishte humbur shpresat të takonte. E paprekur ende nga xixëllimat blu të muzgut që shkrepnin e shuhejnë për qark supit të saj, ajo dukej shumë krenare dhe moskollëçarëse. Por ecte ngadalë dhe disi zorshëm sikur tërhiqte pas vetes heshtjen e thellë të fushave.

Kur u afrua fare pranë, Adriani u trëmb. Po ishte vërtet për t'u shqetësuar. Ajo merrte frymë shpejt,

duke e vështruar tjetrin në dritë të syrit me një si nënshtrim dhe urgjencë që me kalimin e sekondave haxhohej dhe zëvendësohej nga një qortim i fshtë.

— Morën Ludovikun! — tha ajo.

— E di. Isna atje...

— Është e pesta apo e gjashta herë....

— E di...

— Çfarë i bëjnë? — pyeti ajo.

— E latojnë, e bëjnë rrumbullak, rrumbullak që të mos zerë vend kërkund, përveçse në grumbull. Ke dëgjuar për gurin e rrumbullakët? Vetëm në grumbull e ka vendin.

— Kjo është e tmerrshme! — protestoi ajo.

— Ke të drejtë. Kjo është historia jonë! — tha ai.

— Histori është kjo? Kjo nuk është histori!

— Nëse mund të quhet histori...

— Jo! Kjo nuk mund të quhet histori, — këmbënguli ajo.

Ai u drodh dhe rishtas, kundër vullnetit, kujtoi napoletanin e rezervatit të gjuetisë. Vetvetiu hodhi sytë andej nga perëndimi. Gryka e thellë e natës atje valvitej me drithërima dhe ai pati përshtypjen sikur nga çasti në çast ajo grykë do t'i përthithte drejt një bote tjetër plot mistere dhe aventura.

— Unë nuk dua të të humbas ty, — tha ai.

Ajo i vuri pëllëmbën në faqe. Pastaj pëllëmba e saj rrëshqiti ngadalë si dora e pastërvitur e një të verbri mbi pllakën e shkronjave, preku mjekrën, qafën, kraharorin e tjetrit dhe u ndal mbi duart e tij të lidhura diku afër kërthizës. Duart e saj ishin të rënda, të ftohta. Adrianit i erdhi çudi se si mund të jenë të ftohta duart e një vajze që ka punuar në orizore gjithë ditën dhe më tej, si mund të jenë të ftohta duart kur te sytë digjet flaka e një pasioni të vërtetë. Pa sqaruar asgjë nga ky dyzim klime brenda një trupi, ai i shtrëngoi fort duart e saj në duart e veta, i mbajti ashtu një copë herë, i ngriti lart që t'i ngrohte me hukamë, por kjo iu duk e tepërt, e panatyrshme. Hapi

pöllëmbët dhe duart e Liljanës ranë si degë të prera.

— Përse m'i lëshon duart? — tha ajo.

— Ti mërdhin akoma?

— Jo, nuk mërdhij, po mos m'i lësho duart!

— Mund të kalojnë njerëz, — tha ai dhe në çast u pendua që foli ashtu.

Ajo nxori një firomë të mprehtë, shgënjyese. Adriani ia kapi përsëri duart.

— Unë nuk kam frikë, — tha.

— Ke! — tha vajza duke drejtuar gjoksin. — Në përgjithësi ke frikë.

— Ti ngatërron frikë me të përmbajturit dhe me keqardhjen, — tha ai, duke u sprapsur paksa për të mos u çikur me gjoksin e saj që hepohej përpara në mënyrë gati provokuese.

— A thua? — hapi gojën Liljana gjithë sarkazëm.

— Unë nuk jam aventurier...

— Bravo!

— Madje si të ta them... Nganjëherë më vjen keq, më vjen kaq keq...

Ajo u shkëput prej tij dhe u spraps tre katër hapa duke qeshur me zë të lartë. Adriani u lëkund sikur rrinte mbi një trinë që e tërheqin befasisht.

— Liljana, mos ikë! — thirri.

— Unë jam aventuriere. Por s'kam nevojë për keqardhjen e askujt. — po thoshte ajo me një zë të ndryshuar, pa e kthyer kokën.

Ajo po ikte me gjithë mend. Ajo e kishte keqkuptuar keqardhjen e tij. E kishte marrë si pendim, si tërheqje, si ndalim të dhimbshëm të dashurisë. Ha! Ha! Ha! — thërmohej e qeshura e saj në muzg.

— Liljana, mos qesh ashtu! — bërtiti Adriani.

— Jü kujtoni se vajza, sapo shtrihet së pari, nënshtrohet njëherë e përgjithmonë. Por e keni shumë gabim. Edhe sa dekada u duhen për ta kuptuar këtë?

— Liljana, kthehu të them!

Adrianit i vinte plasja që ajo po ikte ashtu, e zhgënjyer, e mërzitur, pasi u ishte vjedhur kunatave

vigjilente për të gëzuar ditën e saj të gjatë me një takim.

Ku djallin vajti e m'u ngjit ajo fjalë e nëmur «keqardhje?» Më në fund i doli asaj në krah.

— Dëgjomë një minut, të lutem! Ti i more ters fjalët e mia! Të kam parë gjithë ditën në orizorë, Liljana! Je lodhur atje, kurse në mbrëmje vjen tek unë, që s'jam lodhur fare. Se si më vjen... Ti i kishe duart të ftohta, kurse sytë krejt ndryshe, krejt ndryshe, a më kupton?

— Të lutem, mjaft! — e ndërpreu ajo. Në pjesën e mollzave i shkëlqenin ca vraga lotësh.

Ajo ka qarë, kur qeshte qëparë, mendoj Adriani.

— Ti je lodhur, — tha ai.

— Ajo parandjenja për shiun që dikush e përmendi në mbledhje, më futi tmerrin. Punuam si të marra deri vonë.

— Edhe unë kam frikë se moti do të prishet. Gjithë kjo heshtje, kjo tulatje. A nuk të thashë? Lazër Bocin e kapën dhimbjet e stomakut. E dëgjova mbrëmë....

— Sa e frikshme më duket, — tha ajo.

Adriani ia kaloi krahun pas shpine.

— Vere kokën te supi im dhe bëj sikur po fle, — tha ai. Liljana e mbështeti kokën te supi i tij dhe hodhi sytë nga kodrinat e lakuara sipër fshatit. Me cipën e muzgut përsipër, ato dukeshin si mbulesa të gufura nga ajri që po ndereshin pak nga pak mbi gjumin e njerëzisë. Duke ndjerë ngacmimin e gishtave të tij te sqetullat, Liljana fërgëlloi dhe ngriti fytyrën karshi qiellit. Ai ishte më i gjatë, i shihte nga sipër sytë e saj të shushatur dhe buzët e trasha, gjysëm të hapura me një si ftohtësi brymë përsipër. U përkul dhe i puthi lehtë. Ajo bëri një gjysëmrrrotullim të shpejtë djathtas, iu var në qafë dhe zuri ta puthte gjithandej nëpër fytyrë, në qafë, në duar sikur kërkonte me ngulm një pikë të fshehtë eksituese. Ku është, ku? Adriani

miklohej nga puthjet e saj, i përkëdhelte flokët dhe kjo vazhdoi gjatë. Më në fund ajo u shkëput prej tij dhe lëshoi duart sikur thoshte s'kam se ç'bëj më.

Ideja e ndarjes vibronte si një flutur e padurimtë në të gjitha poret e mbrëmjes. Diçka nuk kishte funksionuar në takimin e tyre. Për këtë shkak ndarja ulërinte në sytë e vajzës si një mendatë. Adriani u përpoq të riparonte diçka nga ai dështim zemërbrerës kur tha «Liljana, të dua shumë, shumë, qëparë të përfytyrova nuse, nuse të bukur si yll...» Këto fjalë plot shpirt e tronditën botën rreth e përçark. Sytë e Liljanës shndërritën një sekond në errësirë si për t'i kumtuar tjetrit se e kishte kapur atë sinjal të vërtetë të shpirtit. Pastaj krisi e iku me vrap duke trazuar natën e pafundme me flokët e dendur që i tundeshin majtas e djathtas si kurorë dellinje.

«Liljana, të dua shumë, shumë». Qetësi. Asnjë zë, asnjë tingull. Me gjethet e palosura si luspa plepat dukeshin qindravjeçarë në heshtjen e tyre. Papandehur Adrianit iu bë se në të katër anët e horizontit ushtoi zëri i Lazër Bocit si bulërima e një kau të mbetur në brinjë. U shpua kaceku i fjetur i erërave, vërshoi veriu, plepat u zhveshën sa çel e mbyll sytë dhe dolën degët e bardha si gjymtyrë të fosilizuara. Instiktivisht mbylli veshët me gishta.

KAPITULLI I TETË

Në të vërtetë era filloi të pasnesërmen në agim, kur njerëzia flinin. Ajo sikur u shpif me fishkëllima nga shkurret, nga rrasat, nga kallamishtet, nga zukthet, nga hardhitë, nga plepat, nga hurmat, nga tjegullat e pullazeve duke tundur gjithëcka. Gjysëm i përkuhur, Adriani ngriti kokën nga nënkrejsa. Në dhomë ishte errësirë dhe kjo e bënte më të mistershme zallamahinë te dritaret dhe në oborr. Xhamat dridheshin, kanatat e derës së jashtme rënkonin, një ulërimë e stërzgjatur u lëpihej mureve nga jashtë dhe, si nuk gjente një shteg për t'u futur brenda, kthehej dhe uturonte larg. Ai brofi nga shtrati. Teksa u orientua në terr për të gjetur çelësin elektrik, pati kohë të shpërgjumej plotësisht.

Për një çast ai u ndie si i kapur në rrethim. Vështroi kot orën rrumbullake të tryezës ku miniatura e një gjeli çokiste papushim me sqep në sinkron me tiktakun e sekondave. Siç ishte në të mbathura dhe kanatjere doii në dritare të shihte ç'bëhej përjashta. Por ndërkohë dera e dhomës u hap. Hyri e ëma. Ajo kishte lidhur kokën me shami. E alarmuar dhe e kop-situr dukej më e vogël se sa ishte në të vërtetë.

— Vishu shpejt! — tha ajo. — Kemi lënë teshat jashtë.

Adriani u vesh dhe doli në oborr. Drita e ndezur

mbi shtalkën e derës së jashtme ndriçonte oborrin dhe një pjesë të kopshtit. Pemët, hardhitë, gjithçka ishte përkulur në drejtim të jugut. Një pikë shiu e goditi në kurrizin e dorës së djathtë. Mes shtjellës së gjethurave që ikin tutje si të çmendura, ai dalloi të jëmën në kopësht tek përpiquej të arrinte një çarçaf që era e kishte rrëmbyer nga telat. Përpjekja e saj në gjysëmterr ngjante me një dyluftim vegimesh. Më në fund çarçafi u ngatërrua në një pjergull rrushi. Gruaja e mbloodhi shuk, e rراسi nën sqetull dhe u kthye e dërmuar nga lodhja. Adriani mbloodhi rrobat e tjera që tundeshin në tel. «Kiamet, kiamet», — tha gruaja.

Sa u futën brenda, mbërthyen mirë të gjitha kanatet e dritareve. Adriani vuri fytyrën në njërin prej xhamave dhe pa se gjithandej në fshat ishin ndezur dritat. Në rripat e ndriçuar të natës dallohej vërshimi i gjethurinave të kapura në gjumë, në dremitje, në ëndërrim. Ca degë të xhveshura me një ndriçim zemërak në lëkurë përkuleshin furishëm drejt tokës sikur pyesnin «ku na i çoni gjethet?», pastaj drejtoshnin si të habitura. Në rripat e dritës shfaqeshin herëpashërë ca pika shiu të hutuara që humbisnin menjëherë në errësirë. Atë që ndodhte në errësirë nuk e shihte njeri.

Përtej, në oborret e shtëpive fqinjë dukeshin e shdukeshin silueta njerëzish që kishin harruar ndonjë gjë përjashta, që vendosnin copa dërrasash apo batanije në dritaret qorre me xhama të thyer. Vetëm Dodë Belsha rrinte i qetë në ballkonin e shtëpisë së vet dykatëshe. Ai kishte futur duart në xhapat e pardesysë së gjatë, kishte ngjeshur kokoren në kokë dhe ashtu manifestonte përballë erës dhe territ krenarinë e vet prej orakulli.

Drita e mëngjezit e shpalli plojën e gjethurinave. Peizazhi i kërleshur dhe i rralluar, si t'i kishte shkuar përsipër një rrashqel gjigand, tani, pas sulmit të parë stuhisë, dukej më stoik. Kishte filluar stina e erërave.

Gjithnjë, që nga kohrat që s'mbahen mend, aty

nga vjeshta e dytë; në Barbullojë lëshoheshin erërat e ftohta të veriut. Njerëzit ishin mësuar me to, madje kur më të rrallë ardhja e tyre vonohej, ata shqetësoheshin. Ç'kanë? Pse nuk po vinë? Sepse erërat ishin bërë një element i jetës së tyre.

Sa fillonin erërat, Barbulloja futej në një jetë tjetër. Përgjithësisht mblidheshin pranë vatrave, burrat dhe djemtë e rinj vinin në kokë kapele apo kokore që i lidhnin në mjekër me llastikë. Fëmijëve u mbathnin këpucë të rënda. Në ditët me erë shumë të fortë qëllonte t'u futnin gurë nëpër xhepa që të mos ngriheshin hava. Gratë gjithashtu, sidomos shëndetligat, fushnin gurë nëpër xhepa kur zbrisnin në fushë. Një pakicë mbanin edhe gjyslykë ere me xhama të mëdhenj, por ky ishte luks.

Çudia më e madhe e Barbullojës në stinën e erës ishte komunikimi i banorëve me gjeste e vërshëllima. Ata arrinin t'i kuptonin njëri-tjetrin të gjitha lajmet, dëshirat, nevojat, porositë, sharjet, madje edhe mendimet duke përdorur gjuhën në forma të habitshme apo duke fërshëllyer. Era nuk të linte të merreshë vesh pa çjerrë zërin. Për këtë arsye ata kishin shpikur një kod të veçantë marrëveshjeje, unik në mbarë lëmshtin tokësor, siç ishte shprehur një studiues nga kryeqyteti që kishte ardhur katër pesë në Barbullojë me qëllim që të hetonte mekanizmin e atij kodi. Por në këtë pikë vendasit pa përjashtim ishin qind për qind fanatikë; nuk e tregonin, ose nuk dinin ta tregonin sekretin.

Edhe Barbulloja kishte plangprishës, llafazanë, gojëshqepur që argëtoheshin nga nxjerrja në publik e jetës private të njërit a tjetrit. Por kur vinte puna për t'u mësuar vizitorëve apo fqinjëve gjuhën e gjesteve dhe fërshëllimave gojëshqepurit, llafazanët, e plangprishësit sundoheshin nga ndjenja e fshatit dhe heshtnin. E bukur ishte se sapo rreshtnin erërat, hiqnin dorë nga gjestet dhe fërshëllimat si të ishin këto thjesht paimë

dimërore dhe ktheheshin menjëherë te gjuha e zakonshme që flasim ditë për ditë.

Kur erën e kishe në shpinë, zor se mund të lëvizje ndryshe veçse me vrap. Ata që kanë pasur rastin të udhëtojnë rrugëve të Barbullojës me makina të mbyllura gjatë dimrit, i kanë parë njerëzit që duken e zhduken në kthesa e në bërryla rrugësh si figurat e një filmi me xhiro të përsërituara. Dhe ndofta kanë menduar se njerëzit në atë fshat kryesisht fluturojnë dhe janë më të lehtëit në botë.

Kur erën e kishe përballë ishte e detyrueshme të ecje i kthyer në njëerën anë, me trup të përkulur dhe me gjunjët e rrëzuar deri afër tokës. Në formimin e natyrës së vendësve era përballë padyshim ka lozur rolin e vet.

Vazhdimisht dilnin djem që provonin t'i bënin sfidë erës përballë duke ecur me trup të drejtuar apo duke pedalar mbi biçikletë. Por e paguanin shpejt aventurën e tyre. Era u përbirohej në rroba, ua këpuste kopsat e pardesyve, për të mos përmendur rastet kur ua nxirrte prej supesh pardesy të dhe ua merrte me vete si trofe. Këta tipa pastaj i shihje të kapur fort pas trungjeve të plepave, apo duke mbajtur biçikletat në hava si zogj të lidhur me penj.

Këto pamje dukeshin të rëndomta në krahasim me bëmat fantastike të erës që banorët e Barbullojës i trillonin me mburrje të veçantë nëpër hangarë, klube, trena, autobuza, agjenci apo kafene qytetesh të tjera ku frynin ca puhiza dhe fllade mediokër. Sipas trillimeve, të shikoje burra të flakur në çatinë e shtëpisë së fqiniit, gra që fluturonin një metër sipër tokës me fustanet e hapura si parashuta, djem që hidheshin pupthi nga plepi në plep etj., ishte diçka e natyrshme.

Në krye të episodeve të këtij lloji qëndronte historia për «Fluturimin e jashtëzakonshëm dhe shumë të andrrallshëm të Ibër Ramës».

Ibëri u nis sefte në udhëtimin e tij të gjatë një natë dhjetori këtu e pesëmbëdhjet vjet më parë. Ishte

ngritur nga shtrati aty në të aguar për të derdhur ujët e hollë. Mos i mbath ato, i kishte thënë Terezës ndërsa po dilte. Prit e prit Tereza, sillu në të majtë, sillu në të djathtë, u mërzit. U hodh nga shtrati dhe doli në dritare të shihte ç'po bënte i shoqi. Frynte erë e marrë. Ibëri nuk dukej kërkund. Ç'është e drejta, ajo vuri re një si njollë të bardhë në horizont, por as i shkoi ndërmen se mund të ishte Ibëri. Priti deri në mëngjez me gjak të ngrirë dhe me pikëllim të thellë në zemër për zhdukjen enigmatike të burrit. Sa zbardhi mirë u mbush me guxim, doli jashtë, kërkoi në nevojto-re; kërkoi në qilar, në kotecin e pulave, u fut në kopësht, kontrolloi pemët me radhë, u lëshua me një frymë drejt hotelklubit se mos ai tutkun kishte harruar se ishte natë dhe në vend që të kthehej në shtrat, instiktivisht ia kishte mbathur nga «Ngjala», apo s'mbante edhe çelës rrezervë! Hiç. Tereza atëherë nxorri kushtrim. Para «Ngjalës» u mblodhën gjindie e madhe. Ca harama talleshin: «Shih mos e ke mbyllur në raftin e rrobave? Mos ke harruar se po flije pikërisht me Ibërin?»

Tereza, e hidhëruar jashtë mase, nuk e ndjente fare helmin e këtyre frazave. Bënte be e rrufe se kishte cenë në shtrat pikërisht me Ibërin, madje ai i kishte dhënë edhe një porosi para se të dilte.

Dy ditë e kërkuan Ibërin fshatçe, s'lanë vend pa shkelur, u shpupurisën kavaletat e bykut, u lëvizën rrasat e malit, u kontrollua me fener shpella prehistorike e Kajanit. Më në fund kërkimet pa fryt u ndërprejnë dhe ranë të gjithë në një mendje: Ibërin e kishte marrë era. Vejusha i derdhi ca pika loti. Fshatarët nuk dinin se si ta ngushëllonin. As kufomën e të shoqit nuk ia premtinin dot. Se është ndryshe kur mbytesh në lumë! Sillesh nga nga sillesh, por kufoma gjendet një ditë. Kurse kur të merr era është tjetër gjë. Nuk mund të thuhet u mbyt, u dogj, ra, vdiq. Fluturoi, thuhet. Një vdekje të tillë luksoze, një vde-

kje që ikën qiellit, Barbulloja s'kishte patur rast ta provonte kurrë më parë.

Më vonë, kur Ibëri u kthye triumfator në gjirin e familjes, pasi kishte kaluar ca ditë për t'u mbajtur mend në Rogozhinë ku e kishte dërguar era, Terezës i kërcyen xhinaët nga tërë ai harxhim i kotë nervash.

Zbarkimi i Ibërit pa parashutë drejt e nga qielli ishte regjistruar si ngjarje e jashtëzakonshme në jetën e qetë të Rogozhinës. Jo më kot thuhet se ambiciozët më të shkalluar jetojnë në qytezat e vogla. Pra nuk është për t'u çuditur që disa njerëz të etur për të tërhequr vëmendjen e mbarë botës kah provinca e tyre e mënjanuar, nxituan të lajmërojnë me telefona dhe telegrame se në Rogozhinë kishte zbritur më së fund njeriu i parë i Kozmosit. Ndryshe nga njerëzit e tokës, megjithë ngjashmërinë e madhe fizike me to, njeriu i kozmosit kishte aftësinë ende të pashpjegueshme për të ecur nëpër qiell njëloj si ecet zakonisht në tokë. Opinioni, i trullësuar fillimisht nga versioni i kozmofilëve, zuri të reflektonte me gjakftohtësi mbi zbarkimin gjithësesi enigmatik të njeriut të panjohur. Ngaqë Ibëri ishte shumë i zbehtë, i dobët, i zbathur dhe qimerralluar, qarkulloi një mendim sikur ai qenkësh shenjt. Shumica që nuk besonin në fe, vunë menjëherë në përdorim aparatit e dyshimit. E morën në pyetje pa humbur kohën Ibërin e shkretë që dridhej si purteka. Kur ky u tha «vij nga Barbulloja, ju lutem më ndihmoni të kthehem atje, ime shoqe, Tereza e «Ngjalës», ju e njihni Terezën e «Ngjalës», pra Tereza është gruaja ime dhe më pret», hetuesit amatorë shqyen sytë nga habia që margaritari i tyre fliste shqip, pastaj i vunë menjëherë nën kontroll emocionet, nënqeshën, shikuan njëri-tjetrin me djallëzi dhe thanë «Ku ka Barbullojë?» Ibëri kaq shumë u tremb nga ky mosbesim i rrezikshëm, saqë e bëri aty atë që ishte nisur të bënte kur doli nga shtrati bashkëshortor. «Açtu është, nuk ka Barbullojë», belbëzoi. «Po nga vjen atëherë?» e pyetën hetuesit amatorë të gëzuar që ia nxorrën rrenën në shesh me të parën. «Nuk e di, më rrëmbyen erërat.» Ah, çfarë pehlivani! E paskan rrëmbyer erërat!

Hetuesit amatorë u pushtuan nga dyshime të tjera, dyshime që e kanë bazën te atdhedashuria, ndryshe, te vigjilenca e lartë ndaj tokës, ujit dhe ajrit nga mund të befë e keqja. Tre ditë e tre netë e bombarduan me pyetje desantin dinak, por s'nxorrën gjë të re në dritë. Ditën e katërt Ibëri nuk ishte në gjendje të fliste më asnjë fjalë. Rrinte sypërpjetë, i pikëlluar, sikur priste kthimin e kalit tradhëtor që e pat lënë mes atyre njerëzve mosbesues. Atëhere banorët që e mbajtën me bukë e deklaruan të çmendur dhe kërkuan të lihej i lirë.

Këtu mbaronte udhëtimi i ciklit të «Fluturimeve», që pat nisur si krijim tendencioz i disa personave që nuk i patën honepsur mburrjet dhe natyrën prej kameleoni të Ibër Ramës sikurse edhe harxhet e tepërta të familjes që kryesonte. Këta persona patën shfrytëzuar një rast të hidhur kur Ibër Rama pat humbur vërtetë dy ditë dhe qe gjendur në kokërr të gjumit në dhomën e rezervuar të hotelklubit «Ngjala». Duan të thonë se në trillimin e mësipërm kishte gisht edhe ndonjë sarhosh Barbulloje që synonte të shtinte në dorë Terezën, ndaj, për të siguruar alibinë e çdo dyshimi dhe akuzë të mundshme, përpiquej ta paraqiste Ibërin si tuaf para botës.

Por, më vonë, kur po ata persona, ose të tjerë (kjo nuk u muar vesh kurrë) e nxorrën Ibërin përtej kufijve shtetërorë dhe zunë ta shëtisnin vend më vend duke e pajisur me fjalimet përkatëse të një misionari luftarak; motivet fillestare të «Fluturimeve» u zëvendësuan me motive të tjera; Ibëri nuk ishte më ai i vërteti, por një personazh që ndryshonte vazhdimisht gjatësinë, trashësinë, ngjyrën e zërit, të lëkurës dhe të syve, veshjën, krehjen, madje edhe seksin. Ky burrë Barbulloje, pjellë e natyrshme e aplikimit në një kënd fatlum të globit e ligjësisive dhe filozofive përnjimend laike dhe, përnjimend diellore, ishte zotuar të ndriçonte popujt. Përballë sirenave të panumërta të botës matanë, ai do të dëshmonte forcë dhe përbuzje. Kështu, një mëngjes të ftohtë dimri, kur burrat e katundit çanin me lopata

akujt sipër fushave të përmbytura nga shirat dhe gratë kujtonin pranë oxhakëve të vdekurit e kahershëm në tokën e Diellit, ky zgalem i ri i furtunës kapërceu detin me librin e trashë të mësimëve nën sjetull dhe ja ku pa tokë. Por nuk u ul menjëherë. Radarët dhe instrumentat e tjerë interceptues e kishin sinjalizuar me kohë hyrjen e njeriut me flatra në kufijtë e atij shteti, shtypi ishte vënë në lëvizje, fotoreporterët, kameramanët dhe analistët shtyheshin rrugë më rrugë e shesh më shesh, duke parë njeriun që rrëshqiste nja pesëdhjetë kat sipër tyre.

Ndjenja e ngulitur e tribunit e këshilloi atë të ulej në sheshin më të madh ku ishin grumbulluar më shumë njerëz. Dhe ai, shend e verë, i gjatë dhe i qeshur, bukurosh dhe kryelartë, zbriti duke përshëndetur me dorën e djathtë. Deri në ato çaste qielli që mbuluar me re të zeza dhe pritej të binte shi. Por buzëqeshja e gjerë dhe drita e fortë e syve të atij burri i davariti retë e zeza, qielli shndriti si xham dhe njerëzia u mek nga mahija. Vetëm më vonë, pasi që larguar duke lënë shumë mall e shumë ëndërrime në dritaret erotike të atij vendi, analistët zbuluan se përshëndetjet e dorës së tij nuk tregonin dashuri, por forcë.

Kjo domethënie e pakapshme qysh në krve dëshmonte thellësinë e tribunit dhe prandaj analistët iu rikthyen edhe një herë fjalimit që ai kishte mbajtur para popullit, kur pasi kishte denoncuar faqazi farsat e politikave pseudopopullorë dhe fasadën e shoqërisë në kalbëzim, gjë që pëlqehet gjithmonë nga qytetarët, kishte nënvizuar se çështja e revolucionit nuk është më një aspiratë dhe një perspektivë, por një problem i shtruar për zgjidhje. Në të vërtetë, me gjithë inteligjencien e padyshimtë të oratorit, analistët e gjenin të errët dhe pa sens këtë frazë. Sipas të gjitha konkluzave politiko-sociale, kombi i tyre po kryente dita ditës një revolucion, kështu që nuk merrej vesh për çfarë çështjeje ishte fjala. Po gjasat ishin që oratori mund të ishte i painformuar mirë, pa llogaritur një version të dytë, sipas të cilit ai mund ta kishte pasur fjalën për kombin e vet.

Këtë version e përforconte hutimi i tij elegant kur shkoi të kalonte natën në një vilë luksoze afër detit dhe meqenëse aty për pak qe duke harruar detyrat e veta, kërkoi ta dërgonin urgjentisht në një shtëpi të thjeshtë punëtori.

Ndërsa analistët vazhdonin zhbirimet e këtij lloji. Ibëri, mjaft i kënaqur që kishte mundur të linte gjurmë, madje të hidhte farë idesh në ndërgjegjen e atyre qytetarëve, ishte kthyer në Barbullojë për t'u thelluar në librin e Mësimeve. Proven e parë përtej detit e kishte përmbushur me sukses.

*
* *

Gjëja e parë që mendoi Adrian Miraj pas gjithë asaj nate shkandulluese, ishin orizoret. Ai lidhi një shall rreth qafës, ngjeshi kapelen dhe u nis për atje. Pamja në parcelat e orizit ishte e lemerishme. Bimët të gjitha pa përjashtim, kishin pësuar një si frakturë të nyja e dytë e kërcellit dhe ishin plandosur mbi njëra-tjetrën si të vdekura. Era kuiste mbi to. Adriani ktheu kokën majtas. Si nja dymbëdhjetë burra rrinin në këmbë mbi bankina. Të gjithë kishin dalë pa kapele. Pak më vonë, duke u torovitur majtas e djathtas si rosë e plagosur, ia mbërriti Skënder Abdylit. Ai u përkul dhe ngriti nga toka një dorë kallinj. I mbajti gjatë në pëllëmbë sikur numëronte kokrrat e mbetura, pastaj duke fshirë sytë e përlotur (nuk merrej vesh nga era apo dhimbja), i la kallinj të përsëri aty ku kishin qenë. Dikush e pyeti me gjuhën e gishtave: «a janë shkundur shumë?». Skënderi pohoi me kokë. Flokët e tij të butë lëkundeshin nga të gjitha anët.

Në rrugën ndanë orizoreve frenoi makina e kryetarit të kooperativës. Gaspri u hodh nga dera e parë, i kërrusur si parashutist. Ai vuri re se njerëzit atje te bankina po fjaloseshin me atë zhargonin e mallkuar të gishtave. Ndofta më shajnë mua, mendoi dhe u ndie i

huaj në atë vend. Fill mbas tij ia mbërriti me Gaz drejtorin i SMT-së. Rafail Dodbiba, një burrë i mbaitur rreth të pesëdhjetave. I mbështjellë me gozhupin e vet të madh; ai doli nga makina me urgjencë. Era ia përllau kapelën, ai ngriti dorën ta mbante, por ishte vonë. Kapela fluturoi si raketë kalamajsh sipër arave. Askush nuk bëri përçapjen më të vogël për ta ndjekur. Koka e Rafailit, me ato flokët e rralluar dhe të lvrshëm u duk krejt e pambrojtur, vetë ai i pasigurt dhe pa epërsinë e zakonshme ndaj kolegëve të bujqësisë.

Gaspri i tha me zë të lartë djeka. Rafaili vuri pëllëmbën te veshi. «Çfarë, çfarë?». Ata u nisën si me komandë drejt njëri-tjetrit. Gaspri bërtiti me sa nati në kokë një fjalë të rëndë. Rafaili hodhi edhe një hap para dhe gati sa s'u cikën.

Ishin skuqur e shpërthekur të dy. Era i shturte zanoret dhe bashkëtingëlloret e fjalëve që thoshin duke i shpërndarë në hapësirë si ciatie. Më në fund ata u kthven mbrapsht që të dy dhe ecën duke gulcuar në vijë të drejtë sikur shkonin të rriheshin në një vend ku nuk i shihte njeri. U futën secili në makinën e vet. Makina e Rafailit u nis e para. Makina e Gasprit nuk po ndizej. Shoferi jepte e merrte me manivel i ndjekur nga sytë prej kukuthi të Gasprit. Këti i vinte plasje që makina e Rafailit po zhdukej në horizont. Në trurin e tij feksi dhe u shua si vetëtimë mendimi i vjetër për të blerë makinë më të mirë.

Si e pa që nuk po nxirrte gjë në dritë me manivel, shoferi u bëri ca shenja me gishta fshatarëve. Gaspri uli xhamin dhe zëjati kokën.

— Çfarë u the atyre? — e pyeti shoferin.

— I thirra ta shtyjnë! Ka rënë bateria, nuk ndez!

— «Pif, more djall i madh, tani e gjete», — tha me vete krvetari dhe zbriti.

— Rri brenda, e shtyjnë ata! — thirri shoferi.

— «O është djall me brirë, o është karroqe nga kaptina», mendoi krvetari. Tym sic ishte, duke dyshuar në sinqeritetin e shoferit, lëshoi një urdhër kot: Ndize makinën!

— Nuk ndizet pra! Kanë rënë bateritë.

— Çfarë bën ti, kullot lopët?

Ndërkohë nja katër-pesë burra qëndruan prapa makinës duke fërkuar duart. Gaspri i kërkoi njërit prej tyre një cigare.

— E humbëm orizin, — tha duke thithur cigaren e fshehur në grusht, Megjithëse ishte i bindur se nuk e kishte dëgjuar njeri, u përpoq të mos e kryqëzonte vështrimin me atë të Skënder Abdylit. Por humbja dhe dëshpërimi i lexoheshin në fytyrë.

— «Nuk është njeri i keq», — ia bëri me gjeste njëri nga burrat.

— «Është kryetar i keq», — ia ktheu një tjetër.

«Kryetari ynë është nikoqir me emocionet e veta. — mendoj Adriani. Por tani orizi ra dhe nikoqirllëku i shëmtuar i emocioneve s'ka më asnjë vlerë».

— E humbëm orizin, — përsëriti Gaspri duke flakur cigaren e pirë përgjysmë. Ngriti kokën dhe u ndie si i kapur në çark brenda heshtjes së rëndë të burrave. Sytë e tij u bënë menjëherë të vëmendshëm. Tani ai kërkonte ngushëllimin që meritonte e jo mëshirë. Jo mëshirën e fajtorit! Jo, jo! Ai s'kishte bërë faj! Thjeshtë ishte treguar mirëbesues ndaj Rafailit. Nuk kishte dashur t'i lodhte njerëzit në orizore.

Skënder Abdyli tha diçka me zë të lartë. Gaspri ngriti supet. Asgjë s'dëgjohej. Skënderi ia bëri me shenjë, por u kujtua që Gaspri s'e dinte atë gjuhë. Të dy u futën në makinë. Mbyllën dyert.

— Keq, shumë keq, — mërmëriti Gaspri duke kqyrur me bisht të syrit duart e lira të tjetrit.

— Ka edhe më keq, — tha Skënderi.

— Domosdo, ka edhe më keq.

— Orizi ka humbur mjaft, por shumica është në arë. Tani të shpëtojmë këtë që ka mbetur.

Në sytë e Gasprit u ndez një dritë shprese.

— Ah, more Rafail, ç'më bëre, — foli më tepër me veten se me Skënderin.

— Lere Rafailin tani, i zoti e nxjerr gomarin nga balta! Duhet bërë diçka!

— Çfarë të bësh, mor, çfarë të bësh? — foli Gaspri me atë inatin e paharxhuar për drejtorin e SMT-së.

— T'i përvishemi orizit të gjithë, këtë të bëjmë! — Skënderi zbriti nga makina dhe fill pas kësaj u dëgjua thirrja e shoferit «o burrani!». Katër palë duar, të ndihmuara edhe nga era, e shtynë makinën nja tridhjetë metra si të ishte prej letre.

KAPITULLI I NËNTË

Shkulmi i kristaltë i ujit të trumës midis arave u murrëtye papritur. Adriani dhe Liljana ngritën sytë njëkohësisht nga qielli. Shtresa e reve bojë hiri nxihej ngadalë sikur i kalonte dikush përsipër me pambuk të ngjyer.

— Dimri, — tha Liljana.

— Ku? — ia bëri Adriani i habitur. Ajo u bë gati të tregonte me dorë një drejtim çfarëdo, por era ia hodhi prapa kokës shaminë e lidhur nyje në mjekër. Adriani ju kujtua vargu i një kënge që e kishte dëgjuar gjatë një udhëtimi me tren:

«Mirupafshim në verë, Marije,

Mirupafshim në verë!»

Nën qiellin e mbushur me re fërshëllente era dhe ekzistenca e verës iu duk atij si një ëndërr. Grupe fshatarësh që kishin zbritur në orizore pa çadra dhe mushamaj po ikin nga fusha.

— Do të fillojë shiu, — tha Liljana.

— Do të fillojë, — përsëriti nëpër dhëmbë Adriani. Liljana e vështroi me vëmendje dhe se si i erdhi që sytë e tij nuk ishin më aq të kaltër sikur edhe atie në bebëza po fillonte dimri. Ata u vështruan një copë herë pa folur, pa lëvizur, me një mall dhe me një frikë që as njëri, as tjetri nuk e shpjegonin dot.

— Ec para ti, — tha Adriani dhe ajo u bind. Pasi bëri pesë gjashtë hapa ktheu kokën për ta përshëndetur,

atij se si iu shkrep dhe tha mirupaishim në verë, Liljana.

— Siiii?

— Asgjë.

Ajo gjithashtu tha diçka dhe ai ktheu veshin andej nga vinte zëri, por nuk kuptoi asgjë.

Huqimi dhe ngashërimi në fytyrën e saj ngrinë menjëherë nën tufat e flokëve që era e veriut ia përpiaste parreshtur faqeve. Ajo shtriu duart përpara sikur po lutej, pastaj ktheu pelëmbët si kupa drejt qiellit dhe filloi të fliste me gishta. Ajo po thoshte se në jemi rritur bashkë, se jemi gati-gati binjake, se njëherë tepër o vëlla i pandasëm dhe prapeseprape jemi rober të vetmisë dhe, kushedi pse, nuk dalim dot nga vetmia. Një gulçim i brendshëm u jepte jetë gjesteve dhe kërrusjeve të saj energjike. Adriani mbylli sytë me dhimbje. Nuk e shihte dot ashtu, të tendosur, të kërrusur, të shëmtuar. Mjaft! Mjaft! Mjaft! Sakaq, Liljana u kthye me vrull me fytyrë nga era dhe krisi e iku gjithë duke çarë me krahë vrundujt e veriut.

— Liljana! Liljana! Liljana!

Era sikur e shkepte emrin e saj nga goja e tij dhe e dërgonte larg atje ku mbaronin fushat dhe fillonin lagunat.

Adriani u çapit ngadalë — ngadalë drejt fshatit, duke shkelur mbi gjethë. Kurrë s'kishte pasur aq shumë gjethë në tokë. Në kanale, ndanë rrugëve, në anë të qardhiqeve, në gropat e zbrazura të gëlqeres, prapa muresh e trungjesh gjethet ishin rrasur njëra mbi tjetrën, duke krijuar ca si duna të palëvizshme. Ndërkaq mijëra gjethë vërtiteshin andej-këndej shesheve, rrugeve, oborreve, koopshtijeve, arave. Duke i parë ato nuk do të çuditeshe aspak sikur në buletin meteorologjik të mbrëmjes të thuhej se në Barbullojë ka qenë kohë e ftohtë me erë dhe rreshje gjethesh.

Para dyqanit «Artikuj të përzier» patrullonte qetë-qetë Ibër Rama me pallton e gjatë, me gjyslykët e mëdhenj dhe me kapelen e rrasur deri afër veshëve. Të gjithë ju mund të fluturoni si puplat, dukej sikur thoshte ai, vetëm unë jo. Ku ishin strukur, pse nuk dilnin

në logun e burrave, por fshiheshin si minjtë vrimave ata që kishin shpikur atë historinë vulgare të «Fluturimeve»? Ai ndofta nuk e dinte se njerëzia po mpirhinin drapërinjtë për të korrur orizin, po nxirrnin nga bodrumet e nënminderet çizmet e gallosnet, po shtrëngonin kopsat e xhakëve dhe tallaganëve, po qepnin llastikët e këputur të kapeleve, po arnonin çadrat dhe mushamajt.

Adrian Miraj e përshëndeti Ibërin me kokë dhe shkoi në shëpinë e vet të rregullonte çizmet e shqyera qysh pranverën e kaluar. Pasdite, me zemër të thyer dhe i mërzhitur sa s'bëhet për Liljanën, kaloi nga hotelklubi «Ngjala». Salla e ngrënies ishte plot me djem të rinj. Pasi kishin përgatitur drapërinjtë, rrashqelat, fturçit, kapelat, çizmet e paimet e tjera që nevojiteshin për aksionin e vështirë në orizore, ato ishin grumbulluar te «Ngjala».

Aty-këtu dëgjohej kënga «Shkova në prru me la qemerin».

Te tryeza prapa derës ishte ndezur biseda mes Ferdinandit dhe përgjegjësit të shtëpisë së kulturës.

— Puno më shumë që të marrësh më shumë më thotë brigadieri im, Palushi. Po punoj, mor dajë, shumë po punoj! Ej, ju! Zini një këngë tjetër, pash nderin! Mjaft me këtë këngë! I doli boja! Po punon, mirë po punon, por mund të japësh më tepër, më thotë Palushi. Futi edhe një marrsh tjetër unë! Vjen fundi i pesëmbëdhjetë ditëshit, përsëri e njëjta pagë...

Adriani shkoi gjer te banaku. Dy djem u drejtuan sikur do të kryqëzonin shtizat. Ata ishin caktuar nga Tereza të ruanin banakun një copë herë sa të mbaronin matanë një punë llogarie me Prengën e gjatë. Në fytyrën e njërit prej djemve rrëshqiti një buzëqeshje djallëzore.

Adriani u kthye përsëri drejt tryezës ku Ferdinandit, flakë i kuq në fytyrë, tundte duart përballë fytyrës tmerrësisht të vëmendshme të përgjegjësit të kulturës.

— ...kjo është një shpifje armiqësore, mor djalë, unë nuk lejoj, bërtiti Palushi! As unë nuk lejoj

të ushqehen dembelët e tarafi yt me djersën timë! Po keshtu, lumë e për lumë po shkojnë punet këtu! Njeri punon dhe s'merr, tjetri s'punon dhe merr. Ke parë ti? M'u hodh si xhindi: Si ta nxë goja te thuasht kush nuk punon merr dhe kush punon nuk merr? Kjo është në kundërshtim e tjerë e tjerë. Ngaqë është në kundërshtim e ngre zërin unë, ia prita... Hë, ju lumë o djema, Lilos merrjani, — e nderroi tonin Ferdinandin duke kthyer kokën andej ku këndohej kënga «Oj Lilo». — Ja, më ranë nervat, — vijoi. — Dëgjoj këngën e Lilos dhe më bien nervat. Kështu, i dashur... O, paske ardhur ti Adrian. Po i tregoja përgjegjësit një debat me brigadierin. Na ha pikët, more! Ua jep cave që s'punojnë. Mirëpo unë dua pikët. Është djersa ime. Dua të marthohem, kam nevojë për para.

Adriani u drodh. Vetimthi, në mendjen e tij u përhi figura e Liljanës. Çfarë kishte thënë ajo atje te truma?

— Brigadieri se ku ka gjetur një citat, në mos e pastë stisur vetë dhe më thotë, kush lufton për para është armiku i interesit të përgjithshëm. Hajde merre vesh! Pastaj ma ngre këtë edhe në mbledhje! Keni lakra në kokë, thotë. Luftoni për para! Në sulm Palushi, vetëm në sulm. Pikët na i vjedh ama! *Dy punojnë, dy vëgjetojnë*. Në fund paguhemi njëllonj... Për zotin, — thirri i entuziazmuar Ferdinandin, — e kam kapur kyçin që s'po na ecin punët.

— Këtu në Barbullojën tonë kudo ta shtrish dorën kap një kyç — tha bjondi Artan Boci, që mbante vesh nga tryeza fqinjë. Zëri i tij ishte i veshur, kopje e zvoqëluar e zërit të të atit, Lazër Boci.

Drejt tyre me hapa të lehtë e të ngadalshëm, me vështrimin e ngulur te feneri sipër derës në dalje, duke mbajtur në dorë një gotë të zbratur, po vinte Desaret Leci. Përmbi shallin e lidhur fort në qafë ishte zgjatur si rrepë mjekra e tij e hollë. Kishe përshtypjen se po ta hiqte shallin, mjekra do t'i varej në gjoks.

— Ç'thonë teoricientët? — foli nën hundë Desareti sikur fliste me sqep. Të tjerët i hodhën ca vështrime pa shprehje, pastaj përkulën kokat mbi tryezë. Nuk ia

kishin qejfin Desaretit. Ky u zgërdhi me ilegalitetin e dëftyer ndaj tij. Gjithë me të njëjtin hap të ngadalshëm u nis drejt një grupi të zhurmshëm djemsh që pas këngës së Lilos kishin zënë këngën «Kam uri ditë e kam tri netë».

— Prapë me këngë vajzash, — u ankua Artan Boci. Siç ishte i ulur në karrige, u kthye përgjysëm dhe thirri:

— Ej, merrjani një kënge burrash! Tfy, piskuriqët! — shau pastaj nën zë. — Vetëm fustanet u mungojnë. Gjithë rolin e femrës e luajnë vetë.

— Kënga nuk ka gjini! — tha dikush.

Ndërkohë, Prenga i madh kaloi nën deriçkën e banakut dhe duke i hedhur këmbët e gjata si proteza, me nofullat e shtrënguara panatyrshëm si kllapa metalike, zuri të pyeste klientët ç'dëshironin të merrnin. Në të gjithë tryezat i përgjigjeshin njëlloj me dorë në zemër «asgjë të faleminderit», «asgjë të faleminderit». Dy djemtë që kishin vigjëlur në banak i lëpiheshin nga pas me një lakmi të keqe në sy. Një minutë më vonë në banak u shfaq Tereza. Nën ndriçimin e fortë të neonit, tek rrotullonte majtas e djathtas kokërdhokët e kukur të syve ku voziste një hutim i ëmbël, ajo ngjante me një kukull të plakur. Herë pas here prekte me gishta krelat e flokëve në të dy anët e kokës, pastaj supet, gjoksin, prehërin tamam si një rosë që pastrohet me sqep pasi ka dalë nga uji.

Ajo që nuk dukej, por që ishte kudo e pranishme në atë mjedis të paqëndrueshëm, u shfaq: Fytyra elastike e «të gjithanshmit» Mikel Kaçorri. Mikeli ishte nga ata djemtë e shkurtër dhe të shkathët për të cilët përdoret epiteti zhivë. Ai po qeshte me të madhe me vërejtjet e Artan Bocit për këngët grarishte të kënduara nga djemtë. Por ishte në gjendje ta shuante në çast të qeshurën dhe të pozonte njëpasnjëshëm, në një kohë rekord, të gjitha shkallët e shprehjes mes gëzimit më të madh dhe pikëllimit më të thellë.

Gjithë duke qeshur, Mikeli u përkul mbi supin e Artanit dhe tha:

— Po! Kënga është e gjinisë asnjane!

— Ata edhe zërin e bëjnë si të vajzave. I dëgjon me shpinë dhe thua me vete: po këndojnë shoqet. Kur, fup, kthehesh dhe sheh alamet shulash. Të vjen pështirë! — thirri Artani.

— Ç'vret mendjen kot! Ashtu kanë qejfin e tyre, — foli gjakftohtë dhe i përhumbur ai që rrinte në një tryezë me të, Aleks Basha, djali i Dodë Balshës, i cili kishte mundur ta provonte se një rrem i Balshajve të përmendur të Arbërisë së vjetër kishte çarë nëpër mungun dhe rrebeshet e kohës deri në ditët tona dhe kishte degëzuar e lulëzuar sërish të Balshajt e Barbullojës. Stemën e principatës së vjetër me një rreqebull në mes, Doda e kishte porositur te një bakërxi dhe e mbante varur në dhomën e miqve. Ndërkaq ai përpiqej t'i përkujtonte kushërinjtë e largët edhe duke kalitur te femijët qëndrushmërinë kundër lakadredhave të ndërëgjjes. urtësinë kundër shturjes së gjuhës, durimin kundër frymës së mjerë ankestore. Të gjitha këto, që sipas tij i kishin ndihmuar stërgjyshërit të mbijetonin, për bënë fisnikërinë e një arsyeje të shëndoshë që synon të rrokë jetën, jo çastin.

Duke e studiuar natyrën e Aleksit në dritën e cilësive të lartpërmendura, thoshje me vete: Jo ai nuk është vuv, siç duket. Ai është i urtë, i matur! Ai është i mençur! Dhe vërtetë: asnjëherë nuk ishte kritikuar nënër mbledhje. asnjëherë nuk dërgohej në punë të vështira. asnjëherë s'kishte ndodhur të bënte sherr me njeri.

Artanin nuk po e lëshonte inati me këngën vajzërishte të djemve.

— Ç'e vret mendien kot. ashtu e kanë qejfin. — përsëriti Aleks.

— Bëjnë qejfin e tyre dhe prishin tonin. Qejf është ky?

— Kështu e ka kjo punë. Koha do t'i rregullojë...

Artani ia këputi frazën në mes me një shikim të rreptë që nuk paralajmëronte për mirë.

Djemtë ia morën një kënge tjetër, kësaj radhe «të gjinisë asnjëherë». Artani u ngushëllua pjesërisht dhe sakaq i mbetën sytë te hija e dorës së Ferdinandit mbi tryezë. Hija dridhej pa pushim si në ethe. Pastaj sa

çel e mbyll sytë ajo hije u shtyp si një insekt i kapur beft. Prram! kërciti tryeza. Adriani pa pëllëmbën e Ferdinandit mbi të.

— Mos u nxe! — tha.

Kjo ishte e tepërt, krejt e tepërt.

— Në dejtë e mi rrjedh gjak njeriu, jo gjak bretkoce, — tha Ferdinandi.

— Sigurisht.

— Ç'prishni nervat kot, — foli Aleks Balsha, që kishte mbështetur kurrizin në shpinoren e karriges dhe shëtiste vështrimin e fjetur nëpër sallë.

Artan Bocit i kruhej dora e djathtë. Në sytë e tij fikej dhe ndizej një shkëndi sherrane. Ata djemtë në skaj të lokalit po këndonin përsëri një këngë vajzërishte. Ca të tjerë kishin futur në mes Mikelin e gjithanshëm dhe po i luteshin të fillonte me imitimet. Mikeli i kishte faqet të skuqura. Pak më tej Vlash Keqi me dy të tjerë pinin në heshtje raqinë që u kishte servisur Prenga i gjatë. Vetëm ata kishin bërë porosi. Desaret Leci me mjekrën e gjatë të shtrënguar me shall dhe me një gëzim zogjsh në sytë e vegjël rrëshqiste sa të njëri grup te tjetri duke pyetur ç'thonë këngëtarët. Ç'thonë shakaxhinjtë, ç'thonë Balshajt e rinj. Ç'thonë teoricientët? Kur u përkul për herë të tretë mbi tryezën ku rrinin Ferdinandi, Adriani dhe përgjegjësi i kulturës, kishte fituar më shumë guxim sepse gërveshi buzët, ia nguli sytë e vegjël Adrianit dhe lëshoi një pyetje bombë:

— Ç'thotë dashuria?

Në vështrimin e tij nuk ishte vetëm kumtimi i një të fshehte. «Atë femër, domethënë Liljanën kam pasur dhe kam fatin ta ëndërroj edhe unë», thoshnin sytë e tij cicërues.

Ai zuri të zbythej me një përrulje fare të lehtë të trupit, duke i dhënë zemër sa mundtte Adrianit që kishte rënë në mërzë.

— Dehet pa pirë. — tha Ferdinandi.

— Luan rolin e Ibër Ramës, — tha me përbuzje Artan Boci.

— Unë luaj rolin tim, — tha Desareti duke ikur.

— Roli yt është t'i bësh të gjitha pa bërë gjë, — tha Ferdinandi.

DËSA sekonda ra heshtja. Zhurmat e lokalit i mbyti kënga e djemve në skaj. Artan Boci u përpush në karrige. Dora e djathtë i kruhej 'eq. Në sy i vizlluan papë ato shkëndijat sherrane. Kënga e pambaruar e djemve sikur ndalte diçka. Dhe vertet, pas pak, në aerë të lokalit u duk nusja që po bënte muajin e mjaltit në Barbullojë. Me tualeun e zakonshëm në rityrë, krenare, ngacmuese dhe agresive, ajo dukej sikur thoshte: «Me turrët? Erdha!». Pamja e saj reflektonte triumfin ndaj pengesave që mund t'i kishte vënë i shoqi për ta penguar të dilte.

Desaret Leci e nuhati dëshirën e saj të plotësuar dhe rranu shuplakat me gezim. Ajo nuk kishte frikë nga djemtë e Barbullojës! Ajo i pëlqente argëtimet e tyre, ajo mund të lozte me to! Bukur, shumë bukur!

Kënga dhe bisedat pushuan. Eda u dhuroi djemve një buzëqeshje të lehtë falenderimi dhe pafajësie meqenëse vetëm ajo ishte vajzë në atë mjedis meshkujsh. Pastaj ngriti vetullën e majtë, ndofta vuri re diçka të pakëndëshme diku dhe ashtu vetullngritur eci serbes midis tryezave. Palat e fustanit me pika i përplaseshin pas këmbëve të holla e të drejta tamam siç përplasen ca dallgë kryeneçe pas bregut të detit.

«Do të jetë zënë me të shoqin dhe tani po merr hak», — tha me vete Adriani.

Mendimi se ajo hakmarrje kryhej në kurriz të ca djelmoshave të entuziazmuar e trishtoi.

Një kokëqethur nga grupi i këngëtarëve mbylli sytë dhe ia nisi i vetëm «O, shkova në prru», por shokët nuk e ndoqën. Ai e ndërpreu këngën krejt i hutuar. Heshtja u bë më e thellë.

— Këndoni, mos e lini këngën! — u lut vajza, duke u kthyer e tëra me fytyrë nga djemtë. Zëri i saj kumboi

në lokal si gurgullima e një burimi malor. Inisiativa e atyre që kishin ndërmend të këndonin u pre më keq. Jo, jo. E folura e nuses ishte më e bukur se çdo këngë.

Mbi sytë e saj shpuzë varej një si rrjetë e hollë melankonke. Ajo ishte e sigurt se mund t'i tërhiqte për hunde nga të donte e si të donte turmën e djemve. Por nuk ndjenez shumë e rrahur për të ushtruar pushtetin mbi vullnetet e nënshtuara.

Nga njëra anë i vinte keq pse disa rrinin fare të tulatur. Ndërkaq ndiente edhe frikë. Ndaj zuri të përdorte me kujdes ndikimin e vet, duke u kumtuar të gjithëve lirinë e argëtimit. Le të argëtoheshin në qefin e tyre! Pa turp fare! E kush ishte ajo në fund të fundit? Një njeri si ata, një motër e ardhur nga larg! O burra, jepni! Ahiiii! Më paskan rënë çorapet. Një sekondë ju lutem sa t'i çoj. Ajo u përkul, duke zbuluar mishin e bardhë të kofshëve.

Midis heshtjes së thellë që pasoi përkuljen e saj gjëmonte diçka si rrahje pulsesh. Dy-tre djem, të eksituar menjëherë nga ajo që panë, u larguan vjedhurazi nga lokali për t'u çliruar diku jashtë nga sekrecionet seksuale.

Ikim! — i tha Adriani Ferdinandit.

— Prit! Të shohim çka ndërmend të bëjë!

— Nuk e kupton?

Ferdinandi ngriti supet.

Pasi ngriti çorapet, duke treguar edhe njëherë ashtu si pakujdesshëm pjesën e bardhë të mishit sipër gjunjëve, Eda thirri:

— Më falni, ju lutem. Gati!

— Eda! Eja pak në dhomë! — kumboi që nga dera e sallës, gjithë qortim e lutje, zëri i të shoqit.

— Prit, — u përgjegj ajo dhe puliti sytë duke i buzëqeshur me përzemërsi të kërkuar. Pastaj u kthye nga djemtë sikur u lutej për ndihmë.

— Eja të them! — bërtiti Hektori. Kësaj radhe disa nga djemtë e panë me egërsi. Flokët e tyre të drejtuar si tela paralajmëronin sherr. Desaret Leci e shpoi lehtë në kurriz Mikelin e gjithanshëm. «Fillo, ç'pret». Dhe

ky, mu sikur po e priste padurimshëm prej disa minutash këtë sinjal, u hodh në mes të sallës dhe shpejt e shpejt, sa për të kruar zërin bëri si gjel, si trumcak, si qen dhe si maçok. Shpërthyen të qeshurat dhe duartrokitjet. Atmosfera u ndez përsëri.

— Shkëlqyeshëm, — thirri Eda që ndërkohë ishte ulur këmbë mbi këmbë në një karrige midis djemve. Hektori ziente nga inati. Kishte qëndruar si kukuth diku prapa shpinës së atyre që shërbenin si eskortë e Edës dhe nuk dinte ç'të bënte.

Mikeli i gjithanshëm u rrotullua në shpinë si një peshk, pastaj kërceu si delfin deri afër dyshemesë, u kthye në ajër me kokë poshtë dhe u var drejt dyshemesë me duart e lidhur në gjoks. Sytë e Edës u mbushën me tmerr. «Do coptohet» mendoi në të qindtën e sekondës dhe mbuloi fytyrën me pëllëmbë për të mos e parë gjakun. Por në çast duart e akrobatit u zgjatën dhe u mbështetën si balestra në dysheme. Trupi i tij me këmbët e ngritura lart qëndroi në ekuilibër.

— Bravo! Bravo! — thirri Eda me një zë të papastruar plotësisht nga tronditja. Mikeli zuri të ecte me duar nëpër sallë me shpejtësinë e zakonshme të një këmbësori, duke zgjatur kokën përpara si breshkë...

— Ai i imiton të gjitha krijesat, me njerëz dhe me kafshë, — i tha Edës Desareti.

— Besoj se sonte do të paraqitet me repertorin e tij më të zgjedhur! — vërejti Eda.

— Me siguri! O sonte, o kurrë, — ia ktheu Desareti duke e mbështjellë tjetrën me një vështrim adhurues-ëndërrues.

— Po ti ç'farë je i zoti të bësh? — iu drejtua Eda duke ngritur vetullën e majtë në një farë feje që Desaretit iu duk provokuese. Ky mori zemër nga ai gjest ngacmues dhe vendosi të përgjigjej me guxim, shumë sinqerisht: Liroi paksa shallin e shtrenguar rreth qafës si për të thithur një dozë më të madhe ajri dhe i pëshpëriti asaj te veshi i majtë me zë të dridhëruar nga emocioni:

— Unë dashuroj më tepër se gjithë këta që sheh këtu.

Eda nënqeshi dhe kërkoi me sy të shoqin. E gjeti diku në një boshllëk përtej djemve. Ai ishte bërë dyllë. Nga fytyra e saj u shkëput një shkrepëtimë kënaqësie. Desareti e futi në xhepin e vet atë shkrepëtimë kënaqësie. E pa me vend të lëshonte hapin tjetër drejt nuses. Por në këtë çast, në sallë u derdh breshërima e fjalëve të Mikelit që po thoshte formulën e paraimitimeve.

— ...sepse çdo njeri ka diçka për t'u imituar. Kjo e dallon atë nga njerëzit e tjerë. Ky dallim është vetë personi. Prandaj shikoni e mbani vesh e të mos i ngelet qeifi askujt, por të gëzoheni që unë, Mikeli, mora mundimin t'u studioj, t'u zbuloj, t'u imitoj!

Duartrokitje. Në ajër rrinte varur një pritje e etshme. Mikeli ia nisi në fillim me cingërimat e memecit Hysen. Eci duke çaluar drejt banakut dhe u këthye gjithë duke çaluar, duke gërveshur buzët, duke rrotulluar shtë si gogla, duke fërkuar gishtin e madh me treguesin dhe u ndal përballë Artan Bocit. «Kv. para shumë». — tha Mikeli, «para...para» dhe hapi krahët anash sikur do të fluturonte. Në sy i vizllonte një dritë e argjente lakmie. Artan Boci u kërr duke turfulluar a thua se ca duar të padukshme po i rrëmonin xhepat. Ai i rezistoi gati dy minuta ftesës së Mikelit për të lozur. Mandej brofi në këmbë, rrsi në xhep dy a tre taketuke dubani dhe nisi të gjezdiste rëndë-rëndë nëpër sallë i ndjekur nga «çalamani» Mikel që përsëriste papushim «para...para».

Duke trokëllitur taketuket, pasi u ra me shpulla atyre që këshin kënduar vaizërisht atë mbrëmje, qëndroi hijerëndë në krah të Mikelit. Ky doli menjëherë nga roli i memecit Hysen dhe zuri të imitonte të folurin si në mulli të Lazër Bocit, babait të Artanit. Një kakofoni zanorësh dhe bashkëtingëlloresh, fjalë që kumbonin fort dhe shuheshin a thua se njeriu që i shqiptonte nuk kishte asnjë dhëmb në gojë ose ishte shqyer në fyt. Nuk merrej vesh asgjë. Mikeli e ndërpreu imitimimin dhe sgarroi çfarë kishte thënë: Artan, o Artan! Sillja tatës kmesën e vogël! Është një rripë ferre në fund të kopë-

shtit. Pulat e dreqit kanë filluar t'i bëjnë vezët në atë rripë ferre. O ferrat, o pulat i pres sonte!

Gëzonin të gjithë, qeshnin, i luteshin Mikelit të vazhdonte më tej. Një çast, të shqetësuar, ata vunë re se Artani nuk kishte qeshur fare dhe kjo nuk ishte shenjë e mirë. Flokët e verdhë sikur i ishin ngjeshur më tepër pas kokës. Artani nuk e kishte kuptuar humorin e Mikelit. Eda gjithashtu fare pak kishte kuptuar nga shakaja e djemve. Ishte zverdhur dhe vështronte si e frikësuar majtas e djathtas. Një mal me vështrime mashkullore e pyesnin «a të pëlqen?» Desaret Leci kërkonte të çarën mes saj dhe bashkëshortit për të futur nëpër këtë të çarë në fillim një gisht, pastaj një dorë. Ky desareti vazhdimisht i pësnpëriste dicka në vesh dhe vazhdimisht përpiqej t'i tërhiqte vëmendjen drejt syve të vet plot me një gatishmëri të hapur për fli. Por Eda nuk e kishte mendjen. Ajo parandjente diçka të keqe. Dhe ja sepse. Djaloshi me flokë të verdhë që luante rolin e bosit e kishte duruar imitimën e djaloshit tjetër duke kycur nofullat me stërmundim. Eda e kishte vëzhguar me vëmendje dhe tani priste nga çasti në çast që bjondi ose t'ia mbathte, ose të ulërinte mu aty në sallë.

Asaj i shkoi ndërmend ta zbuste bjondin e zyrtë duke i paguar një teke raki. Ndërsa ngriti gishtin për të thirrur Prengën e giatë, Artani filloi ta rrihte Mikelin me shpulla. E qëllonte pa shumë forcë dhe zbardhte dhëmbët duke e ndiekur hap pas havi tjetrin që zhythej i habitur drejt banakut. Në të vërtetë nia katër pesë hapa qeshi edhe Mikeli duke i duruar shpullat e Artanit brenda turiniët dhe u përnoc t'ia mbante duart e gjata. Artani nuk e kishte mendjen, se nga fluturonte. Megjithatë vazhdonte të qëllonte si automat. Mikeli shtrembëroi turinitë dhe u përnoc t'ia mbante duart e gjata. Artani sikur u fye që Mikeli po i kthente dorë, ndaj zuri të qëllonte më me ashpërsi. Atëherë Mikeli i dha një të shtyrë të fortë. Artani humbi ekuilibrin dhe ra në kurviz duke lëshuar një vilamë të keqe. U ngrit pa humbur kohë dhe çau si shigjetë grumbullin e diemve që i kishte dalë përpara. Mikeli priste i qetë me pëllëmbët e

mbledhura grusht afër gjoksit. Artani qëlloi, por goditja i shkoi bosh. Trupat e tyre u përplasën furishëm.

Eda ndjeu shtrëngimin e fortë të një dore në krahun e djathtë. Ktheu sytë e trembur. I shoqi po e kqyrte gati me urrejtje. Ai e shkuli nga karriga dhe e tërhoqi drejt derës.

— S'kam për të imituar kurrë më për ju, kurrë më!
— thërriste Mikeli që po ikte supevarur e krahëlëshuar. Në lokal kishte rënë heshtja.

Desaret Leci, me shallin e liruar dhe me mjekrën e varur si një mundim, kërkoi me sy Edën. Ah, ajo paska ikur, mermëriti dhe u trishtua.

Terezës i kishin kërcyer xhindët. Pasi formalisht i urdhëroi djemtë të shporreshin sa më parë nga lokali, mori përdore kamerierin dhe bashkë me të u përpoq të lidhej me telefon me qendrën e fshatit për të njoftuar këshillin. Por nuk ishte nevoja. Djemtë po iknin. Askush nuk e kishte çuar nëpër mend se ajo mbrëmje e gëzuar do të përfundonte ashtu. U vinte shumë keq. Jashtëzakonisht keq. Ndofta vërtetë Mikeli nuk do të imitonte më kurrë.

Tutje në fushat e kredhura në terr fërshëllente era.

— Ajo nusja e pati fajin, — tha Ferdinandi.

— Ndofta, — ia ktheu Adriani duke ngritur jakën e xhaketës.

KAPITULLI I DHJETË

Shirat e shkurtër që ranë gjatë tre ditëve e zbutën shumë tokën e orizoreve. Dhjetëra njerëz, burra, gra, vajza, djem madje edhe të moshuar shiheshin gjatë ditës të përkulur mbi kallinjtë e rrëzuar nga era. Dhjetëra të tjerë nxirrnin në breg duajt e korrur dhe ktheheshin për t'u ngarkuar prapë, duke ngulur e shkukur çizmet apo galloshet në baltë. «O burra, se e nxorrëm!» thërriste dikush herë pas here. Nuk e kthente kokën njeri. Të gjithë e dinin se do të thaheshin aty, por nuk do të largoheshin nga arat pa nxjerrë orizin.

Në mesditë shpërndaheshin grupe-grupe, dy e nga dy apo veç e veç mes parcelave të korrura, shtronin kashitë orizi në tokë, lanin duart në ujërat e kanaleve, i fshinin me copa leckash që i mbanin në trasta apo në për xhepa dhe uleshin për të ngrënë drekën. Gjatë drekës nuk flitej asnjë fjalë, nuk shkëmbej asnjë gjest.

Për shkak të kohës së keqe gratë me barrë dhe ato me foshnja gjiri ishin përjashtuar nga aksioni. Askush tjetër. Brigadierët kishin marrë urdhër të prerë: të gjithë në orizore! Po ku bridhte, ku e kishte futur kokën Ludovik Margjoni që s'po dukej asnjë ditë? Organizata e rinisë u mbledh urgjent. Pasi nuk doli njeri të thoshte diçka të saktë për zhdukjen e Ludovikut, Ferdinandi dhe Aleksii u ngarkuan të merrnin takim me familjen, ta gjenin dhe ta sillnin menjëherë në orizore.

Të nesërmen ata sollën në fushë lajmin e paimagjineshëm: Ludoviku ishte martuar në Stom.

Lajmi në fillim u përhap si një shaka pa kuptim. Ludoviku qënka martuar në Stom? Hi, hi hi! — zunë të qeshnin me radhë djemtë e rinj. A qau shumë i shkreti dhëndërr kur e nxorrën nga dera e prindërve? Hi, hi, hi! A ia kishte mësuar nënë Dila fjalët e vajit: «ej, ej, kam harru dy lëmsha penj», hahahahaha! Posi, ore posi! Nusja erdhi vetë për ta marrë. Ishte rruar e kruar për bukuri dhe shkëlqente, si lum ne për të, në rreshtin e krushqëve. Për zotin nuk i paska ardhur hiç mirë që Dylberi po qante ashtu me shami e me lot dhe paska marrë vendim ta bëjë pistil qysh natën e parë, hahahahaha! Nuse e pavararë, o të marsha të keqen!... Po bie mbrëmja e lume, po pushojnë muzikat e ringaxhingat e tjera.

Nusja na futet në dhomë dhe na e gjen dhëndrrin me sytë përdhe, kredhur në mendime të përmallshme për shtëpinë që ka lënë. Nusja po e hulumton me një palë sy që mjerë kujt i bien për hise! Aman o zot si i përçethet trupi dhëndrrit! Nusja i vë llozin derës dhe urdhëron: Zhvishu! Me një barrë turp dhëndrri arrin të zhveshë xhakëtën. Ndërkohë nusja ka hequr nga trupi i vet një fill tesha më shumë. «Ej, dhëndërr, zhvishu fare po të them, e dini ju në Barbullojë kujt i thonë fare? Cupllak», hahahahaha! — gajaseshin djemtë në orizore.

Por Ferdinandi, që gjatë gjithë kohës kishte ndjenjur i heshtur, ua preu gazin në mes.

— Ludoviku është martuar vërtetë! — shqiptoi shumë seriozisht. Djemtë u stepën dhe gati të gjithë në një kohë vështruan majtas e djathtas sikur kërkonin të verifikonin në fillet e erës të vërtetën e atij lajmi.

— Martuar, po si? As këngë dëgjuam, as daulle, — tha me naivitet Artan Boci.

— Ka ikur në Stom pra. Dhëndërr brenda, kollovar, — u përgjigj Ferdinandi duke i shkoqitur fjalët me përtesë.

— Ta di se rri pa martuar, s'hyj dhëndërr brenda,

— tha Artani. Flokët e tij të shkrifët dhe të verdhë frushulloheshin në erë si flakë.

— Ngordh te carani im! — shtuan me një gojë Festim Ndoja dhe Jetmir Cubi, dy akrobatët që dalloheshin për patriotizëm.

— A thua do të vijë më këtu? — pyeti Aleks Balsha.

— Do vijë, si s'do të vijë, — tha Ferdinandi.

Aleksi tundi kokën sikur thoshte «në rregull».

— Po si nuk e pamë fare, as morëm vesh asgjë! Sa ditë u bënë? — pyeti Artani. Ata zunë të vrisnin mendjen të gjithë kur e kishin parë për herë të fundit Ludovikun. Me një energji të panevojshme, Desaret Leci tregoi se e kishte parë të nesërmen e asaj mbrëmjes në hotelklub. A ju kujtohet ajo mbrëmja kur doli Eda, a ju kujtohet apo jo? Unë hyra në muhabet me Edën. Kisha arsyet e mia ta përcillja të nesërmen deri te autobusit. Aty pashë Ludovikun që hipi në autobus pas çiftit. Mbante në dorë një boçe të vogël dhe çadrën. Një çast më shkrepiti të hipja edhe unë në autobus. Madje, që të mos u gënjej, hipa. Ludoviku ishte brenda. E pashë me këta sy, ju betohem që e pashë. Ndofta ai po shkonte të martohej, s'më vajti mendja ta pyes. Ishte veshur mirë, jam shumë i sigurt se ishte ai dhe jo tjetër kush. Kur erdhi nata, e pashë në ëndërr autobusin, po jo Ludovikun. Megjithatë, ai ishte brenda, më plaçin sytë ishte!

Desareti ndihej shumë i gëzuar që ai dhe jo një tjetër e kishte parë i fundit Ludovikun.

— «Sytë të plaçin!» — mermëriti Ferdinandi.

Asnjërit nuk i pëlqente të kujtohej ajo mbrëmja në hotelklub. Pajtimi i Artanit me Mikelin qysh të nesërmen, pa i dhënë asnjë shpjegim shoku-shokut, ishte një thirrje për të harruar.

Desareti hodhi litarin e barrës në tokë dhe u nis për të njoftuar grarinë më tutje se të mërkurën në mëngjes, po, po, pikërisht të mërkurën, ai e mbante mend shumë mirë sepse në autobus kishte hipur edhe Eda dhe ai kishte shkruar diçka në ditarin e tij për këtë, pra të mërkurën e kishte parë Ludovikun...

Gratë kukurisnin me njëra-tjetrën, nuset e reja korrnin oriz të heshtura, ndërsa vajzat rrinin si vuve përballë erës. Në përshtypjet e tyre këngët vajzërishte të disa djemve nuk ishin asgjë në krahasim me martësën vajzërishte të Ludovikut. Ludoviku kishte kryer një akt femëror, pra u kishte hyrë në pjesë atyre, madje u kishte hyrë në hak vajzave dhe djemve bashkë, duke lënë udhën e mashkullit e duke marrë udhën e femrës.

Artan Boci çante baltën me duajt e orizit në shpinë dhe pështynte herë pas here në tokë. Ai nuk guxonte t'i hidhte sytë nga grumbulli i vajzave. Seç kishte një parandjenjë sikur ato do t'u sulleshin djemve faqezinj me drapërinj, me sfulqje e me britma luftarake. Madje, në thellësi të shpirtit, e dëshironte këtë. Dhe ishte gati t'ua shtinte në vesh planin, duke u dhënë edhe listën e djemve pufte që këndonin vajzërisht dhe që fare mirë mund të ndiqnin shembullin e Ludovikut.

— Turp! — ia bëri dikush fare pranë veshit të tij.

Ishte një zë i hollë, plot pezm. Artani zgjati kokën nëpër duajt e orizit që i vareshin deri poshtë qafës, dhe njohu Festim Ndojën. Ky ishte kapur për dore me Jetmir Cubin dhe ecnin rëndë-rëndë që të dy, duke ngulur e shkukur çizmet nga balta me një krenari sfidantësh.

Ata po i binin kryq e tërthor fushës për të denoncuar faqe të gjithëve martesën e rrezikshme të Ludovikut. Jetmir Cubi hipi mbi një grumbull dheu dhe bërtiti para djemve që po shkarkonin barrët e orizit:

— Është kollaj të hash një copë bukë për vete!

— Mikroborgjez safi, — shtoi Festim Ndoja, i prishur në fytyrë. Të pranishmit u stepën.

Skënder Abdyli hodhi litarin e barrës në sup dhe shtrëngoi rripin e pantallonave.

— Mos shaj, — tha.

Festim Ndoja i ra ballit me pëllëmbë. Hunda e hollë dhe e gjatë në fytyrën e vogël i ngjante si sqep.

— Unë nuk po shaj, — tha.

— Mua m'u duk sikur po shaje, — tha Skënderi.

— Nuk i kemi thënë ende të gjitha, — klithi përsëri Jetmir Cubi dhe vijoi me një frymëzim gati-gati të egër: Është toka jonë... t'parët na e kanë lanë...

Skënder Abdyl i vuri buzën në gaz.

— Ku e gjeti të marthohet pikërisht tani! — Ferdinandi shkuli çizmen nga balta dhe hoqi kapelën e le-rosur sikur e tanishmja të kishte të bënte vetëm me baltën dhe erën.

— I pabesë! — tha Jetmir Cubi.

— Njeriu nuk është i detyruar të jetojë në vendin ku ka lindur, — ndërhyri Skënderi. — Po të vihej kv detyrim. njerëzit do të sëmureshin, jeta do të ishte shumë e lodhshme.

— Njeriu nuk lidhet si qeni në stel, — tha Artan Boci.

— Kudo është toka e njerëzve, — shtoi Adriani.

— I luajti fenë Ludoviku, — tha Mikeli i gjithanshëm.

— Aj ndoqi planin e tij për të jetuar sa më mirë, — tha Aleks Balsha.

— Mbyllni, more gojën! — thirri Jetmir Cubi.

I pandikuar nga fjalët e djemve. Festim Ndoja rru-dhi vetullat. bëri një «hëm» refuzuese. domethënë. pu-pu. mor zot, sa shumë punë duhet të bëjmë me këta njerëz, dhe foli me ton të rreptë, duke i ngulur fjalët si gozhda, teksa bënte ca lëvizje të prera të kokës ku spikaste hunda si sqep:

— Ai ndoqi planin e tij për ta gjetur shtruar. Ai ndoqi planin e tij për t'i bërë bisht kësaj ere, kësaj balte, kësaj lufte, këtyre halleve që po kalojmë. Iku si një hajdut! Tregoi se ishte i dobët, i padurimtë. Duke ikur ashtu, si dezertor, dhe duke pasur namin e njeriut të shëtitur, ai u ka thënë këtyre grave dhe burrave se halleve të Barbullojës nuk i dilet dot! Koka e tij!

— Na marrtë të keqen! — briti Jetmir Cubi.

— Ja, përgjigja! — ia bëri Festim Ndoja duke treguar gratë që po kukurisnin. Era shpërndante andej

këndeje zërin e ngjirur tashmë të Desaret Lecit. «E pashë me këta sy! Për kokën e babait e mos i paca robt e shtëpisë. E pashë të ulur në ndenjësën e autobusit. Unë...»

E qeshura vinte rrotull në shtjellat e erës. Adriani ndjente ca si plasje fluskash në trup. Ai e mori me mend se gazi do t'i pushtonte gjithë sa ishin në fushë. Ndofta edhe Donika Shqutin, ndofta edhe Liljanën. U rrotullua në vend që të shihte c'po bënin vajzat e reja përtej. Agetina Suli, në vajzë shtatgjatë me trup të bukur sportisteje. po qeshte vërtetë duke mbajtur ijet me duar.

E qeshura u përhap në fushë si sëmundie ngjitëse. Njerëzit përkuleshin e drejtoheshin si shelgje. Adriani kërkoi me sy Donika Shqutin. Nia tridhjetë metra më tej, mbështjellë me një mushama plasmasi. ajo gjithashtu torovitei. Adriani i shikonte vetëm kurrizin dhe pati nërshtynien se ajo no dëneste. Në cast, kur era ia hodhi flokët mbi sy dhe ajo ktheu fytyrën vrik nga jugu. ai dalloj zmalin e dhëmbëve të saj që shkëlqenin me një bardhësi tronditëse në hapësirën gri.

KAPITULLI I NJËMBËDHJETË

LILJANA: Më përqafo!

ADRIANI: Urdhëro!

LILJANA: Kush lëviz atje?

ADRIANI: Era. Rrëzohen gurët e qimiterit...

LILJANA: Më duket sikur nuk më përqafon. Ti i ke duart e ftohta!

ADRIANI: Eraaa... Sa emër i bukur për vajza! Në shkurt të vitit të kaluar erdhën në Barbullojë disa studente.

Të kujtohet? Njëra quhej Era.

LILJANA: Te qiparizat është një njeri! Shiko! Po fërkohet pas trungjeve!

ADRIANI: Mos u tremb. është Desaret Leci.

LILJANA: Ulu se do të na shohë!

ADRIANI: Ai na ka parë, na ka parë qyshkur! Por nuk i tregon njeriu, nuk i bën zemra!

LILJANA: Qycja! Çfarë po bën me trungjet?

ADRIANI: Ja, ashtu, dashuri...

HESHTJE

LILJANA: Po ikën.

ADRIANI: Kaq e kishte.

HESHTJE

LILJANA: Shih si fluturon ai gargulli në qiell! E ka marrë era dhe as ai vetë nuk e di ku po shkon.

ADRIANI: Të vjen keq!

LILJANA: Po. Më vjen shumë keq.

ADRIANI: Sidoqoftë, ai po shkon diku...

LILJANA: Ke të drejtë. Ai po shkon diku.

ADRIANI: Kurse ne s'kemi ku vemi!

LILJANA: Ju mund të shkoni në Stom!

ADRIANI: Kush «ju»?

LILJANA: Ju, Adriani!

ADRIANI: Lëri ironitë!

LILJANA: Ju gjithashtu mund të martoheni një ditë në Stom dhe ne prapë do të qeshim. Ne kemi rrezerva, aq sa nuk ua merr mendja!

ADRIANI: Ju fisi i madh i Simonajve.

LILJANA: Ne, Barbulloja!

ADRIANI: Më vjen jashtëzakonisht mirë. Po më mirë akoma do t'u vinte Jetmir Cubit dhe Festim Ndojës. Ata janë patriotë!

HESHTJE

LILJANA: Gargulli u zhduk!

ADRIANI: Ndofta ka qenë Ibëri i shndërruar në gargull!

LILJANA: Ibëri vazhdon të fluturojë?

ADRIANI: Ne të gjithë vazhdojmë të fluturojmë. Fluturimet tona kanë një emër: Ibër!

LILJANA: Ty të pëlqejnë «Fluturimet»?

ADRIANI: Nganjëherë. Po ty a të pëlqejnë «Fluturimet»?

LILJANA: Më pëlqen fluturimi në Portugali.

ADRIANI: Nuk më kujtohet Portugalia.

LILJANA: Është ajo pjesa me detin e bukur që mashtron. Deti i Portugalisë, pra, është shumë i bukur dhe njerëzia i afrohen për ta parë. Por papritur, deti ngrihet përpjetë si gjarpër dhe përmyt gjithçka. Ibëri shkoi atje dhe zbuloi se deti mashtrues ishte shumë më tepër se një det. Zbulimi i tij u kuptua nga vegjëlja portugeze. Shpërthen revolucioni. Ibëri merr pjesë personalisht në demonstrata, duke e drejtuar

urrejtjen popullore drejt thembrës së Akilit. Píkaset nga policia, plagoset në shtatë vende dhe rrëzohet. Turma arrin ta fshehtë në një shtëpi të thjeshtë lisbonase, ku edhe e kurojnë, jo vetëm se ai e meriton jetën, por edhe sepse i duhet njerëzimit. Me dy fjalë, kjo është e gjitha.

ADRIANI: Përse të pëlqen kjo histori kaq e varfër?

LILJANA: Si të të them? Kur e dëgjova për herë të parë, përfytyrova gratë që i rrinin te koka dhe mendova kështu: ne jemi prerë për të marrë pjesë në demonstratat e të tjerëve! Sa të vlefshëm jemi përtej detit!

ADRIANI: Trishtim, trishtim i madh!

HESHTJE E ZGJATUR

ADRIANI: Më ke inat, Lili?

LILJANA: Përse të të kem inat?

ADRIANI: Që jam djalë Barbulloje...

LILJANA: Sa budala që bëhesh!

ADRIANI: Sot kisha përshtypjen se ju vajzat na kishit marrë inat...

LILJANA: Sa budalla bëhesh.... Po ti pse nuk më përqafon?

ADRIANI: Moj? Kë quan përqafim ti?

HESHTJE

LILJANA: Diçka lëviz atje!

ADRIANI: Rrëzohen gurët e çimiterit.... Afrohu! Afrohu!

LILJANA: Nuk mundesh...

KAPITULLI I DYMBËDHJETË

Ishte kohë dreke kur nga orizoret u nxorren duajt e fundit të orizit. Fshatarët hodhën litarët, tërkuzat, drapërinjtë e sfurqet në krah dhe qëndruan një copë herë të shtangur sipër bankinave, sikur nuk u besonin syve dhe sikur u vinte zor t'u kthenin shpinën gropave e gjurmëve të panumërta në arat e përbaltura. Për t'i dhënë pak ngjyrë atij triumfi, Mikeli i gjithanshëm bëri ca ushtrime tërheqëse të gjimnastikës artistike duke e kaluar litarin e barrës me shkathtësi nën këmbë, rrotull trupit, sqetullave dhe qafës. Pastaj e vërtiti litarin si fugë dhe thirri me zë të lartë:

— Tani e kemi hak të hamë katër rracione pilaf për njeri.

— Përse të hamë pilaf? Më mirë të shkojmë në Tiranë! — tha Agetina Suli, së cilës ia kishin vënë emrin lauresha për shkak të syve gjithherë të qeshur. «Në Tiranë! Në Tiranë! Urraaaa!» thirrën njëzëri vajzat dhe djemtë dhe vrapuan drejt kanaleve e pellgjeve me ujë për të larë çizmet, këpucët, galloshet, njollat e baltës në rroba, në fytyra, në duar. Sa e pafundme dhe e larmishme ishte bota! Kishte orizore, por edhe hotelklub «Ngjala»; kishte Barbullojë, por edhe Tiranë. Në përfytyrimin e tyre rrëshqisnin ngadalë rrugët e gjera të kryeqytetit, urbanet lara-lara, godinat e veshura me mermer, dyqanet, hotelet restaurantet.

— Nisemi pasnesër dhe pikë! — tha Ferdinandi, teksa

vështronte Agetina Sulin që po krihej. Ajo e kalonte krëhërin me kujdes nëpër flokët e drejtë që era ia shplekste hijshëm supeve dhe fytyrës dhe Ferdinandi u pendua që kishte thënë nisemi pasnesër. E pasnesërmja në ato çaste i dukej një shekull larg.

Por nisja nuk paskësh qenë kaq e kollajtë sa ç'u mendua në fillim. Gjithë ditën e nesërme ato u morën me përgatitjet. Deri në orët e vona u vunë re lëvizje sa te njëri te tjetri për të kërkuar këpucë, këmisha, bluza, fustane, vathë veshësh, valixhe. Në dyqanin «Artikuj të përzier» u ble sapun si asnjëherë tjetër. Ndërkaq u tha se në hotelklubin «Ngjala» të qeshurat e parisë së ka-tundit nuk rreshtën gjithë ditën.

Nata kaloi me fare pak gjumë dhe me ëndrra që kërkush nuk pati guximin t'i kallzonte, me përjashtim të Jetmir Cubit, i cili flokëkërleshur nga një tmerr ën-dërror, zuri pritë që pa gdhirë me lopatën në sup para zyrave të kryesisë.

— Ata nuk do të kthehen më, nuk do të kthehen më,
— përsëriste papushim. Dëgjoni o fshatarë! Pashë ëndërr..

Kënga e thekshme e gjelave e bënte të besueshme ëndërrën e tij.

«E ku do të mbvtemj!». mërmëriti nëpër dhëmbë Adrian Miraj, tek zuri vend para të tjerëve në njërën prej ndenjësve të autobuzit urban. Prej aty vëzhgonte rrugën ku dhjetra njerëz bënin sehir nisjen e vajzave dhe djemve në ekskursion.

Ekskursionistët dalloheshin shkoqur mes sehirxhinjve nga mënyra si ishin krehur, nga një shkëlqim më i madh i flokëve dhe fytyrave, nga rrobat që kishin veshur, nga cantat dhe rrjetat që mbanin në duar. Desaret Leci ishte spërkatur me parfum, dikush tha se ishte larë me shampo, ndryshe s'kish si shpëgohej tërë ajo krekosje e tij tek priste me duart në xhep të hipte i fundit në autobuz. Adrianit iu qesh. Vajzat të cilat ndjeheshin shumë më të çlirta në makinë se sa në tokë, sikur xha-mat e kaltër i mbronin nga një rrezik kurdoherë i pra-nishëm jashtë, ia morën këngës «Moj e mira flokët e gjata/ Shkurtoi pak të të duket qafa».

Adriani ndjeu t'i pakësohej ajri në lukthin e gjoksit sikur ia thithnin me shiringë. Kështu i ndodhte gjithmonë kur dëgjonte lirikat e vjetra të ngjizura me virgjinitetin dhe vetminë e lartësive. Ndofta ne kemi zbritur këtu nga malet, mendoi. Fillin e mendimeve ia këputi thirrja sarkastike e Jetmir Cubit «Të fala Tiranës, eeeeej!» Adriani ktheu sytë nga sheshi para zyrave të kryesisë. Jetmiri diç po i pëshpëriste në vesh Festim Ndojës dhe të dy shkriheshin në gaz duke u mbajtur mbi bishtat e lopatave.

E parafundit hypi Liljana Simoni, gjithë me një dilemë të pacilësueshme në fytyrë, dhe fill pas saj, siç merret me mend, hipi Desaret Leci, serioz dhe madje i zymtë. Si njeri i shëtitor, ai e ndjente për detyrë që kilometër pas kilometri të bindte secilin se entuziazmi i tepruar ishte qesharak.

Por nuk ishte nevoja. Tirana e përpiu menjëherë, si një pikë uji, entuziazmin e tyre. Sa lanë pas stacionin e trenit vështruan njëri-tjetrin dhe heshturazi menduan se nuk ishin veshur aq mirë sa ç'u ishte dukur në Barbullojë. Të bezdisur nga kërshëria indiferente e studentëve që hanin pasta para fakultetit të shkencave, ata përparuan ngadalë drejt sheshit «Skënderbej». Bënte ftohtë. Sipër kodrave në jug të qytetit, rrëzëllinte një diell që shndriste shumë dhe ngrohte pak. — Sa larg qënka dielli këtu! — tha Donika Shquti dhe vajzat e tjera u shtrënguan më shumë me njëra-tjetrën. Desaret Leci u shkëput duke manifestuar sheshit pakënaqësinë karshi ndrojtjes së tyre provinciale. Oh, këto nuk mund të jenë ndryshe, nuk mund të jenë ndryshe, u duk sikur tha tek hynte duke shkundur supet me një neveri patetike në barbufenë «Peza». Mikeli i gjithanshëm qeshi me zë të lartë dhe pas tij edhe të tjerët. U duk se gazi për Desaretin shkriu diçka të ngurtë që i mbante të lidhur me njëri tjetrin si në një mjedis jomiqësor. Një e nga një, dy e nga dy hynë në hollin e hotel «Pezës» duke tundur çantat dhe rrjetat pa atë pengimin e pakmëparshëm.

Në hotel «Peza» nuk kishte vend për të gjithë, kë-shtu që grupi u shpërnda. Një pjesë ndenjën aty, në pritje për t'u rregjistruar, të tjerët u nisën të gjenin vend tjetërkund. Ferdinandi, Adriani, Agetina Suli dhe Liljana, që gjithnjë kishin ndenjur prapa të tjerëve, pa-si dështuan te sporteli i hotel «Internacionalit», u kthyen drejt «Tiranës». I hidhnin hapat shpejt, me një vull të panatyrshëm, pa i folur njëri-tjetrit, pa e ngritur kokën sikur kishin frikë se mos masivi hijerëndë i ho-telit do t'i stepte. Liljana mezi shtyhej përpara. Takat e larta të këpucëve ia kishin mpirë muskujt e këmbë-ve. Vetëm prania e Adrianit e pengonte t'i hiqte fare këpucët dhe të ecte me çorape midis sheshit pa e çarë kokën se kjo mund të mos përputhej me rregullat e atij qyteti. Ndërkaq i vinte çudi me Agetinën. Në krejt gjymtyrët e kësaj të fundit ndjehej një padurim i ha-reshëm sikur atje, përtej xhamave të hotelit e priste parajsa.

— Është shtrenjt, — tha Liljana kur kishin kaluar shatërvanin në mes të sheshit. Nuk iu përgjegj njeri.

Në fakt Liljana nuk kishte hallin e çmimit. Kishte reshëm sikur atje, përtej xhamave të hotelit, e priste nin mirë.

— Do të na tallin! — tha me dhimbje dhe mbajti hapat.

Adriani mori një pamje kryeneçe.

— E pse do të na tallin? A s'jemi njerëz ne?

— Kërkojmë hotel tjetër, Adi. Nuk duroj dot të na shohin me vëmendje.

— As unë nuk duroj të na shohin me vëmendje. Por s'jemi në atë gjendje që t'u nxjerrim sytë të tjerëve.

— E çfarë po na tallën? Ne kemi punën tonë, ne bëjmë qejfin tonë, — tha Agetina Suli. Liljana u skuq, Vetiu sytë i shkuan te këmbët e saj të gjata dhe të bu-kura ku ndjehej një hare dhe një padurim i madh. Kjo sikur i dha zemër, por kur hynë në hotel uli sytë me-njëherë që të mos hutohej nga llampadarët e mëdhenj në tavan.

Sa u bënë formalitetet e rregjistrimit, ajo pati kohë ta mbudhte veten plotësisht, por zërra zuri ti rrinte përseri me forca kur Adriani priu drejt ashensorit. Ja gracka, mendoi dhe u skuq. Ajo nuk do të dinte ta komandoje ashensorin dhe ne do të benemi gazi i ootes. Me një kujdes të përpunuar zgjati kembën e ujalit, pastaj të majtën dhe ja ku u gjend në kosnin e ashensorit. Papritur u vu përballë itytrës së vet në pasqyre. Pavarësisht se ishte zverdnur jashtë mase, itytra nuk iu duk dhe aq e keqe. Kjo e qetësoi disi. Adriani shtyp numrin shtatë, dera u mbyll dhe ashensori zuri të ngrihej ngadalë duke lëshuar një zhurmë të këndshme. Agetina gëzonte si fëmijë. O zot! Me mendjen e Agetinës çan Atlantikun, mendoi Liljana.

Ashensori lëshoi një psherëtimë të zgjatur, dera u hap. Ata kërcyen në hollin e katit të shtatë dhe u përqaftuan gjithë qejf sikur vërtetë kishin kaluar një provë të vështirë. Bravo, Adi, bravo! ia bëri Agetina.

— Do çlodhemi pak apo do dalim menjëherë? — i pyeti vajzat Adriani.

— Nuk kemi kohë të çlodhemi, — tha Agetina. — Në orën dymbëdhjetë është lënë takimi në restorant.

— Sa do të jetë ora tani? — pyeti Ferdinandi.

— Duhet të jetë njëmbëdhjetë e gjysëm, — tha Agetina.

— Të këshilloj ta ulësh pak zërin, — tha papritur Liljana duke përgjuar rreth e rrotull.

Agetina u patak. Hodhi çantën në supin tjetër dhe qeshi. I pyeti djemtë:

— Ju keni përshtypjen se unë flas me zë të lartë?

— Jo, zëri yt është normal, — tha Adriani.

— Ju të gjithë flisni me zë të lartë! — këmbënguli Liljana.

— Ty të duket ashtu, — tha Adriani. Pakuptuar e kishte ulur zërin.

— Shisht! — ia bëri Ferdinandi duke vënë gishtin sipër buzëve. Pastaj sa mezi u ndie: — Lini çantat në dhomë dhe takohemi këtu. O burra!

Shakaja e tij shkoi kot. Nuk qeshi kërkush. Përkundrazhi. Me kujdes të madh dhe pa zhurmë hapen dyert e dnomave dhe po ashtu, të matur dhe të urtë, sikur kishin frikë mos lëndonin njeri, zbritën përsëri në holl.

— Unë nuk të kuptoj ty! — thirri Agetina sapo dolën në ajër të pastër. — Nëqoftëse je sëmure na e thuaj! Ne dimë të sillemi me të sëmuret.

Liljana qe duke ia plasur vajit, por Adriani e hetoi me kohë dhe nuk e la ta mbulonte fytyrën me flokë.

Ai ia mbajti fytyrën me duar, duke e vështruar drejt me një mijë lutje me sy që të mos qante.

— Ju kërktoj ndjesë, — tha me gjysëm zëri Liljana.

— Nuk është nevoja të kërkosh ndjesë... Unë e di, e di shumë mirë... Ajo shtëpia juaj e madhe... Agetinë! — ai u kthye me vrull nga Agetina dhe u trondit kur pa vijat e lotëve në faqet e saj. Ajo kishte ndryshuar krejt, nuk i kishte mbetur asgjë nga lozonjarja, nga lauresha e zakonshme.

— Po ti... ti ç'ke? — tha Adriani.

Agetina nuk u përgjegj. Fshiu lotët dhe u mundua të buzëqeshte.

— Edhe unë e di tani, — tha. — Ajo gjuha jonë e shenjave... Ajo i ka fajet.

— Ndofta edhe ajo, — tha Adriani, — por nuk ia vlen të flasim për këtë. Veçanërisht sot nuk ia vlen.

*
* * *

Në orën dymbëdhjetë u mblodhën të gjithë para restorant «Donikës», por nuk hynë për të ngrënë drekë.

Artan Boci u rikujtoi programin. Pushim një orë. Vizitë në ekspozitën «Shqipëria sot», vizitë në parkun e lodrave elektronike, shikim filmi në kinemanë «Republika». Ky plan i hartuar me bujë në Barbullojë, taqi shëmbëllente me një tollumbace të shfryrë. Ata s'kishin më dëshirë të shkonin grumbull si delet këtu e atje.

Ferdinandi i vuri kapak dilemës së tyre kur tha të ndjekë secili planin e vet dhe të takoheshin të nesërmen në stacionin e trenit. Pa e zgjatur i bëri shenjë Agetinës dhe u nda i pari. Fill pas tyre u shkëput Desaret Leci. Ai tha po dal njëherë nga njëzet e njëshi. E kishte fjalën për sheshin «21 dhjetori». Gjatë viteve të ushtrisë e kishte patur zakon që në orët e liridaljes të ngulej te borduri i berberhanes atje dhe të mbante vesh debatet e zjarrita të djelmoshave për futbollin. Desareti besonte se djemtë e kryeqytetit nuk shkuleshin kurrë nga borduri ndaj u nis sikur shkonte të nxirrte një mall.

— Eja! — i tha Adriani Liljanës. Ajo rrotulloi sytë majtas e djathtas dhe vuri re se të gjithë kishin ikur. I erdhi çudi si nuk i kishte bërë kujt përshtypje që ajo kishte mbetur prapa të tjerëve? Koka i vinte vërdallë. Adriani ngutej. Asaj nuk i pëlqeu ngutja e tij. Në çast i shkoi ndërmend se ai dhe Ferdinandi ishin marrë vesh për t'i liruuar njëri-tjetrit dhomën e hotelit. Prandaj nxitonte Adriani. Minutat e tij ishin të numëruara. Ideja se ata të dy kishin bërë një pakt të heshtur në kurriz të vajzave dhe ideja tjetër se mos Ferdinandi i çuquriste në vesh Agetinës në ndonjë pastičeri «Duro! Ata atje kanë punë», ndërsa Agetina lazdronte sytë e mbushur me një hare skandalizuese, i shkaktuan Liljanës një ligështim të përgjithshëm. Vetiu ngadalësoi hapat.

— Prapë të vrasin këpucët? — e pyeti Adriani.

— Nuk i duroj dot takat, — tha ajo.

— Ja, edhe pak dhe do të pushosh, — tha ai duke kthyer në një dyqan parfumerish. Liljana priti te dera. Asnjëherë nuk i kishte pëlqyer kozmetika, madje trembej prej saj. Në Barbullojë kishte patur miqësi me një mësuese nga Shkodra. Ajo ishte shumë e dhënë pas tualetit. Çdo pasdite ngulej para pasqyrës, hiqte

vetullat, lyente sytë, thonjtë ndërronte formën e flokëve. Ajo ishte shumë e bukur dhe e përzemërt, por Liljana sepse ndiente një lloj dhimbsurie për të kur e shihte tek ngjyente me aq kujdes një fije shkrepse në shishen e vogël të manikyrit dhe ta shtrinte pastaj lëngun e kuq në thonjtë e këmbëve. Mësuesja ishte përpjekur t'ia shtinte në gjak pasionin për grimin dhe vërtetë, disa kohë Liljana lyhej fshehurazi të tierëve në dhomën e mësueses. Pastaj shakaja kishte marrë fund, mësuesja ishte transferuar dhe Liljana kishte hequr dorë, e bindur se një vajzë që mban çizme të gjata dhe drapërin në krah gjithë ditën s'ka përse t'i lyejë thonjtë me manikyr.

Adriani doli nga dyqani.

— Çfarë bleve? — e pyeti Liljana.

— Ca gjëra, — tha ai dhe futi duart në xhepat e frvrë të pardesysë. Ajo afroi supin pranë suoit të tij. I vinte shumë mirë që Adriani nuk dukei i huaj në atë qytet dhe kjo ia shtonte sigurinë. Megjithatë mendja i vinte prapë vërdallë. Urbanët, veturat, këmbësorët, ndërtesat dhe vetë sheshi «Skënderbej» vërtiteshin si në një kolovaizë të ngadalëshme. Ajo ndieua një dëshirë të fortë t'i fuste krahun Adrianit. Ç'të keqe ka? — tha me vete. Këtu nuk na njeh njeri! Por diç e pengonte. Ndofta vetë fakti që nuk i njihje njeri.

Duke rrëshqitur anash ndërtesave të larta, duke u shkëmbver me dhjetra njerëz të panjohur, truri i saj u përndrit nga mendimi për të bërë doemos një proçkë me Adrianin. Ideja e proçkës e pushtoi të tërën, ad sa harroi edhe dhimbjet e këmbëve. Vetvetiu i shneitoi hapat duke vështruar me bisht të svrit orën e madhe në krue të sheshit. Tani proçka e saj kishte një afat: një fillim dhe një fund. Ajo do ta bënte për të korigjuar atë që kishte ndodhur pak më parë në hotel, për të korigjuar shumë gjëra, për të sfiduar shumë gjëra dhe për t'u pajtuar nëfarësoi me shkëlqimin e ndërtesave, të rrugëve, të shatërvanit dhe, më tej, të atyre shërbyesve skofiarë në hotelin e madh.

Sapo kapërceu portat me xhama të hotelit dhe u gjend nën tavanin e lartë me llampadarë të mëdhenj, ndjeu një shkëndijim të beftë në kraharor, pastaj frymëzimi i saj zuri të digjej si fill detonatori. Nuk kishte ç'bënte. I hodhi këmbët shatra-patra pas Adrianit, hipi në ashensor me parandjenjën se deri në katin e shtatë dicka do të shpërthente si vullkan brenda saj dhe pastaj do të fikej e gjitha. Kati i dytë, kati i tretë, fytyra pa shprehje në pasqyrë, ndezja dhe fikja e numrave si shndritje prushi në errësirë, zukama brenda saj dhe shija e shkrumbit në gojë. Kur ashensori ndaloi dhe Adriani u hodh i pari, ajo ndiehej krejt e topitur. Koka i vinte përsëri vërdallë, por nuk ishte në gjendje të mendonte dicka të saktë.

Adriani e shoqëroi deri në dhomë. Ndërsa vaiza zbathte këpucët, ai rrinte si kukth në mes të parketit duke shëtitur sytë si të fjetur sa rafti i rrobave, te tvli në dritare, te mbaitësia e këpucëve, te furcat mbi komo, te dera e banjos me xhama akulli, te telefoni i heshtur, te kuverta e shtratit, te fotografitë në mur. Ai zgjati dorën dhe ndezi radion. Në dhomë u derdhën tingujt e një kënge ritmike dhe sendet rreth e përçark sikur u shpërgjumën. Liliana u ul në shtrat dhe zuri të fërkonte këmbët e skuqura.

- Të dhëmbin shumë? — nyeti ai.
- Po, më dhëmbin dhe ndjehem e lodhur.
- Ndofta është mirë të bësh një banjë, — tha ai.
- Banjë?

Adriani u fut në banjë dhe hapi njërin nga rubinetet. Pas pak nga vrimat e kokës së dushit u derdh me presion uji i nxehtë.

- Eja të të tregoj si përdoret dushi! — thirri ai.

Liljana futi këmbët në pandofla dhe me dy hapa u gjend në banjë. Dushi lëshonte një zhurmë të këndshme. Curilat e ujit të ngrohtë binin me presion mbi pllakën prej porcelani prej nga ngriheshin ngadalë-ngadalë shtjellat e bardha të avullit. Ai po i tregonte funksionin e sendeve të tjera të banjës, ndërsa ajo rrinte e

hequr mënjanë, duke e parë me habi se si zmadhoeshin krahët e tij midis avujve.

— Të dal unë tani? — pyeti Adriani.

— Mirë, — tha Liljana.

Adriani doli dhe mbylli derën. Ajo filloi të zhvishej duke u kthyer kotnasikoti majtas e djathtas, për t'ju fshehur rrezeve të dritave që shkrepnin nga të gjitha anët si për ta kapur rob atë trup të bardhë që mjegullohej në pasqyrën e veshur me avull. Kur i hoqi të gjitha rrobat, e pa veten të mbledhur kruspull poshtë pasqyrës, me duart e kryqëzuara para gjinjve. Ajo ndjente mbi lëkurë prekjen e butë të avujve dhe kishte përshtypjen se trupi i saj e thithte si sfungjer atë, për ta kryer përsëri në gjendjen e lëngët.

Me ndjesinë se ishte bërë e ujtë, u ngrit dhe fshiu me pëllëmbë pasqyrën e mjegulluar. Instiktivisht kërkoi me duar çelësin elektrik për të shuar dritën, por sakaq ngriu në vend duke parë trupin e vet lakuriq në pasqyrë. Dora që kërkonte çelësin dhe kureshtja për t'u parë në pasqyrë luftuan disa sekonda. Mandej, e mbërthyer prej mirazhit të syve jashtëzakonisht të mëdhenj, ajo s'pati fuqi as të kthente kokën për të parë ku ishte çelësi; dorën nuk e komandante dot, dorën e lehtë, shumë të lehtë si të qe shndërruar në avull. Ja, ky është trupi i femrës, tha me vete. I shkoi ndërmend të rrotullohej për t'ju kallzuar krejt pasqyrës, por diçka i gurgulloi befaz në trup. Pati frikë se po të lëvizte pak nga vendi do të rrëzohej e do të shkrehej në lot. Unë e kam dhënë një herë trupin, kam përshtypjen se e kam dhënë njëherë trupin. Ja këtë trup të panjohur! Në mos e kam dhënë, e kam treguar. Aldoja e ka parë. E ka parë nga një largësi prej tridhjetë metrash. Pra trupi im është parë, është parë, është parë...

Ajo briti me vete kështu, për t'i rezistuar ngashërimit që po i ngrihej në gjoks. Por qe e kotë. Sytë e saj, deri në ato çaste të ngrirë nga habia dhe trishtimi, u lëkundën si zambakë uji. Ato e kishin parë trupin. Misteri për to nuk ekzistonte më!

— Përse nuk laheshe? — i thirri Adriani që nga dhoma. Zëri i tij e ftonte në realitetin e thjeshtë, tmerrsisht të thjeshtë të gjërave, por ajo, ende robinë e mahive që e kishin kapur, nuk iu përgjegj.

Rezeti e derës sakaq kërcitën, ajo u ngjesh pas murit, por nuk bëri asnjë përpjekje të mbulohej. Ishte vonë dhe ishte e kotë. Një valë e ngrohtë gjaku ia skuqi faqet, tek pa si nëpër mjergull Adrianin që po i afrohej. Duart e saj që po rifitonin peshën e zakonshme u zgjatën për ta përqaftuar. Sa çel e mbyll sytë ajo iu ngjesh pas trupit, duke e fshehur kokën në supin e tij dhe duke e shtyrë drejt dhomës. Atje, sipër tryezës, pa kalimthi kremërat dhe parfumet që Adriani i kishte blerë për të.

Në dhomë, nën ritmin e një muzike të shtruar, vërtiteshin papushim ca pikadrita të argjendta që sikur ishin thërmuar nga llampadarët e mëdhenj në hollin e poshtëm të hotelit. Ajo përpiqej pavullnetshëm të krijonte diçka unike me ato thërmiza vezulluese, por ishte e pamundur. Ato shkëmbeheshin bukur dhe harmonishëm, duke i zgjuar përfytyrimet e një breglumi me ujra të kthjellta, me mirazhe yjesh që uleshin e ngriheshin mbi dallgët e vogla, me pemë të dyfishta që zgjateshin në ajër dhe në pasqyrën e ujrave. Mbi gjithë këtë vegullsi ngjiteshin e shqifeshin me pasion dy buzë të nxehta.

«Jo këtu, jo këtu!» mërmëriti ajo pas pak, si për t'u shfaqësuar para dikujt tjetër që nuk e'kzistonte kërkund në faqe të dheut, të cilit, megjithatë, ajo i detyronte një rezistencë kallpe. «Po ku, ku?» ia bëri Adriani. Ajo tërhoqi kurrizin prapa me forcë dhe shtrëngoi dhëmbët. «Në livadhe», tha duke lidhur krahët si darë pas kurrizit të Adrianit.

Zilja e telefonit që ra pas tridhjetë minutash sikur e ngriti peshë dhe e shkatërroi saora harrimin e tyre. Adriani brofi në këmbë, Liljana u mbulua vrik dhe që të dy i mbërthyen shikimet mbi telefonin e kaltër sikur brenda çërritjes së tij brutale ishte fshehur një njeri që i hetonte.

— Ngrije ti! — tha Adriani. Liljana hezitoi një çast, pastaj u kujtua se ishte në dhomën e saj dhe nuk bënte që dorezën ta ngrinte Adriani.

— Alo, — ia bëri me gjysëm fryme. Dikush e pyeste për diçka, ajo ende s'po e mblidhte veten. Ndërsa përku lej panatyrshëm mbi dorezën e telefonit, arriti ta 'kuptonte më në fund çfarë thoshte njeriu me zë të ngjirur matanë. «Po, po», tha e lehtësuar dhe në fytyrë iu përhap një hare e veçantë.

— Policia ka ndaluar Desaret Lecin, — sqaroi ajo Adrianin. — Kërkohet një nga ne që të vërtetojë kush është sepse nuk paska me vete asnjë dokument.

Adrianit iu qesh.

— Kushedi ç'ka bërë hajvani, — tha.

— Vishu të dalim, na presin te rajoni 1. E di ku bie rajoni 1? — pyeti Liljana teksa shkoi të merrte rrobat në banjë.

— Po e di, — tha Adriani përtueshëm. Ai u kthye në brinjë me fytyrën nga dritarja e zënë me grilë ku drita e pakët e ditës zbehej edhe më. Dukej se nuk kishte fillim as fund ajo dritë vjeterane dhe hapësira ku qe nderë, por kishte vdekur në atë gjendje.

Ai vuri kokën në dërrasën e shtratit dhe vazhdoi të 'kqyrte kot rrigat horizontale të dritës. Nuk kishte dëshirë të shkonte në rajon, nuk donte të shkonte kërkund deri sa të binte nata, deri sa të zbardhte drita sepse kam pak kohë, tha me vete dhe ajo pak kohë e pandashme ishte e atij dhe e asaj, e Adrianit dhe e Liljanës, e mrekullueshme dhe e papërsëritshme, qelizë e gjallë dhe vitale në një trup të ngrirë, një kohë e zorshme për t'u pasur më, madje ndofta e panevojshme për t'u pasur më...

— Çdo të bëjmë? — pyeti Liljana kur u kthye nga banja dhe e gjeti atë të kredhur në mendime.

Adriani drejtoi kurrizin dhe e veshtrou përhumbshtëm.

— S'kemi ç'bëjmë, — tha. Pastaj: — 'I mendon se mund të bëjmë gjë?

— Gjëja më e mirë që mund të bëjmë tani për tani është zbritja me ashensor, — tha ajo.

Ai bëri një grimasë kotësie.

— Nga kati i shtatë! — tha.

— Përkërisht, — ia ktheu ajo.

— Unë jam i lodhur, — tha ai. -- Unë mund ta evitoj ashensorin.

Ai vuri pëllëmbën në faqe sikur po mendonte a ishte e drejtë të evitonte ashensorin.

— Eja! — e luti Liljana me një fije zë. I arridheshin qerpikët, buzët, pulpat e këmbëve dhe mërdhinte. Sidomos në pjesën e poshtme të barkut mërdhinte shumë.

Adriani u vesh pa folur.

— Sidoqoftë, nuk është e drejtë, — tha, dhe vajti të fuste në çantën e Liljanës tubetin e kremit dhe parfumin.

— Çfarë nuk është e drejtë? — pyeti ajo. — Mos të mbeti merak që nuk u lyva?

— S'ka rëndësi, — tha ai. — Unë kisha një ide tjetër. Por kjo dhomë nuk u bë dot shtëpia jonë as edhe një orë... Ndofta unë e kisha gabim.

— Po ne mund të provojmë prapë, — tha ajo. — Në të ardhmen.

Mezi i rrihej dhe Adriani e kuptoi se në fund të fundit padurimi i saj për të dalë jashtë ishte fisnik.

Në rajonin e policisë ku mbërritën pas një cerek ore gjetën Desaret Lecin që po ndukte flokët dhe faqet përballë një polici me cigare në gojë.

— Lot bixhoz në fshat ky, lot? — i pyeti polici, duke përdredhur cigaren nga njëri cep i buzës në tjetrin.

Sytë e Liljanës u mbushën me mister. U përpoq të përsëriste me mend fjalën që kishte shqiptuar polici, por ajo i rrëshqiti nga kujtesa. Vështrou Desaretin që

dalengadalë po rifitonte karakteristike. Për here te pare mendoi se ai dinte dhe benite vërtete ca gjera te çuditsme qe i dinte dhe i bëjne djeinte e qyteteve. Adriani ndërkaq, e siguroi policin se ne ishim e tyre nuk ishte luajtur dhe as kishte gjasa te tuj bixnoz dhe nëse ai kokëtui, Desareti, është kapur ne ndonje qoshe rrugice mes bixhozçinjve, të jeni i sigurt snoku polic se atje e ka çuar vetem kureshtja.

— Ashtu, ashtu! — u hodh Desareti, i gëzuar që Adriani, pa qenë pjesëtar në ngjarje, i kishte rënë pikës. — Unë u ndala në rrugicë rastësisht të snihja ç'bënin ata çunat. Ata, se nga e morën vesh se po vinin ti kapnin me presh në duar. Ia mbathën vrapit. Unë... u nisa me vonesë... Tani e kuptoj se nuk duhej të ikja tare sa kohë që s'isha me ta, por se si m'u shkrep dhe vrapova pas tyre.

Polici dhe Adriani qeshën të dy njëkohësisht.

— Ik, ore, ik, — ia bëri polici. — Na falni që ju shqetësuam, — u tha pastaj Adrianit dhe Liljanës. — Mbajeni me vete dreqin se do humbë gjëkund.

Desareti ngriti vetullat me qesëndi sikur thoshte «më merr të keqen, Tiranën unë e di në pëllëmbë të dorës».

Sa dolën në ajër të pastër, më saktë pasi ishin larguar nja tridhjetë metra nga rajoni, Desareti kukurisi si një shejtan triumfator.

— Hi, hi! Ia hodha! — tha. — Unë në të vërtetë u shqepa duke lozur bixhoz me tiranasit, hi, hi!

Adriani vështroi i mahnitur qiellin gri të Tiranës.

— O Desaret, o budalla! — foli pa ulur kokën, por ndërkaq Desareti u kishte lënë shëndetin. Përbirohej me ngut mes radhëve të ngjeshura të kalimtarëve gjersa nuk u pa më.

Ata ndenjën shumë kohë në trotuar, të kapur dorë për dorë, përskaj lumit të njerëzve që shkonin e vinin. Nata i zuri ndanë një rrugë tjetër që shëmbëllente krejt me të parën, me të njëjtët njerëz që shkonin e vinin. Vonë, kur rrugët mbetën të shkreta, ata zbritën në asfaltin e shëtitores së madhe, ku për dy tre orë rresht kryeqyteti kishte nxjerrë në parakalim banorët e vet.

meditimet e veta, britmat e veta, dashuritë, përbuzjet, shpresat, zhgënjimet, vajzat e reja që jetonin për një mbrëmje, djemtë që e kishin natën dhe s'dinin c'të bënin me të, të porsafejuarit që i dëshironin shumë ngjarje fejesës, ngjarje të vjetra e të reja, dhe që kushtonin... Gjithë ai vërshim i pangushëllueshëm jete tani ishte shpërndarë në mijra dhoma të vogla. Prapa nuk kishte lënë asnjë shenjë, asnjë impuls dhe neonet rrezë tro-tuareve e derdhnin me tërbim dritën mbi pllakat bojë-hiri të bulevardit, sikur po jepnin shpirt.

KAPITULLI I TREMBËDHJETË

Një mëngjes të ftohtë dhjetori, Mitroja ia behu përsëri në Barbullojë. Makina që e solli kollitej me gulçe dhe ai vetë, i shpërthekur dhe i tretur si eremit zbriti duke dihatur. I merreshin këmbët, sytë e tij të skuqur i largoheshin me përçmim brymës që kishte mbuluar tokën, nipi vigjilent përpiqej ta mbante, por ai ia largonte duart me zemërim. I kishte mbetur pikë në zemër marshimi enigmatik i njerëzve në rrugë gjatë vizitës së mëparshme në Barbullojë. e kishte parë në ëndërr, dhe duke ndier sinjalin e një shpërthimi të rrezikshëm, kishte vendosur t'i rrëfehej dreitpërsëdrejti kryeministrit. Ky, pasi e kishte dëgjuar me vëmendje, kishte qeshur me zë të lartë. Sipas kryeministrit përjashtohej kategorikisht mundësia e një dyshimi për efektivitetin e kooperativave. Nëse disa persona në një kaptund të humbur i kishin futur frikën plakut Mitro. ky, po të dëshironte dhe po të kishte akoma përkushtimin dhe energjinë për t'i shërbver atdheut. le të thellohej në shkaqet e brendshme të prapambetjes atje.

Mitron e kishte habitur mendielehtësia e kryeministrit. Do të kishte dashur ta besonte me gjithë shpirt dhe sa herë që hapte zemrën për t'i bërë vend mesazhit të tij qetësues. kuitesa i përgjigjej me lëvizien e pelesrinëve të Barbullojës. me dorën e përgiakur të një diaboloshi. me fytyrën funebre dhe sarkastike të një burri me pesë fëmijë. Përse ty të pëlqen ta besosh kryemini-

strin?, — i thoshte një zë. Përjashtimet ekzistojnë, — ia kthente zëri tjetër. Përse të mos jetë Barbulloja një përjashtim? Po përse të mos e marrësh si rast tipik? Dhe kështu zërat grindeshin në ndërgjegjen e tij, duke e gërryer papushim përbrenda dhe duke e zhytur në gropat e errëta të një hiçi që nuk e kishte menduar kurrë, por që kallzohej si finale e një kauze. I pafuqishëm për t'i bërë ballë këtij zhgënjimi madhor dhe i stërplagosur nga sherret e rëndomta të nipërve e mbesave, ai e shtrëngoi veten të besonte opinionin e kryeministrit. Dhe një mesnatë, kur qe duke e lëshuar prapë ky opium i bekuar që mbante në eufori krejt shtetin, ai i hipi makinës dhe u nis për në Barbullojë.

— Te Ibëri! — u tha liderve të katundit që dolën ta prisnin. Novruz Begollit iu mbush trupi mornica.

— Për ideal do ta arrestojë më duket, — i pëshpëriti në vesh brigadier Palushit, por ky nuk e kishte mendjen. Pamja e mjerë e përfaqësuesit të lartë të shtetit e godiste si një mandatë. Duke u gëlltitur vazhdimisht për t'u çliruar nga një komb që i qe mbledhur lëmsh në fyt, mori guxim të pyeste.

— Si është udhëheqësi me shëndet?

Përmendja e emrit të udhëheqësit e shkriu akullin që i pengonte ata burra të përqafoheshin e të putheshin siç e kishin zakon. Mitros i ndërroi fytyra dhe Gaspri qeshi, pastaj qeshi edhe Novruz Begolli. Maska e gatshme e mirënjohjes ku përzihej gëzimi i ngulitur thellë me gatishmërinë për t'u bërë fli, zbukuroi fytyrën me prenka të brigadier Palushit.

— Te Ibëri! — përsëriti Mitroja dhe Gaspri u priu burrave me hap ushtarak.

Tereza dhe Ibëri, sic po vinin kafetë, brofën në këmbë savo panë mysafirët e lartë në oborr.

Mitroja sakaq u fut brenda si njeri i shtëpisë. Burrë e grua u vunë menjëherë në lëvizje, njëri drejt qilarit, tjetri drejt raftit të ushqimeve.

— Rrini, rrini. Ne nuk duam asgjë! — tha Mitroja.

Ibëri picërroi sytë me qesëndi sikur thoshte: «Rri o

Mitro, pash besën! S'dashkeni gjë!» Kishte arsye të mos besonte. Kush hynte në shtëpinë e tij donte një gjë.

Atëherë Mitroja tha:

— Më sillni këtu gjelin më të madh të qyvezit!

Dhe ata u nisën me vrap, Ibëri duke kërcyer si dre, Tereza duke u hedhur si patë, me qëllim që ta zinin, ta thernin, ta ripnin dhe ta pignin në tavë kaposhin.

— E dua të gjallë! — u thirri Mitroja kur kishin bërë gjysmën e rrugës për te qyzezi.

— E dashka rob, hi, hi! — u zgërdhi Ibëri duke shpuar të shoqen në ije me bërryl.

E zunë gjelin dhe ia sollën mikut përpara. Ky kërkoi edhe një filxhan vaj. Atëherë Ibëri e humbi fillin. Plani aq i qartë dhe i kuptueshëm i Mitros për ta marrë gjelin të gjallë në makinë erdh e t'u ngatërrua e t'u bë lëmsh sa ai nuk gjente dot shishen e vajit. Tereza, e cila nga natyra s'para çuditej me planet e ngatërruara të burrave, e gjeti shishen menjëherë dhe solli vajin pa bërë fjalë. Mitroja e ktheu me kokë poshtë gjelin që përpushej në duart e tij, ia hapi me gisht puplat në pjesën e prapanicës dhe e zbrazti aty filxhanin me vaj.

— Ejani ta dëgjojmë si këndon! — u tha të pranishmëve duke i futur në oborr. — Por më parë Tereza të lëshojë pulat.

Tereza çeli derën e qyvezit nga vërshtuan duke shtyrë njëra-tjetrën nja njëzet pula të shëndetshme.

I rrethuar nga pulat lozonjare që e shtynin në ngasje, gjeli ngriti lafshën e kuqe, hapi pendët e shkruara, u mbush me frymë, shtrëngoi muskujt e trupit, mbylli sytë dhe... çudia ndodhi. Nuk këndonte dot, nuk i dilte zëri. Mori vrull përsëri dhe të pranishmit panë si frushulluan puplat e tij në pjesën e prapanicës.

— Oj, ma morën sysh gjelin! — thirri Tereza, duke hedhur dy-tre hapa para për t'i dhënë zemër atij fatkeqi. Gjeli bëri edhe tre-katër prova të tjera të dëshpëruara, pastaj përtheu gjunjët në tokë dhe u përpoq të verifikonte defektin duke u rrotulluar rreth vetes. Ibëri mbante një fytyrë solemnisht të vrerosur si në një fu-

neral, ndërsa Terezës i vinte çudi që Mitroja e ndiqte kaq gjakftohtë vuajtjen e tmerrshme të shpendit.

Kureshtarët e mbledhur përtej gardheve vështronin me habi burrat në oborr, gjelin, burrat, gjelin, burrat, gjelin, pastaj u shpifej një gaz i panatyrshëm. Po ishte vërtetë për të qeshur me atë masë puplash që kërlesheshin e tulateshin sikur poshtë tyre të ishte një gjel lodër.

Në fillim askush nuk u kujtua të pyeste përse nuk këndonte gjeli, ose u kujtua, por s'deshën të pyesnin nga një lloj bestynie sipas së cilës shkakut e shvlerëson të qeshurën. Dhe vërtetë, kur po atë ditë u muar vesh se lyerja me vaj e pengonte kaposhin të këndonte, nuk qeshi me njeri.

Pak më vonë Gaspri protestoi energjikisht kundër alegorisë së panjerëzishme, brutale dhe të padrejtë të lakut të ngeshëm Mitro. U ngujua në zyrë, nuk i dillej jashtë, kishte frikë se mos prapa gardhiqeve njerëz të ndryshëm do të këndonin «ki-ki-kiiii».

— Ju jeni tendencioz ndaj meje, — i tha. — Nuk e kuptoj përse ju jeni tendencioz? Ku dhe kur ju kam shkelur në kallo? Çfarë ju kam bërë xhanëm?

— Unë nuk jam tendencioz, — u përgjigj Mitroja. — Megjithëse ju më keni bërë diçka.

— Çfarë? Çfarë? — thirri Gaspri. Në sytë e tij vërshoi drita e një gëzimi të fshehtë, «shprehu mor aman, nxirre helmin që të ka frymëzuar kundër meje, ta marrim vesh kush ka shpifur, kush na ka ngatërruar, të çthuret njëherë e mirë intriga...»

— Më keni çuar atje, te Ibëri, — tha Mitroja duke zgjatur dorën përpara kot. — Dhe keni dashur të më fshihni prej të tjerëve.

Për një çast Gaspri pandehte se Mitroja po tallej, por kur pa se ky ndjehej me të vërtetë i fyer, sa s'i ra pika.

— Njerëzinë e quani diçka të keqe? — pyeti.

— Jo njerëzinë. Fallsitetin.

— Më vjen mirë që i jepni vetes atë rëndësi që keni pasur para se të dilnit në pension, — tha Gaspri pa e fshehur ironinë. — Veç duhet ta dini, — shtoi i nëvri-

kosur, — unë nuk e fus kokën në thes, nuk fshihem prej jush, madje prej kërkujt. Unë shkoj shpesh te Ibëri kur më zë nata në Barbullojë. Dhe nuk ia përmbys kupën. Kurrë!

Dy tre sekonda ra heshtja. Në fytyrën e Gasprit shëtiten ca njollëza të kuqe — shenja të një triumfi të vogël.

— E besoj, — tha Mitroja me një vuajtje të vërtetë në zë. — Shkoni atje dhe gënjeni veten dhe të tierët.

— Naiviteteve të tilla u ka ikur koha! — u hodh në sulm Gaspri.

Mitroja ktheu kokën me vrull. Fytyra e përflakur dhe e lëmuar e tjetrit nuk tregonte tepri shëndeti siç i ishte dukur dikur, por energji. — Shkoj atje ku më pëlqen! — shtoi me mburrie Gaspri. — mjaft të kenë qëndrim të mirë moralo-politik. Na takon edhe neve të bazës të bëjë një çikë qejf, apo jo?

Zëri i tij ishte bërë cinik. Ai e ndjeu këtë.

— Jam ballëlart para kujtdo, — vijoi me një ton të ndryshuar. — Nuk vjedh. nuk intrigoj, nuk mbaj taraf. nuk i marr nëbër këmbë vartësit e mi. as kooperativistët e thjeshtë. nuk shkoj pas fustaneve. Le të dalë një burrë burri t'u bierë hasha këtvre cilësive. Janë pesë pika që i zbatoj me fanatizëm, nuk i shkel kurrë. kurrë! — buçiti zëri i tij dhe vetiu hapi pesë gishtërinjtë e dorës së djathtë.

Mitroja u ngrit.

Gaspri mbeti si vuv nja dhietë pesëmbëdhjetë sekonda pastaj u turr si t'i kishte shpëtuar zogu nga duart.

— Përse më bini në qafë kot, shoku Mitro! Gjiithcka dihet. Gjiithcka. Këtu fryn shumë erë. një shi të bierë dhe traktorët mbesin në baltë ditë të tëra. Është e vërtetë se Rafail Dodbiba e shkeli me orizin dhe unë i punova qindin. Drurin që hëngri në arë. face punëtorëve. ka për ta mbajtur mend sa të jetë gjallë. Por ama. prit e bje nuk shkon kjo nunë! Është kollai të hësh keq! Por unë nuk kam zemër katili! C'të hësh? Kështu iam gatuar! Jemi njerëz, djalli e mori! Shpeshherë harrojmë

se jemi njerëz! Si ta padis Rafaelin? Se mos deshi ai të vonohen autokombajnat? Një mijë halle ziejnë në këkën e drejtuesit, o Mitro burri! Ku të kapet më parë i ziu njeri! Eh, Barbulloja! Kemi ca brigadierë që bëjnë hatere si në arën e tatës. Po hajt t'i kapësh. Është më lehtë të zbulosh Amerikën, hahaha! — qeshi Gaspri. Dhe pasi heshti një hop sa për t'u mbushur me frymë, shtoi me një ton mjaft intim: — A do të dish për Barbullojen? Të gjitha t'i them unë, të gjitha!

Mitroja ndjehej shumë i lodhur dhe i pafuqishëm për të folur. Përveç kësaj, vuajtjet që i kishte shkaktuar tjetrit, po vepronin si një lloj ballsami për vuajtjet e veta.

— Lermë, të lutem! — tha duke u mbështetur në supin e nipit.

— Ik tani! — bërtiti i nxehur nipi. Sa u bë gati të këpuste një fjalë të rëndë për Gasprin, Mitroja, si t'ia kishte blerë mendjen, e pickoi fort. Nipi shtrembëroi turinjte. Sytë i shkrepëtinë nga inati. Gaspri u ndal duke falenderuar me një buzëqeshje lehtësuese në fytyrë. I ndoqi me sy ata derisa dolën në oborr.

KAPITULLI I KATËRMBËDHJETË

Një xhips rrëshqiste ngadalë dhe duke u lëkundur në rrugën e prishur nga qerret. Gjithandej në orizoret e shkretuara dukeshin gropat e thella të makinave shirëse, vijat zigzake të qerreve dhe gjurmët e panumërta të njerëzve. Të ftohtët e kishte ngrirë si gravurë atë peisazh që të kujtonte një tërheqje këmbëngulëse dhe shumë të vështirë nga fushëbeteja. Ndërsa vështronte atë pikturë me mece gjurmësh, në trurin e Mitros dyndej pa ndërprerje përfytyrimi i turmave të njerëzve që kishin punuar aty, gjallonin zërat, frymëmarrjet, thirrjet, shfaqeshin fytyrat e rreshkura nga era e shiu me ato nofullat e shtrënguara nga të ftohtët dhe me shikimet e hedhura nga bregu. Ato fytyra bartnin tërë mundin, shpresën dhe vendosmërinë për t'a nxjerrë në breg orizin e kapur pas baltës si një rrëshqanor. Tani beteja ka mbaruar, mendoi. Njerëzit janë më të qetë kur kalojnë pranë orizoreve. Por kjo fitore e orizit që mbeti, kjo fitore e gjashtëdhjetë përqindëshit nuk do t'i shpërblejë.

— Mbaje! — i tha shoferit.

Drejt tij po vinin Adriani dhe Ferdinandi.

— Tungjatjeta, shoku Mitro, — e përshëndeti Ferdinandi. — Ngjarja me gjelin e Ibërit ka bërë bujë. Ishle diçka e mrekullueshme. Të gjithë të mbajnë në gojë.

Mitroja vuri buzën në gaz, e kqyri tjetrin nën vetulla dhe tha:

— Për rengje jemi ne të vjetrit tani! Kryetarit tuaj i ka mbetur qejfi.

— Sa para bën, — tha Ferdinandi dhe nënqeshi me njërin cep të buzës sikur thoshte: E hëngri kunjin tani! Ta mbajë me shëndet!

Mitroja po mbërdhinte. Nipi zgjati kokën nga dera e makinës dhe tha se kishte porosi të mos e linte në murrllasnjë minutë. Por plaku, nuk kishte ndërmend të kthehej nga fusha pa takuar Skënder Abdylin.

Hipën në makinë bashkë me djemtë dhe u vunë në kërkim të Skënderit. E gjetën nja pesëqind metra më poshtë te lëmenitë e misrit. Kishte mbushur një thes të madh dhe po përgatitej ta hidhte në krah, kur makina frenoi fare pranë tij. Skënderi hodhi sytë pa shprehje nga makina. Mitroja ndjeu t'i lëvrinte dicka e ngrohtë në gjoks. Skënderi ishte dobësuar. Fytyra e tij solide ngjante si e pahitur me pluhur toke dhe erë; në sy i pluskonte një etje sonambuli, flokët si të lagur me brymë i rrinin ngjeshur pas kokës. Ditët dhe netët e vështira të atij dimri kishin lënë damkën e tyre në atë qenie të papërkulur. Erërat iknin. Shirat dhe ngricat gjithashtu. Ai mbetej si për t'u kujtuar ardhacakëve se këndeje nga Barbulloja fryn shumë erë dhe tokat mbajnë lagështirën dhe stinët e shirave janë të vështira, por ne jemi ngulur dëshira të zbriste në fushë, Mitroja kishte pasur një ide të turbullt për të takuar atje disa njerëz në përgjithësi për të verifikuar diçka që kishte lidhje me gielin dhe me rivendosjen e autoritetit të tij si njëri i njerëzve, jo i tryezave, i drekave dhe darkave. Por gjatë rrugës e kishte kuptuar se po shkonte të takonte pikërisht Skënder Abdylin. Ah, ajo fytyra e tij sarkastike! Sa shumë e kishte shqetësuar, sikur i thoshte: «Edhe ti, xhaxha, sado popullor që dukesh, je frymëzuar në grazhdin e Ibërit!»

Tani ndjehej i qetë përballë Skënderit. Dëshëronte vetëm ta shihte dhe të shihej prej tij. Po ai, pse i kishte sytë ashtu, të vrarë, të etur? Pak më vonë i thanë

sc ditën transportonte misër dhe natën ruante lëmin deri në orën njëzet e katër. Mbrëmjen e kaluar nuk kishte ardhur njeri për ta ndërruar dhe ai ishte gdhirë te lëmi pa vënë gjumë në sy.

Edhe Skënderi e kishte pëlqyer rrengun me gjelin e Ibërit, të cilin e quajti një numër të goditur. Diçka u fik me shpejtësi në trurin e Mitros. Një gjepur argëtuese, ja se ç'është për këtë njeri historia me gjelin, mendoi. Sytë e etur për gjumë të Skënderit iu dukën sikur mbytën një mendim të pathënë: Luani estradë ju në oborrin e Ibërit! Punojani njëri-tjetrit! E pastaj?

— Përse transportoni edhe me krahë? — pyeti kot.

— Për të fituar kohë. Gjysma e qerreve mbeten në orizore.

«E pastaj?».

— T'i kishit riparuar. Është gjithë kjo rrugë!

— Dimër i papë.

«E pastaj? E pastaj?».

Po e turturonte kjo pyetje që truri i tij e nxirrte si me çikrik nga sytë e tjetrit. E pastaj? E pastaj? E pastaj? Me shumë vështirësi u kthye nga fushat e ndërruara në pritje. Parcelat, bankinat, plepat, kapat e misurit, sikur lëviznin drejt tij. Po ecte edhe ai. Shpejt, më shpejt, më shpejt.

Jo, mendoi i mërzhitur, duke u çliruar vendosmërisht nga ky vizion. Jam plak. Nuk eci dot më shpejt.

Toka nën këmbë po ngrinte sikur të ftohtët vinte nga thellësitë. Adriani e tërhoqi Skënderin mënjanë dhe i pëshpëriti diçka në vesh. Thirrën Ferdinandin, Artan Bocin dhe që të katër i propozuan Mitros të pinin së bashku një kafe të hotelklubi «Ngjala».

— Nuk po mërdhinj, mor djem, — tha ai ndërsa hipte në makinë. Në fakt po i ngrinin gishtat e këmbëve.

* * *

Tereza me qëllim i la të prisnin disa minuta, duke shfaqur kësisoj krenarinë e papërkulur të familjes. Nga mënyra si qeshte me dy cemërdhokë në banak dhe me

Prengën e gjatë, nga gatishmëria e lartë për t'i zier kafënë të sapofuturit në klub Dodë Balshës kuptohej qartë se jo vetëm ishte e dëshëruar, por kishte edhe guximin të kundërvepronte me çka kishte në dorë ndaj plakut Mitro me kompani.

«Ne duam paqe, ne i urrejmë trazirat, por ne nuk jemi servilë. Ne i respektojmë njerëzit, qofshin edhe pleq të skaduar, por ne nuk kemi frikë».

Këto ishin fjalët e marrshit të pashkruar që shoqëronte parakalimin e saj mes tryezave. Për t'i dhënë ngjyrë këtij marrshi kishin ndihmuar të gjithë të prekurit nga rrengu me gjelin. Ishte e qartë se ata e kishin cilësuar Mitron ikonë, ikonë plakë dhe asgjë më shumë. Por tamam-tamam atë marsh fodull plot nënkuptime e kishte skalitur buxheti tashmë i stabilizuar i familjes. «Ne s'kemi frikë», domethënë, ne kemi para, ne nuk mund të humbasim më, prandaj kush merr mundimin të na gërvishë diku, ta dijë mirë se fitore nuk do të ketë për të.

Në të vërtetë tërë ky kumtim nervoz shkante në efir. Asnjëri nga pesëshja që priste te një tryezë afër derës nuk e kishte mendjen te Tereza.

— Nuk na ka borxh toka, o vëllezër, — po thoshte Skënder Abdyli. — As popullsia, — vijoi dhe sytë e tij u mbushën me një dritë të ftohtë hidhërimi. — Një natë edhe unë thitha frymën e djalit dhe i mora inat fëmijët e mi. S'kishte gjë më të tmerrshme. Më erdhi turp nga vetja, kisha frikë t'i shihja në sy. Oj, pse s'na i sjell kafetë ky Prenga?

Ata kthyen kokat njëherësh nga banaku si për ta shkarkuar tjetërkund një mallëngjim të papritur.

Tereza, Prenga dhe tre katër djem të tjerë po argëtoheshin me dialogun dramatik të dy artistëve që rrinin në këmbë me gotat e pijes në dorë, ndanë banakut. Ata kishin ardhur një natë më parë në Barbullojë «për t'i dhënë fund një konflikti kulturor». Kishin pirë deri vonë, ishin përlëshur mirë e mirë, kishin marrë një sy gjumë dhe sapo ishin zgjuar, ia kishin nisur prapë,

duke kaluar nga dhoma e gjumit në sallën e ngrënies. Ngjanin shumë me njëri-tjetrin, që të dy kishin flokë të kuqërremtë si paruke, mbanin këpucë me taka të larta dhe xhaketa treçerekëshe me kuadrate. Por mund t'i dallojë nga shtrati. Njëri ishte paksa më i gjatë.

«Unë kam famë në popull», këmbëngulte i shkurtëri.

«Në popull? Hahaha!» gajasej tjetri sa ushtonte tërë lokali.

«Ti je një fallsifikator! Por unë ta ngrita perden deri në rrëzë! E pashë mirë sa bosh je».

«Natyrisht, injoranca nuk sheh».

«Ti je një sofist i maskuar».

«Kurse ti nuk je as sofist. Ti vdes për të qenë sofist. Por s'je asgjë».

«Unë kam shpirtin. Shpirti më jep fuqi në mendim».

«Ku e ke? Ku?».

«Unë jam i vërtetë! Ty të vjen shumë inat që unë jam i vërtetë. Qysh mbrëmë të ka ardhur inat që unë jam i vërtetë. Madje qysh verën e kaluar».

Shirxhinjtë e hotelklubit kujtuan se ata të dy, gjysëm të pirë siç ishin, po ushtroheshin në artin e debatit. Por i shkurtëri i zhgënjeu kur u këthye me vrull nga Dodë Balsha, ia nguli sytë zhbirues, pastaj duke shtrirë gishtin përpara, tha:

— Ti shok pse hesht? Pse rri ashtu si një mumje. Të tjerat janë heshtje, thotë Shekspiri. Kush janë të tjerat? Pa m'i trego një cikë kush janë të tjerat? — bërtiti dhe ngriu në një pritje të ankthshme.

Dodë Balsha i qëndroi provokimit pa lëvizur qerpikun, duke treguar faqe të gjithëve urtësinë dhe dinjitetin e gjyshstërgjyshëve që kishin mposhtur Anzhuinët e Francës, Karl Topinë, feualët boshnjakë e të tjerë.

Jashtë u dëgjua boria e autobuzit të linjës. Dy artistët vrapuan në dhomë, rrëmbyen çantat dhe dolën

me urgjencë nga hotelklubi ndofta për ta vazhduar polemiken në një pikë tjetër të gjunësise.

«Vinë, ikin, njerëz të ndryshëm të krahinave e profesioneve të ndryshëm», kujtoi Adriani fjalët e piktorit Hektor që kishte kaluar muajin e mjalitit në Barbullojë. Në trurin e tij u zvarrit ngathtësisht një pyetje: si do t'i ketë punët me gruan?

— Tjetërkund është e keqja, — foli Skënder Abdylly duke gjerbur kafënë e shërbyer më në rind.

Fjalët e tij mbeten pezull si të lidhura në bishtin e një insekti. Në tryezë rëndoi heshtja, pastaj më shumë me firiomë se sa me zë, Ferdinandi pyeti:

— Ku?

Të gjithëve u kishte lënë shije të keqe dialogu i dy këngëtarëve. Ata sikur kishin lënë pas hijen e një plogështie të turbullt që zvarrisej në qoshet e mureve, ngrihej si mjegull mbi tryeza, përbirohej nëpër gjymtyrë... Skënderi u shkund me rrëmbim dhe duke ngritur zërin në mënyrë të panevojshme tha:

— Çfarë dreq kafeje është kjo? Lëng gështenjash!

— Skënderi është në kontradiktë me kryetarin, — foli me një buzagaz të kërkuar që nga tryeza tjetër Dodë Balsha.

— Jam kundër me mungesat e mia! — ia ktheu rreptë aty për aty Skënderi. — Por jam aq i pasur sa të jap kuotën time për t'i plotësuar kryetarit një rrogë, — shtoi me sarkazmë. — Kryetari i mirë, them unë, nuk i bën temena rrogës së vet, por pagës së punës së punëtorit. Ky yni hiç s'e vret mendjen! Na i ka lënë neve kompetencat! Ju populli i keni punët në dorë, thotë. Në fakt nuk e ka keq. Ne rrimë urtë, presim ç'do të ndodhë.

— Mbaje veten, bre burrë! — thirri Tereza që nga banaku, Skënderi e vështroi me përbuzje. Dodë Balsha ngriti kokën nga libri që kishte përpara.

— Populli i ka në dorë të gjitha, — deklaroi me

zërin e hollë duke shëtitur gishtin tregues mbi faqen e librit sikur thoshte «kjo është shkruar këtu».

— Populli doemos, jo era, — foli për herë të parë Adriani. — Ju thoni: «ju, populli». Po ç'jeni ju atë-herë?

— Ah, t'u luaj zotin! Asnjëri nuk do të jetë popull, — u skërmit Skënderi dhe bëri me dorë nga banaku. Tereza fërgëlloi me një sforcim plot dinjitet.

— Edhe ty Skënder ta ka ënda të mos jesh popull, prandaj ke nxjerrë shpatën, — tha ajo dhe me ca hapjembyllje të shpejta të syve i kumtoi atij «mos mbaj shpresë».

Dodë Balsha gërvishi buzën e sipërme. Mitroja ndjeu një shtypje në krahëror. Skënderi ishte mbledhur palmuç në karrige, duke përmbajtur me të gjitha forcat një hovje të brendshme për t'u ngritur. Fytyra e tij kishte marrë ngjyrën e dheut.

— Ç'ja var, — i pëshpëriti Adriani.

— Janë pleh, por janë edhe të ligj, — tha Skënderi. Po ç'karrierë do të bëj unë, aman! Unë dua të rroj, të rroj mirë me fëmijë e me shokë. Në fytyrën e tij shkrepri papritur një dritë e fortë sa u duk se pas pak do të digjej fare. — Na fal, o shoku Mitro, po kështu e kemi ne në Barbullojë. Diskutojmë, vazhdimisht diskutojmë.

Një valë mallëngjimi kaloi sa çel e mbyll sytë në fytyrën e Mitros.

— Ju punoni, — tha me zë të thellë duke vënë pëllëmbën e vet mbi atë të Skënderit.

U ngritën dhe po dilnin. Në oborr Mitroja dëgjoi një zë nga prapa: Shoku Mitro! Shoku Mitro! Ktheu kokën dhe pa një burrë të shkurtër rreth të tridhjetave. Kishte lidhur pëllëmbët si kupa përpara dhe vështronte me ca sy plot shpresë dhe drojtje sikur kërkonte leje për t'u afruar.

— Jam Gjoni, Gjon Shllaku... Këshilli më kaloi ço-

ban lopësh. Jam i lumtur, shoku Mitro, nuk di ç'të bëj! Të fala dhe jetë të gjatë udhëheqësit!

Profili i tij i qeshur rrëshqiti nën degët e sallkave në oborrin e hotelklubit, pastaj ia shkeli vrapit, si për të provuar se lumturia e tij nuk ishte një gjë e ngjitur që mund të bjerë nga lëkundjet, por diçka e thellë, krejt e tij. E kishte vënë brigadier Palushi ta luante atë rol. Ishte një peshqesh për humorin e Mitros.

KAPITULLI I GJASHTËMBËDHJETË

ADRIANI: — Përse s'ke ardhur të më takosh?

LILIANA: — Erdha pardje, por nuk të gjeta.

ADRIANI: — Pardje në orën gjashtëmbëdhjetë kam qenë këtu.

LILIANA: — Ah, unë erdha më shpejt! Tani erret herët dhe unë vazhdimisht vij më shpejt.

ADRIANI: — Ti sikur vjen për të ardhur dhe jo për mua! A s'mund të prisje pak?

LILIANA: — Bënte ftohtë. Pastaj s'mund të rrija gjatë. Dodë Balsha me të birin po punonin te ai varri atje!

ADRIANI: — Ata e kanë gërmuar tokën ashtu?

LILIANA: — Po. Flitet se Doda ka ndër mend të ndërtojë një varr madhështor për gjyshin.

ADRIANI: — Përnjimend?

LILIANA: — Ai po bën PEMËN. Ma tha Aleks.

ADRIANI: — Pemën? Ç'është kjo pemë?

LILIANA: — Pemën e fisit!

ADRIANI: — I krisuri!

LILIANA: — Sidoqoftë, ai po bën dicka...

ADRIANI: — Ah, më fal! Ju Simonajt e ndërtoni jashtëzakonisht shumë ndienën e fisit!

LILIANA: — Qvqja! Si flet kështu?

ADRIANI: — Ti vetë më ke thënë se të janë mërzi-tur njerëzit e shtëpisë.

LILIANA: — Unë kam bërë shaka! Vërtetë më janë

mërzitur k'natat, ato shumë-shumë më ngjallnin keqardhje. Kurse babai im është njeri shumë i mirë! Nëna gjithashtu ka zemër shumë të mirë.

ADRIANI: — Ç'bën si kalama edhe ti!

LILIANA: — Nuk më pëlqen ta marrësh kallëp ndonjë pakënaqësi timen. Në qoftë se të duhen arsye për të mos ardhur në shtëpi, thuaj s'kam para, thuaj ç'të duash, por mos m'u bjer në qafë njerëzve të shtëpisë.

ADRIANI: — Ngrije kokën!

LILIANA: — Nuk e kam ulur k'kokën!

ADRIANI: — Hapi sytë fort desha të them! Shikomë tani!

LILIANA: — Mos më shiko ashtu! Në qoftë se je penduar dhe të vien keq për mua, ma thuaj! Nuk dua t'i ngjall keqardhje kërkujt! Jam e zonja të rroj pa keqardhje...

ADRIANI: — Liliana! Sec kam këto kohët e fundit! S'më flihet, s'më hahet, s'më flitet. Më duket se po harroj gjuhën, më duket se po bëj hije kot mbi dhé... Nganjëherë më ngulitet diçka në kokë si gozhdë dhe nuk e shkul dot, si për shembull një plep i zhveshur, një fytvrë burri, një gjurmë nieri në orizore.... Më e keqja: këto figura fillojnë e deformohen në përfytyrimin tim, ndërrojnë trajtë: fytyra e Skënder Abdylit hollohet si teh sëpate, fytyra e kryetarit përtypet vazhdimisht dhe më kall krupën, shtëpia juaj e hallakatur gjithashtu më tmerron... Kushedi si e kam hallin... Pyeta doktorin. Kështu e kanë të rinjtë e moshës tënde, — më tha. Shohin ëndrra me sy hapur. Por unë e kam gjetur ilaçin. Duhet bërë diçka. Nganjëherë kjo më duket kaq e lehtë. E ndjej të plotë veten time, dal i gëzuar nga shtëpia, megjithëse nuk e kam të qartë

çfarë duhet të bëj. Stomi, them me vete,
s'ka asgjë më shumë se ne. Më pushton një
gëzim i madh, vendos që në mbrëmje t'i
tregoj nënës për ty... Por kjo nuk vazhdon
gjatë... Ulu shpejt!

LILIANA: — Çfarë?

ADRIANI — Po kalojnë kunatat e tua!

LILIANA: — Nuk ka kuptim! Nuk ka asnjë kuptim
të fshihesh...

KAPITULLI I SHTATËMBËDHJETË

Me afrimin e vitit të ri era pushoi, por të ftohtit u bë më i hidhur. Gjatë gjithë ditës mbi sipërfaqen e tokës qëndronte një push i thatë bryme pa shkëlqim. Në mbrëmje dëgjoheshin andej këndeje zhurma të mbytura që të kujtonin rrëshqitjen e ngadalshme të blözës në oxnaqe. Toka rënkonte sikur e shtrëngonin me darë. Dukej se nga çasti në çast diçka do të kriste, do të thyhej. Dhe vetvetiu të shkonin sytë nga plepat e zhveshur me lëkurat si luspa të thara.

Ishin ditët më të shkurtëra të vitit, kur dielli duket më pak se kurrë në horizont. Për këtë arsye psikologë dhe mjekë të ndryshëm këshillonin me anë të radiove vigjilencë dhe vetëkontroll të posaçëm, sepse mungesa e rrezeve ultraviolett, siç thoshin ata, nxit për veprime të rrezikshme.

Adrian Miraj sapo ishte larguar nga mbledhja e zgjeruar e kryesisë së kooperativës, ku liderët e kandidateve, të tronditur paksa nga historia e gjelit, por edhe të egërsuar për këtë shkak, ishin mbledhur për të kallzuar edhe një herë forcën e pathyeshme të shtetit. Ishin aq të ndërkrayer dhe agresivë sa edhe të kolliturat i merrnin si provokacion. Nuk hanin pykë për asgjë, nuk pranonin asnjë vërejtje dhe, siç pat menduar Adriani me vete, digjeshin nga dëshira që diku në ndonjë postë kufitare të vendit të fillonte lufta që ata pastaj të komandonin me ligje të tjera që përputheshin me situatën e bekuar të gatishmërisë nu-

mër një. Brigadier Palushi i kishte hedhur në lëvër mendimet e veta për veprimtarinë armiqësore të Skënder Abdylit me shokë. Idhnak si asnjëherë tjetër, ai kishte deklaruar se marrja nëpër gojë e shokëve kryesorë këtu është një djallëzi me qitje të largët që nënkupton Udhëheqësin. Thinjat e rralla mes flokëve shumë të zinj të Novruz Begollit kishin shndritur si shkëndija baroti dhe kur Adriani kishte thënë se Skënder Abdyli nuk merr nëpër gojë njeri, ata kishin zgjatur kokat dhe duart gati për linçim. Po ky? Nga na doli ky? Me kë është ky? Ky që paska një fytyrë të indinjuar!

Kokërdhokët e syve të brigadier Palushit ishin rrotulluar nga brenda dhe Adriani kishte patur përshtynjen se tjetri e shikonte me anën e pasme të syve. Fytyra kuqaloshë e komandantit të batalionit ishte ngurtësuar si nga cikma. Pastaj ata kishin filluar të flisnin të gjithë njëherësh, mjaft të bezdisur që kishin buzë. Kush e thirri në mbledhje këtë bastard? Ç'punë ka ky në forumin e lartë të kooperativës? S'ka bërë! Të merret vesh një herë e përgjithmonë! Ka cen-tra-li-zëm! Hekurat, more hekurat! Ato bëjnë punë!

— Ka marrë fund. — kishte thënë Adriani, duke shikuar nga dritaria ca fiolla imcake dëbore që qenë shfaqur atë cast të xhamat. Ato rrotulloheshin si vashëza çanëne dhe teksa u afroheshin xhamave për t'u ngjeshur pas tyre, dukeshin sikur thoshin: «Erdhëm në! Erdhëm në! të mbuluar gjifhcka!».

«Edhe unë po vij», u qe përgjigjur në heshtje Adriani dhe kishte dalë i përcjellë nga një pështjellim akuzash, sharjesh, kërcënimesh dhe gërvishtiesh nëpër blloqe ku shkruheshin me nxitim fjalët «ka marrë fund kooperativa. Adrian Miraj, 23 dhjetor 1989».

«Ka marrë fund», përsëriti me vete Adriani. Pushi i brumës kërciste nën këmbët e tij. Ai ngriti jakën e pardesës, mbështeti kurrizin në trungun e ullirit dhe zuri të shikonte borën që binte.

Ka marrë fund, tha prapë. S'ka zot ta shpëtojë! Ndihej i qetë, madje i lehtësuar, sikur ajo vdekje që

afrohej për të marrë kooperativën do të pastronte të gjitha të këqiat, brenat dhe pikëpyetjet e jetës.

Pak më tej, në dhomën e vogël të rojes operative dëgjoheshin, të qeshura të forta. Të qeshurat pushuan pak dhe Adriani dëgjoi fare shkoqur ligjëratën solemne të një burri... Në mes të vapës kapitëse, por me shpirtin e paepur të kryengritësit, Ibëri na mbërrin në atë krahinë të varfër të Afrikës. Me një kapele kashte 3a një tepsi në kokë, me gjyslykë të trashë dielli, hipur mbi një citrojen të hapur, ai frenoi mu në zemër të getos. Dhjetëra zbatharakë vrapuan kush e kush t'i bënte më shumë nderime shpëtimtarit, atit që do t'u kallzonte si pushtohen majat e lumturisë. Në çast e shpallën prijës. Filloi ceremonia e kurorëzimit. Katër zezake të bukura me katër tepsi argjendi nëpër duar...

Adriani zuri veshët me pëllëmbë. Nuk i duronte më «Fluturimet». I qenë mërëzitur prej kohësh, por tani i shkaktonin tamam dhimbje. Vjen një çast kur parodia bëhet aleate, madje shërbyese e jetës që ka tallur për shumë vite. Dhe jeta vazhdon të jetë edhe më tej ashtu siç ka qenë, e mbrojtur tashmë nga parodizimi. Njerëzit, më në fund, lejohen të tallen me regjimin dhe me gjithçka tjetër dhe kjo i kënaq. Por pikërisht te ky kufi, te ky kufizim fillon për ta një robëri e re, robëria e lirisë që nuk përdoret.

Ishte errur. Fjollat e borës dalloheshin turbull dhe toka kishte filluar të zbardhej. Adriani ecte kuturu mbi livadhin idilik të borës. Përtej, në rrugën para rreshtit të shtëpive njëkatëshe, nxitnin katër silueta. Ata lanë pas të qeshurat bubulluese të komandantit të batalionit, u shmangën djathtas në njërën prej rrugicave të shumta dhe ecën drejt një drite. Adriani gjeti me mend shtëpinë e Lena Përgjokës. E paska shkukur Gasprin, mendoi.

Gaspër Matrizi nuk po shkonte në shtëpinë e Lena Përgjokës. Andej nga fundi i mbledhjes, kur kishin mbe-

tur vetem besnikët e patundur, ishte ndier keq midis tyre.

I refuzoi të gjitha ftesat, madje edhe ftesën e veçantë të Palushit, i cili u kthye për se dyti kur kishin ikur të tjerët.

— Jo, pra jo! Dua të fle në zyrë!

— Ska lezet, ne të ikim, ti të rrish vetëm!

— Ketu e kam lezetin, të rri vetëm!

E percollu me sy Palushin derisa ky humbi në errësirë, u kthye në zyre dhe u ul në shtratin akull të montë. Një rrymë ajri e gojave në kurriz. An, ndofta është tnyer xhami, mendoi dhe ktheu kokën për të parë. Në pjesën e xhamit të ngjitur me kashen po shtresonte debora. Megjithëse nuk dalloi ndonjë tnyerje, ishte i bindur se të ftohtët hynte andej. U ul në shtat, iu mjekren në mes të pellëmbëve si këllëf dhe u perpoq të kujtonte diçka të bukur. Por truri i mpirë nuk e shpërbleu me asgjë për të qenë, por me ca fragmente darkash, një etiketë «Kalimet-Verë e Kuqe», një pirun i kthyer përmbys, një skelet peshku, një pjatance e mbushur me lëvore dhe kocka dhe të gjitha këto iu dukën të neveritshme.

Ai po mbushej me inat. S'kishte vallë kujtime të bukura jeta e tij? Si një përgjigje e ligë e këtij ankimi, një valë e re të ftohti i përqethi trupin. I erdhi ndër mend shprehja «njeri i mërdhitur» që në Barbullojë e përdornin për të tipizuar njerëzit e mefshtë, ata që nuk nxjerrin qimen nga qulli. Unë jam njeri i mërdhitur, artikuloi pa zë. U ngrit dhe eci me hapa të shpejtë drejt tryezës sikur kërkonte kundërrarmën e kësaj shprehjeje. Tërhoqi karrigen dhe u ul. Druri i saj gjithashtu ishte akull i ftohtë. Njeri i mërdhitur... Njeri i mërdhitur... Kush fliste? Kush? I mbërthyer në tharkun e akull të këtyre fjalëve, ai mori një letër në sirtarin e tryezës, nxorri stilografin dhe shkroi me rrëmbim, sikur çelte me daltë një shteg mes atij agushtimi:

«Shoku kryetar! Vendosa t'u kërkoj sonte më 23 dhjetor lirimim tim nga detyra e kryetarit të kooperativës së Barbullojës...»

Shpëtoi. Qerthulli ishte hapur. Ai uli stilografin dhe u mbush me frymë. E kishte mposhtur veten. Nuk ishte më kryetar. Menjëherë nga supet e tij, si një tufë sokolash e pëllumbash e laraskash e gushëkuqësh e trumcakësh e thëllëzash e grifshash e sorrash e laureshash, fluturuan vështrimet, kritikak, përbetimet, ledhatimet, akuzat, buzëqeshjet, hallet përqeshjet... U ndie i lehtë, jashtëzakonisht i lehtë. Tani kishte kohë të arsyetonte dorëheqjen. Madje falë kthjelltësisë që i dhuroi akti i vetëshkarkimit, mund të dilte në një terren të thatë fare që të shpëtonte pa lagur edhe këpucët. U mbledh kruspull sikur e kishte aty përballë kryetarin e komitetit dhe shkroi:

Sikur ardhja në Barbullojë, e ndava mendjen ta mbyll këtu karrierën time të gjatë drejtuese. Por tani e kuptoj se dëshira ime për t'a mbyllur këtu karrierën e gjatë drejtuese mund të realizohet në kurriz të kërkesave të reja të kohës. E ndjej, shoku kryetar, se nuk kam më fuqinë e dëscurshme. Kurse punët janë shtuar, problemet janë përë komplekse, lipset një njeri më energjik se ne, kuadrot e vjetër, I thashë këto me dorë në zemër, shoku kryetar, duke fituar mbi sedrën që na pëshpërit në botën e brëndshme «dalen, ju të vjetrit i dini të gjitha», e duke patur bindjen e patundshme se dorëheqja ime do të mirëkuptohet prej jush. Me respekt, Gaspër Matrizi.

I lexoi nga e para ato që kishte shkruar, buzëqeshi i kënaqur, u ngjiti lart e më lart në majat e një ngazëllimi të përfutur me zgjuarsia. Po, po, në goftë ndopak inteligjent kryetari i komitetit do ta lexojë të plotë nëntekstin e letrës time dhe do të më gjejë një punë për të qenë...

Lartësitë e ngazëllimit janë të rrezikshme sepse të largojnë shumë nga toka. Ai pati rastin ta vërtetonte edhe një herë këtë urtësi kur sa hodhi dy hapa drejt shtratis portativ, u trand. Në kokë i buçiti kumtimi i hidhur «ti nuk je më kryetar kooperative!» Diçka ju bë rrëmuje në krahëror, sikur binte nga hapësira drejt

e ne batakun e mosqënies, në hijen e hijeve, në shkallën zero, nen zero... Ai të mos ishte më kryetar? Berr, sa ftonte që bente!

Largo! me dorë mbulojat e shtratit dhe ashtu, i çoroditur, i etur për t'u mbuluar kokë e këmbë me diçka, për t'u verbuar, për të mbetur vetëm për vetëm me mendime., nuk vuri re se shtrati kishte vetëm dy çarçarë dhe një batanije të hollë. Hoqi këpucët dhe u fut nen to. Fiontësia e çarçafëve iu përshkua nëpër veshjet e trasha të trupit derisa i përqethi lëkurën. Filloi të përpëlitej majtas e djathtas si për të dëbuar të ftohtin që i kishte zënë shtratin. Më kot, O perëndi, do të ngrij, mendo!

Asntu flokëprishur, të kokorithur dhe të vuvosur e gjeti brigadier Palushi që hyri në zyrë pas çerek ore bashkë me të shoqen, një grua e gjatë me tipare të mprehta prej nevrastenikeje. Gruaja rrudhi buzët me nënvieftësim kur pa fytyrën si në jerm të kryetarit. Ajo la në tryezë si një gjë të tepërt pakon me ushqime. Kurse Palushi, njërin sy të dorëheqja e harruar mbi tryezë, tjetrin të fytyra e patakur e Gasprit, shpërtheu papritur:

— Të poshtërit! Të ligjtë! Maskarenjtë! Nuk do të bësh dorëheqjen! Nuk do të lemë ne të kapitullosh se duan disa kokrra!

Ai e ndihmoi kryetarin të ngrihej nga shtrati, i nxorri nga xhepat çelësat e zyrës dhe e tërhoqi drejt derës si të ishte i verbër. Jashtë vazhdonte të binte borë, por tashmë ajo ngjante e largët sikur s'kishte punë me këtë botë.

Dritat e «Ngjalës» ishin të fikura. Adriani u mbështet në parmakët prej druri me një shtresë bore përsipër. Vrulli i parë i fjollave të zhdërvjellta kishte kaluar, tani u kishte ardhur radha floqeve të mëdha që

binin qetë-qetë dhe si të lodhura. Ai mendoi se të nesërmen djemtë dhe vajzat do të luanin me topa bore gjersa t'u mekej fryma. Vajzat sidomos, në kundërshtim me natyrën e tyre të tërhequr, bëheshin shumë agresive kur luanin me borë. Ishte ndër lojrat e pakta kur atyre u lejohej të luanin si të barabarta me djemtë deri në orët e vona. Madje nuk merrej leje fare prej prindërve. Leja vinte prej lart me rreshjet e borës. Pushi i saj i bardhë uniformonte peizazhin dhe vajzat, krejt të ndryshuara, me një dritë hakmarrëse dhe ngjasjeje në sy, dilnin të parat. Por ndofta lojtarët e borës kishin kudo, edhe në vendet e tjera, të njëjtin portret. Adriani mbante mend se dhjetë muaj më parë, një pasdite shkurti me borë, katër studente të ardhura në Barbullojë për të kaluar natën, kishin dalë me vrull nga dera e «Ngjallës» dhe kishin filluar të qëlloheshin me topa bore. Adriani po kalonte para parmakëve dhe pikërisht te dera e hyrjes në oborr ishte ndalur pavullnetshëm disa sekonda. Vajzat dukeshin shumë të bukura në borë. Në të ikur, ai kishte dëgjuar zërin e pastër të njëres prej vajzave që u tërhiqte vëmendjen shoqeve mbi sytë e bukur të atij djalit atje. Sa sy të bukur paska kishte thënë tekstualisht ajo. Ai kishte vazhduar rrugën pa e kthyer kokën. Katër pesë hapa më tutje kishte ndjerë flurudhën e topit të borës përskaj veshit të majtë, sa çel e mbyll sytë ishte kthyer prapa dhe kishte parë krahun e vajzës duke u ulur pa ndonjë urgjencë dhe sytë e saj me një ngjasje të harxhuar përgjysmë që kërkonin pak a shumë të shfaqësoheshin për xhestin, sepse ajo nuk... «Mos u mërzit bukurëshe bora e ka fajin e di unë...» Ai kishte qeshur dhe ajo kishte vënë buzën në gaz gjithashtu, e lehtësuar që i pajohuri e kishte kuptuar drejt trillin e saj dhe s'kishte ndërmend të kërkonte asnjë lloj dëmshpërblimi. Pastaj, kur ai ishte nisur përsëri, ajo e kishte pyetur në ç'orë vjen urbani ditën e dielë. Vajzat e tjera kishin qeshur lehtë dhe ai e kishte marrë me mend se ato e dinin shumë mirë orarin e urbanit të së dielës, por ndofta ajo që i

kishte lëvduar sytë pak më parë dëshironte t'i ndjente edhe zërin dhe kjo dëshirë gjithashtu kishte lidhje me borën dhe me një interesim të paqëllimtë njerëzor.

Ai kishte buzëqeshur dhe para se të nisej për rrugë e kishte pyetur atë si të quajnë? Era, studente në ekonomik... Ah, ti sikur ke lindur në Barbullojë, këtu fryn shumë erë dhe është e çuditshme që asnjëra nga vajzat e këtushme nuk quhet Era...

Adriani shkundi flokët dhe vështroi i magjepsur rreth e qark. Ndrëimi i borës kishte pahitur natën deri afër qiellit. Fjollat tani dukeshin si grimca të qemtuara nga një masë kristallore drite. Binin bukur, jashtëzakonisht bukur.

Një hije njeriu rrëshqiti dhe humbi përtej kaktusit të madh në oborrin e hotelklubit. Adriani s'pati kohë të vriste mendjen kush ishte sepse prapa shpine dëgjoi zëra.

«Mos m'u qepni më! Falmani me të mirë! Për zotin do t'i bie hasha! Kush ju ka vënë të ruani rrugën e madhe? Jo, mor shokë, ruani misrin ju! Sa njerëz kalojnë...»

«Ti po vidhje!»

«Unë po vidhja? Kush të tha?»

«Sytë e mi.»

«Shiko! Po më rëndon, pasha krishtin! S'ua kam borxh syve të tu!»

«Kush ishte ai tjetri?»

«Lëre, o Skënder tani! Je hallelxi për vete, nuk të ka lezet!»

Adriani mbante vesh symbyllur si njeriu që bëhet gati të kalojë mospërmes një zjarri dhe ashtu i tronditur nga prova e pashmangshme, nuk i emërton dot pasojat por i përjeton në trajtën e frikës dhe dilemave boshe që vetijnë e shuhen në fraksione të pakapshme kohe. Njeriu që ishte kapur duke vjedhur ishte Shtjefën Simoni, kushëriri i Liljanës.

«Shih, o Skënder hallexhiu mos ndukësh ndonjë gjë për vetë se kështu ka shkuar kjo punë, po thoshtë Shtjefni. Ç'ta prishim për derzhavën me që jemi brez pas brezi këtu! Sa vjedhës ke kapur ti këto netë dhe s'i ke treguar? Pse të bëhem kokë turku unë që jam i krishterë?»

Zemra e Adrianit rrihtë me tërbim në gjoks. E mori për një çast vendimin për të mos u bërë i gjallë. Por zëri ngadhnyes dhe sarkastik i Kolë Kunorës, që ruante lëmenjtë e mirsit bashkë me Skënder Abdylin, përmbysi çdo gjë:

— Ej, ti atje! Dorëzohu! S'ke ku ikën më!

Gjithçka tjetër pastaj u zhvillua me shpejtësi në floknajën e borës që binte gjithashtu me fërfëllima të ethshme. Adriani doli përballë rojeve dhe, duke vënë duart në gjoks me një ndjenjë të pakuptueshme turpi, tha se ndodhej rastësisht aty, se nuk i shkohej në shtëpi prandaj...

Skënder Abdylin ngriu në vend, kurse Kolë Kunora u gëlltit me gëzim si të kishte kapur një trofe të rrallë. Mendja e tij e stërvitur në zbulimin e planëve kundër kooperativës e krioi saora si gjëndismë skëmën e bashkëpunimit Shtjefën-Adrian. Masat kundërvepruesë të shtetit mbinë si lulëkuqe në atë gëdhismë, pastaj ai pa gazmendin luftarak në fytyrën e brigadier Palushit, pa lotët në fytyrën e Liliana Simonit dhe një dekoratë të shndritshme në gjoksit e vet, dekoratë e cila mund t'i hapte rrugën për t'u pranuar në grupin e rojeve të rezervatit të gujetisë në lagunë ku cdo të shtunë e cdo të dielë vinin shokë nga byroia politike për të gjuajtur... O, zot! Ai do t'i shihte ata nga afër, do të merrte urdhëra prej tyre për të nxjerrë nga lagunat rosat e vrara... Ai qysh tani po merrte vrull dhe nuk i pritei sa të zbardhonte dritën e bëkuar e berëndisë, e cila do të vinte me një xhips dhe me tre-katër policë të armatosur...

I dehur nga këto përfytyrime, Kolë Kunora nuk i ndjente fare lutjet e Shtjefnit:

— Mosni, bre burra, pash zotin! Pashë tokë e qiell mosni! Nuk doni, a? Nuk këri ndërmend të më falni? Po a keni zemër, bre burra!

— Ah, ta dini ju sa e zorshme është të ngrihesh nga gjumi i parë, të ecësh në majë të gishtave nëpër shtëpi që të mos zgjosh fëmijët, të ecësh mes acarit... Një kuintal peshon frika!

— Sikur të të rëndonte edhe munda i të tjerëve aq! Do të flije rehat në shtëpi! — tha Skëndëri.

— I preva në besë! — shterroi zëri i Shtiefnit. — Më tha kjo kokë e shkretë: mos shko, mos shko, por desha... uf... desha të fitoj ndonjë lëkë... Për atë zot s'kam vjedhur kurrë! Në fisin tonë, si në gjithë Barbullojën, është turp për burrin të vjedhë. Por djali im... uf... djali im s'ka këpucë!

— Mjaft! — ia bëri Kolë Kunora. — Në emër të popullit... Ai deshi t'i thoshtë «në emër të popullit jeni i arrestuar», por ishte akoma natë.

— Mirë, bre burra! Bëni si t'u fhotë mëndja! Më paditni! Uf... sa turp më vjen nga fëmijët, nga gruaia nga të gjithë...

Disa çaste nuk foli kërkush. Çfarë njeriut është ky Shtiefni? po thoshte Adriani me vete: si nuk e kishte pyetur Liljanën qoftë edhe një herë për të! Ne dashurojmë sipas modës së re, mendoj me ironi. Nuk jemi të askujt, për ne asgjë nuk dihet, themi duke u puthur e përqafuar dhe kështu shpallim egoizmin tonë për t'u veçuar nga njerëzit mes të cilëve jemi formuar.

Binte borë papushim. Dukej se toka nuk do të ngopej kurrë. Nën atë rënie të heshtur dhe madhështore përojekia e Shtiefnit për të vjedhur dukej edhe gjebur, edhe mëkat i madh.

— Ik! — i tha Skëndëri më në fund. — I janim karar nesër kësaj pune.

Shtiefni la prapa ca vështrime të përdëllvera, çan borën me mundim nja shtatë tetë metra, pastaj ia dha vrapit.

— Po ti, pse nuk ikën ti? — iu gërmush Kolë Kunora Adrianit. Ky e vështroi me habi, pastaj u kthye dhe pyeti Skënderin:

— Çfarë thotë ky, Skënder?

Kolë Kunora mbloodhi duart grusht në gjoks dhe përpushi këmbët mbi borë:

— Bah! Bah! — ia bëri pa i lënë radhë Skënderit të fliste. — Nuk ma mbushni dot mendjen as njëri as tjetri! E di unë... e di... Ju.... Eh, e di unë. Por nuk dorëzohem! Ta di se më shkon copa e mishit në qiell, nuk dorëzohem!

— Mos u dorëzo! — i bërtiti afër veshit Skënder Abdylit. — Por edhe mos shpif. Adriani po... bridhte... kot!

— Hëëë! — përdrodhi zërin dhe trupin Kolë Kunora. — Ashtu vidhet në ditët tona, si përgjumshëm, si jerm. Janë marifete këto!

Adriani e mbërtheu për gjoksi dhe sabo u bë gati ta pështvnte, tjetri filloi të përpëlitej si epileptik, duke klithur me sa kishte në kokë.

— Ndhimë! Ndhimë!

Adriani ia rrsi me shpullë dhe vetvetiu u përkul të lante duart me borë. Ndërkaq Kolë Kunora kishte rënë përmbys dhe vështronte qiellin sublim sipër tij me ca sy të prushtë si sy maçoku.

KAPITULLI I NËNTËMBËDHJETË

I pashpërgjumur plotësisht, Skënderi hapi sytë përgjysmë. Ishte ditë. Në kuzhinën ngjitur mbretëronte një heshtje e pazakonshme, nëpër të cilën vibronin ca shenja të paemërtueshme jete, ca brambullitje flakësh, ca frymëmarrje të këputura dhe ca pëshpëshe të mbytura. Atij i shkoi mendja se mos mësuesi kaçurrel i matematikës kishte ardhur për të ngritur çmimin e unazës së Adiles. Ka për t'ia blerë, tha me vete. Një ditë Adilja do të thëhet dhe ajo do të jetë ditë zie për të.

Ai u mbush me mërzë. U ngrit pa zhurmë dhe vuri syrin në plasën e dërës. Një fëmijë i panjohur vështronte si burrë i madh zjarrin. Mbante sandale verore pa çorape. Vajza e vogël i kqyrte me habi këmbët e skuqura.

— Po ë zgjoj, — foli me një padurim të përmbajtur Adilja.

— Lere, lere! T'i dalë gjumi! Është lodhur, — ia ktheu nën zë një burrë. Skënderi njohu zërin e Shtjefnit. U vesh me përtesë. Nuk kishte asnjë dëshirë të bisedonte me të.

Ata matanë, me sa duket, e kuptuan se ishte zgjuar. Dikush trokiti lehtë. Fill pas kësaj vajza e vogël ia shkrepri vajit. Skënderi hapi derën me rrëmbim dhe u gjend turi më turi me fytyrën e mprehtë dhe shumë të kuqe të Shtjefnit.

— Po pse qan moj shpirt, babanë tënd e kam shok, nuk do t'i bëj asgjë babait tënd!

Njerën dorë mbi floket e vajzës, dorën tjetër në xhëpin e djathtë të kapotes, Shtjefni rresqiti nën sqellat e Skënderit dhe u lut në dhomën e gjumit. Po vele e mbylli derën. Veshtrimet e tyre u kryqëzuan dhe u ulen përane dy-tre here në atë dhomë të ndriçuar dobët. Shtjefni e shtynte ngadalë dorën që kishte lutur në xhëp sikur ai xhëp të mos kishte rëndësi kurrë.

Me në fund ora e tij u ndal, diçka rremoi në thelesi dhe zuri të ngrintej po aq ngadalë sa ç'ishte i lutur. Pastaj ajo dorë e holla me gishtat e mbledhur si sqep lejleku u shkul me një drithërimë patetike nga kapota duke ngritur lart një turë kartmonedhash të zhuqrosura si dhe ca qindarka metalike. Ia parate në komonë aty pranë dhe u mbush me frymë fort sikur nuk i mjaftonte ajri. Lekura e tij tashmë nuk ishte e kuqe, por e zbehtë si dyll i prishur. Qerpikët e syve i drithësoheshin përdërprerje, ndërsa në bëbëza i llapsie një dritë mizore. Dang-dang-dang, rrahu fort zemra e Senderit. Shtjefni po ia blinte ndershmerinë. Jo, ai nuk po i blinte ndershmerinë. Ai po pranonte humbjen, po i nënshtrohej me shpirt nën dhëmbë presioneve, po ia mbyllte gojën me ato para gjaku. Keto deshe, merri, haram të qofshin! Sytë e tij të kallnin datën. Pas çdo llapsjeje të dritës, dukej sikur atje rëndonte të zbuluar ditën e ditës, dukej sikur atje rëndonte të zbuluar ditën e ditës. «Merri, haram të qofshin!». Damarët e Skënderit tani rrihnin si një këmbanë e shurdhuar. Me shpejtësi të skëtërrshme në mendjen e tij parakaluan këmbët e futura në sandale të fëmijës në kuzhinë, një kartmonedhë e shqyer mbi të cilën rrëshqisnin gishtat e hollë të Adiles. Pastaj e gjeti veten krejt të zbuluar përballë syve të verbër të Shtjefnit që tani ngjanin me dy gropa të vogla hiri. Ai i kishte dorëzuar paratë. Ai kishte mbaruar punë dhe po bëhej gati të dilte.

— Ndalo, Shtjefën! — tha Skënderi. Prapa derës vajza e vogël ia plasi përsëri vajit. Ai ndjeu një shembje në kraharor si t'i qe këputur diafragma, nëpër gjysmëterr pa tufën e lekëve mbi komo. Pati përshtypjen se nga çasti në çast ai shuk i vogël letrash do të shpërthente si bombë.

— Merri paratë! — tha me një fije zëri. Në lutjen e tij të butë ndihçoj alarmi, urgjenca, domethënë merri paratë dhe ik shpejt prej këtu! Shpejt, shpejt, shpejt! Dhe frymëmarrjet e dy burrave që rrinin kokëulur dhe sup më sup si dy fajtorë shpeshtoheshin po ashtu, shpejt, shpejt, shpejt. Pastaj si një klopsidër e pandikueshme nga kurrfarë emocioni në fytyrë të dheut, një rrigë akulli diku në pullaz apo në ndonjë degë peme filloi të shkrinte duke i lëshuar pikat me një tingull të butë dhe plot jehonë mbi një copë dërrasë që njëra nga vajzat e kishte vënë rrëzë dritares për të kapur zogj.

Shtjefni i futi lekët në xhep.

— Ti ndoshta e ke të vështirë të më falësh për shkak të Adrianit, — tha nëpër dhembë. — Por... Adriani nuk hap gojë.

— Përse nuk e hap gojën Adriani?

— Ashtu është një punë...

— Adriani është djalë i ndershëm.

— I ndershëm! Kush tha se nuk është i ndershëm? Por i ka rënë sqepi në mjalte se, pse ta fusë në pleh nesër?

— Gënjen! — tha Skëndëri. — Ai nuk mund t'i pranojë lekët.

— Jo lekë, mor burrë, — nxitoi të shpjegohej Shtjefni, — askush s'i ka dhënë lekë, ai do të paguajë lekë... Skëndëri ngriti supet i habitur.

— Nuk të kuptoj! — tha.

— Në jetë ka gjëra më të shtrenjta se një thes misër!

— Ka. Por njeriu i drejtë nuk bën llogari të tilla!

— Njeriu i drejtë? A nuk tingëllojnë pak të vjetëruara këto fjalë?

Skëndëri shtrëngoi dorezën e derës. Ftohtësia e hekurit iu përshkua në trup dhe flokët e tij u ngurtësuan si fije teli.

— Ik, o Shtjefën, ik se më lodhe! Ik se më çmënde... Nuk duroj dot më...

Ishte dëshpëruar.

Shtjefni mori djalin e vogël për dore — fishekun e fundit që s'kishte patur nevojë ta shtënte — dhe krisi e iku nëpër borë. Sandalet e fëmijës linin drapa ca gjurme që të kepusnin spirvan.

— Kush ishte babi, kush ishte? — po thoshte vajza e vogël, duke iu mbëshijellë nëpër kembë. Zëri i saj sikur i përshkohej brinjëve dhe i ndalej mu në zemër. Gjithçka ndalej në zemër: edhe flakët e zjarrit, dhe sytë e Adiles, edhe pjatat e lara... Gjithçka.

Ai doli nga shtëpia që të takonte Adriani. E gjeti me sy në oborrin e shkollës tek çante shpinëkërrusur nëpër breshërnë e topave të borës që vajzat ia hidhnin nga të gjitha anët. E qëllonin si të dehura, në krahëror dhe në kokë.

Adriani i buzëqeshi Skënder Abdylit dhe ngriti duart përpjetë. Por nuk qe nevoja të dorëzohej. Vajzat e lanë lojën si me urdhër dhe vështruan nga rruga. Atje, Vlash Keqi ecte dhe fliste me zë të lartë, duke ngulur e shkukur në dëborë një hu të madh. Po përhapte gjithandej lajmin e pikëlluar se kryetari ishte gdhirë me temperaturë. «E gërmuan xhakonjtë, hë mos pafshin dritë kurrë ishallah... Dridhej si thupra në ujë. As rripin e pantollonave nuk e mbërthente dot. E kush? Gaspër Matrizi! Gjithë jetën kuadër, gjithë jetën në drejtim...». Huri që mbante në duar vringëllonte midis bluashkave të borës si kërcënim.

— Ngrihuni, more katundarë dhe mbroni kryetarin tuaj! — thirri pafuqishëm Vlash Keqi. Një thirravajë e thekshme gruaje dhe një krisëm pushke pasuan këtë kushtrim. Lena Përgjoka u pa në kopësht me shaminë e gremisur në fytyrë, ndërsa brigadier Palushi qe ngulur me këmbët e hapura në shkallaret e jashtme të zyrave. Po i merrte erë barotit të mauzërit.

— Duan të na prekin, — tha Agetina Suli.

— Të na prekin dhe të na trembin, — tha Artan Boci.

— Si s'u vjen zor! — shtoi Agetina. Loja ishte prishur. Vajzat e djemtë po largoheshin nga oborri. Pei-

sazhi shkumbues i borës sikur kallkanosej nga ftoma dhe Adriani ndjeu një therje ulëritëse në shpirt.

Mërzinë e tij e shtonte vështrimi ngulmues i Skënder Abdylit. Ca shkëndija rebele dilnin nga bebëzat e tjetrit dhe i nguleshin drejt e në zemër.

— Shtjefni tha se ty të ka rënë sqepi në mjaltë, — tha Skënderi kokulur.

Ata u mbështetën pas trungut të një plepi dhe Adriani i tregoi fill e për pe për Liljanën.

— Kam kujtuar se marrëdhëniet e mia me të nuk i di njeri. — vazhdoi Adriani, — por ja që nuk qenka kështu. Shtjefni i ditka. Prandaj kujton ai se unë do të hesht.

Për Skënderin gjithçka tani ishte e qartë. Merrte frymë i lehtësuar, kishte gjetur mikun e paprishur. Një herë e një kohë Ndue Margjoni kishte thënë në mënyrë alegorike se në Barbullojë fryn shumë erë dhe është vështirë të rrih drejt. «Adriani rri drejt», po është vështirë të rrih drejt. Sakaq në fytyrën e tij katoshte me vete Skënderi. Sakaq në fytyrën e tij kaloi me rrëmbim një pyetje që e bëri me turp: qysh do të prishej Adriani me njerëzit e Liljanës për një thes misër? I shkreti djalë në ç'pozitë të keqe ishte vënë! Dhe ky, për të mos zhgënjyer (ah, vetëm për të mos e zhgënjyer!) po i merrte në sy të gjitha pasojat.

— Ta falim! — tha nëpër dhëmbë Skënderi.

Adriani e kovri me mospërfillje.

— Gjërat mjaft ianë të ngatërruara, s'kemi përse t'i ngatërronim më tej. Po giej Kolë Kunorën dhe po e mbyllim këtë punë. — tha Skënderi.

Ai zuri të largohej duke hapur me këmbë një vazhdë të thellë nëpër borë. Adriani e ndoqi me sy derisa humbi në rrugicat mes shtëpive, pastaj u nis edhe vetë drejt shkollës mos shihte gjëkund Liljanën. E merrte me mend se vajzës nuk do t'i bënte përshtypje të vecantë giesti i xhaxhait. Si ishte bërë ajo kohët e fundit, s'ishte cudi t'ia plaste gazit.

Loja me topa bore kishte rifilluar prapa shkollës. Desaret Leci trishtonte përnjëmend që vajzat e trajtonin

si rob-lufte. Makare ta kishin lidhur me diçka! I kalonin të hunda pa ia lëshuar sytë.

Pak më tej, Artan Boci i priste gjylet e borës në këmbë, me gjoksin e nxjerrë përpara dhe sytë e ngulur në një pikë. I qante mendjen se njëra nga vajzat që shtinin papushim mbi të ishte mashkull i maskuar me roboa femre. Artani u afrua drejt saj si një kreshnik i blinduar, çakarriti sytë sapo njohu fytyrën me pikla bojë kafe të Nin Arrës, zgjati krahun si vetëtimë dhe ia hoqi shaminë nga koka. Pastaj duke sharë me çfarë i vinte nëpër mend, e rrëzoi mbi borë dhe ia hoqi edhe fustanin nga këmbët. Vajzat u stepën. Të ndezura nga loja, ato nuk e kishin vënë re tepdilin Nin Arra, që po ikte me vrap duke ulërirë si kalinë.

— Hi, hi, hi! — u zgërdhi dikush fare pranë Adrianit. Ky ktheu kokën. Aleks Balsha ishte futur në zgavrën e një ulliri të vjetër dhe vëzhgonte lojën.

— E ke parë Liljana Simonin? — e pyeti Adriani. — Para një ore, — tha Aleks. — Po shkonin bashkë me Donika Shtjefnin andej... nga Drandja e Madhe.

Adrianin e trënditi ky lajm. Ç'punë ka ajo të Drandja e madhe? — thirrri me vete dhe gjaku iu ndez. Drandja e madhe, sipas tij, ishte sajuar për të ndenjúr më djem me burra, për jo me vajza të reja. Vajzat e reja që josheshin pas Drandes nuk i kishin mirë punët. Kundër vullnetit e përfytyroi Liljanën duke pirë duhan në dhomën e errët të lahutares. Portreti i vajzës me flokët e prishur, me vulën e një urie duhani në fytyrë, me sytë e hallakatur që vështrojnë gjithkund dhe s'shohin asgjë, ia ngriti leshrat përpjetë.

Ai u lëshua gati me vrap në drejtim të veriperëndimit, andej nga ishte shtëpia e vetmuar e lahutares. Në rrugën e mbuluar me borë dalloheshin shkoqur gjurmat e vajzave. Të dyja mbanin galloshe, kështu që nuk kuptohej cilat ishin gjurmat e Liljanës dhe cilat të Donikës. Për herë të parë e pa në një dritë tjetër shoqërinë e tyre. Lidhja e tyre bazohej te sekretet vajzëror i konsumuar para kohe, pra te fati i njëjtë. Por ato nuk kanë fat të njëjtë, po thoshte me vete. Ai s'do

të ndiqte shembullin e Ludovikut për t'u martuar në Stom apo tjetërkund. Ai nuk do ta braktiste Liljanën dhe kjo s'kishte asnjë arsye të bënte gjeste prej lëneshë.

Shtëpia përdhese e lahutares, ishte mbuluar me borë. Përqark nuk pipëtinte asgjë. Ai eci pa kujdes përpara dhe sakaq, dëgjoi ca të qeshura të zgjatura atje brënda. Diçka i sëmboi në gjoks. Liljana po qeshte, po qeshte me gjithë shpirt. Kërshëria për të mësuar përse po qeshte ajo e shtyu të ngadalësonte hapat dhe të mbante vesh çfarë bisedohej brenda. S'dëgjohej asnjë fjalë, madje atij iu bë se atje nuk llafosej, vetëm qeshej. Për një çast deshi të futej brenda me furi dhe t'ua priste të qeshurën në mes.

Stop! Kaloni këndej ju vajza të reja! Kurse ti, rri atje në shenjtinë tënde, o grua plakë. Ti e di se diçka e keqe ka ndodhur në këtë botë, një mëkat i madh është kryer dhe ka pak shpresa për t'u shkimbur, prandaj dy nuse të pamartuara kanë ardhur tek ti për të parë se si jetohet dhe a mund të jetohet këndej...

Tingulli i përvajshëm i lahutës e çarmatosi. Ai u mbështet pa fuqi pas shtalkës së derës. Një zë i vjetër u ngrit si me çikrik nga thellësitë letargjike të epokave, një zë që shkundte në rrugë e sipër ndryshkun dhe pluhurin dhe kullohej vazhdimisht derisa kumboi mrekullisht në pallatin magjik të kujtesave.

Adriani u çudit. Fjalët e këngës i përshkoheshin në kokë si gjëra. Zogj, pula, flokë, ujë, lot, fytyra të bardha vajzash... Po i çon zogjt tuj fluturue/ Fluturim po i çon përpjetë/ Për një punë hatri m'ka mbetë/ Kam qenë sëmure kam dashë me dekë/ S'erdhe një natë djalë për me pvetë/ S'erdhe një natë djalë për me fjetë/ Ta kisha ndie zanin sall ka flet/ Dhimbja e shtatit mu kish hek.

Ai deshi të qante, por ngashërimet i mbetën në grykë dhe filloi të dridhej. Dikush në arat me borë përtej, po thërriste emrin e tij. Krejt hapsira e ngrirë si qelq përgatitej të kriste prej thirrjeve: Adrian Miraj! Adrian Miraj! Adrian Miraj!

Ai u tërhoq pa zhurmë dhe kur dy-tri minuta më

vonë Vlash Keqi që po e kërkonte i tha të paraqitej menjëherë në kryesi, pothuajse e dinte këtë gjë.

Sheshi para zyrave ishte i shkretë, s'pipëtinte zë njeriu kërkund, si t'i kishte tharë dimri të gjithë. Një xhips i zi në rrugë ngjante i braktisur. Adrian Miraj trokiti me ndrojtje në derën e zyrës së kryetarit. Nuk iu përgjegj njeri dhe ai krejt i qetë dhe i pashqetësuar për atë që parashikonte të shihte brenda, e shtyu derën. Tre policë, komandanti i batalionit dhe nja shtatë civilë rrinin në këmbë prapa karrigeve rreth e përçark tryezës. Ndër ta brigadier Palushi dhe Festim Ndoja e kallzonin hapur vuajtjen që nuk ishin veshur me uniformë ushtarake. Ata përpiqeshin ta plotësonin këtë mangësi me anë të shikimeve luftarake dhe kërcënuese që i lëshonin pa mëshirë mbi trupat e urryer të Shtjefën Simonit dhe Skënder Abdylit.

Nga fytyrat e skuqura, por të shlodhura të civilëve, kuptohej se ata pothuajse kishin mbaruar punë. U kishte mbetur vetëm diçka e vogël për të sqaruar. Dhe këtë detyrë, një civil me flokët që i ngriheshin si brirë në qoshet e ballit, ia ngarkoi komandantit të batalionit. Ky mori vrull sikur do të ulërinte, dhe i klithi Adriani në fytyrë:

— Ka vjedhur misër Shtjefën Simoni?

Adriani fshiu çurgat e pështymës së oficerit dhe vëstroi në drejtim të Skënder Abdylit. Ky i kishte ngulur sytë si gozhdë mbi çimenton e dyshemesë, një përcmim dhe një mospërfillje e madhe i qe vulosur në fytyrë.

— Ka vjedhur apo jo? — klithi akoma më fort komandanti i batalionit ndërkohë që brigadier Palushi shkuli nga xhepi i prapmë i pantallonave një bllok të vogël të cilin e çeli mu sikur mbushte revolen.

— Ne... i dimë të gjitha... të gjitha, — tha me zë të drithëruar, duke e kqyrur tjetrin nën vetulla.

— Shih more si rrin biri i bushtës! — i tha civilit me flokë si brirë Vlash Keqi. — Me demek na bën karshillëk! Këta more, këta duan ta rrëzojnë pushtetin popullor!

— Pushteti popullor u thyen brinjët! — tha brigadier Palushi.

— Ashtu! — tha Novruz Begolli.

Civili me flokët si brirë dhe me vetullat kaleshe u përtyp sikur po bluante dyshimet e fundit. Një goditje ishte e nevojshme në Barbullojë. Në atë katund kishte kohë që nuk ishte dhënë goditje.

— A ka vjedhur ky? — e pyeti Adrianin për Shtjefnin.

— Po, ka vjedhur, — u përgjigj Adriani me fytyrë nga Skënder Abdylit. Sytë e këtij të fundit sikur u shkulën me zor nga dyshemeja dhe e panë me trishtim.

— Mjafton, — tha civili me flokët si brirë. Ai nxori shaminë nga xhepi dhe u kërrit mbi të për të pastruar zërin. Si u çlirua nga grykët e nga hunda, teksa paloste me kujdes shaminë që të mos i derdheshin në tokë sekrecionet, tha:

— Ju të dy, në emër të popullit, jeni të arrestuar!

Pa e mbaruar frazën shefi, policët nxorën prangat nga çantat dhe i lidhën dy të pandehurit.

— Kurse ti djalosh, — vazhdoi civili me flokët si brirë, duke iu kthyer Adrianit; — bëj kujdes! Bëj kujdes dhe puno për ngritjen ideologjike në do të shohësh ditë të bardha. Kaq të them unë! — ai mori një çantë të madhe nga tryeza dhe u nis i pari. Të tjerët e ndoqën si një eskortë.

— Çfarë bëni kështu? — u thirri nga prapa Adrianit. Sytë e tij të terratisur nga dëshpërimi dhe dobësia u vërtitën si gogla.

Skënder Abdylit i shpif një gaz i keq pa ngjyrë dhe pa shpirt sikur i nxirrte nga grykët ato gogla që kishte në sy Adrian Miraj.

* * *

Pasdreke qielli u hap. Në fund të horizontit shndriti një diell i zbehtë, por temperatura ra edhe më dhe bora filloi të ngrinte. Me një orë ditë në sheshin para hotelklubit ndaloi autobuzi i Stomit. Nja njëzet djem e vajza me kitarra, fizarmonika e magnetofonë nëpër duar zbritën njëri pas tjetrit. Ata mënjanonin supet te dera e autobuzit, përkulnin kokat me hijeshi, hidheshin lehtë mbi borë, kundronin disa sekonda peizazhin përreth, shkëmbejnë ndonjë fjalë pa rëndësi dhe futeshin në hotelklub. Një bjond i veshur me xhinse qëndroi prapa shokëve dhe shkrepiti dy tre herë aparatit fotografik.

Salla e ngrënies u mbush me zhurmat dhe fjalët e mysafirëve nga Stomi. Ata gjetën brenda dy djem të imët që vështronin herë pas here me trishtim një derë përtej banakut. Pesë minuta më vonë, me një fytyrë të lodhur e të hutuar dhe me ca sy të hallakatur doli prej andej Prenga i madh. Ai eci përmes sallës si i këputur në mes. Dy imcakët i shkuan pas me ca hapa të vegjël dhe të shpejtë. Prenga i gjatë mundi të dilte në paradhomën e sallës së ngrënies dhe aty u shemb në një karrige kashte duke mërmëritur «shtriga», «kafsha», «dosa», «Shkoni, shkoni edhe ju! Do të kënaqeni!» u tha me shpirt ndër dhëmbë dy imcakëve. Me një lëvizje të vrullshme të dorës ai zbuloi klavikulën e majtë ku skuqte shenja e një kafshimi dhëmbësh. Pastaj, i neveritur me vetveten, zbuloi një pjesë të shpatullës së djathtë ku dhëmbët e zonjës së lokalit kishin lënë shenja të tjera:

Ashtu, i sakatuar nga epshi i gruas, ai bëri të ngrihej, por e lanë forcat. Lëshoi krahët dhe u shkreh. Të heshtur dhe të ngrysur si nata dy imcakët e ngritën me rrëmbim nga karriga dhe e çuan në shtëpi.

Mysafirët nga Stomi nuk vunë re asgjë. Ata akor-

donin kitarrat, provonin magnetofonët, jepnin mëndime si të vendosnin tryezat për ta hapur sa më shumë sheshin e vallzimit.

Lajmi për suarenë e stomionëve mu në zemër të Barbullojës u përhap me shpejtësi, sikurse lajmi tjetër për arrestimin e dy fshatarëve. Bënte ftohtë, dallgët dhe supet e borës kishin ngrirë dhe peizazhi ngjante shkëmbor, i vdekur prej shekujsh. Derisa ra mbrëmja në gjithë Barbullojën mbretëroi një heshtje e thellë, po të mos llogaritet serenata e mysafirëve në hotelklub. I pari që u bë i gjallë në rrugë ishte Ndue Margjoni. Duke u lëkundur mbi hapat e vet të shtrembër, ai u afrua drejt «Ngjalës» për të pyetur për të birin, Ludovikun. I thanë se ishte mirë, se e kishin lutur të vinte me ta, por ai kishte parapëlqyer të rrinte me grupin kryesor që festonte po atë mbrëmje në Stom.

Kur u err krejt, nga të katër anët u panë të afrosheshin drejt «Ngjalës» silueta të veçuara njerëzish. Mbështeteshin te dritaret, vinin kokat në xhama dhe përpiqeshin të shihnin nëpër të çarat e perdeve ç'bëhej atje brenda. Pastaj largoheshin për t'u lënë radhë të tjerëve.

Rreth orës njëzet e dy banakierja rronkoke e hotelklubit kaloi duke buzëqeshur mospërmes sallës që gëlonte nga vallëzuesit. Meqenëse Prenga ishte pa qejf, e kishte marrë vetë përsipër detyrën e kamariere. Në fytyrën e saj si në një klepsidër që mbushet pikonte kënaqësia e dehjes së ngadalëshme të mysafirëve. Dikush e kishte thirrur përjashta dhe ajo po llogariste me mend fitimet. Sa doli në errësirë katër pesë duar u zgjatën si tentakula, e mbërthyen për flokësh, për fustani, për gjoksi e për zverku, e hoqën, zvarrë dhe zunë ta qëllonin me shqelma dhe me grushta. Ajo mundi të lëshonte ca ulërime të tërbuara, por mysafirët brenda, të ardhur në qejf nga muzika, vera dhe vallëzimi, nuk dëgjuan gjë. Përpëlitej në dëborë si kallëzim me qëllim që t'u shpëtonte goditjeve, thërriste,

lutej, premtonte para, ushqime, pije, veshje, por as lutjet, as premtimet nuk i zbusnin mizorët e panjohur që e godisnin papushim dhe si të ndërkyer.

Më në fund atë zunë ta linin fuqitë, zëri iu mek, sytë i digjnin si shkrumb, brinjët i ndjente të shkallmuara, kokën të rëndë dhe jashtëzakonisht të madhe. Nuk mendonte dot asgjë, lëshonte ca cingërima të mbytura dhe luste perëndinë që tmerri të ndalej. Dhe vërtetë, tre katër sekonda më pas, siç ishte e kruspullosur dhe e mpirë në dëborë, ajo e kuptoi se nuk po e godisnin më. Përmblodhi të gjitha fuqitë të ngrinte kokën për të njohur së paku njërin prej atyre jere-mitëve të pashpirt të natës. Por nuk mundi t'i lëvizte qepallat. Në kokë iu përshkua një mendim i tmerrshëm sikur nuk i kishte më sytë, ngriti dorën me vrull t'i prekte. Ah, sytë ishin, ishin thellë guvave të enjtura dhe të përgjakura.

Mendimi se e kishin shfytyruar e dëshpëroi shumë. Duke duruar dhimbjet e panumërta, bëri një përpjekje të mundimshme të ngrihej, por në çast u kruspullosoi përsëri nga tmerri: Ajrin e bruztë të natës e çanë ca fërfëllima gurësh që u përplasën me rropamë në xhamat e dritareve. Muzika dhe zhurmat brenda lokalit pushuan në çast.

Të nesërmen Desaret Leci dëshmoi se atje s'bëhej asgjë e keqe. Hahej, pihej, vallëzohej dhe këndohej. Ai u betua në kokën e sëmës se para se të largohej nga dritaret xhamat ishin në rregull. Po kush e rrahu Terezën? Kush i theu xhamat? Këto nuk u morën vesh për shumë kohë, siç nuk u mor vesh kush e vendosi në hyrje të fshatit një tabelë llamarine ku ishte shkruar me shkumës: Jo vizitorë!

KAPITULLI I NJËZETË

Traga e përdredhur e makinës së policisë mbeti si vizatim zinxhirësh mbi kallkanin e borës. Moti i ftohtë shumë vonoi ta shkrinte atë kujtim të keq që netëve, nën ndriçimin e zbehtë të hënës, dukej dyfish kërcënues. Dhe jeta që tërhequr nga rruga kryesore, disa ditë me radhë nuk shkeli njeri atje, me përjashtim të Adiles, e cila, të nesërmen e arrestimit të burrit, i pat ndjekur deri në njëfarë vendi shenjat e dhëmbëzuara të rrotave. Mandej atë e patën lënë fuqitë dhe që rrëzuar përtokë. Ajo kishte kujtuar se do të ngrinte në mes të rrugës, e pa vënë re prej kurkujt, ose e përburzur prej katundit si gruaja e tradhëtarit, por dy djem të rinj, Adrian Miraj dhe Ferdinandi, që kushedi pse përgjonin me ankth gjithë ditën rrugën dhe fushat e vdekura, i patën shkuar në ndihmë, duke marrë në sy me një gëzim të egër rreziqet e mundshme. Dhe vërtetë: po atë mbrëmje i kërkuan në kryesi.

Ata u morën vesh t'ia mbathnin nga Barbulloja. Deri sa ra nata qëndruan të fshehur në shpellën e vjetër të Kajanit mbi fshat. Kur i plotfuqishmi i zonës, komandanti i batalionit dhe brigadier Palushi, dërguan përsëri korrierë për t'i thirrur, ata të dy ecnin njëri pas tjetrit mbi dëborën e kodrave.

Ata i dëgjuan të shtënat e armëve në fshat. E merrnin me mend si turfullonin shokët kryesorë atje, si

rëzohej sipër akujve Vlash Keqi duke bërtitur «alarm», si rënkonte doreza e telefonit në duart nevrastenike të komandantit të batalionit, teksa urdhëronte brigadier Palushin të përforcoheshin rojet pranë depos së armatimit dhe të shpallej kërkimi i «të pandehurve». Por ata ishin larguar mjaft dhe, përveç kësaj, e dinin se pakush në Barbullojë i përgjigjej atij kushtrimi.

Ishte mesnatë kur iu afruam periferisë së qytetit. Nën dritën e neoneve, shkretimi atje dukej më i rëndë.

Ata qëndruan një copë herë pa folur përballë atij peizazhi steril, të braktisur kahmot prej ëndërrimeve. Nuk bënte dhe aq ftohtë në qytet, ata vendosën ta prisnin mëngjesin në hollin e hotelit, por Adriani u kujtua për telefonin e Barbullojës. Ndofta linja kishte funksionuar dhe Qendra ishte vënë në dijeni për largimin e tyre në drejtim të panjohur. Nuk përjashtohej mundësia që qendra ta merrte seriozisht njoftimin nga Barbulloja, kështu që sa të na bllokojnë në rrajonin e policisë, gjykoj Adriani, më mirë presim trenin e mëngjesit përjashta.

Ferdinandi që në një mendje me të. Të nesërmen ata duhej të takoheshin patjetër në Tiranë me shokun Mitro. Ky ishte i vetmi shans për të shpëtuar Skënderin dhe veten e tyre, pra kapja e trenit të mëngjesit pa e komplikuar punën meritonte çdo sakrificë.

Fati nuk i la të vuanin shumë. Ndërsa vejevinin lart e poshtë për të ngrohur këmbët që u mbërthinin, prapa magazinave të fabrikës së sodës gjetën një kolibe të vogël me një plak të armatosur brenda. Plaku i priti buzëqeshur, u bëri vend në stolin e gjatë afër sobës që brombullinte nga flakët e zjarrit, i mbajti me muhabet, mađje i la të loznin edhe me pushkën. Drejtësi s'ka, por njerëz të mirë po, mendoi me vete Adriani në të zbardhur tek po ndaheshin si miq të vjetër me plakun.

Morën trenin dhe aty afër drekës, pasi kaluan në-

për një oborr të madh si kopësht, plot me limonë e kaj-sia, trokitën në shtëpinë e Mitros. Derën ua çeli një grua e re, shumë e bukur, por edhe e përzemërt. Ata deshën të përparonin, por vështrimi i rreptë i gruas i ndalo-i në vend. Merrej vesh se i kishte ardhur shpirti në majë të hundës me popullaritetin e vjehrrit. Ajo shkoi ta lajmëronte për vizitën e dy djemve nga «malësia», por nuk u kthye më për t'u thënë urdhëroni. Zëri i veshur i Mitros buçiti që nga kuzhina: Ejani, mor trima! Si në shtëpinë tuaj!

Siç ishte me pizhama, la librin mbi kanapenë ku qe shtrirë dhe nxitoi t'u dilte përpara mysafirëve. Kishte kaluar një grip të vërtetë, thashë se e ndëra këmbën, tha, por laydi zotit e hodha edhe kësaj radhe. Nuk desha të vdes pa dalë në Shëngjergj! Tani jam mbyllur këtu si kërcëp i zi! Ç'të bëj? E kaloj me lexime... Oh, sa më gëzuar zemrën që kaluat njëherë kënde! Ja për këtë është mëkat të vdesësh... Se vjen dikush e të kërkon...

Ai po fliste pothuajse me vete, ndërsa kontrollonte në ca servise e kutija mos gjente diçka për të qerasur djemtë që rrinin të heshtur e të ngrirë si në kishë. Plaku buburronte me gishta nëpër kutija, kur ja, në kuzhinë u futën me zhurmë dy djem të gjatë, njëri brun dhe tjetri bjond. Bruni nuk e fshehu pakënaqësinë për vizitën e palajmëruar të fshatarëve, aq më tepër që gjyshi ishte mirë tani dhe ata vinin si kofini pas të vjelave.

— S'më lenë nipat vetëm, për nder! Kanë frikë mos më jep ndokush helm, ha, ha, ha! — tha Mitroja duke u gajasur. Pa i lënë kohë brunit të reagojë, u kthye nga mysafirët: — Pa hë, ç'thotë Barbulloja?

Adriani dhe Ferdinandi shikuan njëri-tjetrin, por nuk folën.

— Me halle, po! — vazhdoi Mitroja. Ferdinandi po-hoi, me kokë.

— Kanë arrestuar Skëndër Abdylin... nëse të kuj-

tohet, — tha Adriani. Mitroja ngrii vetullat lart në shenjë habie. Lajmi e tronditi me të vërtetë, ai nuk mundi ta përballonte në këmbë, prandaj vajti dhe u ul në kanape.

— Përse e arrestuan? — pyeti nervoz djaloshi flokëverdhe, duke vështruar me një farë përcmimi plakun e gjorë.

— Ore, do ta mbyllësh gojën ti? — iu gërmush bruni.

— Desha t'i kujtoj gjyshit se rendimenti i lartë i arrestimeve nuk po e ngre mirëqenien e popullit, — tha bjondi.

— Mbylle se të nxora me shqelma! — briti bruni. — Në mos po lajmëroj policinë të të hedhin hekurat në vend!

Bjondi u lëndua nga sjellja prej harbuti e kushërrit. Buzët e holla i dridheshin nga inati, ndërsa kërkonte mbështetjen e dy djelmoshave nga fshati duke i kqyrur me ngulm sikur u thoshte «thashë ndonjë gjë të keqe, thashë ndonjë gjë që nuk shkon?». Por ata, të fshehur prapa mërzisë së tyre, dukeshin krejt të pakuptueshëm. Atëherë bjondi krisi e iku sa të thojë ti kurrë më do të shkelte në atë shtëpi. Bruni i vajti pas. Kushedi, ndofta do ta vazhdonin grindjen në ndonjë dhomë tjetër.

— Më hëngrën shpirtin! — shkrofëtiu Mitroja që e kishte humbur fare. Ai i mbante sytë në një pikë, diku poshtë njëres prej lingotave ku ishte kapur shtiza e perdes. U shtri me përtesë në kanape, u mbulua me kuvertë dhe sakaq u kujtua se nuk ishte mirë të sillej ashtu. U zbulua përsëri dhe zgjati një heshtje e keqe që bëri të spikaste më shumë vuajtja e plakut. Ai nuk u përpoq asnjë grimë ta fshihte vuajtjen. Le të bezdiseshin mysafirët, le të mendonin çfarë të donin ai nuk kishte fuqi të hiqej tjetër për tjetër.

Mandej, papritur e pakujtuar, në sytë dhe në fytyrën e tij shndriti ajo që Adrian Miraj e quajti më vo-

në «kapje e momentit». Brofi nga kanapeja, u ngjall dhe u nervozua siç e kishin zakon njerëzit e serës së tij, u informua shpejt e shpejt sa për formë përse e kishin arrestuar Skënder Abdylin, njeriun e klasës, gurin e papërlyer, të themelit. Ishte çasti për të kallëzuar se uji buronte i kulluar atje lart, por qelbej rru-gës. Po. Po! Një kooperativist të thjeshtë e kanë lidhur me hekura! Një njeriun tonë! Dhe e kanë bërë këtë vetëm e vetëm që t'i fusin një grusht të mirë iniciativës që shpërthen nga poshtë, prirjes së njerëzve për t'i shfaqur pa frikë pikëpamjet për punën drejtuese...

Ai ia tha të gjitha këto përmes telefonit një udhëheqësi të lartë, që ndofta kishte begenisur të mbante shënim, me siguri kishte begenisur të mbante shënim! Fytyra e purpurosur e Mitros nuk mund të ngazëllehej për gjë tjetër dhe dinakëria fluide në sytë e tij kallzonte pikërisht një hesap të qëruar tashmë: Skënderi do të lirohej! Po ai nuk u ngut ta thoshte këtë. Triumfi i menjëhershëm nuk ka shije. Nuk ka asçmim të mirë.

Nuk u muar vesh kurrë a u shty me qëllim lirimi i Skënderit, apo plaku vërtetë nuk ia doli të shpërthente menjëherë labirinthin e hallkave shtetërore që kujdesen për mundimin e njeriut. Sa herë sillte ndërmenç vizitën në shtëpinë e tij. Adriani përfytyronte kordonin e telefonit që sikur fryhej vazhdimisht gjatë kohës që Mitroja bisedonte me udhëheqësin e lartë.

Sidoqoftë, kur pas shtatë ditësh të kaluara nëpër kushërinj e miq, Adriani dhe Ferdinandi u kthyen në fshat, situata kishte ndryshuar, komandanti i batalionit kishte marrë lejen e zakonshme, dëborë kishite shkërrë shumë, baltë gjeje kudo, ndërsa brigadier Palushi nuk e kallzonte më çelësin rrezervë të zyrës së kryetarit. Një mrekulli e paarsyetueshme pritej t'i jepte impulse të gjalla rrugëve dhe oborreve, ndofta telefonat kishin rënë nga lart në sensin e kundërt, do-

methënë të mos paragjykoheshin shumë ashpër fjalët në Barbullojë.

Të nesërmen Skënderi u lirua nga arresti. Vetë sho-ku Mitro, i shoqëruar nga nipi brun dhe nga shefi i policisë që mbante një buzëqeshje diskrete prej ish ministri, erdhi për të shpallur para popullit pafajësinë e bashkëfshatarit të tyre. Ai e nënvizoi ngutjen e vigjilentëve, madje mund të thuhet se edhe ua hoqi një dru, pastaj zhvilloi tezën e raportit midis syçeltësisë së shtetit dhe dashurisë së shtetit kundrejt qytetarëve, duke i dhënë më shumë vend dashurisë. Të pranishmit në atë tubim u përpoqën mjaft t'i shtinin në kokë fjalët e mençura të plakut Mitro. Këto përpjekje i paguan njëfarësoj sepse harruan të duartrokisnin. Ndofta kësaj harrese i ndihmoi edhe qëndrimi i ftohtë i Skënder Abdylit, nifullat e të cilit përcillnin në krejt fytyrën e tij ca rrahje damarësh sikur mezi përmbahej të ulërinte.

Sapo u mbyll tubimi, ai falënderoi edhe një herë me dorë në zemër shokun Mitro dhe krisi e iku me hapa të mëdhenj drejt shtëpisë. Adrian Miraj po e prishte në fund të oborrit. Nuk kishte patur fuqi të merrte pjesë në tubim, durimi i tij ishte sosur, nuk i bënte dot ballë hipokrizisë dhe cinizmit, neveria i lexohej këtu e atje, prandaj u largohej njerëzve. Por akoma më e rëndë ishte heshtja në shtëpinë e Skënderit. Nuk pipëtinte asgjë atje brenda, sikur Adilja dhe vajzat nuk e dinin se i zoti i shtëpisë po vinte me një gurgullimë lotësh në gjoks. Dhe kur ai hapi derën, vajzat u ngjeshën pas murit të trembura, pastaj ia plasën vajit dhe shtëpia sikur mori flakë nga të qarat e tyre. Nuk mësoheshin dot me kokën e qethur të babait.

E bërë dyllë në fytyrë dhe e kllaposur si t'i kishte harruar njëherë e përgjithmonë fjalët e shqipes, Adilja që mbështetur pas rrasës së oxhakut. Duart i mbante mbi bark dhe nuk lëvizte. Pas pak damarët e mavijosur të qafës filluan t'i dridheshin, ngjyra e tyre i

shpërhapej në lëkurë gjersa fytyra e saj u skuq krejt.

— Ç'ke bërë? — tha Skënderi.

— E shita atë, — tha ajo. E kishte fjalën për unazën.

Ai u kthye me vrull nga dritarja dhe shau nëpër dhëmbë, shau me hakërrim, shau me gjithë shpirt, duke ndjerë vlimin e një fuqie titanike në trup. Por bota përtej dritares ishte tepër e varfër, tepër e shurdhër dhe tepër e përbaltur për ta ndjerë atë fuqi.

KAPITULLI NJËZET E NJË

Ibëri i «Fluturimeve» ndërroi jetë. I veshur si grua, u mbeti në dorë ca djelmohave nga Burkina Faso. Fytyra e tij e vrerosur u pat përkujtuar të gjallë një anëtare të Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, e cila i kishte vizituar muaj më parë, duke u lënë mbresa të veçanta. Për këtë arsye e rrethuan me mall e britma gazmore, kape njëri për qafe, shtrëngoje tjetri për gjoksi... Dhe gëzimi i verboi dhe dashuria i çmendi dhe harruan se Ibërin mezi e mbanin këmbët. Në fillim nuk kuptuan asgjë. Vokjen e syve dhe faktin që ai merrte frymë me grahma i morën si gjeste të emocionit dhe falenderimit të thellë. Madje edhe në sekondin kur u shkurdis për fare djelmoshat e deliruar nga entuziazmi kujtuan se do t'a mbante një fjalim madhështor për ardhmërinë e tyre. Pritën me veshët ngritur duke e mbajtur mbi supë «oratorin» kokëvarur. Pastaj të lebetitur nga ideja se mos «ajo» ishte shuar, e zbritën ngadalë në tokë, e lanë pa mbështetje dhe Ibëri atëherë u shemb përdhe me fytyrë nga qielli.

Barbulloja reagoi me hidhërim për mbylljen tragjike të «Fluturimeve». Shumkujt i vinte keq që heroi i sa e sa reagimeve nëpër botë, që kishte mbushur me gaz ditë e netë të tëra, të vdiste larg vendit ku u lind dhe ca më keq në një krahinë të humbur. Sipas tyre heroi meritonte një fat më të mirë: kthimin ngadh-

njyes në Barbullojë pasi t'i vinte rrotull mbarë planetit. Nëse ishte e pamundur kjo, ani, le të vdiste diku, por ama le të vdiste si trim.

Ca gra të moshave të mesme u pikëlluan si t'u kishte humbur një libër gjeografie i lexuar përgjysëm. Me vdekjen e Ibërit sikur ishte shuar për to hapësira e panjohur e globit. Nuk ishin të pakët ata që e shihnin ndërprerjen e «Fluturimeve» si një ogur të keq. Festim Ndoja dhe Jetmir Cubi shkriheshin në gaz me frikën e tyre të pakuptimtë. Këta të dy mbronin pikpamjen se Ibërin e vranë mendjet e lodhura, skematike, kapse, madje tendencioze dhe xheloze. Nuk mungonin tipat që mbanin zi për modë, për uniformitet, sa për të thënë se edhe ne prekemi. Por pati mjaft që nuk u pajtuan menjëherë me vdekjen e Ibërit. Një delegacion të indinjuarish vajtën të vinin në dijeni Gjergj Sherrin, lexuesin e Madh. Ky ishte mbyllur si koshadhe në shtëpi, në dorë mbante një libër të trashë astronomie, sytë i kishte të lodhur me një lbyerje qiellore anash. E dëgjoji me vëmendje rrëfimin për vdekjen e Ibërit dhe në fund qeshi. Sa e papërfillshme dukej vdekja e Ibërit përballë të qeshurës së tij. Ibëri filloi jetën tjetër, tha para se të përkulej përsëri mbi librin e trashë.

Edhe Adrian Mirajn e pushtoi një gëzim i përzishëm kur mori vesh për ringjalljen e Ibërit në botën tjetër. E dinte shumë mirë se askush s'kishte vdekur, askush s'ishte ringjallur prandaj edhe gëzimi, edhe dëshpërimi i rastit ishin të rrejshëm. Megjithatë ndihej i lehtë. Ecte fushës dhe mendonte: Njeriu s'rri pa sajuar diçka. Mirëpo gjërat kanë një fund. Kur u vjen fundi, njeriu pikëllohet dhe thotë: për të zezën time i paskam krijuar.

Ai mbajti hapat prapa varrezave të vjetra dhe i nguli sytë te bërryli i qimëritit. Disa sekonda kujtoi se koka e Liljanës, e anuar paksa majtas do të shfaqej atje. Pastaj do të shfaqej krejt kurmi i saj në një rreth

ngrohtësie dhe malli. Mahi! — thirri një zë brenda tij, ndërsa u mbështet pakujdesshëm pas gurëve.

Qysh se Shtjefni u arrestua, Liljana s'kishte ardhur më për ta takuar te varrezat e vjetra.

Në të vërtetë ishte e pamundur për Liljanën t'u vidhej dy kunatave të mëdha që ishin caktuar ta ruanin. E fusnin në mes që kur dilnin nga shtëpia e derisa ktheheshin në mbrëmje. Ecnin të tria sup më sup me trupat e drejtuar panatyrshëm sikur u kishin vënë një dërrasë prapa shpinave. Adriani kujdesej të mos u binte në sy. Kishte shpresë se gjakrat do të ftoheshin, inati i parë i Simonajve do të binte, kunatave do t'u vinte keq për Liljanën, do t'u vinte turp nga vetja dhe ata të dy do të mund të takoheshin si më parë madje më lirshëm sepse ndërkohë dashuria e tyre do të ishte e njohur për të gjithë.

E çuditshme ishte sjellja e burrave të fisit të Simonajve me të. Kudo ku kishte njerëz i flisnin, i qeshnin. Adriani kishte vfarë mendjen disa herë për këtë sjellje dhe kishte arritur në përfundimin se Simonajt ose i qeshin për sytë e botës, domethënë, ti vërtetë mëre në qafë një kushëririn tonë, por ne nuk mbajmë inat, ti bërë atë që do ta bënte gjithsecili prej nesh sepse vjedhjet dënohen e tjerë e tjerë. Ose donin ta vinin në gjumë, ta shtynin në aventurë me Liljanën me qëllim që t'i thyenin nja dy a tre shkopinj në kurriz, domethënë, i lumtë që paditi Shtjefnin, ne s'hamë gjë, perkundrazi, dru i shtrembër doli Shtjefni, por të na prekë edhe në nder? Këtë nuk e duron burri!

E gjithë kjo ishte një shkak më shumë për të ndenjtur mënjandë e për të duruar.

Sa i vështirë ishte ky durim! I lodhur nga pritja boshë, u mbështet mirë pas gimitit dhe mendoi keq për Liljanën. Asaj i është ndezur gjaku i fisit dhe heshturazi më quan hajvan, palo djalë që vë një thes misër para dashurisë. Ajo më përbuz. I pëlqen të ecë

si robinë mes kunatave që edhe unë ta përcmoj, ta harroj. Po, po. Ka kohë që ajo kërkon një fund. I është mbushur mendja se s'do të jetë e lumtur me mua. E ka lëshuar veten. Prandaj shkonte te Drandja e madhe. Drandja e madhe është më e kthjellët se çupëlinat e dëshpëruara. U bën qejfin me një këngë lirike dhe u tregon udhën. Sa bujari ka në sjelljen e saj të vrazhdë. Por mendjet fyçkë të çupave nuk e kuptojnë. Janë madje të lodhura që kërkojnë vetëm t'i ngushëllosh.

Ngaqë e kishte marrë malli shumë për Liljanën, harroi ç'kishte menduar pak më parë dhe zuri t'i shkonte ngjarjet të përdhura në prizmin e mungesës së vajzës. Ideja se vetë Liljana kishte pranuar, në mos propozuar për të bredhur mes kunatave, ia ndezi gjakun keq. Ajo kishte faj. Gjithë fisi i saj kishte faj! Të poshtrit! Kërmat! Idiotët! Injorantët!

Po ti? Po ti? Po ti? Kjo pyetje vizilloi në kujtesën e tij si sinjalet e një fari në terr. Instinktivisht vuri grushtat në gjoks. Mbrëmjen e kaluar, duke çarë grumbullin e djemve në dyqanin «Artikuj të përzier», përtej një morie supesh me një shtresë mugu përsinër, kishte kapur vështrimin ngulmues të dy syve të hapur iashtë mase. Vetimthi ishte kthyer andej. Shkëlqimi i fortë i syve sikur hidhte një perde drite në fytyrën e tjetrit. Adriani ishte ngritur në majë të gishtave dhe kishte njohur Sokol Simonin, dialin e njërit prej xhaxhallarëve të Liljanës. Sokoli ishte shtatëmbëdhjetë vjeç, por tregonte akoma më i vogël. Kishte një fytyrë të pastër, të lëmuar, me një hutim të përherëshëm në pjesën midis vetullave.

Sokoli kishte vazhduar ta kqyrte drejt, pa egërsi, pa mëri. Vështrimi i tij sikur përcillte tërë hallin e Liljanës tërë sarkazmën e pasivitetit të Adrianit. Po ti, ofarë bën ti? Adriani ishte tronditur, kishte mbledhur grushtat në krahëror dhe kishte tundur kokën pavetëdiishëm. Prej meje nuk pritet asgjë! Sokoli kishte pulitur sytë sikur thoshte: Sa keq, sa keq që prej teje nuk pritet asgjë!

Vërtetë, çfarë mund të bëj unë? pyeti veten Adriani. Nuk ishte hera e parë që vriste mendjen për këtë gjë. E dinte se nuk do të merrte ndonjë vendim tjetër nga ai i mëparshmi për të pritur. Megjithatë gati pavullnetshëm mendja e tij i rreshtoi përsëri rrugët e mundshme të bashkimit me Liljanën. Rruga më e thjeshtë ishte të merrte nënën, të shkonte në shtëpinë e Ndreç Simonit dhe t'i kërkonte dorën e vajzës. Mirëpo ashtu siç kishin rrjedhur punët, kjo ishte si t'i hidhje zjarrit benzinë! Simonajt do t'i hidheshin në grykë. Shiko çfarë mistreci! Edhe na padit, edhe na kërkon krushqi! Po unë nuk kam paditur! Unë isha rastësisht atje; atë natë me... borë...

Idea e një shpjegimi për atë që kishte ndodhur vizllonte herëpashere pafuqishëm në mendjen e tij. Në të vërtetë i vinte mirë që s'e kërkonte dot Liljanën si gjithë bota. Ai nuk i pëlqente fare Simonajt. Në këto kushte nuk i mbetej rrugë tjetër veçse ta rrëmbente. Gjithnjë i kishte përbuzur martesat me rrëmbim. Ta bënte vetë tani, i dukej njëlloj si të lëpinte aty ku kishte pështyrë. E gjithë kjo megjithatë nuk ishte ndonjë pengesë kushedi se çfarë. Në fund të fundit vinte një gur në zemër dhe e bënte martesën. Pengesa kryesore ishte gjatë. S'kishte para. Martesë pa para s'mund të ketë. Martesë për martesë s'mund të ketë.

Shkurt fjala, më mirë të pres, tha me vete. Koha qetëson shumë nerva, shëron shumë plagë. Po kësaj Liljanës çfarë i kushton t'u vidhet një pasdite kunatave, makar edhe po të dijë se do ta rrahin? Sa mirë ka zënë e shkon te Drandja e madhe?

I dëshpëruar nga mungesa e vajzës, ai mendoi përsëri keq për Liljanën. Po, po. Ajo mban inat me mua, tha me vete. Ajo nuk ngrihet dot mbi marrinë e kushërinjve...

Kur pandehim se na ka harruar njeriu i dashur, egoja jonë përpëlitet, vuajmë, bjerrim sigurinë dhe arsyen, e shohim ndryshe të dashurin, e zbulojmë në ca

pika të errëta, miklohemi dhe themi: Më mirë që ndodhi kështu! Dhe presim vërshimin e limfës qetësuese në gjak. Por limfa nuk vjen dhe pas pak e kuptojmë se kemi bërë një alkimi boshe me ndjenjat.

Adriani e la pas varrezën e vjetër, e cila tani sikur i përkiste njëfarësoj edhe atij. Një si tërheqje magnetike, një si thirrje e shpresave të pashuara për të kthyer kokën... Por ai pati frikë ta kthente kokën se mos në vend të vajzës do t'i farfurinte në sy imazhi i një grumbulli me dhe të freskët. Po ne, pse takoheshim atje? tha me vete. E kisha zgjedhur si vend të qetë, të fshehur nga syri i botës. Syri i botës... Ha, ha! Syri i botës, syri i Shtjefnit!

«Njatjetaaaa! Njatjetaaaaa!» ia bënte dikush nga krahu tjetër i rrugës. Desaret Leci po vraponte midis hurmave në vijë të drejtë me të.

Adriani kapërceu pasarelën mbi kanalin vaditës dhe doli në rrugën e asfaltuar para hotelklubit «Ngjala». Nga malet përkarshi zbriste një muzg i ngadalshëm. Toka dhe qielli dukeshin shterpë. Kishte përshtypjen se nata nuk do të arrinte kurrë.

Në hotelklub nuk pipëtinte njeri. Qysh se e patën rrahur në errësirë, Tereza e mbyllte banakun sa perëndonte dielli, me përjashtim të rasteve të veçanta kur kishte vizitorë.

Djemtë e rinj tani mblidheshin zakonisht para dyqanit «Artikuj të përzier» ose te berberi. Adriani i vu ri re nga larg, por nuk kishte asnjë dëshirë të bashkohej me ta. U nis drejt shtëpisë për të vazhduar leximin e një libri që ishte shkruar në heshtimin e pruar të dhomës, siç thoshte autori. Ideja se në shtëpi e priste ai libër e mbushi me gëzim. Çfarë mrekullie! Unë mund të lexoj çdo mbrëmje, tha me vete. Mjaft me endje të kota lart e poshtë! Mjaft me dilema, dialogë, monologë, vrasje mendjeje! Mjaft! Mjaft!

Dikush po vraponte në rrugë prapa tij, por ai nuk e ktheu kokën... I ndritte shpirti atij që shpiku librin

së pari... Hapat prapa ngadalësuan shpejtësinë, ai ndjeu frymëmarrjen e dikujt, pastaj prapa kurrizit të tij u nder një heshtje e thellë sikur në rrugë kishte vrapuar një hije që tani ishte tretur në efir.

U kthye i tëri me vrull dhe u step. Sytë e Liljanës shndrisnin në gjysmëterr si milá. Ishte veshur shumë hollë për stinën, një fund veror, një bluzë pambuku dhe kaq. Adriani e vështroi një copë herë pa menduar asgjë. Ajo iu duk më e vogël se më parë. Në fytyrën e saj të hequr me një tendosje kapriçioze të lëkurës, lexohej malli, ngutja dhe pakënaqësia.

— Ty të ruajnë, — tha Adriani si për t'u shfajësuar, — dhe unë kam pasur frikë mos e pëson po të shihemi bashkë.

Liljana shtrëngoi dhëmbët fort dhe u gëlltit. Fjalët që kishte ndërmend sikur kërkonin prej kohësh një ritëm tjetër për t'u thënë. Ishin shumë fjalë dhe ajo nuk mund të rrinte gjatë. Zemërgjerë ky Adriani, mendoi. Më fshihet që të mos pësoj gjë! A nuk e kupton ai se kështu e pësoj më keq?

— Më kanë rrahur! — tha. Shtjefni i tha baba! se i kam bërë të gjitha me ty, se po të mos i kisha bërë të gjitha me ty, ti nuk do të thoshje... Po kjo s'është asgjë, nuk erdha për këtë... — thirri Liljana dhe fryma në krahëror sikur iu sos. — Ata... është e paimagjinueshme Adí! Ata bënë mbledhje natën vonë. Tërë burrat e fisit! Ata kishin kryesinë dhe kryetarin! Ata e shkarkuan babanë tim si kryetar... Ata morën vendim të silleshin mirë me ty. Dhe heshtën. Unë nuk i shihja. Vetëm i dëgjoja... Pastaj ata vendosën të më martonin në Stom, dikush më paska kërkuar atje para ca kohësh... Më hynë të dridhurat. Kisha përshtypjen se matanë murit bënin mbledhje ca pleq të vdekur qyshkur. Më dukej vetja njëqind vjeçe, dyqind vjeçe. Kujtoja se gjatë gjithë shekullit tim s'kishte ndodhur asgjë e re që të ndryshonte diçka në thelbin e jetës Kupton?

Adriani dëgjonte krejt i habitur, ndërsa ndjente zmadhimin e pandërprerë të një kobi që i lidhej në grykë. Sakaq mori kokën në grushta dhe e kapën të dridhurat. Liljanës iu shpif një gaz i keq, zmaliti i dhëmbëve të saj zbuluar panatyrshëm viziloi si rreze drite në terr.

— Mjaft tani, — u lut Liljana. — Nuk të duroj dot kështu?

— E ç'të bëj sipas teje, të qesh?

— Ti e di ç'duhet të bësh!

— E di. E kam marrë me mend: ty të pëlqen vep-
rimi, megjithëse s'je dukur më te varrezat!

— Nuk vij më atje!

— S'të lenë kunatat?

— S'dua vetë... Dhe mos më kërko të vi atje e kë-
tu, — e ngriti zërin Liljana. — Mos më kërko se më
vjen të pështrë.

— Ja, kjo është një nga ato skenat që ty s'të pël-
qejnë, — tha Adriani.

— Kjo s'është skenë, — tha ajo.

— S'është kaq e thjeshtë, — mërmëriti Adriani,

Ata nuk e shihnin më njëri tjetrin për shkak të
errësirës. Liljana u kthye papritur dhe zuri të ikte
duke nënqeshur e duke shqiptuar nëpër dhëmbë «më
ke pas thënë një ditë se do të vije me kalë si heronj-
të e mesjetës». Adriani e arriti me vrap.

— Të durojmë, — i tha vajzës te veshi. — Kjo
është gjëja më e mençur që mund të bëjmë tani për
tani. Koha do t'i rregullojë të gjitha, koha...

— Ty të thotë mendja se unë s'duroj dot? Në qof-
të se mendon kështu, e ke shumë gabim!

— S'ka lezet të martohemi tani, — vazhdoi Adria-
ni në të tijën. — Të dalë vera njëherë, të shpërthejë
gjethi. Të...

— Të çlirohet Shqipëria... Të zbarkojnë aleatët! —
e plotësoi Liljana me ironi.

Ajo ia hoqi dorën nga krahu, u mendua një hop, u mbush me frymë dhe tha:

— Kthehu Adrian, mjaft më përcolle!

Toni i saj ishte më i rëndë se urdhëri. Se si i vinte për Adrianin. A i kishte veshët në vend ai? A më dëgjoi çfarë i thashë? A e mori vesh se duan të më martojnë në Stom? Ajo po largohej dhe ai zvogëlohej vazhdimisht në errësirë. I erdhi mirë që ai zvogëlohej. Së paku kështu zvogëlohej edhe vuajtja e saj.

— Natën e mirë, — tha dhe iku me vrap.

Adriani e ndoqi disa sekonda me ca sy si të fjetur. Kundër vullnetit, me një këmbëngulje mizore, i përfytyrohej mbledhja e kryesisë së fisit të Simbonajve. Pothuajse e kishte marrë me mend diçka të tillë. Ajo banesa e llahtarshme, ato gra të heshtura, ata burra të mbyllur në jetën e tyre... E kishte parandjerë se brenda atyre kutizave që quheshin dhoma punonte një mekanizëm i vjetër, i mykur-mbeturinë e një kohe të lashtë plot pabesira dhe mosbesim kur fisi organizohej si një shtet i vogël.

Mendja i vinte vërdallë dhe po ashtu edhe dritat e katundit, edhe ca yje të zbehtë në qiell vinin vërdallë. U fut në një oborr, trokiti në një derë dhe pritë. Lart në shtalkë u ndez llampa elektrike; ai sikur u zu beft nën kërpu dhën e dritës. Kërciti llozi, dera u hap. Fytyra e Skënder Abdylit në prag. Eja Adrian! Jo, jo, ai nuk kishte ndër mend të hynte brenda, kishte ardhur sa për një fjalë në këmbë.

— S'është ndonjë gjë urgjente, madje kot ta thash. Po kaloja këtej dhe, nuk i bie derës them. Ja, kështu, Liljanën duan ta martojnë në Stom!

— Liljanën?! Kush të tha?

— Liljana. Do të shkoj në gjermadhën e tyre dhe do t'u them: Mos e martoni vajzën në Stom, vajza më dashuron mua, dhe në qoftë se nuk marrin vesh me

të mirë do ta provoj me të keq! Në qoftë se nesër
gdhihem i gjakosur në ndonjë skutë, ta dish se...
Natën e mirë, Keno! Gjumin e ëmbël, i dashur!

Adriani zuri të prapsohej ngadalë, gjysmë i për-
kukur, me një buzagaz të lehtë në fytyrën e prishur
nga brengosja.

— Prit! — thirri Skënderi. Siç ishte në çorape, zbri-
ti në oborr, por Adriani ia dha vrapit me të gjitha fu-
qitë.

«O zot! Kanë shkalluar të gjithë!» bubulloi përtej
zëri i veshur i Lazër Bocit. Kushedi përse e kishte fja-
lën. E dëgjoi krejt mëhalla.

KAPITULLI NJËZET E DY

Rruga lëvizte si mbi rula dhe ai kishte përshtypjen se në vend që të shkonte përpara, i largohej vazhdimisht shtëpisë së Simonajve. Nuk e mbante mend sa herë ishte turrur me të gjitha forcat, ishte përplasur për tokë, kishte gjakosur gishtat e duarve, gjunjët dhe bërrylat, ishte ngritur dhe kishte vazhduar prapë drejt mureve lara-lara.

Më në fund, i dërmuar nga lodhja, u gjend në oborrin e madh me shtatë ndarje. Kënga e gjelave sikur e griste nga të gjitha anët perden e natës. Klithmat e tyre të fshehura në terr ndillnin panik. Herë, herë Adriani kishte përshtypjen se edhe në trupin e tij ishin hequr ca të gërvishtura me sqep. I bëhej se aurora do të shpleksej pikërisht nga trupi i tij dhe kjo hemorragji drite do të vazhdonte derisa të shuhej si thëngjill rrzëzë mureve — martir i një rrëmbimi të pakryer.

Një pëllëmbë e badhë tundej alarmueshëm në parvazin e njërës prej dritareve të katit të parë. Kënde! Kënde! Kënde! Ai u fut në ndarjen e tretë të abarrit dhe eci përpara si i ngrirë. Ende s'kishte filluar të nxirrte dritë nga trupi. Liljana ia çeli portën e jashtme. Ai hyri. Në shtëpinë e vjetër mbretëronte një heshtje e frikshme që trazohej nga disa frymëmarrje të thella muresh, oxhaqesh dhe njerëzish që s'dukeshin kërkund. «Erdha», tha Adriani, por nuk e

ndjeu zërin e vet. Liljana i bëri shenjë t'i shkonte pas. Ai eci nëpër një korridor të ngushtë. Ngaqë nuk shihte mirë përplasi kokën në një tra. Dhe tek mbahej me duar pas mureve anësore, për pak rrëshqiti në një shkarrëzim të llagëmit, u mbajt prapë por nuk shpëtoi pa u çokitur në kokë nga një thep. guri, trari a kush e merre vesh çfarë.

Diku në thellësi u dëgjua një zhurmë e mbytur si rënie bloze. Liljana doli papritur në një fashë të zbeh-të drite që s'dihej ku e kishte burimin. Për herë të parë ai vuri re se ajo ishte mbështjellë me një velencë të kuqe, rreth e përqark kokës kishte lidhur një gajtan të gjelbër që i varej deri afër supit të djathtë.

— Liljana, ku po shkojmë kështu? A i dëgjon gjelat?

— Eja, eja, — ia bëri ajo me dorë pa e kthyer fytyrën. Vajza ectë lirisht në atë llagëm të mallkuar. Me lëvizje të përpikta të supeve i shmangej ndeshjes me gurët, çengelat, drurët dhe gozhdat e ngulura në mure. Kurse ai pengohej vazhdimisht, mezi mbushej me frymë dhe përveç kësaj nuk kishte idenë kur do të mbaronte kjo torturë.

Pas disa minutash zbritën në një truall të sheshtë dhe më të gjerë. Liljana i bëri shenjë të ectë me shumë kujdes. Gjysëm të përkulur për të mos ndeshur me kokë tavanin, ecën drejt një si frengjie në faqen ballore të atij tuneli. Ai pati përshtypjen se atje ishte mushkëria e gërmadhës sepse frymëmarrja e mureve dëgjohej gjithnjë e më shkoqur. «Këtu», ia bëri Liljana duke treguar me gisht frengjinë e vogël. Ai vuri syrin në një katror qelqi të pafshirë qyshkur. Prej aty dallohej një dhomë e madhe, dritaret e së cilës ishin zënë me perde të zeza. Në të katër qoshet e dhomës ndriçonin katër kandilë të vegjël. Drita e tyre shpërndahet kryesisht anash, duke krijuar një si mug të tejpa-shëm në mesin e dhomës, ku shtatë tetë burra me flokë të gjatë si të grave dhe me veshje të zeza ishin përkulur rreth një tryeze të gjatë. Ata vrojtonin në heshtje

një si hartë të shtrirë në tryezë, vinin me radhë gishtin tregues në një pikë, qëndronin ashtu pesë gjashtë sekonda pastaj drejtoheshin si me komandë dhe përgjohnin dritaret dhe frengjinë e vogël.

Adriani u tërhoq prapa me vull dhe instinktivisht vuri dorën në kokë i bindur se në vend të flokëve të butë do të prekte një aliazh telash. Por sa u tremb kur vuri re Liljanën, e cila po qeshte me vete. «Ata po ndajnë tokat», mermëriti ajo me gëzim. Adriani e mbërtheu për krahu dhe zuri të ikte me vrap andej nga kishte ardhur duke e tërhequr vajzën me stërmundim pa pyetur për xhungat që i ngriheshin në ballë nga përplasja me gurët dhe hekurat e tunelit. U zvarrit në shkarrëzimin ku desh kishte thyer qafën pak më parë, doli në korridor, eci drejt daljes, e hapi derën dhe kur u kthye një sekond që të ngrinte nga toka vajzën e tërhequr shang, trupi iu mbush kokrra-kokrra nga tmerri. Ajo nuk ishte Liljana, por kunata e saj që qeshte llahtarshëm. Adriani e lëshoi menjëherë dhe u sul përpara me të gjithë fuqitë. O zot! Nuk hidhte dot asnjë hap. Diçka e papërcaktueshme e mbante lidhur pas pragut të derës. Gruaja e shtrirë përdhe qeshte dhe kënaqej me përpjekjet e tij për të shpëtuar nga tirania e pragut. Pastaj sytë e saj zunë të mbylleshin si një kurth. Atje vizllonte një dëshirë e ligë. «Ooo, ooooo!» bërtiti Adriani me sa pati në kokë.

Ai u hodh nga shtrati i trembur duke fërkuar sytë me gishta. Zemra i rrihte me forcë. Flokët i kishte qullë me djersë. Si për t'u bindur plotësisht se kishte parë ëndërr, i paçliruar akoma nga ankthi, vajti të ndizte dritën. Gjithandej në fshat këndonin gjelat. U vesh, u mbështet në dritare dhe priti të zbardhte.

— Pse je kështu kaq i zbehtë? — e pyeti e ëma kur po dilte nga shtëpia.

— Pashë një ëndërr të keqe!

— Qyqja! Ti asgjë nuk i tregon nënës sate! — u ankua ajo. Shamia e kokës i kishte shkuar paksa mënja-

në duke lënë zbuluar një tufë flokësh që dukeshin sikur i qenë zbardhur atë minut. Adriani mbyti një kob që iu lidh në grykë papritur, doli nga oborri dhe mori rrugën drejt lagunës.

Prej larg pa autobusin urban që ndaloi para zyra-ve. Zbritën mësuesit dhe Novruz Begolli me çantën e zezë nën sjetull.

Ashtu kalimthi vuri re edhe Skënder Abdylin. Diç po bisedonte me mësuesin e qeshur të matematikës. Adriani ngriti jakën e pardesysë dhe vazhdoi rrugën me një mendim krejt të papërcaktuar në kokë se përse po shkonte te hidrovori rrëzë lagunës.

Dëborra kishte shkrire në fushë. Zogj të vetmuar fluturonin andej-këndej nëpër arat e nderura në pritje të kotë. Ai u ndal aty ku fillonte kallamishta dhe gjolet që mërdhinin dhe livadhet me barin e shkurtuar përsipër që sigurisht ëndërronin pranverën e mëtej ëndërronin një kohë të largët, shumë të largët vashash e gjahtarësh që dikur, kaherë, mblihdeshin atje për të kërcyer natën nën dritën e hënës.

Këto gjëra tani vetëm mund të kallzohen, tha me vete Adriani. Brezi im e ka humbur përgjithmonë atë kohë që atje vonë polli një kohë shterpë, të cilën na ra risku ta jetojmë. Jo. Ne nuk jetojmë! Ne vetëm jemi këtu, thjeshtër apo kopilë të një befotrofi të madh që na fsheh fillimet dhe origjinën, që na largon nga toka dhe nga ujërat, që na lë fillikat në kolektivin e madh të fillikatëve, që na lyp mirënjohjen dhe na ushqen frymëzimet për t'u shumëzuar si kopilë. Tani është mëkat i madh të bëhesh dy, të bëhesh tre, të bëhesh katër. Një je tepër. Ne jemi mbërthyer në një të tanishme pa fund që kujdeset të përsërisë dhe të lindë vetveten, pavarësisht se nuk e ka përjashtuar nga fjalori fjalën «e ardhme». Por nuk ka më eksperiencë vetiake dhe kjo është prova e asaj që ndodh me ne, më saktë, e asaj që na imponohet. Fakti që i mendojmë këto dhe fakti tjetër që arrijmë të kujtojmë e të

dëshpërohem i tregon se me të vërtetë ekziston e ardhmja: ajo është matanë xhamit përballë ku herë pas here lëshojmë frymën dhe shkruajmë ndonjë fjalë. Tani ne nuk mund ta prekim atë pa thyer, pa u gjakosur.

Në imagjinatën e tij sakaq kupola gri që mbyllte horizontin krisi, hapësira u mbush me çarje dhe zhurma, mijëra duar e gishta u zgjatën si nga zgafella e një miniere për të kallzuar ekzistencë, dëshirë, mbërritje.

Siç ishte i rënduar plumb nga ky vegim, ai u kthye mbrapsht dhe u nis të gjente Lilianën dhe t'i thoshte se... ai... italiani... Aldoja, nuk vjen deri sa të dalë dimri... se, në pastë pakëz sinqeritet në këtë mes, gjithsesi me të mund të kombinohet diçka... Jo, mor jo! Ai nuk do t'i thoshte asgjë për italianin, asgjë! Por do t'i thoshte kundërshtojë deri në fund martesën në Stom, s'ka asnjë vlerë, asnjë kuptim. Dhe është e neveritshme. Më e neveritshme se vdekja.

KAPITULLI I NJËZETË E TRE

Adriani nuk shkoi të gjente Lilianën. As të nesërmen, as të pasnesërmen. Ajo priste diçka prej tij. Me orë të tëra përgjonte në dritare se mos ai vinte për të biseduar. Po të vinte Adriani, ajo do ta kishte më të lehtë ta ngrinte zërin kundër fejesës në Stom, rrethimit të kunatave dhe sjelljes së vrazhdë të xhaxhallarëve. Po të vinte Adriani ajo ishte e lirë të ikte fare me të. Mirëpo Adriani nuk po bëhej i gjallë! Adriani po mendohej! Ndofta i trembej sherrit, ndofta ishte penduar për fare, kush djalli e merrte vesh.

Dikur edhe ajo e kishte përbuzur ngutjen për t'u fejuar; vajzat që mezi prisnin të futnin një unazë në gisht, nuk i shihte dot me sy. Pra, në një rrethanë tjetër më të zakonshme nuk do t'i bënte përshtypje ngurrimi i Adrianit për të mos thënë se do të pajtohej me të. Por rrethana e saj tani ishte e jashtëzakonshme. Si t'u thoshte prindërve s'dua të martohem në Stom?

T'u thoshte s'martohem sepse dashuroj Adrianin, i ati dhe xhaxhallarët do t'i gërmusheshin njëherësh: S'ke turp! E dashke ti! Po hé, ku është, pse s'vjen të të kërkojë? Prapa kësaj fraze që s'mund të shqiptohej ndryshe përveçse me cinizëm, fshiheshin gjëra shumë të trishtuara që nuk thuhën:

Në shtëpi përgatiteshin për të pritur miqtë e rinj nga Stomi. Lyheshin muret, forcoheshin minderet, lahe-

shin perdet e dritareve, kruheshin kusitë dhe tenxheret, flakeshin shkarpat dhe çiznet e vjetra, pastroheshin oxhakët dhe tubat e sobave, drejtoheshin fotografitë në korniza. Liliana i vëzhgonte zemërplasar gjithë këto përgatitje.

Një mbrëmje, me një stil entuziasti që shprehte tërë ironinë e fatit të saj, shkroi në një letër përgatitjet në fjalë. E palosi letrën, e mbylli në një zarf, thirri Sokolin dhe ia dha me porosinë që t'ia dorëzonte Adrianit në dorë.

Përgjigjen e mori të nesërmen. «Përrshkrimi yt më pëlqeu. I përfytyrova tërë kushurinjtë e tu duke u rruar e kruar. Ç'ka! Ndofta po fillojnë të marrin kthesën. Seftë e shohin me vend të lahen mirë e mirë. Tani diçka tjetër: Një ditë shkova nga hidrovori. Shkretim i plotë andej. Mendova për ty. Mendova gjatë për ty, për vete, për të gjithë moshatarët tanë. Puna është që të mos dorëzohemi më, domethënë t'i evitojmë edhe ato pak rrite, me të cilat jeta jonë e tanishme, gjithmonë e tanishme, maskon mbrapshtinë e vet. E kupton?»

Më poshtë Adriani shkruante se një delegacion nga Barbulloja do të nisej së shpejti në Stom për të marrë përvojë! Atë e kishin caktuar anëtar delegacioni. Qesharake, apo jo? — vazhdonte ai. Por unë kam vendosur të dal një herë. M'u zu fryma. Të përqafoj fort, Adriani!

Liliana shtrëngoi letrën me një dorë, ndërsa tjetrën e vuri në faqe. Fytyra e saj mori një shprehje të përzishme mes hutimit, brengës, qesëndisë dhe inatit: Vërtetë s'e kishte kuptuar Adriani pse po lyheshin shtëpitë e kruheshin kusijat? Vërtetë i kishte marrë të gjitha këto si aksion higjiene? Apo hiqej si naiv me qëllim që të rrinte përskaj së vërtetës? Asaj iu mbush mendja top se Adriani shtirej. Duke e gjykuar punën kështu, arsytimi i tij për «të dalë një herë» iu duk i neveritshëm, një burracakëri e denjë për njerëzit e

pacipë. Meqenëse ai nuk donte të kuptonte, ajo kishte të drejtë t'ia përplaste hapur: Shiko. Adrian! Shtëpitë tona po rregullohen sepse priten miq nga Stomi. Ata vij-në që të më kërkojnë mua për nuse!

I shkroi këto fjalë në një copë letër dhe ia nisi pa humbur kohë me Sokolin. Ky e kërkoi Adrianin gjithan-dej. Mbeti udhëve deri sa ra nata. Nuk i bënte zemra të kthehej në shtëpi. I vinte keq për Lilianën. Ndërko-hë zunë t'i kruheshin duart për t'u rrahur një herë mirë e mirë me Adrianin. Kur kishte humbur shpresat, e pa tek zbriti nga një motorr para zyrave të kryesi-së. I doli përpara me një frymë dhe ia dha letrën duke e këqyrur me përbuzje. Adriani ngriti supet sikur thoshte: «Përsëri letër?». Sokoli pështyu në tokë duke përmbledhur të gjitha forcat për të mos ia hedhur pë-shtymën në surrat atij fodulli humbamen. Pa marrë përgjigje, u kthye dhe iku.

Liliana po e priste në dhomën e saj. Kuptohet qar-të se kishte qarë dhe tani nuk e befasonte më asnjë lajm i keq. Kjo ia lehtësoi punën Sokolit, i cili gjatë rru-gës kishte vrarë mendjen si do t'i dilte përpara Lilia-nës pa përgjigje. U ul te cepi i shtratit dhe teksa po bëhej gatë t'i thoshte «Adriani nuk i meriton vuajtjet e tua», Liliana foli para tij:

— Më fal Sokol! Të mundova shumë sot...

Zëri iu përdrodh në grykë dhe heshti. E kishte të vë-shtirë të fliste pa bërë pushim. Sokoli psherëtiu.

— Martohu në Stom dhe vëri kapak kësaj pune! —
tha.

— Nuk martohem për të nxjerrë inat me dikë! — tha Liljana. Fytyra e saj u shtrembërua panatyrshëm. Sy-të i shkëlqenin nga një përbuzje e paemërtueshme, gi-shtat e duarve i dridheshin. — Do rri këtu, — vazhdoi pastaj, — do hesht sa të kem fuqi, sa të jetë e mundur, sa të jetë e arsyeshme. Më kupton?

Sokoli e vështroi me habi. Jo, ai nuk e kuptonte mi-rë. Po mendonte si t'i vinte në ndihmë kushërirës.

Pas një heshtje të gjatë zuri të kujtonte verën e parvjetshme kur bashkë me Liljanën kishin mbledhur she-rebelë lart në male dhe në zheg ishin larë të dy në hur-dhat e përroit. Sa bukur e kishin kaluar atëherë! Dil-nin nga uji, shtriheshin në rrasat e nxehta dhe nuk i shihte njeri. Po Liljana ishte pritur shpejt, shumë shpejt!

— Kjo s'ka ndodhur verën e parvjetshme! — tha Liljana me të qeshur.

— Eh, Ku mbaj mend unë. Di se nuk ishe njohur akoma me Adrianin!

— Mos, Sokol! Nuk jam e penduar pse u njoha me Adrianin. Nuk jam e penduar për asgjë. Po ta rifillo-nim jetën te hurdhat ku jemi larë bashkë, prapë do të rritesha e do të njihesha me Adrianin. Më kupton?

— Të kuptoj, por s'jam dakort me ty! Nuk më pël-qen që ti ta duash gjatë kurse ai për pak kohë! Ai... nuk të meriton ty!

Liljana vuri buzën në gaz.

— Tani nuk flitet më në kohën e tashme, — tha. Ai... dëshiron të martohet në Stom!

— Kush të tha ty? — pyeti i tronditur Sokoli.

— Ja ashtu, e mora vesh...

Atë pasdite Hilë Simoni, xhaxhai i tretë, i kishte sjellë një letër. Lexojë shpejt e shpejt, i kishte thënë, se duhet ta mbyllim përsëri në zarf. Ishte një letër që gjoja Ludovik Margjoni ia dërgonte Adrianit. Ishte një letër e sajuar. Punët shkojnë mirë, shkruhej në të. Vajza ka mbetur e kënaqur prej teje. Po ashtu edhe ë ëma. Të presin krahapur si zot shtëpie. Ta kam zi-li. Ludoviku.

Liljana kaq ishte tronditur, sa e kishte besuar me-njëherë atë letër. Prandaj zhduket ka sa ditë, pat thë-në me vete. Prandaj ka përdorur të gjitha marifetet për të qenë anëtar delegacioni. Kur martesë e tij nesër të bëhet fakt, do të justifikohet kështu: Jo, unë s'kisha uj-

disur gjë paraprakisht. Isha me ekipin në Stom dhe rashë në dashuri!

Liljana kishte vazhduar ta kqyrte letrën një copë herë. Xhaxhai në krah kishte nënqeshur gjoja gjithë duf kundër dredhëarakut Adrian Miraj. Tani vajzës i takonte të merrte një vendim! Ose ta bënte hasha djalin, ose t'ia nxirrte të palarat në shesh dhe kështu kryesia ta hiqte nga delegacioni! E mira e të mirave ishte ta bënte hasha dhe t'i vinte kapak njëherë e përgjithmonë asaj meseleje.

— Mos është intrigë? — tha Sokoli.

— Ashtu? Intrigë? Vërtetë? — ajo u gjallërua disa sekonda, sytë i shndritën, pastaj ia nguli sytë errësirës në xham dhe s'foli më.

Të nesërmen Agetina Suli i solli përgjigjen e Adrianit. Ajo e hapi zarfin mekanikisht sikur duart ia komandonte një njeri tjetër. E lexoi tërthorazi gjithë me një nënqeshje qesëndisëse në buzë. Adriani bënte thirrje për realizëm, për rezistencë, ha, ha, ha! Ai shtjellonte përsëri atë punën e riteve dhe ishte kundër dramatizimit të gjërave, kundër pajtimit me zakonet neveritëse. Duhej pritur. Ai akoma kishte shpresë se koha shëron gjithçka. Në qoftë se koha nuk shëron plagë, së paku nuk duhet lejuar që të hapë plagë të reja. Prandaj edhe po shkante në Stom. Që të largohej ca kohë, të mungonte. Mungesa gjithmonë është qetëse... Posi, posi! Tani s'ma hedh dot! E di unë ç'ke në kokë, i pabesë! S'të vjen rëndë që më këshillon të rezistoj kur ti je dorëzuar këmbë e kokë. Shko! Shko ti! Unë do të rri këtu, vetëm këtu.

Ajo e flaku letrën mënjanë dhe filloi të vishet.

Në kufi të ndarjes njerëzit ndjejnë një nevojë të çuditshme të shihen. Liljana u vesh dhe doli nga shtëpia. I ra mospërmes fshatit dhe mori rrugën drejt veriperëndimit, andej ku ndodhej shtëpia e Drandes së madhe. Në qoftë se Adriani ka mall për mua, do të më

shohë dhe do të më ndjekë, mendonte me vete. Në gofshin të vërteta ato që mora vesh dje, nuk do të bëhet i gjallë. Ecte dhe gjaku i ngrohej dhe lëkura e fytyrës i digjte sikur i afrohej një zjarri. Asnjë zë, asnjë zhurmë nga prapa. Hyri në shtëpinë e Drandes së madhe, dëgjoji një këngë që plaka e këndoi me shpirt ndër dhembë vetëm se iu dhimb ajo vajzë, doli dhe mori rrugën e kthimit. Tani nuk ziente më si furrë. Përkundrazi. Ishte e ftohtë akull.

KAPITULLI I NJËZET E TRE

Dy ditë me radhë fryu një erë e ngrohtë mesdhetare. Bënte mot me diell, pleqtë dhe plakat, të hollë dhe të zbardhur, u shfaqën pas një mungese të gjatë në oborre, në kopshte, në rrugë. Takoheshin me mall sikur kishin qenë shumë larg për t'u shpëtuar ngricave dimërore dhe tani kishin dalë gjallë në pranverë; flisnin me gishta, flisnin me vete, shikoheshin me habi, me gëzim.

Me shfaqjen e tyre u duk sikur dimri u thye para kohe. Ishte rasti më i mirë që delegacioni i Barbullojes të nisej për Stom.

Dy anët kryesore të rrugës u mbushën ding me njerëz. Anëtarët e delegacionit, të veshur me rrobat më të mira, kaluan si në revistë para tyre.

Adriani pa midis vajzave Agetinën. Ishte ngritur në majë të gishtave dhe tundte dorën lart. Atij iu shkri diçka e ngrohtë në krahëror, diçka që kishte lidhje me dorën e saj, me kaltërsinë e thellë të qiellit dhe me horizontin e hapur shumë që dhuronte një përmasë tjetër të jetës.

Shikimi i tij i vëmendshëm kaloi nga njëra fytyrë te tjetra... Donika Shquti, as e qeshur as e vrenjtur, vajza të tjera me sytë plot mallëngjim, Aleks Balsha si i gjetur rastësisht në atë tollovi, Mikeli i gjithanshëm që mbinte herë këtu, herë atje, Ferdinandi që buzëqeshte me kursim, Jetmir Çubi dhe Festim Ndoja, të cilët dolën

nga radha e njerëzve si me komandë dhe rendën në livadhet përtej duke i rënë ballit me pëllëmbë e duke mbajtur ijet nga të qeshurat: O perëndi, o perëndi! Këta kujtojnë se do të sjellin bashkën e artë nga Stomi! Ja edhe Novruz Begolli, solemn dhe i shkrirë me pullin, Prenga i gjatë me vulën e një inati të pandërrueshëm në ballë, Dodë Balsha me bllokun bojë qielli në dorë, Lena Përgjoka që kotej dhe gjallërohej papritur, tre sehirxhinj nga fisi i Simonajve, dy kunatat si koshadhe dhe mes tyre Liljana me një gëzim të vendosur si me pahir në fytyrë.

Dikush nxorri në rrugë katër vajza të vogla të veshura me rroba kombëtare. Ato hapën krahët dhe zunë të kërcenin duke vështruar njëra tjetrën. Dukeshin aq të lehta sa kishe përshtypjen, se këmbët e tyre nuk shkelnin në tokë.

Adriani ktheu kokën përsëri mos shihte Liljanën. Kishte dëshirë t'i buzëqeshte. Midis kokave të kunatave zbardhte profili i saj i hequr. Shikonte tjetërkund. Syri i majtë i ishte veshur me mjegull lotësh.

«Shikomë! Shikomë!»

Adriani mbeti disa sekonda prapa të tjerëve.

«Shikomë! Shikomë!»

Asnjë shenjë. Asnjë përgjigje.

Kur autobuzi u nis, mes turmës së njerëzve që mbetën në rrugë u dëgjua një vajtim i hollë dhe i zgjatur si kuisje. Njerëzit rrotulluan kokat të habitur dhe zunë të shfrynin njëri tjetrin sikur burimi i atij vaji misterioz ishte fshehur diku mes radhëve të shtrënguara. Artan Boci, në kulmin e nervave, u vodh prapa kurrit të turmës, iu afrua pa zhurmë Mikelit të gjithanshëm, e kapi befasisht në zverk dhe e ktheu me fytyrë nga vetja duke pandehur se Mikeli i pacipë imitonte fshehurazi kalinën. Por nofullat e Mikelit ishin të uthitura si darë.

Vajtimi pushoi. Njerëzit zunë të shpërndareshin si të frikësuar pa kuptuar asgjë. Pak më vonë u muar vesh se ajo që kishte qarë ashtu pavullnetshëm dhe pa i lë-

vizur asnjë muskul në fytyrë kishte qenë Liljana Simoni. M'i bënë magji vajzës! Kushedi ku shkeli, u shpjegonte e ëma me lot në sy grave që shkuan për ta pyetur. Para dy ditësh e zuri për herë të parë kjo shajni. Dolëm në mal për dru bashkë me kumatat. Ju e dini, presim miq nga Stomi, i doji fat i mirë vajzës, por qoftëlargu s'rri urtë, punon, punon. Prit dru na, ajo shikonte pyllin, kur fap, filloi të qante si fëmija në djep. Çfarë ke, moj? Liljanë! Liljanë! Ajo më shikonte drejt në sy, donte të më thoshte diçka dhe s'mundte. Qante sikur merrte frymë, pa lot e pa kurrgjë. Si nuk më lufti kapaku i kresë, unë e di! Ju luta të madhit zot kij mëshirë për vajzën e re, alla, s'pata numëruar deri në njëzet dhe vajza pushoi. Ç'qe ky hukubet, moj bija e nënës? Nuk di gjë më tha. Më mbështillej ajri në grykë e bënte zhurmë vetë. Qyqja! Shkova e pyeta te plaka e Donajve. I vura kripën. U shëndosh vajza. Nuk qau më as atë ditë, as të nesërmen. Sot filloi prapë — u ngashërye gruaja dhe fshiu lotët me shami.

Liljana qau edhe katër herë të tjera deri sa ra mbrëmja. Dukej e qetë, bisedonte, bënte ndonjë punë, kur krejt papritur ngrinte e gjitha si shtatore dhe nxirrte ato kujet e zgjatura. Disa nga burrat e Simonajve kërkuan të dërgohej menjëherë te mjeku, por i ati i Liljanës, Ndrec Simoni nuk pranoi. Edhe kjo na duhet, ta marrë vesh gjithë bota dhe të mbetet virgjëreshë në shtëpi. Vajza s'ka gjë, e ngriti zërin pastaj. Të kuptohet nga të gjithë se nuk ka gjë. Hajde, ikni tani se na zutë frymën!

Dy ditë e dy netë prindërit i ndenjën vajzës te koka, por të qarat e saj nuk u përsëritën më. U duk sikur e keqja kaloi. Ajo ndihej e lehtë, madje më e gëzuar se zakonisht. «A të shkoj në mal për dru?» i tha sëmës një mëngjez. Gratë kujtuan se vajza, e çliruar nga shajnia e qoftëlargut, kishte dëshirë ta mundte të këqen deri në fund, pikërisht aty ku kishte nisur. U nisën menjëherë. Pas gjysëm ore ishin në pyll.

Era uturonte në lugaja, piskaste në thepat e shkëm-

binjve dhe në degët e zhveshura të lisave, fërshëllente në hapësirën e lirë drejt fushave dhe ndofta qetësohej larg në det. Gratë prisnin dru, ndërsa Liljana vraponte shpatit, hipte e zbriste nëpër shkëmbinj, ndalej, kundronte peizazhin me një habi fëminore në sy, ledhatonte trungjet e lisave dhe barin rreth e qark, ecte me kujdes në majë të gishtave... Ah, fusha të merrte shpirtin me atë shtrirjen e vet uniforme si një pritje pa shpresë, kurse pylli ishte ndryshe, ndryshe, ndryshe... Si ishte pylli? Ajo zuri të rendtë përsëri me vrap sikur diku, përtej relievit të përthyer, përtej shkozave dhe gurëve gjendej enigma e pyllit, ajo gjë e pakrahueshme dhe e paemërtueshme që përshkohej si flur zogu në qënien e saj. Pakutuar kishte mbërritur buzë një kanjulli të thellë. E pa errësirën që nxite atje poshtë. Në një rast tjetër do t'i ngrinte gjaku nga frika dhe do të ndalej, por kësaj radhe lakmia, kurrështja, dehja, veshja e gjithçkaje me një prarim luksoz, perceptimi i ëndërrt i gjërave — të gjitha këto — e morën në qafë. I rrëshqiti këmba dhe ra teposhtë në greminë pa nxjerrë asnjë zë.

* * *

Adriani ishte në Stom kur Ludoviku i tha se Liljana Simoni kishte vdekur. Lajmi i zi e përshkoi si rrufe. Pastaj, kotsëkoti, u kujtua se në Barbullojë nuk e kishin për gjë t'i vdisnin dhe të ringjallnin njerëzit sipas qejfit. Për herë të parë ky humor i rëndë i pëlqeu. ashtu siç na pëlqen gërvima e molës në dhomën e errët kur zgjohejmë nga një ëndërr e keqe. E pyeti Ludovikun:

— Kush të tha se Liljana vdiq?

— I pashë me sytë e mi njerëzit e saj tek zbrisnin duke qarë nga spitali, — u përgjigj ai me gjysëm zëri. — Sepse ta thashë një herë, vajza nuk vdiq në vend, e çuan gjallë deri në spital...

Adriani zbërtheu pardësynë, liroi shallin e lidhur në qafë dhe e la erën t'i rrihte krahërorin. Në mendjen e tij shkrepëtiu si vetimë profili i hequr i Liljanës ashtu siç e kishte parë ditën e nisjes në Stom. Shikomë! Shikomë! Shikomë! Ajo nuk lëvizte. Sikur ishte prej allçie. Muskujt e trupit iu shkrehën ngadalë si të mos ishin të tijat dhe një forcë mizore filloi ta përkulte e ta mblidhte si me dorë.

Vegimi i profilit të Liljanës farfuriti diku anash supit të tij të djathtë dhe u zhduk sa çel e mbyll sytë. «Ç'ë?» ia bëri duke prekur supin me dorë.

Ai u rrotullua nga e majta, pastaj nga e djathta sikur kërkonte të kapte një hije.

— Çfarë bën ashtu? — i briti Ludoviku. Adriani i mori atij biçikletën, mbërtheu pardësynë, shtrëngoi shallin dhe para se të nisëj, me një zë të ndryshuar, i tha Ludovikut se Liljanën e kishin kërkuar nuse në Stom. E duam! — thanë stomianët. Siurdhëron! — u përgjegjën Simonajt. Ai deshi të shtonte diçka tjetër, por e ndjeu se zëri po e tradhëtonte përfundimisht. U përkul në timon dhe çau përpara në rrugën drejt Barbullojës.

Mijëra yje lëbyrnin kupolën e natës. Adrianit i dukej sikur shkiste nëpër to. Veshi i majtë i gumëzhinte nga era e veriperëndimit. Yjet rrotulloheshin e kalamendeshin si të varur në penj dhe ai kishte përshtypjen se nuk do të arrinte kurrë në Barbullojë.

... Na ishin një herë dy kunata dhe një vajzë e bukur. Eja me ne të shëtisim në pyll, i thanë kunatat vajzës së bukur një mëngjez. Vajza rrahu shuplakat nga gëzimi, veshi rrobat më të mira, u kreh, u stolis, por nuk harroi të merrte me vete një trastë me miell për ta derdhur çikë e nga një çikë rrugës. Dhe u nisën dy kunatat, ec e ec pambarim derisa ra nata... Na ishin një herë dy kunata. Ec e ec nëpër terr, ec e ec nëpër terr...

Fap-fup, i vetoi në sy profili i Liljanës. Ai u për-

kul akoma më shumë mbi timon dhe vazhdoi të pedaloonte me të gjitha fuqitë, i tmerruar nga ai vegim... Na ishte një herë një djalë i ri dhe një vajzë e re. A vjen me mua të shkojmë diku? — i tha djali. Vij, tha vajza. Dhe ata shkuan në një qytet ku nuk i njihte kërkush dhe atje ku nuk i njihte kërkush dhe ku nuk i shihte kurkush u zhveshën lakuriq dhe i kalizuan njëri-tjetrit gjërat që nuk kallzohen dhe i dhanë njëri-tjetrit ato gjëra që kishin pasur shumë frikë t'i jepnin, pastaj atje vajza e re e pyeti djalin e ri po tani çdo të bëjmë dhe djali i ri u mendua gjatë në qytetin ku nuk i njihte askush, u mendua prapë e prapë me javë e me muaj se si t'i përgjigjej vajzës së re...

Na ishte kush na ishte... Na ishte një herë një vajzë e re. „Fap-fup, vetoi rishtas profili i Liljanës dhe kjo u përsërit edhe tre-katër herë të tjera gjatë rrugës për në fshat

Në Barbullojë s'pipëtinte asgjë, porpos erës që fërshëllente. Ai hyri në oborrin e shtëpisë së tij, zbriti nga biçikleta, u afrua te dritarja e kuzhinës dhe trokiti në xhamat e veshur me avull. E ëma zgjati kokën dhe sa u tremb kur pa atje djalin e rraskapitur nga lodhja.

— Nga vjen kështu? — pyeti ajo.

— Nga Stomi, — u përgjegj ai me kokën e mbështetur në xham sikur Stomi të ishte nëntë male larg. Flokët e tij të lagur nga djersa shndrisnin nën dritën e llampës elektrike.

— A ka vdekur Liljana Simoni?

— Po, o bir, ka vdekur e mjera! Ra nga shkrepiti.

Avulli që kishte veshur xhamat sikur u zhvendos në sytë e saj.

— Adrian! Adrian! Ç'bën aty? — thirri ajo dhe u tërhoq prapa me vrull për t'i dalë përpara. Kur dolë jashtë nuk e pa më Adrianin te burduri i dritares. Ai po ikte duke dënesur mospërmas oborrin.

Kodrinat e kredhura në errësirë dhe yjet e qartë mbi to dridheshin si nën ritmin e një muzike nevri-

ke. Gjithçka rreth e përçark dukej e paqëndrueshme, me përjashtim të hijeve të njerëzve që shkonin ose ktheheshin nga shtëpia e madhe e Simonajve. Mbi supet e tyre të kërrusura nata sikur kishte peshë. Adriani e dinte: edhe gurë po të binin nga qielli, njerëzit do të shkonin se s'bën në ngushëllim. Kështu u shëndoshej koka të gjallëve, atyre që kishin humbur përgjithmonë njeriun e tyre. Ndërkohë, duke marrë pjesë në mort, secili rezervonte për të gjithë dhe të gjithë për secilin detyrimin për t'u nderuar në mungesë të plotë ditën e mbramë.

Një dyzinë fytyrash parakaluan në mendjen e Adrianit. Ata janë të gjithë atje, në mort, të pajtuar sepse ka vdekur një njeri! — mendoj me hidhërim. Asnjë vdekje s'ka të drejtë t'i pajtojë ata! Asnjë vdekje s'ka të drejtë të më bëjë mua trim, të urtë dhe të paepur! Asnjë vdekje s'ka të drejtë ta zbusë Ndrec Simonin! Kjo zbutje ka një çmim çnjerëzor!

Fare pranë u dëgjuan të qarat e mbytura të një vajze që vinte kundruall. Adriani u mbështet në një sop dhe duke marrë frymë si një dre i lodhur. Donika Shquti kaloi pa e vënë re.

Ai ndofta ishte ndër të fundit që shkante në mort gjatë asaj dite. Shumica e dinin në Stom, ndaj u habitën kur e panë. Ndrec Simoni i kallzoi një vend në dhomën e burrave. Fytyra e tij e parruar, me ata sytë e skuqur, vetullat e varura dhe flokët si të tymosur u shtrembërua fare pak. Adrianit iu lidh një kob në grykë, u skuq dhe uli sytë.

Në fund të koridorit përkarshi, mes tollovisë së grave që hynin e dilnin në dhomën ku duhej të ishte e ndjera, mbështetur në shtalkën e derës, me trupin e harkuar pikëllueshëm rrinte Agetina Suli. Ajo kishte lidhur në qafë një shami të zezë dhe herë pas here fshinte sytë e përletur me çepat e saj.

Agetina nuk ia ndante sytë opakë Adrianit. Duke e ndjerë ngulmimin e saj për të shkëmbyer së paku një vështrim, Adriani ktheu kokën me vrull në drej-

tim të kundërt, majtas. Por edhe në këtë krah nuk e priste një fat më i mirë. Sytë e hapur jashtë mase të Sokol Simonit e goditën si dy duar që të japin një të shtyrë. Dikush i vuri përpara tabakanë e kafes. Ai e tërhoqi me rrëmbim filxhanin dhe vuri buzët mbi të sikur kafeja do ta shpëtonte nga sulmi i gjithanshëm i vështrimeve.

Ja, kjo është shtëpia e Simonajve, mendoi pasi e kishte mbledhur veten dhe njerëzit nuk po i kushtonin më vëmendje. Shtëpi si të gjitha shtëpitë, me dysheme, me mindere, me dritare, me mure të lyera, me tavan të bardhë, me llampë në mes... Ku ishin llagemët, ku? I erdhi turp me marrinë e vet të dikurshme, gjaku i hipi në kokë dhe instiktivisht ktheu fytyrën drejt derës së dhomës në fund të koridorit përkarshi. Agetina Suli nuk ishte më atje.

E plazmuar në fytyra, në duar, në shikime, në frymëmarrje, në fjalë, në mure dhe në xhama, vdekja rrinte pezull sikur nuk do të zbriste kurrë në tokë. Por të gjithë ata që vinin rrotull nëpër atë shtëpi pikëllimi si skafandër e kishin fatin me vete për arsyen e thjeshtë se ishin gjallë dhe në mos nesër, pasnesër moplepsja mortore do t'i braktiste. Vetëm një njeri nuk kishte më fat dhe kjo ishte Liljana Simoni.

Adriani u çua në këmbë dhe, duke u përkundur mbi këmbët e mpira, mërmëriti diçka që e trazoi papandehur qetësinë e vonë të mortit. Çfarë? Çfarë? Ai kërkon të shohë xhenazen? Pse pikërisht ai? Si pse ai? Ç'pyetje! Ai pra, ai! Ka arsyet e veta për ta parë! Po tani është natë! Nuk lejohet! A zbulohet i vdekuri natën? Ku e di unë a zbulohet i vdekuri natën! Ja, mësoje tani: i vdekuri nuk zbulohet natën. Natën bëhet gjyqi me të përjetshmit. Nëna ime! Vajzat tona nuk janë rrëfyer asnjëherë! Sa shumë helm mblidhet në shpirtin e tyre! Jo! Ato rrëfehen, sepse altari nuk është vetëm një dërrasë me bira dhe prifti nuk është vetëm një njeri! Shshsht! Mos përmend prifta! I përmend që

ç'ke me të! S'kam frikë unë! Eh, ti s'ke frikë, po kush të mbron? Këtu nuk njihet zoli... Oj, ky djali ka lajthitur! Shih si i lëvizim sytë! Po shkon në dhomën e xhenazes, po shkon në dhomën e xhenazes. Mbyll veshët...

Adrian Miraj nuk shkoi në dhomën e xhenazes. Sokol Simoni e nxorri jashtë duke e mbajtur për krahu si të ishte i paralizuar, e përcolli deri aty ku niste errësira në fund të oborrit dhe e lëshoi.

— Vrasës! Ik prej këtu! — tha Sokoli. Adrianit iu zu fryma, vuri duart në krahëror si për të thënë... si për të thënë... Asgjë s'mund të thoshte, asgjë s'mund të mendonte, me përjashtim të një dëshire të vagëllt që dikush ta flakëronte lart, sa më lart në qiell dhe atje ta linte fryma fare duke zbritur. Po kush mund ta bënte këtë? Kush mund ta merrte në shenjë, prej dritares përtej? Përçmimi i thellë i kushëririt të Liljanës nuk jepte asnjë shpresë. «Vrasës! Ik prej këtu! Ik dhe mbytu në gjakun tënd, në dhimbjen tënde». Ai u mbajt me duar pas trungut të një kumbulle. Qëndroi një copë herë ashtu, pa ditur ç'të bënte. Pastaj një mendim i befte e shkundi nga ngujimi, u lëshua teposhtë me vrap dhe e mbajti frymën në shtëpinë e Skënder Abdylt.

— Hyrë! — i tha Skënderi nga brënda dhe ai shtyu derën dhe hyri duke fërkuar sytë që ia vrau drita. Burrë e grua rrinin shpinë për shpinë në një tryezë të vendosur nën llampën elektrike. Vajzat në dhomën tjetër flinin dhe ata ishin shumë të trishtuar, jashtëzakonisht të trishtuar që vajzat flinin.

— Këtë punë bëjmë ne! Vemë në gjumë kalamajtë, — tha Skënderi. — Mandej nuk na bëhet të shtrihemi...

Adrian u godit rishtas si prej detit. Ritmi i shpejtë i frymëmarrjes nuk e linte të fliste. Në sytë e mëdhenj bojëqielli që dukeshin sikur ishin vendosur me pahir në fytyrën e tij të prishur, lexohej ngutja, një ngutje prej të urituri dhe njëherësh bezdija për madhësinë e tyre të jashtëzakonshme. Ai seç kishte një

frikë të vështronte drejt. Kokulur, më në fund foli kë-
shtu:

— Skënder! Ti më ke pas treguar një histori për unazën e Adiles. A ma jepni mua atë unazë dhe unë ua kthej paratë gjallë a vdekur deri në maj.

Adilja mbuloi fytyrën me duar sikur i fshihej një tmerri.

— Ajo e ka shitur unazën, — tha Skënderi. — E shiti kur më kapën mua. Por do ta marrim prapë, ke për ta parë kur ta marrim prapë. O e marrim, o shu-hemi të gjithë me kuç e me maç. Zoti në qiell do të na gjykojë.

Mandej, pasi zbriti nga tryeza: — Miku im i mallkuar! Unë mund të të ndihmoj ndryshe ty!

— Si?!

— Në muze janë ato stolitë e grave që u gjetën dikur-dikur në varrezat e vjetra. Përse të mos i marrim për Liljana Simonin? Më vonë le t'i zbulojnë prapë ata që nuk do të kenë nevojë për to.

Trupi i Adrianit u mbush me drithërima.

— T'i marrim, thua?

— T'i marrim, — tha Skënderi. — Mua më vjen shumë keq që i kanë nxjerrë para kohe nga toka.

— Ke të drejtë! I kanë vendosur në muze për të helmuar vajzat!

— Janë djaj këta, janë të poshtër! Puna është sa t'i njohësh! Se nuk njihen kollaj, më kupton?

— Të kuptoj!

— Kanë shpikur do fraza të forta që edhe me plumb zor se i shpon. Më kupton?

— Të kuptoj...

— Mandej, he-he, përmendësh e dimë punën e tyre. Natën dhe ditën e dinë përmendësh. S'ka gjë më të tmerrshme, më të pështirë.

Adilja që deri në ato çaste kishte ndénjur e mbledhur kruspull në tryezë si e harruar nga bota, zbuloi fytyrën dhe tha:

— Skënder Abdyl! Veri çelësin gojës të them unë. Ke fëmijë për të rritur.

Skënderi u kthye me vrull nga e shoqja. Në sy i farfurinte një habi foshnjore. Tha: — Unë kam fëmijë për të rritur? Unë po i rris fëmijët e mi? Jo, pasha zotin!—ia bëri duke tundur gishtin. Pastaj nga Adrian: — Fëmijët e mi, bereqavers, po i rrit shteti. Shteti dhe zoti na ka lëshuar gjithë këtë ajër e gjithë këtë ujë, he i qofshim falë jetë e mot. Shkojmë tani ta kryejmë atë punë.

Ai mbërtheu xhaketën e zezë dhe doli. Prapa gardhit që qarkonte oborrin gjeti një levë hekuri, e hodhi në sup dhe priu drejt muzeut, prapa shkollës. Frynte erë me të rrahur, siç i thonë në Barbullojë, kur era ia bën fap-fap papushim dhe, falë asaj shpalosje që nuk trazon kërkënd dhe nuk sjell asgjë, nata duket e gjatë, e pavërtetë, hije e hijes së një natë tjetër që askush nuk e di ku është. Ashtu dhe njerëzit në atë pjesë të rrejtshme apo të vdekur të natës lëvizin si hije të hijeve të tyre dhe nuk ndjejnë frikë.

Skënder Abdyl e futi majën e levës poshtë derës së muzeut e ngriti lart dhe e nxorri prej rezeve të ndryshkura. Mandej i dha një të shtyrë me kurriz dhe përfundoi brenda kuadratit që u hap si grykë e errët. Ai ndezi shkrepshen dhe kërkoi çelësin elektrik, shtypi bulbin e çelësit, por drita nuk u ndez. Atëherë eci kuturu drejt vendit ku mbante mend se gjendeshin stolitë, diku rrëzë murit, majtas. Ishte errësirë e plotë, por një si vezullim i brendshëm e ndillte Skënder Abdylin andej. Në terr kumboi zëri i Adrianit që kishte mbetur prapa dhe s'dinte nga të shkonte.

— Skënder! Bëj pak dritë!

Ai ndezi një fiçe tjetër. Nën ndriçimin e zbehtë të flakës së shkrepshes fytyra e Adrianit zverdhi në terr si maskë e lyer me vernik.

Derisa u shua flaka qëndruan të dy pranë arkës prej qelqi ku qenë hedhur grumbull vathë veshësh,

unaza, groshetarë e stoli të tjera të vjetra me ngjyra të zvetënuara gurkali.

— Unë kujtova se shkëlqejnë! — tha Adriani.

— Është natë, — tha Skënderi. — Po kjo s'ka rëndësi. A janë për t'i shtirë në tokë?

— Se si më vjen, — tha Adriani.

— Nuk i do?

— I dua, por se si më vjen.

— Në qoftë se i do dhe unë them bën mirë t'i dash, atëhere... — Skënderi gjeti me gishta pjesën e dalë të kapakut prej xhami, e ngriti me forcë dhe tha:

— Merri shpejt pra!

Adriani buburoi me duar fundin e arkës, gishtat e tij prekën qelqin e ftohtë, pastaj grumbullin po aq të ftohtë të stolive që lëshuan një tringëllimë të mbytur. Ai u drodh sikur po ia shkulte nga gjoksi një kufome. I tërhoqi duart dhe tha nuk i marr dot. Skënderi u skërmit. Ma lër mua, tha. Me njërën dorë mbajti kapakun, me dorën tjetër mori sa i zuri pëllëmba nga ato metalet e hekurishtet që rrëzëllimin verbueshëm në imagjinatën e tij. Ai e lëshoi kapakun dhe përparoi andej nga ishte dera me ngut, sikur do ta mbanin rob fantazmat e lashtësisë.

Të nesërmen, duke i parë në dritë të zotit ato stoli që ngjanin me një grumbull hekurishtesh të brejtura nga korruzioni, mendoi se nuk ishte ai që i kishte vjedhur ato, por ato i kishin vjedhur një kujtim që kishte përdritur ditë e netë të tëra në fantazinë e tij. Megjithatë iu lut shumë Adrianit që t'i merrte dhe t'i hidhte në krahërorin e Liljana Simonit. Nuk kishte rëndësi vjetërsia, madje nuk ekzistonte vjetërsia në një kohë që nuk ndryshon. Ishte njëlloj sikur një nuse ilire e para dymijëvjetëve ia jepte hua një vajze nga Barbulloja në vitin e tetëdhjetë e pestë të shekullit të njëzet.

KAPITULLI I NJËZET E KATËRT

Liljana Simoni u varros po atë ditë në varrezat e reja në një kodrinë sipër fshatit. Gjithë Barbulloja doli për t'i dhënë lamtumirën e fundit. Kishin ardhur dhe dy burra dhe një grua nga Stomi. Ata ndenjën si të ngrirë gjatë gjithë kohës, me përjashtim të rastit kur gruaja deshi t'i vinte të ndjerës një unazë floriri në gisht. Ndrec Simoni, nuk e la. «Ajo nuk ishte e fejuar», tha. Gruaja nga Stomi u tërhoq pa bërë zë për t'i lënë radhë vajzave të reja të katundit që e mbuluan trupin e së nderës me vjollca, lulekumbulla dhe lot. Gjatë asaj faljeje me të vdekurën, siç e quajnë në Barbullojë, pak-kush e vuri re Agetina Sulin tek futi në arkivol stolitë e vjetra që Skënderi dhe Adriani i kishin rrëmbyer mbrëmjen e kaluar në muze.

Mbaroi gjithçka, në varreza ra heshtja, i fundit prej andej u largua Ndrec Simoni. Ecte duke u kalamendur sa majtas djathtas, herë pas here kthente kokën prapa, vinte duart në rripin e pantollonave dhe ndalej në vend duke baritur me sy rreth e përqark sikur kishte harruar pa bërë diçka.

Çdo vdekje le prapa dhimbjen e humbjes së përgjithëshme të njeriut të dashur që ka qenë, ka folur, ka qeshur dhe që nuk do ta shohim më. Bashkë me dhimbjen, vdekja le prapa një ndjenjë të papërcaktuar pendimi. Na duket se nuk bëmë atë që duhej për

ta parandaluar fundin, madje e përshpejtuam në një mënyrë a në një tjetër. Humbjen tragjike, e cila na jep dritën për të përcaktuar fajin tonë.

Nuk flasim për Desaret Lecin që mjeronte leshra-shprishur rrugëve të Barbullojës.

Fjala është për Ndrec Simonin, që shpiku atë letërën për Adrianin sikur gjoja ia dërgonte Ludovik Margjoni nga Stomi. Ndrecën e zuri pagjumësia e madhe dhe nuk rrinte dot në shtëpi. Për habinë e të gjithëve, shtatë ditë pas mortit, zuri të hapte themelet e një shtëpie të re nja treqind metra larg trojeve të vjetra.

Fjala është për dy kunatat si koshadhe, të cilat u panë tre katër ditë të ecnin në vijë të drejtë dhe me të njëjtin hap një metër larg njëra-tjetrës sikur kishin në mes murtajën. Paskëtaj, u tha se ishin rrahur e ndukur nga flokët prapa mullarëve të bykut. Nuk u panë kurrë më bashkë.

Fjala është për Adrian Mirajn. Me të ndodhi një çudi. Në çastin kur po mbërthenin kapakun e arkivolit, sapo fytyra e vajzës u mbulua përgjithmonë, profili i saj sikur mbiu nga mishi i tij dhe i qëndroi në supin e djathtë. Trupi iu mbush kokrra-kokrra, leshrat iu ngritën përpjetë nga tmerri, por nuk e bëri veten. Një, dy, tre, katër. Brenda kurmit të tij pulsuan si krater ca rrahje të forta damarësh a kushedi çfarë. Ai i numroi në heshtje dhe me shpirt ndër dhëmbë këto rrahje me shpresë se sapo të qetësohej krateri, figurina do t'i shkulej nga supi. Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë... Shemra nuk lëvizi, përkundrazi, sikur u rregullua mirë e mirë në sup. Ai pati frikë të shikonte djathtas, e mbuluan djersë të ftohta, u zverdh si limoni, trupin e ndjeu të rëndë sikur kishte një mal përsipër.

Ai lëvizi qafën paksa djathtas dhe ndjeu një dhimbje të padurueshme. Qafa i kërciti sikur ia kishin futur në allçi. Shemra i kishte sytë të veshur me mjegull dhe vështronte përpara diçka që s'mund të ishte një

pikë, një gjë, një send. Leshrat e Adrianit u ngritën përsëri kas përperjetë, për pak bërtiti «ma hiqni, ma hiqni nga supi!» Ndofta buzët e tij mërmëritën diçka, por ishte mort dhe askush nuk e vuri re.

Rezistoi me shpirt ndër dhëmbë gjer në fund, pastaj krisi e iku duke ngjitur me vrap kodrinat sipër fshatit me shpresë se do ta shkundte nga supi figurinën e vajzës. Më kot! Atëhere u turr drejt shtëpisë, u fut brenda, ra përmbys në shtrat, u vërtit e u rrotullua sikur kërkonte të shkelte hijen e vet, duke mërmëritur me një zë të prishur «ikë, ikë!»

I sfilitur nga lodhja, pasi nuk nxorri gjë në dritë, mbylli sytë dhe qëndroi shtrirë mbi kurriz disa minuta. Pastaj i hapi sytë ngadalë. Figurina ishte përsëri atje, në krahun e djathtë. S'kishte çfarë bënte më. Kushedi, kur ta merrte gjumi, ndofta do të largohej vetë.

I nënshtruar, ai ktheu kokën djathtas dhe ia nguli sytë me tmerr dhe lutje. Shikomë, pra, shikomë! Mos rri ashtu!

... Një valëzim mjegullor, një si tymnajë dhe asgjë tjetër. Ai pati përshtypjen se figurina po shbëhej. Në të vërtetë, kur tymnaja u davarit, figurina shndriti me një shkëlqim të kalteremë qelqi. Pastaj iu bë se lëvizi. Ai u tendos në përgjim duke e kqyrur me bisht të syrit. Ah, ajo po kthehej, po shfaqej e plotë... Truri i tij u godit përbrenda nga ca si stërkala zjarri. Një, dy, tre, katër... Kur të kthehej e gjitha, kushedi çdo të ndodhte. Ndofta atij do t'i mekej edhe ajo çikë frymë që i kishte mbetur. Një, dy, tre, katër... Iluzion! Figurina nuk kishte lëvizur asnjë milimetër.

Atij i shkoi ndërmend diçka. U ngrit nga shtrati dhe vrapoi në korridor. Atje në pasqyrën e madhe të raftit mund ta shihte të plotë fytyrën e saj. Të shohim ç'ka fshehur në faqen e djathtë, mendoi dhe ndjeu ta gicilonte një gëzim i çuditshëm, djallëzor. Tani donte si e si të mos ishte inferior karshi atij mirazhi statik, jolëndor. U qas pranë xhamit të pasqyrës. Atje pa fytyrën e vet të zbehtë dhe të hequr me ca sy si qelqe të pla-

saritur, pa blejtë e flokëve të djersitur, nofullat e shtrënguara, pjesë muresh, një katror drite, ca degë të zhveshura hardhie më tej dhe asgjë më. Ai u habit. Si ka mundësi? Si ka mundësi? pyeste veten dhe afrohej gjithnjë e më shumë gjersa maja e hundës së tij preku xhamin.

Papandehur trupin ia pushtoi një rrënqethje e akullt dhe sa s'kërceu përpjetë nga llahtari. Në pasqyrë, në vend të figurinës, dukej një fytyrë plake. Disa sekonda nuk i ra në të si ishte puna, vetëm pas pak u kthye pra pa dhe pa, të jëmën që afrohej.

Nëna shtangu në vend kur pa sytë e djalit. Atje fikej e ndizej papushim një dritë e keqe si llapsje vullkanike.

—Mos e mbyt veten, bir! Ajo që u bë nuk zhbëhet! — thirri ajo.

— Nuk zhbëhet, — përsëriti Adriani.

— Eja tani të hash bukë! S'ke futur gjë në gojë qyshkur!

— Nuk më halet, — tha Adriani.

— Çfarë borxhi i ke asaj vajze? Thuama ta lajmë bashkë atë borxh!

— Nuk lahet, nënë!

— Zot na ruaj, aq i madh është borxhi?

— Pö.

Ajo hapi gojën të thoshte sërish «thuama». U duk se kjo fjalë i ngriu si allçi përreth buzëve.

— Unë doja ta merrja nuse, — vijoi Adriani. — Unë nuk e mora nuse këtu... Megjithatë... Megjithatë..., — sytë e tij shndritën me forcë sikur do të digjeshin njëherë e përgjithmonë.

— Eh, — psherëtiu nëna dhe zgjati dorën ta përkëdhelte.

— Mos! — bërtiti ai dhe largoi supin. Buzët e hapura të nënës ngrinë përfundimisht në një grimasë mundimi.

— Atë e kam këtu, — vazhdoi Adriani me ton kapriçioz që sikur thoshte «nuk e sheh ti, nuk e sheh!»

— Çfarë ke aty? — kjo pyetje i shkatërroi fare buzët e gruas.

— Atë pra, kokën e Liljanës!

— Qyqja! — u lemerit nëna duke gërvishur faqet.

— Ka mbirë këtu në supin tim. Rri mënjanë! Ta vrasësh nuk kthehet nga unë! Ta vrasësh se shkulet nga vendi. Po ti mos ia kallzo njeriu këtë, — qetësia me të cilën fliste Adriani të kalte datën,

Një vrundull ere u përplas në muret e korridorit. Ata hynë pa folur në kuzhinë. Zjarri i kuq në vatër, avulli mbi kusinë e ujit, zëri i spikeres së radios, pjatat me gjellë mbi tryezë, qëndisimat në jastëkët e mindereve, gjithë dekori i jetës së tyre të përditshme farfurinte me një thjeshtësi dhe intimitet qetësues. Ata u vështruan përsëri me habi dhe mallëngjim sikur i thoshnin njëri tjetrit «sa ftohtë bënte në atë ëndërrën ku ishin qëparë dhe sa mirë qenka këtu».

Të nesërmen dhe të pasnesërmen Adriani brodhi nëpër fshat me figurinën e Liljanës në sup. U mësua me të, nuk i bënte më përshtypje. Ndërkaq sekretin e tij ia besoi edhe Ferdinandit.

Ky e paralajmëroi të mbyllte gojën dhe të tregohej vigjilent me Simonajt. Ata nuk mund të duronin që mirazhi i vajzës së tyre të bridhte rrugës dhe të flinte natën në krah të një djali.

— Gjërat, sidoqoftë, zunë vendin e tyre, — iu përgjigj Adriani me cinizëm. Po atë ditë i hipi urbanit dhe shkoi në Stom.

Kur pas një jave u kthye në Barbullojë bashkë me piesëtarët e tjerë të delegacionit, sekretin e tij ishte marrë vesh. Dhjetra njerëz vrapuan për ta parë atë diabolosh të pashëm që ishte tharë e tretur sikur kishte qenë ne napsanë. Desaret Leci i pari nuk nguroi të shtrinte kafën e gjatë dhe të pyeste:

E ke akoma atë te supit?

— Jo, ka ikur, — gënjeu Adriani. U duk se kjo përgjigje e shoi kuriozitetin e të pranishmëve, por nuk ndodhi kështu. Tani njerëzit vinin grupe-grupe për të

mësuar një sekret edhe më të madh që turbulonte prej kohësh ndërgjegjen e tyre: sekretin e Stomit.

Përtej, në rrugën para hotelklubit «Ngjala» duke i rënë ballit me pëllëmbë, duke i hedhur turmës pa hesap vështrime sarkastike, duke qeshur e duke skërmitur dhëmbët, vinin e shkonin si në lojën «ik e eja» Jetmir Cubi dhe Festim Ndoja. Ibër Rama po ashtu zgërdhihej në shtëpinë e vet. Qysh se i ndodhi ajo historia me gjelin nuk e nxirrte hundën përjashta. Ai kishte vendosur t'i kthente familjes me pendë e me kartë dinjitetin e lëkundur. Po shkruante kujtimet e luftës me bandat e diversantëve në vitet e para të çlirimit, kur edhe ishte plagosur në krah nga një cifël bombe. Ajo që shkruante ai, sipas Terezës, quhej as më pak, as më shumë histori. Të shqydhesh gazet! Të flakësh në zjarr libra, shënime, skeda, relikte e gjithçka! shfrynte i pezmatuar Dodë Balsha. Gaspri, që pas shumë dilemash e tronditjesh ishte rikthyer në krye të detyrës, nuk arrinte ta kuptonte mirë përplasjen e dy shkrimtarëve të Barbullojës, kështu që gjyqin e tyre s'kishte kush ta ndante tjetër.

Anëtarët e delegacionit kaluan përmes pluhurit që ngrinin këmbkat e vogla të kalamaneve dhe hynë në zyrën e kryetarit. Sikur mezi kishin pritur çastin të veçoheshin nga sytë e njerëzisë, zunë të vështroheshin vëngër. Ishin grindur e përçarë. Grindja kish filluar qysh se dy prej tyre dhe pikërisht Vlash Keqi dhe Lekë Kunora harruan fare përse kishin shkuar në Stom, u dhanë pas qejfeve e gostive, e keqkuptuan sjelljen e lirshme të vajzave dhe për pak sa nuk bënë skandal.

— Ç'keni kështu? — i pyeti Gaspri. — Mos ju pritën keq në Stom?

Luigj Ndreka, një komunist i ri, që kryesonte delegacionin tregoi fill e për pe rreth qëndrimit të Vlash Keqit dhe Lekë Kunorës. Këta të dy ngritën krye. Nuk pranuan se e kishin shpërdoruar mikpritjen dhe aq më pak ta kishin tepruar me të ngrëna e me të pira. Po.

Ata vërtetë kishin ngrënë e kishin pirë si në dasëm, por ama kishin ngrënë e kishin pirë çfarë u kishin nxjerrë përpara familjet ku kishin bujtur netëve. Ndërkaq ishin shumë të pakënaqur që pjesa tjetër e delegacionit i kishte lënë disi mënjane, në minoritet, duke treguar mosdashjen për t'i patur anëtarë. Dhe kur ata të dy kishin guxuar të ngriheshin kundër nënvlerësimit që bënte mu, pjesa tjetër e delegacionit, Luigj Ndreka i pari, i kishin kërcënuar deri në përdorim dhune. Por meazalla se i kishin spostuar nga detyra. Në kushte të vështira ata kishin vazhduar punën.

Për t'i mbushur mendjen Gasprit se vërtet nuk kishin shkuar në Stom për piknik, zunë të tregojnë si papagallët se si kishin rrëmbyer nga përvoja e atjeshme shumë e shumë gjëra të vyera, siç ishin dituritë për gatimin e zarzavateve dhe gjellëve të tjera me emra të panjohur, recetat e të cilave, edhe ata, posi, i kishin shënuar me hollësi nëpër blloqe. Ndërkaq ata kishin ç't'u rrëfenin bashkëfshatarëve për kulturën e shërbimit dhe të ngrënies në Stom ku luga, piruni, thika dhe peceta ishin kurdoherë ndanë pjatave plot. Në Stom s'bënte vaki t'i hanin frutat pa i shpëlarë mirë e mirë, peshkun e bënin tavë, e bënin supë, e fërgonin, e piqnin, e rreshknin po kështu edhe putarkën dinin ta gatuanin si lum ata. Po qumështin? Mos vallë e zinin në kusi dhe fap e derdhnin sipër përshesheve? Jo, jo! Kur numëruam nënproduktet që nxirrnin ata nga qumështi, na erdhi turp që ne këtu si injorantë që jemi, edhe kur e kemi ndonjë pikë, e hedhim sipër përshesheve... Në Stom njerëzia i mbanin rrobat e shëtitjeve e festave veç...

Gasprit i kishte mbërthyer sytë mbi fytyrat e tyre të ekzaltuara si për të kapur shfaqjen e një sinjali sado tinzar të ironisë. Por ndofta ata flisnin singërisht, seriozisht dhe atij se si i erdhi. Thartoi fytyrën dhe belbëzoi mjaft! Pastaj:

— Po kallzuat nga këto gjëra or miq, na hodhët në erë!

— Si t'i keni rregullat! — thonë me një gojë Vlash Keçi dhe Lekë Kunora. — Po është për ta mbyllur, e mbyllim, S'themi gjë ne! Ja ku po ju betohemi për nder e për flamur...

Acarimet mes anëtarëve të delegacionit shpërthyen përsëri. Adrian Miraj përfitoi nga rrëmuja dhe doli. Kishte mall të shkonte në shtëpi, kishte mall të zbrishte në fushë, kishte mall të dilte nga kodrat...

Në fushë ishin varrezat e vjetra. Në pjesën juglindore të fshatit, atje ku kodrat dukeshin si kuaj të përgjunjur, ishin varrezat e reja. Ai nuk u trembej kujtimeve, shemrën e mjegulluar të Liljanës e kishte përsëri në supin e djathtë. Kishte pasur çaste gjatë ditëve në Stom kur imazhi ishte zgjyrosur e shkonturuar deri në prishje. Ai e kishte vuajtur fizikisht këtë ndryshim, duke e ndjerë si vdekje të dytë të Liljanës. Por kishin ardhur pastaj orë më të mbara kur imazhi ishte ftilluar përsëri.

Adriani mori rrugën drejt kodrave veriore të fshatit. Bënte ftohtë, qielli ngjyrë plumbi premtonte rreshje bore. Lulekumbullat e çelura para kohe këputeshin si copa kristali, kurse sythat e shegëve të egra ngjanin me buburreçka të ngrira.

Diku ndanë rrugës pa Aleks Balshën. Ai po gdhente me daltë inicialet e emrit të vet në faqen e një shkëmbi. Ishte shpërthekuar i gjithi, djersët i kullonin rrëke nga balli deri poshtë në gropën e gjoksit. Ndofta kishte gdhendur shumë inicialet në rrastra e shpatit, ndofta daltë nuk i punonte mirë, kush e merrte vesh.

— Puna e mbarë, usta! — foli Adriani.

Aleksi u tremb. Lëshoi daltën dhe çekiçin sikur po bënte një punë të ndaluar.

— Ç'je dobësuar kështu, më fute tmerrin! — tha me gjysëm zëri Aleksi tek futi veglat në çantë dhe çau me ngut përmes shegëve.

Flokërleshur, i trallisur që një njeri ishte trembur aq shumë prej tij, Adriani mori rrugën përpjetë duke

vështruar me bisht të syrit figurën e mjegulluar, dëshmitaren memece që e kishte katandisur në gogol për të tjerët. Befas, në krye të shtegut dalloi vizllimin e fortë të dy syve. Dora e ngritur te supi iu këput si degë e prerë. Ngriu në vend. Njeriu përballë ishte Sokol Simoni.

Sokoli hodhi katër pesë hapa të vullshëm përpara dhe u ndal. Adrianit iu kujtua paralajmërimi i Ferdinandit për t'u ruajtur nga Simonajt. Ah, sikur e kërkova me dashje këtë fat sot, mendoi duke e perceptuar më qartë se kurrë shkretimin e vendit rreh e përçark. Të tjerët me siguri ishin fshehur midis shëgëve. Ata e kishin vënë re dorën e tij duke u ngritur drejt supit dhe kjo ishte njëlloj si ta kapnin në flagrancë. Ishte e pakuptim t'ia mbathte. Vetvetiu shtrëngoï grushtat dhe u përgatit të përleshej me cilindro që do t'i dilte përpara derisa të kishte fuqi, derisa të rrëzohej pa ndjenja! Mua mund të më shtrini këtu, por «atë» nuk ma rrëmbeni dot, mendoi në të dhjetën e sekondës.

Për çudi, në fytyrën e Sokolit nuk kishte kurrfarë agresiviteti, kurrfarë ngjasjeje, por një si harrim të përmallshëm, një si dehje të mjegullt. Dy metra larg Adrianit ai u ndal dhe e pyeti për «atë».

Adriani pohoi me një lëvizje gati të padukshme të kokës. «Ku? Ku? Ku?» thirrën sytë e nderur të Sokolit. Ai vuante sepse nuk shihte gjë.

Figurina shndërrohej vazhdimisht në njollë të zezë. Djaloshi i Simonajve me atë fytyrën melankolike nuk lëvizte asnjë grimë nga vendi. Në sytë e tij kishte vërshuar një mall i ri që Adriani, i nervozuar ngaqë figurina po nxihej, e quajti me mendjen e tij mall dinak, të egër.

Një rrënoqethje e shpejtë i shkoi nëpër trup, i hodhi djaloshit një vështrim plot përbuzje dhe u kthye të ikte. Sokoli i ra pas me ngut.

— Unë kam qenë me ju! — zuri të fliste ai duke iu marrë fryma. — Isha kundër Shtjefnit, kundër Ndre-

cës, nuk doja që ajo të fejohej në Stom, nuk doja ta ndanin prej teje. Liljana vetëm mua më donte. Por, isha i vogël...

— S'të vjen rëndë! — thirri Adriani i pavendosi — Unë nuk jam altar ku lahen mëkatet.

Sokoli u skuq. Sytë e tij shkrepëtinë nga zemërimi.

— Faji im është se s'kam bërë asgjë konkrete për ta ndihmuar Liljanën. Po ky është edhe faji yt! Nëse figura e saj të doli në sup në shenjë shpagimi që ke qenë vetëm kalorës i fjalës, atëherë figurën duhej ta kisha edhe unë këtu, — tha djaloshi duke i rënë me dorë supit të djathtë.

Adriani u mpi krejt nga shpërthimi i papritur i djaloshit.

— Çfarë kërkon nga unë? — pyeti me gjysmëzëri.

— Bashkëfajtorin...

— Ja ku jam..

Ata, u vështruan disa sekonda. Pas kësaj sikur u ndien më të qetë. Vazhduan rrugën pa folur.

— Fajin tonë nuk e di askush, — tha djaloshi, duke mbledhur supet sikur mërdhinte.

— Askush, veç nesh.

— Keq, shumë keq. Shumë më keq se të na tregonin me gisht.

— Keq, — përsëriti Adriani.

— Do të na rëndojë gjithë jetën.

— Gjithë jetën!

Sokoli ngriti jakën e xhakoventos. Fytyra e tij, u duk më e vogël, më e imët. Përshëndeti me dorë pa e kthyer kokën dhe u shmang në një shteg majtas.

KAPITULLI I NJËZET E PESTË

Adriani u end andej-këndej nëpër kodra e lëndina, pa guxuar t'u afrohej varrezave të vjetra, ngaqë, siç ia merrte mendja atij, atje mund të ndodhte ndonjë hata tjetër. Aty afër mbrëmjes zbriti në qendër të fshatit.

Përpara dritareve të shtëpisë së kulturës ishin krijuar katër rreshta njerëzish që merrnin rrogat e pesëmbëdhjetë ditëshit. Pak më tej pesë gjashtë djem luain «bis». Kapelet u fluturonin nga koka sa herë jepej goditja dhe ata, të gjithë njëherësh, kërcenin përpjetë dhe rrihnin tokën me shputat e këmbëve duke thirrur e bërtitur si të marrët. Adriani u përpoq të mos u binte në sy, por ata vrapuan drejt tij duke lëshuar britma pakuptim, e futën në mes dhe zunë të vërtiteshin si rrotull një preje. Sytë u shkëlqenin ndërsa nxirrnin nga goja ca zukama të zgjatura «biiiiis, biiiiis». Ata po provonin trimërinë e tyre përballë jeremitit që porsi në balladat e vjetra, shoqërohej me hijen e një të vdekure.

Kur pa se ata nuk kishin ndërmend të sprapseshin, kur vështrimet e tij hakërruese u harxhuan si fishekzjarrë, Adriani lëshoi një bulërimë që të ngjethte mishtë.

Njerëzit që merrnin rrogat kthyen kokat me habi dhe panë Adrian Mirajn që vështronte në tokë krejt i pikëlluar.

— Ç'të gjeti, o Ad? — e pyeti Artan Boci që mbiu para tij si nga dheu.

Adriani tregoi me kokë djemtë që iknin drejt hotel-klubit.

— Ata faqezinjtë! Dëshën të lozin me mua!

— Ç'të keqe ka që ata duan të lozin me ty?

— Këto lodra boshe më ngjallin krupën! Këto lodra dhe ato shprehje të marra «shkova në prru»! — tiparet e tij u shtrembëruan si të kishte pirë farmak. Artani u bë i heshtur.

Drejt tyre, duke tundur një tufë të vogël parash, po vinte Ferdinandi.

— Kësaj i thonë puno fatkeq, ha barkdreq! Jepi Ferdi! Forca Ferdi! Në kanal i pari! Kudi i pari! Vetëm në pagë nuk është i pari Ferdinandi. Plasa duke thirrur: Ore Palush aga, pse m'i vjedh pikët? Po kush më dëgjon? Tani s'kam rrugë tjetër veç të shkul një hu në gardh dhe t'ia vesh kurrizit.

Ferdinandi i luti shokët të shkonin me të në hotel-klubin «Ngjala», i sigurt se Palushi ndodhej atje si gjithmonë ditën e ndarjes së rrogave. Dhe vërtetë: Palushi ishte ulur në një karrige pa tryezë përpara dhe pinte duhan këmbë mbi këmbë.

— Prapë m'i ke vjedhur pikët! — bërtiti Ferdinandi nga larg. Sytë e Palushit u përpëlitën fshehurazi nën strehën e qerpikëve. Një buzagaz i lehtë u ravijëzua në të dy anët e faqeve të tij me prenka. Ashtu u duk i patundur dhe i rregjur ndaj shpërthimeve kritike të njërit apo tjetrit. Ferdinandi, u step si përballë një mumjeje. Me duart që i dridheshin nxorri nga xhepi bllokun e vogël, e hapi para brigadierit dhe pyeti me një qetësi të vështirë:

— Ku i çon pikët e vjedhura? Dua ta dëgjoj nga goja jote. Ta marrin vesh të gjithë.

Trupi i mbushur i Palushit brufulloi nën rroba, gishtat e tij u zgjatën si çataj mbi gjunjë.

— E ç'më duhen mua pikët tuaja. Unë paguhem më ditë fikse, — tha me përtesë.

Një burrë i ngrysur me xhaketën hedhur krahëve, rrinte në këmbë afër dritares dhe mbante vesh debatin e Ferdinandit me brigadier Palushin. Ky ishte Skënder Abdyli.

— Përgjigju! — i briti ai brigadierit — Ç'më përdridhesh si kurvë plakë!

— Shiko, shiko! Avoketërit! — ia bëri Palushi duke gërveshur buzën e poshtme. Fërgëlloi prapë me një ndjenjë bezdie që iu prish qetësia dhe tha: — Unë kam zyrë. Po të ketë gjë ky miku juaj, le të vijë në zyrë. Por, — vijoi duke e ngritur zërin një shkallë më lart, — kjo s'do të thotë se në kohën e lirë jam i shfuqizuar nga detyra. Prandaj mendjen në kokë! Mos bëni lojra me zarar seee... S'ta merr mendja, ë? — shtoi Palushi duke shëtitur sytë e vegjël në gjithë gjerësinë e lokalit. Se nga u shfaq Dodë Balsha, i cili shqiptoi me një zë solemnisht nervoz:

— Nuk lejohet të flitet kështu me kuadrot!

Kishte lidhur në qafë një shall të madh ngjyrë kafe, skajet e të cilit i vareshin si shirita në të dy anët e krahërorit. Fytyra e tij përfytyronte skulpturën e një oratori që predikon ndalimin e çdo gjëje.

Qepallat e Palushit u rrëzuan ngadalë sipër syve. U duk sikur fjeti.

— Dëgjo, ti Ferdinand, — tha duke e trashur zërin më shumë se zakonisht. — Ndofta ti dhe shokët e tu e keni për bezdi të merrni urdhëra, jeni kundër urdhërave, kundër drejtuesve, por kështu është ndërtuar jeta, — ai anoi sytë ironikë djathtas nga dera, pastaj majtas në drejtim të Vlash Keqit që mbante vesh i përqëndruar pak më tej, gati për të thënë fjalën e vet në çastin e duhur. Ndërkaq, me një lëvizje të prerë të dorës, ngriti strehën e kapeles. Një tufë flokësh të zinj, të lagur nga djersa i shkëlqyen nën dritat e lokalit. Vështrori orën e dorës, pastaj derën, pastaj përsëri Vlash

Keqin. Gjithçka në lokal sikur u tkurr nën peshën e heshtjes që pasoi. Gotat nëpër tryeza dhe në banak u dukën butaforike dhe po ashtu, e rrejshme dhe jashtë realitetit u derdh në lokal zhurma piskatëse e frenave të një makine. Brigadier Palushi zgjati dorën dhe i mori Vlash Keqit gotën që ai e kishte mbushur me uzo për vete. Sakaq në lokal hynë njëri pas tjetrit dy punonjës të policisë kriminale dhe një civil me fytyrë shumë të madhe, me vetulla kaleshe dhe me flokët e lartuar në dy cepat e ballit si brirë. Ata përshëndetën me edukatë gjithë të pranishmit, hoqën çantat nga supet dhe zunë të shfletonin disa defterë. Oh, sa të pamposhtur dukeshin me ato defterë nëpër duar! T'ua hiqje ato, ishte njëlloj si t'u hiqje gjymtyrët.

Pasi i kontrolluan defterët, u kthyen nga Skënder Abdyli. Civili me vetulla kaleshe i buzëqeshi pak, si për t'i përcjellë tjetrit diçka prej triumfit të vet, pastaj iu drejtua me këto fjalë:

— Ne të dyve na merr malli për njëri-tjetrin, or mik. Vemi nga vemi dhe na përpiqen rrugët.

— E po njatjeta, pra! — ia ktheu Skënderi.

— Njatjeta e mira! A është nevoja të tregohemi transparentë para ketyre burrave apo vemi në «shtëpinë time» dhe e bisedojmë punën kokë më kokë?

— Si të dëshironi, — tha Skënderi.

— Bukuri! Bukuri! A më lejoni t'ju bëj një pyetje sqaruese para se ta bisedojmë punën kokë më kokë në «shtëpinë time»? Qëllimi është të kursejmë pakëz kohë, domethënë, të mos vijmë vërdallë poshtë e përjetë... A t'ua bëj pyetjen?

— Çjanë këto metoda «a më lejoni, a tua bëj?»! — u ankua Vlash Keqi.

— Transparencë! Transparencë! — thirri brigadier Palushi.

— Durim, burra! — tha civilin me vetulla kaleshe, duke shtrirë duart përpara. Pastaj nga Skënderi:

— A ndodhet «ai» këndeje pari? Fjala është t'i bëjmë një ftesë qysh sonte dhe kështu i dalim punës në fund njëherë e mirë.

— Tani më ngatërrove, — tha Skënderi.

— Ja, fillove nga kthesat! — tha me qortim civil i me vetulla kaleshe. — E mira jonë e përbashkët është të ecim drejt, pa bërë kthesa kot! Si thua?

— Pajtohem, — tha Skënderi.

— Atëherë: A ndodhet «ai» këndeje pari?

— Nëqoftëse e keni fjalën për Adrian Mirajn...

— Jo, mor jo! Ç'na ngatërro me një të sëmure! Kujtohu pak! Kujtohu pak për atë tjetrin. Hë! Hopa! Hyjo! Psssst!

— Sinqerisht nuk di ç'tju them! — tha Skënderi.

Civili me vetulla kaleshe u ngrys. Balli i tij i ngushtuar nga rrudhat sikur humbi mes leshrave të vetullave dhe kokës.

— A kishe ndërmend ti t'ja shisje stolitë e vjetra një italian, njëfarë Aldoje që vjen vërdallë në këto anë gjoja sikur po studion lagunat? — bërtiti ai.

— Jo! Në asnjë mënyrë jo, — tha Skënderi

— Mos m'u hiq si çamarrok matuf mua? — u nxeh përfundimisht civil i me vetulla kaleshe. — Ehu, sa kam parë unë! Desha të merremi vesh si miq. Dhe akoma kam shpresë! Eja! Eja vemi në «shtëpi». Atje kemi kushte për të vënë në punë kujtesën!

Skënderi veshi me qetësi xhakëtën dhe u shkoi prapa dy policëve. Ai nuk begenisi të përshëndeste njëri, por në dalje, ndërsa njëri nga policët kontrollonte në çantë prangat, ai u kthye nga salla me duart gati për t'u lidhur dhe briti:

— Askush të mos guxojë të lajmërojë Mitron! Morët vesh! Askush!

KAPITULLI I NJËZET E GJASHTË

Adriani priste nga dita në ditë ta thërrisnin në polici. Aq u familjarizua me këtë ide, sa filloi të mërzi-tej përse po e linin të lirë. Sigurisht Skënder Abdyli nuk kishte kallzuar as bashkëfajtorin, as vendin ku kishte përfunduar stolitë e grave ilire. Por nuk ishte e drejtë që ai të vuante vetëm për një çështje që kishte të bënte me Adrianin. Këtij herë pas here i shkonte mendja të dorëzohej vetë. Që duke e marrë këtë vendim, sidomos ditën kur Adilja me vajzat u larguan nga Barbulloja dhe shtëpisë së tyre iu vu dryni. Por në castin e fundit gjynahu e mposhti. Figurinën e Lilianës e kishte ende në sup. Se si i vinte të mbyllej bashkë me të në qeli, nën vështrimet e vëngërta apo sjelljet e vrazhda të policëve. Më mirë të priste edhe pak kohë. Po vinte pranvera dhe, kur vien pranvera, fantazmat largohen, thuhet në Barbullojë.

Ditët e para të marsit erdhën bashkë me një gëzim të përgjithshëm, fluid. Adriani e dinte: gëzimi i fytyrave të rreshkura nga era, përveçse me pranverën dhe me braktisjen e gjuhës së lodhshme dimërore të gjesteve, kishte lidhje me ndërrimin e kryetarit të kooperativës. Lajmi ishte marrë vesh: Gaspri do të zëvendësohej me një tjetër. Mendja e Adrianit e futi këtë fakt në kuadrin e gjërave të mërziqshme të jetës. Kështu na e hedhin vazhdimisht, — tha me vete. Duke ndë-

rruar kryetarët, duke na ngjallur shpresa të harruara, duke na falur gëzime të rrejshme. Dhe ne kujtojmë, oh, gjithnjë kujtojmë se të këqijat krijohen afër nesh, se të këqijat krijohen prej gabimeve të njërit apo tjetrit që është taksur të flijohet. Të gjitha shpresat tona i kanë fillesat nëpër fli dhe kjo është e tmerrshme. Në këtë jetë që na u dha kështu siç është nuk është e mundur të shpëtohet prej këtij mashtrimi. Ndofta në një jetë tjetër, kryekëput tjetër, por edhe atëhere pas shumë vitesh, kur flitë nuk do të jenë kurbane për t'u lartësuar demagogët.

Të dielën e parë të marsit, gjithë në vigjiljen e një ngjarjeje të hareshme që s'kishte ndër mend të ndodhte, por që e pushtoi edhe atë, Adriani e harxhoi ditën në lagunë. Atje e pa për herë të parë nga afër napoletanin e hijshëm, Aldon. Ishte më i vjetër se sa kishte kujtuar Adriani. Bashkë me nja dy burra të tjerë, i ranë kryq e tërthor lagunës, pastaj u ngjitën të gjithë në ballkonin e hidrovorit dhe zunë të vështronin një hartë.

I ziu italian, mendoi Adriani. Nga ta dijë se policia shqiptare po bën hetime rreth implikimit të tij në vjedhjen e vlerave kulturore të zonës? Saora e përfytyroi veten në polici, krahëpërkrah me Skënder Abdylin dhe me napoletanin. Si t'i thoshte atij se Liliana kishte vdekur, se stolitë e grave ilire ia kishte dhënë Agetina Sulit për t'ia futur të ndjerës në arkivol? Si ta shkatërronte gjithë këtë lëmsh që ushqente me bukë dhe me karrierë një skuadrilje policësh e hetuesish? Ai nuk dinte asnjë fjalë italisht dhe përveç kësaj, sepse kishte përshtypjen sikur napoletani nuk do të kujtohej fare për Lilianën, me siguri nuk do të kujtohej, kurse Adriani kishte dëshirë që ai të kujtohej, të prekej, të derdhte lotë, të mblidhte lule për varrin e saj.

Në mbrëmje u mbyll në dhomën e tij. Dang-dang-dang, ia bënte zemra.

Një vështrim tinzar djathtas. O zot! Figurina gj-

thashtu gufonte dhe ai mendoi se edhe atje do të vërshonte limfa e jetës. Ai pulsim i brendshëm i jepte imazhit forma të tjera që Liliana nuk i kishte patur.

Të nesërmen në mëngjes i doli gjumi vonë. Rrinte symbyllur në shtrat, duke ndier lodrimin e praruar të dritës së mëngjesit. Pas pak i hapi sytë dhe vuri re se figurina nuk ishte në supin e tij të djathtë. Instinktivisht kërkoi me gishtërinj nën jastek dhe në çarçafe. Një valë e beftë drithërimash ia përshkuan trupin. S'deshi ta besonte se figurina kishte ikur. I mbylli sytë prapë si për t'i dhënë kohë të kthehej. Kurmi i tij po ngurtësohej si trung mbi heshtjen e dhomës. Më në fund i hapi sytë. Asgjë. U ngrit përgjysmë, u kthye me vrull djathtas, u përdrodh mbi dyshek, duke tendosur me duar çarçafët e zhubravitur, u drejtua përsëri dhe kontrolloi me një shikim të llahtaritur të katër qoshet e dhomës. Zbrazëtirë e plotë, U ndie bosh sikur ia kishin hequr rropullitë e brendshme dhe gjakun. Filloi të dridhej i gjithi. I dukej se në supin e djathtë, në vend të mishit kishte një lëndë plastike pa peshë. Liliana kishte rivdekur dhe ai ishte vetëm në rivdekjen e saj.

Diçka si joshje, si grishje e fortë i regëtiu në shpirt. Më mirë të kishte shkuar me Skënderin! Dhe ndërsa shqiptonte me vete shpejt e shpejt këto fjalë, pati përshtypjen se këmbët po i mblidheshin si flatra nën sqetull dhe pas pak do të fluturonte.

KAPITULLI I NJËZETË E SHTATË

Ajo grishje e pacilësueshme për tu bashkuar me Skënderin mbeti përsëri pezull për shkak të një shprese të pakryeshme që erdhi me lulemollët e barin e ri. Por shumë shpejt njerëzit zunë të vështroheshin me një ndjenjë boshllëku si për t'i kujtuar njëri-tjetrit diçka të harruar. Dukej shpikur një histori, një shaka e përgjithshme.

Fantastët po vrisnin mendjen, Gjergj Sherri po sajonte historinë «Ibëri me vashat e reja të parajsës», kur një pasdite, në lagunat përfund Stomit në perëndim u dëgjua deri në Barbullojë një kujë e mprehtë dhe e thekshme. Jehona e saj u përhap rënkueshëm si një mbushje eksplozive. Mbi fshat mbi rrugët, mbi oborret mbretëroi një heshtje e thellë. U duk se edhe era nuk fërshëllente më. Britma u përsërit edhe katër herë të tjera, por kur ra nata nuk u dëgjua më. Të nesërmen gjithçka filloi nga e para.

Ajo kujë misterioze e tronditi krahinën. Nja dhjetë-pesëmbëdhjetë burra nga Barbulloja u nisën menjëherë në Stom për të marrë vesh. Shumica e njerëzve shfaqën mendimin se një kafshë gjigande ishte futur përmes detit në baltovinat e kënetës dhe po jepte shpirt atje, e pafuqishme për t'u rikthyer në det.

Cila kafshë? Si e ka emrin? Pse nuk është ndërjerë më parë? — nxituan të pyesnin bestytët dhe pasi nuk

morën përgjigje, nxorrën versionin se shpirtat e brez-nive të vdekur, zhytur në baltë për shkak të mëkateve të të gjallëve, rënkoin kundër atyre që s'besonin më në Krisht e në Muhamet. U tha gjithashtu se nuk rënkoin shpirtërat, por bushtra mitologjike dhe vetë toka e kërcënuar nga qielli i zotit dhe engjëjve për t'u shndërruar në akullnajë.

Erdhën lajmëtarët nga Stomi. Ata thanë se njerëzit atje kishin nxjerrë kushtrim, ishin tubuar në qendër të fshatit dhe ishin nisur me radhë të shtrënguara drejt lagunës. Kur qenë kthyer ishin të zbehtë dhe mezi flisnin. Britma nuk lokalizohej dot, nuk kishte një burim, një qendër. Ajo dëgjohej me të njëjtën forcë në gjithë gjerësinë e lagunës. Kishte përshtypjen se nuk dilte nga poshtë, por binte nga lart. Banorët e shtëpive afër lagunës ishin shpërngulur te kushërinjtë e tyre në thellësi të fshatit. Megjithatë, pasditeve sopet e kënetës mbusheshin me njerëz të guximshëm nga Stomi, nga qyte-ti e fshatrat përreth që shkonin për të shuar kuresh-tjen.

— C'thuhej? — i pyeti dikush lajmëtarët.

— Mendohet se nën truallin e lëvizshëm të lagunës hapen golla të mëdha ku bie me zhurmë shurdhuese uji i shtuar nga baticat detare.

Varianti i katarakteve të nëndheshëm i nxiti disa burra të shtriheshin përdhé dhe të vinin veshin në tokë si Dhevështruesi i lashtë. Nuk dëgjohej gjë pos mërmë-rimave të buta të tokës në fillim të pranverës. Njerë-zit zunë të shpërndaheshin drejt shtëpive, të qetë dhe të lumtur që ndodheshin larg Stomit fatkeq. Po kur ra mbrëmja, u kuptua se britma e çuditshme kërkonte viktima edhe në Barbullojë. Kishte humbur Desaret Leci. E ëma dha alarmin e para. Ma ndjente zemra se do t'i ndodhte diçka! Qvsh se zuri fill ajo e mallkuar ulërimë s'vinte gjumë në sv... U pyetën pothuajse gjithë djemtë e fshatit. Asnjëri prej tyre nuk e kishte parë Desartin atë ditë. U muar në telefon Stomi, u pyet

mos ishte dukur andej pari një djalë i tillë e i tillë. Hiç. Njerëzit e grumbulluar para zyrës së rojes operative po merrnin vendim për të nisur pa humbur kohë kërkimin e Desartit, kur panë të vinte drejt tyre duke u përkundur, duke u zgërdhirë e duke bërë me dorë nga mali memecin Hysen. Po. Po. Ai e dinte ku fshihej Desareti dhe ishte shumë i lumtur që e dinte. Fytyra e tij rrezatonte gëzim. Atje, atje, atje! — ia bënte duke përplasur buzët. Papritur u kthye dhe i ftoi njerëzit t'i viheshin pas.

Tridhjetë minuta më vonë Desareti u gjet. Ishte rehatuar në shpellën e Kajanit, kishte ndezur zjarr, kishite shtruar kashtë nën brinjë dhe po ngrohej për shtatë palë qeife si një komit i vogël.

* * *

Befasimi dhe frika e parë kaloi. Në Stom mbërritën dy studiues të faunës nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës. Ata ngritën menjëherë çadrën në afërsi të lagunës. Prania e tyre e shtendosi pritjen e njerëzve.

Ndërkaq në Barbullojë u ngjall dëshira e vjetër për t'u shpotitur me stomianët. Rasti i britmës misterioze u dha rast gaztorëve të krijonin epigrame dhe vjersha të tëra ku parodizohej kapitullimi i burrave më të përmendur të Stomit para një ngjale. Këta trima përshkruheshin në çastet e përbetimit për t'ia mbyllur givrykun sokëllimës dhe për t'i sjellë vendlindjes paqen dhe qetësinë. Pastaj tregohet se si shkëputeshin nga duart e lebetitura të grave dhe niseshin me këmbë, me kuaj, me xhipse, me karpate, me aro, sipas pozitës që kishin, drejt sheshmejdanit. Atje, papandehur u lroheshin teshat në trup, u holloheshin kërcinjtë e duarve dhe të këmbëve, u hinte të fikët, ngriheshin dhe iknin të tmerruar sapo kafsha e egër klithte. Pas kësaj zinin shtratin, nuk josheshin pas grave, flinin keq duke folur përçart gjëra të frikshme.

Kështu u krijua një baladë e plotë, e cila u përhap në tërë krahinën. Ishte revanshi i Barbullojës ndaj Stomit. U provua edhe një herë se njerëzit e atij fshati ishin të pajisur me sensin e zhvleftësimit të gjërave dramatike. Çdo ngjarje e zyrtë ka në vetvete një lastar gëzimi. Në Barbullojë kapeshin pas këtij lastari.

Kur britma nuk u dëgjua më, kur dy studiuesit e faunës vërtetuan se kafsha e çuditshme kishte qenë një fokë barkbardhë e ujërave mesdhetare që kishte hyrë përmes lumit në kënetë dhe aty kishte ngecur në balte duke lëshuar kësisoj klithje të dëshpëruara; pra kur u kumtua në shtyp ky lajm dhe fakti tjetër se foka kishte mundur të dilte më në fund në det, si kujtim i saj mbeti pikërisht parodia miqësore e Barbullojës.

Adrian Miraj përsëriste nën zë disa prej vargjeve dhe qeshte me vete: Specialistët dhanë mendim/ Me provu edhe një trim/ Trim i marrë, gjarpni i tokës/ Shok i ngushtë i Kolë Bib Gjokës/ Qet prej goje tym e gaca/ Emri i tij Llesh Pjetër Paca.

Po shkante të dorëzohej në polici. Ishte ora.

Gra të veshura me rroba të lehta si për festë dhe me kova në duar shkëmbeheshin me të rrugës duke e stërpikur me ujë dhe lule. Ishte e dielë, dita e parë e pranverës. Gjithkund në oborre shikoje enë të mbushura me ujë dhe bar të ri, pleq të bardhë me gjyslykë që vëzhgonin pikimin e hardhive, fëmijë me kurora lulesh në kokë që vraponin të kapur dorë për dore drejt kodrave të gjelbëruara mbi fshat. Diçka e brishtë, miturake dhe e padukshme rrëshqiste në ajër dhe kishte ndjesinë se edhe toka, edhe qielli kishin një moshë foshnjore.

Lart në kodra binin tupanat e valleve. Vajzat të pastra dhe të lehta gjeth kërcenin, gra të mallëngjyera shpërndanin cirkat e ujit përzier me petale lulesh mbi këdo që u shkante pranë.

Adriani u ngjiti deri te muret e shtëpisë së re të Ndrec Simonit dhe mbajti hapat. U desh një fli që

bajraku i sëmurë i Simonajve të çthurej, mendoj dhe zuri të ngjitej rishtas pa lehtësinë e pakmëparshme. Në kujtesë i vërshuan mbrëmjet e lehta të vjeshtës kur kalonin bashkë me Liljanën poshtë hurmave dhe mbarë bota përçark sikur mbështillej me një rrjetë vibruese ajri. Atë e pushtoi një trishtim i thellë që hurmat do të skuqeshin prapë, që bota ku kishte jetuar Liljana ishte, ndërsa vetë ajo nuk ishte. Jo, nuk është ky thelbi tragjik i vdekjeve, tha me vete. Të gjithë ne, të gjithë banorët e rruzullit tokësor... Një kob që iu mblodh në grykë ia ndërpreu mendimet.

Ai doli te livadhet ku ishin mbledhur shumë njerëz.

Djemtë kishin hedhur në qafë kurora me bar dhe degë dafine. Me këto kurora ata joshnin vajzat që lajkatoheshin përballë tyre me ca kërcime të lehta sikur kishin pupla në këmbë. Grishje sysh, lajmërimë, premtime, thirrje të veshura me një garniturë lulesh dhe kaltërsie.

Artan Boci i dha një kurorë. Adriani e vuri në qafë dhe zuri të largohej kokulur, me duart e lidhura pas shpine, duke i hedhur hapat me kujdes sikur shkelte në një terren të sfungjertë. Zemra po i plaste nga agushtimi.

Ecte ngadalë, pa ditur ku po shkonte e përse. Qie-lli rrezatonte pa kursim një dritë të kaltër dhe shumë të pastër, në një çast ai ngriti kokën me një parandjenjë se atje do të shihte fytyrën e vet si në pasqyrë, pastaj duke ndier valën e një trazimi të ri, i uli sytë në kra-hëror gjithë i përgatitur të shihte si në rontgen bren-dësinë e vet.

Kishte arritur në pyll. Tani njerëzit ishin kudo, megjithëse nuk dukeshin. Ai u mbështet pas një guri mbi kanjollin e luginës duke mbajtur vesh gurgullimën e ujrave. Duart e tij, si të komanduara prej një njeriu tjetër, e ngritën kurorën e barit lart dhe e hodhën në luginë...

Papritur dëgjoi rrokullimën e një guraleci diku maj-

tas dhe frymëmarrjen e thellë të një njeriu. Ai u mbështet në faqen e gurit përbri dhe zgjati paksa kokën. Shtatë-tetë metra më tej Ferdinandi me Agetinën po putheshin. Flokët e saj të zinj shndrisnin në diell, një dehje e lehtë i endej në fytyrë, ndërsa kqyrte me ca sy të pangopur dhe gjysëm të zalitur të dashurin e saj. Adriani pati përshtypjen se edhe ajo e shihte.

U mbështet përsëri pas gurit, futi kokën midis gju-njëve dhe qau.

Dhjetor 1987 — Janar 1989